Zbatimi i qasjes LEADER në shtetet e Ballkanit Perëndimor - “nga një iniciativë lokale në një koncept qendror në zonat rurale”

South Eastern Europe
SWG RRD
Regional Rural Development Standing Working Group

german cooperation
DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT

giz Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Grupi i përhershëm i punës për zhvillim rural në Europën Juglindore (SWG)
Bulevardi Goce Delçev 18, Ndërtesa e RTVM, Kati i 12, 1000 Shkup,
Maqedoni

Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH,
Zhvillimi rural përmes Menaxhimit të integruar të burimeve pyjore dhe të ujit në Evropën Juglindore (LEIWW)
Antonie Grubisic 5, 1000 Shkup,
Maqedoni

Analizat, konkluzionet dhe rekomandimet në këtë dokument paraqesin mendimin e autorëve dhe nuk janë domosdoshmërisht përfaqësues të pozitës së Grupit të përhershëm të punës për zhvillim rural rajonal në Europën Juglindore (SWG) dhe të Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH.

Redaktuar nga:
Zonja Natalija Bogdanov, Zonja Bogdanka Leveska Gjorshoska, Zonja Anica Palazzo, Z. Petar Gjorgievski dhe Z. Robert Lukesch

Publikuar nga:
Grupi i përhershëm i punës për zhvillim rural rajonal në Europën Juglindore (SWG)

Për këtë libër është në dispozicion një regjistër katalog CIP nga Biblioteka kombëtare dhe universitare “Shën Klementi i Ohrit” – Maqedoni

CIP – Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека “Св. Климент Охридски”, Скопје

332.1(497-15)

ZBATIMI i qasjes leader ne shtetet e Ballkanit Perendimor -”nga nje iniciative lokale ne nje koncept qendror ne zonat rurale” / [redaktuar nga Natalija Bogdanov ... и др.]. - Shkup : Grupi i përhershëm i punës për zhvillim rural në Europën Juglindore (SWG), 2018.
- 143 стр. : илустр. ; 30 см

ISBN 978-608-4760-25-2

а) Рурален развој - Западен Балкан
COBISS.MK-ID 108099338

TABELA E PËRMBAJTJEVE

Lista e shkurtimeve....06

Parathënia dhe mirënjohjet....08

PJESA A: PIKËPAMJET RAJONALE

Natalija Bogdanov, Petar Gjorgievski, Robert Lukesh....09

Kapitulli A.I

1. Hyrje....10
1.1 Qasja LEADER nga perspektiva evropiane: Nga LEADER në CLLD....10
1.2 Zbatimi i qasjes LEADER në kontekstin e bashkëpunimit rajonal në Ballkanin Perëndimor....14
1.3 Historiku i studimit....14
1.4 Qëllimet dhe qasja....15

Kapitulli A.II

2. Mjedisi LEADER në Ballkanin Perëndimor....16
2.1 LEADER në Dokumentet kombëtare strategjike dhe të programeve....16
2.2 Rregullimet institucionale dhe ligjore për mbështetjen e zbatimit të LEADER....16

Kapitulli A.III

3. Financimi....19

Kapitulli A.IV

4. Nismat e mëparshme dhe mësimet e nxjerra....21

Kapitulli A.V

5. Konkluzionet dhe rekomandimet....24
5.1 Konkluzionet....24
5.2 Rekomandimet....25

PJESA B: PIKËPAMJET E VENDIT/TERRITORIT....29

Kapitulli B.I

Vlerësimi i zbatimit të qasjes LEADER në vendet e Ballkanit Perëndimor - "nga një iniciativë lokale në një koncept qendror në zonat rurale" në Shqipëri,

EdvinZhllima....31

1. Hyrje....32
2. Mjedisi Leader në Republikën e Shqipërisë....32
2.1 Leader në dokumentet kombëtare strategjike dhe të programeve....32
2.2 Rregullimet institucionale dhe ligjore....33
2.3 Financimi....35
3. Nismat e mëparshme dhe mësimet e nxjerra....35
4. Konkluzionet dhe Rekomandimet....39

4.1 Konkluzionet.....39
4.2 Rekomandimet.....39
5. Shtojcat.....42
5.1 Shtojca 1: Referencat..... 42
5.2 Shtojca 2: Ligjet dhe rregullat.....43
5.3 Shtojca 3: Lista e kontakteve.....45

Kapitulli B.II
Vlerësimi i zbatimit të qasjes LEADER në vendet e Ballkanit Perëndimor - "nga një iniciativë lokale në një koncept qendror në zonat rurale" në Federatën e Bosnjës dhe Hercegovinës
Sabahudin Bajramovic.....47
1. Hyrje.....48
2. Mjedisi Leader në Republikën e Shqipërisë.....49
2.1 Leader në dokumentet kombëtare strategjike dhe të programeve.....49
2.2 Rregullimet institucionale dhe ligjore.....49
2.3 Financimi.....51
3. Nismat e mëparshme dhe mësimet e nxjerra.....52
4. Konkluzionet dhe Rekomandimet.....57
4.1 Konkluzionet.....57
4.2 Rekomandimet.....57
5. Shtojcat.....59
5.1 Shtojca 1 Referencat.....59
5.2 Shtojca 2 Lista e kontakteve 59

Kapitulli B.III
Vlerësimi i zbatimit të qasjes LEADER në vendet e Ballkanit Perëndimor - "nga një iniciativë lokale në një koncept qendror në zonat rurale" në Republikën Srpska, Bosnjë dhe Hercegovinë
Dragan Brkovic.....61
1. Hyrje.....62
2. Mjedisi Leader në Republikën Srpska, B dhe H.....62
2.1 Leader në dokumentet kombëtare strategjike dhe të programeve.....62
2.2 Rregullimet institucionale dhe ligjore.....63
2.3 Financimi.....64
3. Nismat e mëparshme dhe mësimet e nxjerra.....66
4. Konkluzionet dhe Rekomandimet.....70
4.1 Konkluzionet.....70
4.2 Rekomandimet.....70
5. Shtojcat.....72
5.1 Shtojca 1 Referencat.....72
5.2 Shtojca 2 Lista e kontakteve.....73
5.3 Shtojca 3 Sipërfaqja dhe popullsia e GLV-ve në Republikën Srpska 73

Kapitulli B.IV
Vlerësimi i zbatimit të qasjes LEADER në vendet e Ballkanit Perëndimor - "nga një iniciativë lokale në një koncept qendror në zonat rurale" në Kosovë*
Mihone Kerolli.....75
1. Hyrje.....76
2. Mjedisi Leader në Kosovë*.....77
2.1 Leader në dokumentet kombëtare strategjike dhe të programeve.....77
2.2 Rregullimet institucionale dhe ligjore.....77
2.3 Financimi.....79
3. Nismat e mëparshme dhe mësimet e nxjerra.....80
4. Konkluzionet dhe Rekomandimet.....83

4.1 Konkluzionet.....83
4.2 Rekomandimet.....84
5. Shtojcat.....85
5.1 Shtojca 1 Mbështetja financiare për GLV-të.....85
5.2 Shtojca 2 Buxheti indikativ (dëshmues) për masën 303.....85

Kapitulli B.V
Vlerësimi i zbatimit të qasjes LEADER në vendet e Ballkanit Perëndimor - "nga një iniciativë lokale në një koncept qendror në zonat rurale" në Maqedoni
Petar Gjorgievski.....87
1. Hyrje.....88
2. Mjedisi Leader në Republikën e Maqedonisë.....89
2.1 Leader në dokumentet kombëtare strategjike dhe të programeve.....89
2.2 Rregullimet institucionale dhe ligjore.....89
2.3 Financimi.....91
3. Nismat e mëparshme dhe mësimet e nxjerra.....91
4. Konkluzionet dhe Rekomandimet.....96
4.1 Konkluzionet.....96
4.2 Rekomandimet.....96
5. Shtojcat.....98
5.1 Shtojca 1 Literatura e përdorur, referencat dhe kontaktet.....98
5.2 Shtojca 2 Harta e GLV-ve.....99

Kapitulli B.VI
Vlerësimi i zbatimit të qasjes LEADER në vendet e Ballkanit Perëndimor - "nga një iniciativë lokale në një koncept qendror në zonat rurale" në Mal të Zi,
Ratko Batakovic.....101
1. Hyrje.....102
2. Mjedisi Leader në Mal të Zi.....103
2.1 Leader në dokumentet kombëtare strategjike dhe të programeve.....103
2.2 Rregullimet institucionale dhe ligjore.....103
2.3 Financimi.....105
3. Nismat e mëparshme dhe mësimet e nxjerra.....106
4. Konkluzionet dhe Rekomandimet.....108
4.1 Konkluzionet.....108
4.2 Rekomandimet.....109
5. Shtojcat.....111
5.1 Shtojca 1 Literatura e përdorur, referencat dhe kontaktet.....111

Kapitulli B.VII
Vlerësimi i zbatimit të qasjes LEADER në vendet e Ballkanit Perëndimor - "nga një iniciativë lokale në një koncept qendror në zonat rurale" në Serbi,
Natalija Bogdanov.....113
1. Hyrje.....114
2. Mjedisi Leader në Republikën e Serbisë.....115
2.1 Leader në dokumentet kombëtare strategjike dhe të programeve.....115
2.2 Rregullimet institucionale dhe ligjore.....116
2.3 Financimi.....118
3. Nismat e mëparshme dhe mësimet e nxjerra.....119
4. Konkluzionet dhe Rekomandimet.....122
4.1 Konkluzionet.....122

4.2 Rekomandimet.....123
5. Shtojcat.....125
5.1 Shtojca 1 Referencat.....125
5.2 Shtojca 2 Lista e dokumenteve të rishikuara politike dhe ligjore.....125

PJESA C: QASJA ZHVILLIMI I BAZUAR NË TERRITORE (ABD).....127

Kapitulli C.I
Zhvillimi i bazuar në territore (ABD) në rajonet ndërkufitare të Ballkanit Perëndimor
Damjan Surlevski, Irena Djimrevska, Boban Ilic, Katerina Spasovska.....129
1. Hyrje.....130
2. ABD në Ballkanin Perëndimor.....131
2.1 ABD në dokumentet strategjike dhe të programeve.....132
2.2 Rregullimet institucionale dhe ligjore.....134
2.3 Financimi.....134
3. ABD nismat dhe mësimet e nxjerra.....135
4. Konkluzionet dhe rekomandimet.....140
4.1 Konkluzionet.....140
4.2 Rekomandimet.....141
5. Shtojcat.....142
5.1 Shtojca 1 Literatura e përdorur, referencat dhe kontaktet.....142
5.2 Shtojca 2 Harta e rajoneve ndërkufitare ABD.....143

LISTA E SHKURTIMEVE

ALTER / TLAEZ	Territoret Lokale Aktive dhe Zhvillimi Ekonomik i Zonave Rurale
ABDA / QZHBT	Qasja e Zhvillimit me Bazë Territorin
ALCDF / FSHZKL	Fondacioni Shqiptar për Zhvillimin e Kapaciteteve Lokale
AP / KA	Krahina Autonome
BH	Bosnja dhe Hercegovina
BD / DB	Distrikti i Bërçkos
BRDN	RZHRB Rrjeti i Zhvillimit Rural Për Ballkanin
CAP / PPB	Politika e Përbashkët Bujqësore
CBC / BN	Bashkëpunimi ndërkufitar
CMP / PCM	Programi Civica Mobilitas
CLLD / ZHLUK	Zhvillimi lokal i udhëhequr nga komuniteti
CSO / OSHC	Organizatë e shoqërisë civile
DGAGRI / DP BZHR	Drejtoria e përgjithshme për bujqësinë dhe zhvillimin rural
DG NEAR / DP NFZ	Drejtoria e Përgjithshme për Negocim të Fqinjësisë dhe Zgjerimit (ish DG ELARG)
DAP	Drejtoria për pagesat bujqësore
DABD / DBDB	Departamenti i Bujqësisë i Distriktit Bërçko
EU / BE	Bashkimi Evropian
EC / KE	Komisioni Evropian
ESI / FSIE	Fondet Strukturore dhe Investuese Evropiane
EAFRD / FEBZHR	Fondi Evropian për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural
ELARD / SHELZHR	Shoqata Evropiane LEADER për Zhvillimin Rural
FBH	Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës
FMA WMF / MFB AUP	Ministria Federale e bujqësisë, administrimit të ujërave dhe pyjeve
GIZ	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (Korporata Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar)
HACCP / ARKPK	Analiza e Rrezikut dhe Kontrollit të Pikave Kritike
IPA / IAP	Instrumenti për Asistencë Para-anëtarësimi
IPA CBC / IAP BN	Instrumenti për Asistencë Para-anëtarësimi për bashkëpunim ndërkufitar
IPARD / IAPZHR	Instrumenti për Asistencë Para-anëtarësimi për zhvillimin rural
IPTS / ISAT	Instituti Për Studimet E Ardhshme Teknologjike (Pjesë e JRC)
IDM / IDN	Instituti Për Demokraci Dhe Ndërmjetësim
JRC / QPK	Qendra e Përbashkët Kërkimore
KAS / ASK	Agjencia e Statistikave Të Kosovës*
LEADER	"Liaison Entre Actions de Développement de l'Économie Rurale" që do të thotë 'Lidhjet Mes Veprimeve Të Zhvillimit Të Ekonomisë Rurale"
LDS / SZHL	Strategjia E Zhvillimit Lokal
LAG / GLV	Grupi Lokal i Veprimit
LARD / LBZHR	Ligji Për Bujqësinë Dhe Zhvillimin Rural
LGRD /GLZHR	Grupi Lokal Për Zhvillimin Rural
LEDA / VZHEL	Veprimi Për Zhvillimin Ekonomik Lokal
LEI / ILP	Iniciativa Lokale Për Punësim

LIARD / LNBZHR	Ligji për Nxitjen e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
LIS / ILS	Iniciativa e Projektit LEADER në Serbi
LSRD / SLZHR	Strategjia Lokale Për Zhvillimin Rural
MA / AM	Autoriteti menaxhues
MDG / OZHM	Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit
MPB / BPK	Bordi i Planifikimit të Komunës
MAASP / PMSHKBM	Programi për Mbështetjen e Shërbimeve Këshilluese në Bujqësi për Maqedoninë
MAFWE / MBPEU	Ministria e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave
MAFRD /MBPZHR	Ministria e bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural
MS / SHA	Shtetet anëtare
MoA / MB	Ministria e bujqësisë
MAEP /MBMM	Ministria e bujqësisë dhe mbrojtjes së mjedisit
MADA / AZHZM	Agjencia për zhvillimin e zonave malore
MAFWMRSB / MBPAU	RSB Ministria e Bujqësisë, pylltarisë dhe administrimit të ujërave e RSB
MIDAS	Projekti për zhvillim institucional dhe fuqizim bujqësor i Malit të Zi, zbatuar nga Ministria e bujqësisë dhe zhvillimit rural dhe financuar nga Banka Botërore (me hua nga IBRD dhe grant nga GEF).
MOFTER / MTJME	Ministria e tregtisë së jashtme dhe marrëdhënieve ekonomike
NARDS /SKBZHR	Strategjia kombëtare për bujqësinë dhe zhvillimin rural
NGO / OJF	Organizatë jofitimprurëse
NPA / PKB	Programi kombëtar për bujqësinë
NRDP / PKZHR	Programi kombëtar për zhvillimin rural
NLN / RRKL	Rrjeti kombëtar LEADER
ÖAR	Organizata Regionalberatung GmbH
OECD / OBZHE	Organizata për bashkëpunim dhe zhvillim ekonomik
OP / PO	Programi operativ
PMU / NMP	Njësia e menaxhimit të projektit
P2P / NPN	Njerëzit për njerëzit (People to people)
PPP	Partneriteti publik privat
PLAG /GPLV	Grupi potencial lokal i veprimit
PA / AP	Agjencitë e pagesave
PREPARE / PER	Partneriteti për Evropë rurale
NRD of RM /RRZHR i RM	Rrjeti për zhvillimin rural i Republikës së Maqedonisë
RM	Republika e Maqedonisë
RS /RSB	Republika Serbe e Bosnjës
RDP / PZHR	Programi i zhvillimit rural
RDA / AZHR	Agjencia e zhvillimit rural / Agjencia e zhvillimit rajonal
SARD / SBZHL	Strategjia për bujqësinë dhe zhvillimin rural
SLED / SZHEL	Strategjia për zhvillim ekonomik lokal
SIDA / ASZHN	Agjencia suedeze për zhvillim ndërkombëtar
SBEP / PZBV	Projekti për zgjerimin e bizneseve të vogla
SWG / GPP	Grupi i përhershëm i punës për zhvillimin rural rajonal në Evropën Juglindore
SEE / SEJL	Strategjia për Evropën Juglindore
SHG / GPI	Grupi i palëve të interesuara USAID / ASHBZHN Agjencia e Shteteve të bashkuara për zhvillim ndërkombëtar
UNDP / PZHKB	Programi për zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UN FAO / OKBUB	Organizata e Kombeve të Bashkuara Për Ushqimin dhe Bujqësinë
WB / BP	Ballkani Perëndimor

PARATHËNIA
DHE MIRËNJOHJET

Qasja LEADER[1] përfshin tre lloje të zhvillimit rural lokal, atë që si bazë ka territorin, nga poshtë-lart dhe atë shumë sektorial. Qasja bazohet në partneritetet autonome publik-private në nivelin lokal për hartimin dhe zbatimin e strategjive të tyre të veçanta të zhvillimit . Parimet udhëzuese të Qasjes LEADER dëshmojnë të jenë faktorë suksesi për zhvillimin e vetë-përcaktuar lokal/rural të udhëhequr nga komuniteti, jo vetëm në Bashkimin Evropian por edhe më gjerë.

Vendet e Evropës Juglindore e kuptuan rëndësinë e qasjes LEADER në zbërthimin e potencialit të rajoneve rurale dhe aktualisht janë në faza të ndryshme të procesit të përgatitjes për zbatimin e tij.

Të vendosur për të forcuar integrimin e nismave lokale dhe ngritjen e kapaciteteve rurale në politik-bërjen qendrore në pajtim me BE, në veçanti përmes qasjeve nga poshtë-lartë ndaj zhvillimit lokal siç është LEADER dhe Zhvillimit lokal i udhëhequr nga komuniteti (CLLD), the Grupi i përhershëm i punës për zhvillim rural rajonal në Evropën Juglindore (SWG), së bashku me Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH iniciuan këtë vlerësim rajonal për të vlerësuar gjendjen aktuale të qasjeve të ngjashme me LEADER në Evropën Juglindore me qëllim që shteteve, rajonit dhe partnerëve për zhvillim ndërkombëtar, t'u ofrojë rekomandime për politika të bazuara në prova. Vlerësimi rajonal është udhëhequr në kuadër të projektit të SWG-GIZ "Zhvillimi rural nëpërmjet menaxhimit të integruar të burimeve pyjore dhe të ujit në Evropën Juglindore" (LEIWW) në emër të Korporatës Gjermane.

Qëllimi është zhvillimi i një qasjeje rajonale për zhvillimin socio-ekonomik të zonave rurale, të nxiten qasjet e decentralizuara ndaj politikës rurale dhe të ofrohen rekomandime për politikat në integrimin e LEADER me politikat për zhvillim rural në Evropën Juglindore.

Me këtë rast, SWG dhe GIZ dëshirojnë të shprehin mirënjohjen e tyre për Ministritë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të rajonit të Europës Juglindore, si dhe për të gjithë ekspertët pjesëmarrës dhe për organizatën ÖAR Regionalberatung GmbH për përkushtimin dhe kontributin e tyre aktiv për këtë proces. Dëshirojmë të shprehim mirënjohjen tonë për Menaxherin e Projektit të SWG, znj. Bogdanka Leveska Gjorshoska dhe Këshilltarin e GIZ, znj. Anica Palazzo për rolin e tyre kordinues në këtë proces, si dhe për z. Oliver Pop Arsov për asistencën e tij teknike.

Në emër të Sekretariatit të SWG

Z. Boban Iliç
Sekretar i përgjithshëm

Në emër të GIZ LEIWW

Z. Benjamin Mohr
Lideri i ekipit

[1] *Shkurtimi "LEADER" buron nga fjalët frënge "Liaisons Entre Actions de Développement de l'Économique Rurale" që do të thotë, 'Lidhjet mes Veprimeve të Zhvillimit të Ekonomisë Rurale'.*

PJESA A:
PIKËPAMJET RAJONALE

Vlerësimi rajonal i zbatimit të Qasjes LEADER në vendet/territoret e Ballkanit Perëndimor

KAPITULLI A. I

1. HYRJE

1.1. Qasja LEADER nga perspektiva evropiane: Nga LEADER në CLLD

Sfondi historik

Zhvillimi lokal në Evropë ka kaluar nëpër faza të ndryshme. Në vitet '80 ishte një dukuri spontane e cila kryesisht u ngrit si përgjigje ndaj një krize ekonomike e cila kishte vënë në lëvizje (qasje, përgjigje, zgjidhje) të reja, siç janë dhe 'iniciativat lokale për punësim' (LEI). Ky fenomen u identifikua dhe analizua nga Programi LEED[2] i OECD dhe u kultivua përgjatë viteve nga ana e veprimtarive kërkimore dhe aktiviteteve të rrjeteve të Programit LEDA[3] të Komisionit Evropian. LEDA gjeti veçoritë kryesore të qasjeve për zhvillimin lokal "nga poshtë-lart", gjithashtu triptikun e 'partneritetit lokal', 'rajonit lokal' dhe 'strategjisë së zhvillimit lokal', duke ofruar një model të përgjithshëm të zhvillimit me bazë territorin nga partneritetet vendore me një mori objektivash të tjera për zhvillimin social-ekonomik.

E gjithë kjo u zhvillua në sfondin e industrializimit të përshpejtuar dhe ndryshimit strukturor në zonat rurale, veçanërisht në Francë, Itali dhe në shtetet e reja jugore të anëtarësuara në BE (Greqia: 1981, Spanja dhe Portugalia: 1986). Zhvillimi rural, siç perceptohet aktualisht, nuk ishte pjesë e Politikës së hershme Bujqësore Evropiane dhe deri në vitet e vonshme të 1960-ës kur ajo filloi të shfaqet si një çështje politike[4] si pjesë e të ashtuquajturit Plani Mansholt. Dobësimi i perceptuar i zonave rurale krijoi një qasje të re politike, e cila e vuri në qendër të vëmendjes rolin e veçantë të zonave rurale. Ky ndryshim i politikave u shënua nga Komunikimi i Komisionit Evropian 'E ardhmja e shoqërisë rurale[5]' në vitin 1988, dhe nga mbështetja e synuar për zhvillim rural nga Fondet Strukturore[6] duke filluar nga viti 1989 e tutje, nën presidencën e Jaques Delors[7] dhe Komisionari për Bujqësi Ray McSharry, të dy me një qëndrim të fortë mbi zhvillimin lokal. Më pas, botimi i parë i LEADER doli në vitin 1991, i hartuar kryesisht nga një zyrtar i Komisionit Evropian me emrin Michel Laine i cili më parë kishte punuar në iniciativat lokale për punësim (LEI) në vendet e Mesdheut.

Nisma e komunitetit LEADER I (1991-1993)

Meqë Politika rurale u bë një fushë legjitime e politikës së BE-së në të drejtën e saj që nga viti 1989, të gjithë Komisionarët për Bujqësinë të BE-së zyrtarisht janë pajisur me përgjegjësinë për 'zhvillim rural' si dhe për 'bujqësi'. Politika e strukturave bujqësore të Bashkimit Evropian kaloi nga rritja e produktivitetit drejt përmirësimit të cilësisë së prodhimit bujqësor dhe krijimit të tregjeve të reja për prodhimet bujqësore.

Nisma e komunitetit LEADER I mund të shikohet si një rezultat i një shkrirjeje midis kësaj perspektive

[2] *Ekonomia lokale dhe punësimi, një fokus i vazhdueshëm i OECD që nga viti 1982. http://www.oecd.org/employment/leed/*

[3] *Veprimi e zhvillimit lokal për punësim, zbatuar në 45 zona vendore midis vitit 1986 dhe 1996.*

[4] *Plani Mansholt kërkonte të zvogëlojë numrin e fermave të vogla në Evropë dhe ekzistonte vlerësimi se masat e zhvillimit rural ishin të nevojshme për të adresuar çështjet e reduktimit të numrit të fermave dhe në të njëjtën kohë perpjekjen për të ruajtur një ekonomi të gjallë rurale.*

[5] *https://ec.europa.eu/agriculture/sites/agriculture/files/cap-history/crisis-years-1980s/com88-501_en.pdf*

[6] *Meqë zonat rurale të prapambetura u shënuan si „Objektivi 5b" zonat përfituan nga një version i hershëm i qasjes me shumë fonde.*

[7] *Adresë e dhënë nga Jaques Delors në Bruges, 17 tetor 1989: https://ldnet.eu/wp-content/uploads/bsk-pdf-manager/CLLD_Challenges-and-Opportunities_RSA_blog_08.03.2017_22.pdf*

të re të politikës rurale dhe pasurisë së përvojave të fituara nga nismat e zhvillimit lokal. Ajo mbështetej në tre parime elementare:

- Hartimi dhe zbatimi i një 'plani lokal për veprim' në zonat rurale me popullsi midis 5,000 dhe 100,000 banorë. Ky plan kishte të bënte me përcaktimin e një numri të kufizuar të akseve për zhvillim strategjik dhe masave përkatëse, të cilat duhej të vihen në veprim brenda një periudhe trevjeçare (1991-1993).
- Plani për veprim lokal duhej të ishte hartuar dhe zbatuar nga një partneritet vendor si përfitues përfundimtar i kësaj iniciative.
- Ndërlidhja shumë-sektoriale dhe sistematike e veprimeve zhvillimore duhej të përfshihej në një vizion dhe strategji të përgjithshme[8].

LEADER I, filloi si një nisëm pilot e komunitetit (1991-1993) prej Komisionit Evropian (KE) duke bërë thirrje për Partneritetet lokale[9] (Grupet lokale të veprimit / GLV) nga zonat rurale të pa favorizuara në BE12 për të dorëzuar plane lokale të veprimit për financim nëpërmjet grandeve globale të integruara. Nga të gjithë Partneritetet lokale që iu përgjigjën thirrjes, si përfitues u përzgjodhën 217 GLV.

Ekipi i vlerësimit "ex post" të LEADER I, në bashkëpunim me Observatorin e LEADER II[10] hodhi koncept themelet e asaj që sot quhet Qasje 'CLLD[11]/LEADER' ose 'metodë', e përcaktuar si zbatim i kombinuar i shtatë parimeve operative ose karakteristikave kryesore.[12]

Iniciativa e komunitetit LEADER II (1994-1999)

Shumë shpejt LEADER I, kishte fituar reputacionin si një instrument novator për mobilizimin e potencialit endogjen të zonave të marxhinalizuara rurale. Prandaj, në vitin 1994, Komisioni Evropian vendosi ta vazhdojë atë si një qasje të decentralizuar në Partneritet me Shtetet Anëtare. Më pas, LEADER II u zbatua përmes 102 Programeve operacionale kombëtare/rajonale (OP) në BE-15.

Faza e dytë e LEADER prezantoi katër elemente të tjera:

- iniciativa u fut në logjikën e programimit të Fondeve Strukturore Evropiane;
- përgjegjësia e programit u besua ose në nivel kombëtar ose në atë rajonal - sipas vendimit të Shteteve Anëtare;
- Observatori LEADER II u krijua si pikë nisje e rrjetëzimit dhe ngritjes së kapaciteteve anembanë Evropës;
- Bashkëpunimi ndërkombëtar u përfshi si një komponent i rregullt i programit.

LEADER+ (2000-2006) dhe masat e llojit LEADER në Shtetet e reja anëtare (MS) (2004-2006)

Në fazën e tretë, u hartua iniciativa e komunitetit LEADER+ për të inkurajuar zbatimin e strategjive të integruara, me cilësi të lartë dhe origjinale për zhvillim të qëndrueshëm. Ajo fokusohej shumë në

[8] *Që këtu akronimi: LEADER = Liaison Entre Actions du Développement de l'Économie Rural/ 'lidhje mes veprimeve të zhvillimit të ekonomisë rurale'*

[9] *Përbërja e tyre nuk ishte saktësuar në atë kohë.*

[10] *Nëpër të gjithë periudhat, ka pasur një agjenci/observator/pikë kontakti/ e financuar në nivel evropian për t'u ofruar mbështetje grupeve lokale të veprimit si dhe rrjeteve kombëtare dhe rajonale në zbatimin e programit LEADER.*

[11] *Zhvillimi lokal i udhëhequr nga komuniteti.*

[12] *Qasja me bazë territorin; nga poshtë-lart; partneriteti vendor; qasja shumë-sektoriale; inovacioni; rrjetëzimi; bashkëpunimi. Shiko pasqyrën e fakteve të KE: http://enrd.ec.europa.eu/enrd-static/fms/pdf/2B953E0A-9045-2198-8B09-ED2F3D2CCED3.pdf. Duhet të thuhet se emërtimi i shtatë parimeve ka ndryshuar, por jo në thelb. Po ashtu shiko udhëzimet e vlerësimit LEADER të Asistencës (Helpdesk) së Vlerësimit Europian (2017): file:///C:/Users/user/Downloads/twg-03-leader_clld-aug2017%20(2).pdf.*

partneritetet dhe rrjetet që promovojnë shkëmbim përvojash. Siç dhe emri e nënkupton, LEADER+ përfshiu përmirësime të mëtejshme, respektivisht veçoritë e mëposhtme:

- parimi metodologjik i "inovacionit" u kombinua me parimin rregullator të "qëndrueshmërisë" që synon të inkurajojë "pilot" strategji më ambicioze për zhvillim të integruar rural;
- të gjithë zonat rurale brenda BE-së në parim u bënë të përshtatshme për LEADER+;
- u përcaktuan tema me interes të veçantë në nivel evropian, rreth të cilave Grupet lokale të veprimit duhet t'i fokusojnë strategjitë e tyre për zhvillim;
- pjesëmarrja e aktorëve publikë në organet vendimmarrëse u kufizua në 50%;
- u vu një theks më i madh mbi bashkëpunimin midis zonave rurale - duke përfshirë mundësinë për të mbështetur projekte të përbashkëta të zhvillimit rural midis GLV-ve LEADER dhe strukturave të ngjashme brenda të njëjtit Shtet Anëtar;

LEADER+ vazhdoi të luante rolin e saj si një laborator i cili synon të inkurajojë shfaqjen dhe testimin e qasjeve të reja drejt zhvillimit të integruar dhe të qëndrueshëm dhe të plotësojë programe të tjera për zhvillim rural duke i inkurajuar komunitetet rurale për të hartuar dhe zbatuar strategji të zhvillimit, të integruara dhe novatore.

Organizimi i masave të tipit LEADER+ në shtetet anëtare të cilat iu bashkuan BE-së gjatë kësaj periudhe, ndoqën të njëjtën qasje si të BE-15, megjithëse më shumë theks iu dha ndërtimit të kapaciteteve bazë dhe zbatimit të pilot strategjive.

LEADER si aksi i katërt (horizontal) i PZhR-ve (2007-2013)

Politika e zhvillimit rural për periudhën 2007-2013 u përqendrua në tre tema (po ashtu të njohura si "akset tematike"):

- Përmirësimi i konkurrueshmërisë së sektorit të bujqësisë dhe pyjeve;
- Përmirësimi i mjedisit dhe zonave rurale;
- Përmirësimi i cilësisë së jetesës në zonat rurale dhe inkurajimi i diversifikimit të ekonomisë rurale.

Me përfshirjen e LEADER në programet për zhvillim rural (EU-25+2), LEADER u themelua si boshti i katërt, i ndërthurur me tre akset tjera dhe me financim prej së paku 5% të buxhetit total. Për Shtetet anëtare të cilat iu bashkuan BE-së në vitin 2004 (EU-10), u caktua një prag prej 2.5%, kryesisht për masat përgatitore dhe për ngritjen e kapaciteteve.

CLLD/LEADER (2014-2020)

Në periudhën aktuale, metoda LEADER është e zbatueshme për të gjitha Fondet Evropiane Strukturore dhe të Investimeve (Fondet ESI) nën emrin Zhvillimi lokal i udhëhequr nga komuniteti (CLLD). CLLD vazhdon të funksionojë nën emrin 'LEADER' në EAFRD (Masa 19 nën Zonën Fokus 6b), duke qenë i detyrueshëm në të gjithë 118 programet për zhvillim rural (EU-28) me një fond minimal prej 5% të buxhetit të PZHR (2,5% për Bullgarinë dhe Rumaninë të cilët iu bashkuan BE-së në vitin 2007, dhe marrëveshjet specifike për Kroacinë pas anëtarësimit në 2014).

Tabela A. I. 1: Evolucioni i LEADER

Kreu	Periudha	Lloji i programit	Nr. i GLV	Buxheti total publik (BE+ kombëtar)	Nr. i shteteve anëtare
LEADER 1	1991-1993	Nisma e komunitetit	217 GLV në zonat e prapambetura rurale	1,2 miliardë EUR	BE-12
LEADER 2	1994-1999	Nismë e komunitetit e zbatuar nëpërmjet 102 Programeve operacionale kombëtare/ rajonale	906 GLV në zonat e prapambetura rurale	5,4 miliardë EUR	BE-15
LEADER+	2000-2006	Nismë e komunitetit, e zbatuar	1153 GLV në të gjithë zonat rurale	5,1 miliardë EUR	BE-15+10
Aksi LEADER	2007-2013	Masa e detyrueshme e PZhR/Aksi 4 (5%, përkatësisht 2,5% për shtetet e reja anëtare)	2402 GLV në të gjithë zonat rurale	8,9 miliardë EUR	BE-25+2
CLLD/LEADER	2014-2020	Masa e detyrueshme 19 e RDP (5%)	2536 GLV të financuara nga EAFRD (me ose pa bashkë-financim nga ERDF dhe ESF) dhe 352 GLV të financuara nga EMFF[13]	9,8 miliardë EUR	BE-27+1

Përtej 2020: Detyrat në të ardhmen[14]

Ekziston unanimitet në mesin e ekspertëve dhe politikë-bërësve lidhur me atë që LEADER është, përgjithësisht, një histori suksesi. Është e jashtëzakonshme që kjo qasje është po aq e rrënjosur në nivelin lokal ashtu siç është në shkallë evropiane, për sa u përket rrjeteve, institucioneve dhe asaj që mund të konsiderohet si një kulturë e politikë-bërjes. Sidoqoftë, gjithashtu duhet të përmendet se pas pothuajse 30 vitesh ide dhe praktika lokale për zhvillim në Evropë, zhvillimi lokal ka humbur një pjesë të gjallërisë së tij duke u bërë ose 'pjesë e orendive', p.sh. në zhvillimin rural dhe LEADER, ose është lënë në harresë në fusha të tjera.

Lidhur me debatin e formimit të zhvillimit lokal pas vitit 2020, lind pyetja nëse CLLD po shkon drejt shndërrimit në një mjet të zakonshëm për kohezion dhe politika respektive në të gjitha llojet e zonave (urbane, rurale); zona të cilat janë të ndryshme e në vazhdim do bëhen edhe më shumë të ndryshme . Të gjitha nivelet - BE, kombëtar, nën-kombëtar - duken të shqetësuar me çështjet e qeverisjes: në menaxhimin e programeve dhe 'si të shpenzojnë paratë'. Ekziston rreziku që grupet lokale të veprimit mund të përfundojnë duke përsëritur qasjet burokratike të autoriteteve shtetërore (që merren me administrimin e thirrjeve për projekte të përgatitura nga konsulentët dhe dokumentacionin për pagesa dhe kontrolle), me vetëm një rimeso/lustër të hollë të 'strategjisë lokale' që pretendon të mbajë bashkë projektet e përzgjedhura në një qasje të integruar. Në këtë

[13] *Ky numër nuk është përfundimtar. Reflekton situatën në fund të vitit 2016..*

[14] *Shih H. Martinos (2017): Zhvillim lokal i udhëhequr nga komuniteti: sfidat dhe mundësitë. https://ldnet.eu/wp-content/uploads/bsk-pdf-manager/CLLD_Challenges-and-Opportunities_RSA_blog_08.03.2017_22.pdf*

mjedis mund të neglizhohen aspektet e gjera të qeverisjes, si p.sh. puna në partneritet dhe lidhjet me zhvillimin e komunitetit. Kështu, debati për formimin e CLLD pas 2020-ës është gjithashtu një debat rreth asaj se si të ringjallet kjo qasje dhe të shndërrohet në një mjet të fuqishëm për zhvillimin lokal i cili po përballet me sfidat e shekullit 21. Në këtë proçes rigjallërimi, fillimi i zbatimit të qasjes LEADER për herë të parë nga vendet e Evropës Juglindore me mënyrat e tyre të veçanta, nuk do të jetë vetëm në stadin e fundëm pranimit, por edhe ate vijues të dhënies, pasi inovacioni shpesh frymëzohet dhe nxitet nga të porsaardhurit.

1.2 Zbatimi i qasjes LEADER në kontekstin e bashkëpunimit rajonal në Ballkanin Perëndimor

Grupi i përhershëm i punës për zhvillimin rural në Evropën Juglindore (SWG), përmes misionit të tij i mbështet qeveritë e vendeve/territoreve të BP për të rritur bashkëpunimin dhe për të koordinuar iniciativat rajonale që lidhen me bujqësinë dhe zhvillimin socio-ekonomik. Duke marrë parasysh këtë bazë, SWG vendosi të vlerësojë dhe në të njëjtën kohë të promovojë rëndësinë e LEADER si një model për zhvillimin rural që duhet të prezantohet sa më shpejt në rajon. Që këtej, SWG mbështeti zhvillimin e një studimi me titull **"Vlerësimi i zbatimit të qasjes LEADER në shtetet/territoret e Ballkanit Perëndimor - "Nga një iniciativë lokale në një koncept qendror në zonat rurale"** me qëllim që të përmirësojë kuptimin e qasjes LEADER dhe të kontribuojë në zbatimin e saj efektiv.

Në vazhdim të qasjes LEADER, Qasja e zhvillimit me bazë territorin (ABDA) shërben si një mjet rajonal duke synuar zonat e përcaktuara gjeografike në rajonet ndërkufitare të cilat karakterizohen nga një sërë problemesh të përbashkëta dhe komplekse zhvillimi. Kjo është një qasje lokale rajonale e cila lehtëson rritjen e qëndrueshme në zonat e vogla rurale dhe me kohezion social në rënie, shpesh të karakterizuara nga një traditë dhe identitet të përbashkët. ABDA mbështet zhvillimin nga poshtë-lart të strategjive të zhvillimit vendor me bazë territorin, të cilat mbështesin aktorët lokalë për pjesëmarrje në vendimmarrje dhe në përzgjedhjen e prioriteteve që duhet të ndjekin në komunitetet e tyre lokale. Me anë të grupeve të interesit (SHG), që veprojnë si GLV, ABD mbështet ngritjen e partneriteteve vendore, integrimin dhe veprimet shumë-sektoriale, stimulon inovacionin (duke prezantuar produkte/procese/tregje të reja) dhe gjetjen e zgjidhjeve për problemet e vazhdueshme rurale. Qasja kryesisht lehtëson masat për rrjetëzim dhe bashkëpunim midis grupeve të interesit, zonave rurale, administratave dhe organizatave të përfshira në zhvillimin rural për shkëmbimin e arritjeve, përvojave dhe njohurive. Një bashkëpunim i tillë mund të ndihmojë komunitetet vendore që të rrisin aktivitetet e tyre dhe t'u lejojnë atyre të zgjidhin probleme të caktuara ose t'u shtojnë vlerë resurseve lokale.

1.3 Sfondi i studimit

Një nga sfidat kryesore të shteteve/territoreve të Ballkanit Perëndimor (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova*[15], Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia) është proçesi i anëtarësimit në BE që është në faza të ndryshme. Megjithatë, të gjitha shtetet/territoret janë të zotuara për reforma në sistemet e tyre qeveritare dhe sistemet tjera për t'u harmonizuar me standardet dhe politikat e Bashkimit Evropian. Bashkimi Evropian ofron mbështetje nëpërmjet Instrumentit për Asistencë Para-anëtarësimi (IPA), duke përfshirë masat që lidhen me reformat në shumë fusha të politikës publike dhe të administratës. Instrumenti më i rëndësishëm për proçesin e zhvillimit rural është IPARD që po zbatohet në mënyrë progresive në shtetet/territoret e Ballkanit Perëndimor. Përveç mbështetjes së BE-së përmes IPARD, shumica e shteteve/territoreve kanë programet e tyre kombëtare për bujqësi dhe zhvillim rural, të financuara nga qeveria dhe nën mbikëqyrjen e ministrive të tyre përkatëse. Këto programe kombëtare menaxhohen drejtpërsëdrejti nga qeveritë kombëtare, duke u siguruar mbështetje direkte prodhuesve dhe duke mbështetur projekte të vogla të fermave të vogla dhe të mesme dhe të bizneseve të vogla.

[15] ** Ky përcaktim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve mbi statusin dhe është në përputhje me UNSCR 1244 dhe opinionin e ICJ-së për shpalljen e pavarësisë së Kosovës*.*

Zhvillimi i ekonomive të mëdha rurale është një nga sfidat kryesore të shteteve/territoreve të Ballkanit Perëndimor (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova*, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia) në përgatitjen e komuniteteve rurale për të formuar të ardhmen e tyre. Fuqizimi i popullsisë rurale për pjesëmarrje në hartimin e politikave dhe projekteve për zhvillim rural përmes Grupeve lokale të veprimit si pjesë e Qasjes LEADER është thelbësor për integrimin e sektorëve të ndryshëm dhe palëve të interesuara, pa të cilat nuk mund të arrihet një rritje e qëndrueshme afatgjatë në zonat rurale.

Kjo qasje ka tërhequr tashmë interesin e aktorëve lokal në proçesin e krijimit të një partneriteti lokal midis sektorit publik, privat dhe atij civil, por edhe interesin e qeverive, meqë LEADER është pjesë integrale e IPARD-it në Ballkanin Perëndimor. Në shumicën e shteteve/territoreve të BP ekzistojnë iniciativa të Grupeve lokale të veprimit të cilat janë aktive ose synojnë të veprojnë si partneritete të tipit LEADER.

1.4 Qëllimet dhe qasja

Duke vërejtur mungesën e studimeve sistematike që vlerësojnë progresin e arritur nga shtetet/territoret e Ballkanit Perëndimor, në përshtatjen e politikave të tyre për zhvillim rural me CAP, si dhe informacionin bazë të kufizuar që është në dispozicion për masat specifike (duke përfshirë LEADER), qasja metodologjike e këtij studimi u hartua për të përmbushur objektivat në vijim:

- *Gjetja e fakteve mbi gjendjen aktuale të iniciativave të ngjashme me LEADER në shtetet/territoret e BP*

Për të kryer grumbullimin e të dhënave ekzistuese dhe informacionit mbi iniciativat LEADER në shtetet/territoret e projektit është shfrytëzuar hulumtimi i dokumentacionit. Është bërë një analizë e përmbajtjes (content analysis) për të ekzaminuar se si LEADER dhe/ose aspekte të caktuara të tij (GLV-të, rrjetet sociale, partneritetet lokale, zhvillimi territorial, etj.) trajtohen nga dokumentet strategjike, programuese dhe rregullatore kombëtare. Për të siguruar një pasqyrë të përgjithshme në kornizën politik dhe legjislativ në lidhje me iniciativën LEADER, hulumtimi të dokumentacionit përfshinte vlerësimin e dokumenteve përkatëse të politikave të të gjitha ministrive përgjegjëse për/në trajtimin e çështjeve të caktuara.

Përveç studimit të dokumenteve politike dhe legjislative, janë shqyrtuar të gjitha informacionet përkatëse dhe të dhënat për LEADER që janë grumbulluar ose regjistruar (studimet, raportet, studimet, faqet e internetit të institucioneve kombëtare, lokale dhe rajonale, projektet e donatorëve, OShC-të, etj.).

- *Të kuptuarit e situatës dhe identifikimi i sfidave dhe nevojave specifike kombëtare*

U realizuan intervista me persona të identifikuar të burimeve, me qëllim marrjen e të dhënave primare dhe për të siguruar që janë shfrytëzuar të gjithë informatat përkatëse. Intervistat u realizuan duke përdorur një udhëzues gjysmë të strukturuar (anketim), ku pjesëmarrësit u inkurajuan të diskutojnë të gjitha çështjet që i konsiderojnë si të rëndësishme lidhur me LEADER. Të itervistuarit u përzgjodhën sipas përgjegjësisë dhe pozitës së tyre, nivelit të njohurive ose përvojës praktike nga terreni, ndikimit dhe rolit udhëheqës, kontrollit mbi informacionin (përfaqësuesit e MB-së ose organeve të tjera përkatëse qeveritare, përfaqësuesit e partneriteteve të ngjashme me GLV-të dhe praktikues të tjerë).

- *Ilustrimi në realitet i qasjes LEADER me një shembull dhe në një kornizë të qëndrueshëm*

Rastet studimore u përdorën për të ilustruar shumëllojshmërinë e institucioneve, qasjet e politikave, llojet e partneriteteve dhe praktikat që lidhen me LEADER në shtetet/territoret e BP, si dhe përvojat e fituara nga politikë-bërësit, ekspertët dhe palët e interesuara. Për të siguruar një mostër të ekuilibruar të rasteve studimore, temat nuk ishin të paracaktuara, por u identifikuan nga ana e ekspertëve kombëtarë, duke u lejuar atyre të shqyrtojnë lloje të ndryshme praktikash.

KAPITULLI A. II

2. MJEDISI LEADER NË BALLKANIN PERËNDIMOR

2.1. Leader në dokumentet kombëtare strategjike dhe të programeve

Hierarkia e dokumenteve strategjike që drejtojnë zbatimin e programit LEADER në shtetet/territoret e Ballkanit Perëndimor përfshin: 1) strategjitë për bujqësinë dhe zhvillim rural, 2) programet afatmesme, 3) programet IPARD II dhe 4) dokumentet strategjike dhe/ose të programeve të ministrive tjera ose organeve qeveritare, shumica e të cilave janë përgjegjëse për zhvillimin rajonal, vetëqeverisjen lokale dhe shoqërinë civile.

Tashmë është përmendur në raportet paraprake për politikat bujqësore në vendet/territoret e Ballkanit Perëndimor (Volk et al., 2016, 2017), që të gjithë kanë bërë përparim të konsiderueshëm në përafrimin e dokumenteve të tyre afatgjate strategjike dhe strukturave administrative me kërkesat e BE. Shumica e këtyre shteteve/territoreve po ashtu kanë hartuar dokumente shumëvjeçare të programimit, si dhe programe të Instrumentit për Asistencë Para-Anëtarësimi për zhvillimin rural (IPARD). Dokumentet strategjike janë plotësisht të harmonizuara në mënyrë që të shmangen mospërputhjet dhe mbivendosjet ndërmjet instrumenteve të ndryshme politike.

Sipas informacioneve të siguruara nga ekspertët kombëtarë, të gjithë dokumentet e zhvilluara rishtazi të cilat bëjnë rregullimin e PZHR në shtetet/territoret e BP e njohin rëndësinë e LEADER dhe parashikojnë masa dhe aktivitete për të përmirësuar zbatimin e saj.

2.2. Rregullimet institucionale dhe ligjore për mbështetjen e zbatimit të LEADER

Autoritetet kryesore të cilat merren me PZHR, dhe së këndejmi me aktivitetet e ngjashme me LEADER në BP, janë ministritë e bujqësisë (MB) me njësitë e tyre organizative - 1) departamenti përgjegjës për programim (respektivisht, duke ushtruar detyrën e autoriteteve drejtuese) dhe 2) agjencitë e pagesave si organe ekzekutive përgjegjëse për menaxhimin financiar të PZHR-ve. Përveç MB-ve, në disa vende ekzistojnë entitete tjera në nivel rajonal me mandat për të menaxhuar aktivitete të caktuara që kanë të bëjnë me LEADER:

- Në Shqipëri dhe Serbi ekzistojnë Agjencitë për zhvillimin rajonal (RDA) që drejtojnë aktivitetet e rrjetëzimit midis palëve të interesuara lokale dhe rajonale, duke patur gjithashtu të drejtën për të përpunuar dhe zbatuar strategjitë për zhvillim lokal në rajonet përkatëse.
- Në Bosnjë dhe Hercegovinë, përgjegjësia kryesore për zbatimin e aktiviteteve të ngjashme me LEADER qëndron në ministritë e kantoneve (divizionet).
- Në Serbi, Sekretariati krahinor i bujqësisë i Krahinës Autonome të Vojvodinës është përgjegjës për planifikimin e masave për mbështetje, si dhe për kordinimin e punës së GLV-ve në territorin e saj.

Bazuar në informacionet e grumbulluara nga ekspertët kombëtarë, shumica e organizatave që aktualisht janë duke vepruar si partneritete të ngjashme me GLV, janë themeluar në suaza të projekteve të donatorëve. Si rezultat i aktiviteteve të donatorëve, resurse të konsiderueshme njerëzore janë trajnuar dhe janë bërë të vetëdijshëm për LEADER, janë hartuar dokumente rregullatorë dhe janë realizuar aktivitete pilot për krijimin e partneriteteve të ngjashme me GLV, përgatitjen e strategjive lokale, etj. Megjithatë, numri, kapacitetet, strukturat dhe aktivitetet e këtyre organizatave ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme, varësisht nga konteksti i vendit:

- Shqipëri - u formuan katër partneritete të ngjashme me GLV në kuadër të projekteve donatore (Oxfam dhe ANTARC & ALCDF) - GLV Adrijon-Vlorë, GLV Maranaj-Shkodër, GLV Drini-Dibër, GLV Deshati; për partneritetet e ngjashme me GLV u vërejt vështirësia për tú mbajtur me nën-financim dhe të mbivendosen gjeografikisht me njëri-tjetrin.
- Federata e Bosnjë dhe Hercegovinës - u themeluan tre partneritete të ngjashme me GLV me mbështetjen e një projekti të UNDP: GLV Una-Sana, GLV Rajoni Doboj dhe GLV Drina.
- Republika Serbe e Bosnjes - Partneritetet e ngjashme me GLV: GLV Devetak, GLV Savus dhe GLV Rajoni Doboj, të gjithë anëtarët e Rrjetit për zhvillim rural në Bosnjë dhe Hercegovinë, i cili është pjesë e Rrjetit Ballkanik për zhvillim rural (BRDN), Partneritetit për Evropë rurale (PREPARE) dhe Shoqata evropiane LEADER për zhvillimin rural (ELARD).
- Kosovë* – 30 partneritete të ngjashme me GLV janë themeluar në mënyrë formale (gati se në çdo komunë); më pak se gjysma prej tyre në mënyrë aktive promovojnë dhe zbatojnë projekte në territorin e tyre, ndërsa pjesa e mbetur janë më pak aktive.
- Maqedoni - janë themeluar 16 partneritete të ngjashme me GLV, por akoma janë të regjistruara si organizata të shoqërisë civile sipas Ligjit për Shoqata dhe fondacione;
- Mali i Zi - akoma nuk ka partneritete të ngjashme me GLV. Rrjeti për zhvillimin rural aktualisht është duke zbatuar projektin ALTER i cili promovon LEADER-in dhe kontribuon në themelimin e partneriteteve të ngjashme me GLV. Bërthama për një partneritet të ngjashëm me GLV është duke u krijuar nën Programin ABD të SWG (rajoni ndërkufitar KRSH i cili përfshin njësi të qeverisjes vendore nga Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina dhe Mali i Zi).
- Serbia - Rrjeti për zhvillimin rural në Serbi është themeluar nga MB si një shoqatë "ombrellë" e 16 zyrave rajonale, aktive në fushën e zhvillimit rural. Projekti i financuar nga BE "Ngritja e kapaciteteve për krijimin dhe zbatimin e një iniciative LEADER në Republikën e Serbisë" rezultoi me themelimin e 20 partneriteteve të reja lokale të identifikuara si GLV potenciale. Një grup i këtyre partneriteteve themeluan Rrjetin kombëtar LEADER (NLN). Megjithatë, nuk ka të dhëna të besueshme kombëtare për numrin e GLV-ve aktive.

Korniza ligjore për zbatimin e iniciativave LEADER në shtetet/territoret e BP është i përbërë nga ligje dhe rregulla të shumta brenda tre shtyllave: a) sigurimi i bazës ligjore për masat mbështetëse të ngjashme me LEADER, b) rregulloret lidhur me krijimin e GLV-ve dhe c) baza rregullatore për formulimin e dokumenteve strategjike dhe planifikuese. Megjithëse është bërë përparim i dukshëm në zhvillimin e kuadrit të nevojshëm rregullator, pothuajse në të gjitha vendet ka boshllëqe legjislative dhe mungesë të proçedurave në lidhje me LEADER.

Kuadri ligjor për zbatimin e masës LEADER në të gjitha shtetet përcaktohet përmes ligjeve për bujqësinë të cilat ofrojnë bazën për formulimin e politikave. Megjithatë, rregulloret që drejtojnë regjistrimin e GLV-ve, metodologjia për përgatitjen e strategjive lokale për zhvillimin rural dhe përmbajtja e tyre, ende nuk janë zhvilluar në shumicën e shteteve, me përjashtim të Maqedonisë dhe Kosovës*. Në Serbi, proçesi përgatitor për dokumentet e nevojshme është në vazhdim.

Për shkak të mungesës së rregulloreve mbi GLV-të, shumica e partneriteteve ekzistuese lokale

në rajon (përveç Maqedonisë dhe Kosovës*) regjistrohen në përputhje me Ligjin kombëtar për shoqatat, si shoqata jofitimprurëse. Ky boshllëk lidhur me rregullat ka rezultuar në një situatë në të cilën nuk është e pazakontë të gjenden partneritete të regjistruara të cilët e deklarojnë veten si “Grupe lokale të veprimit”, domethënë duke përdorur këtë term si pjesë e emrit të tyre zyrtar. Përveç kësaj, ekspertët kombëtar kanë ngritur shqetësime që ky lloj i entitetit nuk ka të ngjarë të jetë i përshtatshëm për përfaqësimin e GLV-ve “reale”, për shkak të kufizimeve që kanë të bëjnë me ngarkesat fiskale, strukturat qeverisëse, etj.

Ekzistojnë një sërë ligjesh në shtetet/territoret e BP që rregullojnë aspekte të caktuara të bashkëpunimit mes komunave (duke përfshirë edhe atë ndërkufitar), dhe midis aktorëve nga shoqëria civile, sektori publik dhe privat, ndër të cilat më të rëndësishmet janë Ligji për Vetëqeverisje lokale/ vendore dhe Ligji për zhvillimin rajonal (që të dy ekzistojnë në të gjitha vendet). Ligji për vetëqeverisje vendore siguron bazë ligjore për njësitë e qeverisjes lokale dhe për bashkëpunimin mes njësive të qeverisjes vendore në kryerjen e veprimtarive me interes të përbashkët. Ligji për zhvillimin rajonal vendos kornizën ligjore dhe institucionale për planifikimin, kordinimin dhe realizimin e aktiviteteve zhvillimore dhe mbështetjen për bashkëpunimin mes njësive të qeverisjes vendore, midis rajoneve apo atë ndërkufitar dhe ndërkombëtar.

Sa i përket formatit dhe përmbajtjes së strategjive për zhvillimin rural lokal, Maqedonia dhe Kosova* janë të vetmet shtete ku këto çështje rregullohen me anë të rregulloreve. Bazuar në informacionet e dhëna në raportet kombëtare, vetëm në Serbi janë bërë përpjekje për të prezantuar Ligjin për sistemin e planifikimit. Ligji është hartuar por ende nuk është miratuar.

KAPITULLI A. III

3. FINANCIMI

Financimi i Qasjes LEADER është i rëndësisë së veçantë në shtetet/territoret e Ballkanit Perëndimor. Megjithatë, gjendja ndryshon nga shteti/territori në shtet/territor dhe nuk është gjithmonë e lidhur me progresin e pranimit ose statusin e kandidatit. Në periudhën e vlerësimit aktual, financimi i projekteve të ngjashme me LEADER vjen nga burime të ndryshme siç janë qeveritë kombëtare, autoritetet lokale, por kryesisht nga OSHC-të, fondacionet të cilat financohen nga donatorë të ndryshëm.

Mbështetja nga Qeveria

Për momentin, as autoritetet kombëtare dhe as ato vendore në **Shqipëri** nuk kanë miratuar proçedura të cilat i lehtësojnë veprimet e ngjashme me LEADER dhe zhvillimin e GLV-ve. Kjo mbështetje pritet të sigurohet përmes IPARD II, pas vitit 2018. Deri në vitin 2015, **FBH** si në nivelin e entiteteve ashtu edhe në atë të kantoneve nuk ka qenë aktive në dhënien e mbështetjes financiare për LEADER. Meqenëse vendi nuk ka plan strategjik zyrtar për zhvillim rural, financimi i partneriteteve ekzistuese të ngjashme me GLV-të paraqet një kombinim të fondeve publike nga komunat partnere, tarifat për anëtarësim dhe projektet donatore. Në mënyrë paralele, Republika Serbe e Bosnjës prezantoi Qasjen LEADER si pjesë të Planit strategjik për zhvillimin rural të **Republikës Serbe të Bosnjës** për periudhën 2009-2015, dhe propozoi masa për zbatimin e LEADER përmes të cilave u zbatuan me sukses pesë projekte. Për shkak të mungesës së fondeve, zbatimi i mëtejshëm i projektit u ndal në vitin 2013. Në rastin e **Kosovës***, mbështetja e qeverisë u sigurua gjatë gjashtë viteve të fundit kryesisht për mbështetjen e projekteve të vogla lokale. Këto projekte nuk burojnë nga strategjitë e GLV-ve, por kanë qenë të paracaktuara si pjesë e proçesit investues dhe kontribuojnë për mbajtjen në jetë të partneriteteve të ngjashme me GLV. Ndonëse Programi kombëtar për zhvillimin rural në **Maqedoni** parashikoi stimuj për GLV-të, dy vjet me radhë nuk ka patur thirrje publike për subjektet e interesuara. Prandaj, financimi i parë kombëtar për mbështetje të aktiviteteve LEADER do të jetë i arritshëm nëpërmjet Programit kombëtar për zhvillimin rural ose masës IPARD II LEADER e cila është në proçes të akreditimit nga BE. Situata në **Mal të Zi** është e ngjashme, ku nga sektori i OSHC-ve në bashkëpunim me autoritetet kombëtare/lokale dhe bizneset e vogla është siguruar vetëm një financim i papërfillshëm për promovimin e LEADER. Ndërsa masat mbështetëse kombëtare për LEADER do të aktivizohen në vitin 2018 përmes mekanizmit IPARD II, aktualisht disa qeveri lokale kanë parashikuar iniciativa për zhvillim rural përmes garave për ndarjen e fondeve për OJF-të. Financimi nga autoritetet kombëtare për aktivitetet e ngjashme me LEADER në **Serbi** është identifikuar si një skemë kombëtare e subvencioneve për ngritjen e kapaciteteve të OSHC-ve. Mbështetja e partneriteteve të ngjashme me GLV-të ishte më e efektshme në Vojvodinë ku autoritetet e krahinës mbështetën zhvillimin e një numri të strategjive lokale për zhvillimin rural në formë të një granti (ndihme financiare).

Edhe pse dokumentet strategjike dhe të programeve të Ministrive kombëtare e njohin rëndësinë e LEADER, analiza e buxheteve që shkon për mbështetjen e aktiviteteve të ngjashme me LEADER tregon se ata hezitojnë të investojnë për këtë qëllim. Edhe në ato vende ku kanë ekzistuar iniciativa të tilla, financimi nga buxheti i shtetit është ndërprerë (Serbia dhe Republika Serbe e Bosnjës), me përjashtim të Kosovës*. Nga raportet kombëtare po ashtu mund të arrihet në përfundim që

ministritë përkatëse mbështeten shumë në IPARD për mbështetje të ardhshme për qasjen LEADER.

Mbështetja nga donatorët

Organizatat ndërkombëtare, përmes projekteve të donatorëve, mbeten burimi mbizotërues i financimit sa i përket zbatimit të veprimtarive të ngjashme me LEADER dhe krijimit të partneriteteve të ngjashme me GLV në shtetet/territoret e Ballkanit Perëndimor. Organizatat kryesore donatore të përfshira në mbështetjen e aktiviteteve të ngjashme me Leader janë: Komisioni Evropian, UNDP, USAID, SIDA, Ndihma Zvicerane, GIZ. Një numër i partneriteteve të ngjashme me GLV janë krijuar me mbështetjen e burimeve të ndryshme të financimit të huaj në **Shqipëri**, dhe organizatat janë shumë të varura nga bamirësit e tyre dhe projekteve që ata kanë ngritur me këtë qëllim. Në **FBH** dhe **Republikën Serbe të Bosnjës** pjesa më e madhe e financimit sigurohet nga donatorë të huaj; megjithatë mbështetja shpesh kushtëzohet nga sigurimi i bashkëfinancimit që rrezikon zbatimin e projekteve të zhvillimit. Donatorët tregojnë interes të ulët për ngritjen e projekteve të cilat synojnë të mbështesin aktivitetet e ngjashme me LEADER në **Kosovë***. Mbështetja e tyre është më tepër sporadike dhe varet nga përpjekjet individuale të drejtuesve të GLV-ve. Mbështetja donatore në **Maqedoni** i dha shtytje proçesit të analizimit të nevojave lokale, zhvillimit të SLZH dhe formimin e partneriteteve të ngjashme me GLV-të. Gjithashtu i dha shtytje dhe zbatimit të projekteve të një shkalle më të vogël të cilat u ofronin komuniteteve rurale përvojë "të dorës së parë" të qasjes "nga poshtë-lart". Në nivel kombëtar, përgatitja e LEADER si pjesë e IPARD u mbështet nga Komisioni Evropian. **Mali i Zi** nuk ka ndonjë projekt specifik bilateral donatorësh të dedikuar për zbatimin e LEADER, ndonëse donatorët kanë mbështetur iniciativat e sektorit të OJF/OJQ-ve për promovimin e qasjes LEADER. Situata pritet të ndryshojë me zbatimin aktual të një projekti rajonal gjatë të cilit supozohet të themelohen partneritetet e para të ngjashme me GLV-të në Malin e Zi. Duke filluar nga viti 2008 në **Serbi**, veçanërisht në krahinën e Vojvodinës, mbështetja nga donatorët ndryshonte qasjen, nga trajnimet për qasjen LEADER, menaxhimin e ciklit të projektit dhe planifikimin financiar përmes hartimit dhe zbatimit të projekteve për turizmin rural, deri në identifikimin e 21 partneriteteve potenciale të ngjashme me GLV-të.

KAPITULLI A. IV

4. NISMAT E MËPARSHME DHE MËSIMET E NXJERRA

Nismat e mëparshme

TNismat e mëparshme që praktikojnë aktivitete të ngjashme me LEADER në shtetet/territoret e BP ndryshojnë nga një shtet/territor në tjetrin. Në **Shqipëri** iniciativat e mëparshme u zhvilluan nga organizata të ndryshme aktive në rajone të ndryshme. Rrjeti Shqiptar për zhvillimin rural, bazuar në përvojën e mëparshme të Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), është angazhuar në promovimin e qasjes LEADER. Iniciativat e mëparshme përbëheshin nga një sërë ngjarjesh, përgatitje botimesh, organizim i trajnimeve, dokumenteve strategjike lokale dhe zbatimit të iniciativave të llojit LEADER të cilët synonin krijimin e kushteve për themelimin e partneriteteve të ngjashme me GLV dhe zbatimin me sukses të qasjes LEADER.

Organizatat e ndryshme lokale dhe ndërkombëtare si MADA, UNDP dhe ALCDF, nëpërmjet fondeve të donatorëve të ndryshëm dypalësh dhe shumë-palësh kanë pasur ndikim të dukshëm në zhvillimin e komunitetit lokal përmes sigurimit të një skeme granti për mbështetje të aktiviteteve investuese bazuar në një qasje pjesëmarrëse, edhe pse kur financimi u ndërpre, nuk pasuan veprime të mëtejshme. Kapitali njerëzor i krijuar gjatë rrjedhës së veprimeve të mëparshme mbeti i pa-organizuar dhe i palëvizshëm; megjithatë, ai mund të sigurojë një bazë të mirë për ngritjen e partneriteteve të ngjashme me GLV dhe për zbatimin e Qasjes LEADER.

Në Federatën e Bosnjë dhe Hercegovinës hapat e para për prezantimin e Qasjes LEADER dhe krijimin e partneriteteve të ngjashme me GLV u mbështetën nga UNDP. Megjithëse projekti kishte një shtrirje të gjerë në proçesin e themelimit të partneriteteve të ngjashme me GLV-të, aktualisht janë themeluar vetëm tre: GLV Una-Sana, GLV Rajoni Doboj (pjesë e të cilës është në RS) dhe GLV Drina. GLV Una-Sana është më i vjetri në FBH dhe njëkohësisht partneriteti më aktiv i ngjashëm me GLV, i cili deri më tani ka zbatuar një numër të madh projektesh. Në lidhje me aktivitetet e programimit, qasja LEADER ishte pjesë e projektit IPA "Ndërtimi i kapaciteteve për programim të zhvillimit rural në BH (3P-BHRD)". Aktivitetet e projektit ishin të përqendruara në ngritjen e kapaciteteve të përfituesve të ndryshëm, në veçanti trajnimet mbi parimet LEADER për menaxhimin e ciklit të projektit, për shembujt e praktikave më të mira nga përvoja e BE, përfshi ushtrimet praktike. Në vazhdimësi, projekti ka punuar në zhvillimin e "Udhëzime për prezantimin e programit LEADER në Bosnjë dhe Hercegovinë" sipas standardeve të BE-së. Fatkeqësisht, për shkak të mungesës së vullnetit politik, udhëzimet nuk u miratuan.

Në fazën aktuale, partneritetet ekzistuese të ngjashme me GLV-të në BH nuk kanë të drejtë të shfrytëzimit të fondeve LEADER sepse qeveria e BH nuk ka arritur të përmbushë kërkesat e IPARD.

E njëjta qasje donatore e financimit u zbatua në **Republikën Serbe të Bosnjës**, ku përveç themelimit të partneriteteve të ngjashme me GLV në Rajonin e Dobojit, u krijuan dy partneritete tjera të ngjashme me GLV-të (GLV Devetak dhe GLV SAVUS). Në periudhën midis vitit 2011 dhe 2016 u formuan edhe dy partneritete tjera të ngjashme me GLV-të, GLV Vrbanja-Ukrina dhe GLV Biraç. GLV Devetak është GLV më i vjetër aktiv, i themeluar mbi parimet LEADER në territorin e Republikës Serbe të Bosnjes, dhe si i tillë ka qenë i suksesshëm në zhvillimin e një strategjie të re për periudhën nga viti 2016 deri

në vitin 2020.

Rasti i studimit në **Kosovë*** na njohu me një bashkëpunim të vlefshëm midis Ministrisë, Komunës së Vitisë dhe donatorëve tjerë, në mbështetjen e aktiviteteve të ngjashme me LEADER në këtë zonë, duke u përqëndruar në rëndësinë e strategjisë së zhvillimit lokal me qëllim për t'iu përgjigjur nevojave të komunitetit. Sidoqoftë, mbështetja financiare dhe kushtet siç janë decentralizimi politik-administrativ, rrjetëzimi i aktorëve dhe politikave, si dhe dinamika dhe qasja në fondet e jashtme mbeten shumë sfiduese në arritjen e qëllimeve të programit.

Iniciativat e mëparshme në lidhje me qasjen LEADER në **Maqedoni** kryesisht ishin të mbështetura nga projektet e donatorëve dhe Rrjeti për zhvillimin rural. Promovimi i LEADER ka krijuar ndërgjegjësim për zhvillimin e një qasjeje të re dhe sistematike në mënyrë që të përafrojë qëndrimet dhe përpjekjet e pushtetit lokal drejt zhvillimit lokal/rural me qasjet dhe strukturat e Komisionit Evropian. Palët e interesuara kryesore nga sektori publik, privat dhe civil në çdo rajon u identifikuan dhe u trajnuan mbi parimet dhe mekanizmat e qasjes LEADER, në përgatitje për formimin e partneriteteve të ngjashme me GLV. Këto grupe aktorësh kryesor lokal, të cilët më vonë do të formalizoheshin në partneritete të ngjashme me GLV, u udhëzuan në proçesin e hartimit të SLZH-ve, me mbështetjen e USAID dhe NRD. Që nga viti 2015, projekti i BE-së[16] ka mbështetur Ministrinë e bujqësisë për përgatitjen e masës "fiche" të LEADER. Gjithashtu, hapa të mëtejshëm janë arritur me përgatitjen e dokumenteve të para për akreditimin dhe propozimin e parë të Udhëzimeve për formimin e GLV, përgatitjen e SZHL dhe proçedurat për përzgjedhjen dhe miratimin e projekteve. Miratimi zyrtar i masës LEADER nga ana e MB-së do të sigurojë veprime pasuese në proçesin e finalizimit të paketës së akreditimit. Sapo të përfundohet ky proçes, masa do të duhet të ndahet me DG AGRI për të filluar proçesin e miratimit të tij joformal, para se të përfshihet në Programin IPARD të përditësuar dhe para se të dorëzohet për miratim formal.

Aktivitetet e ngjashme me LEADER në **Mal të Zi** kanë nisur nga një nivel shumë fillestar, kryesisht duke promovuar aktivitete lokale në fushën e turizmit rural. Gjithashtu, qasja për zhvillim ndërkufitar me bazë territorin (përfshi Serbinë, Bosnjën dhe Kroacinë), e mbështetur nga SWG, dha shtytje të fuqishme në krijimin e ndërgjegjësimit për bashkëpunimin dhe forcimin e kapaciteteve njerëzore për përgatitjen dhe zbatimin e Qasjes LEADER.

Në **Serbi** proçesi ka filluar përmes zhvillimit të partneriteteve lokale dhe të rrjeteve të tyre me mbështetjen e Ministrisë së Bujqësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit MAEP me përfshirje të OSHC-ve nga zonat rurale në proçesin e vendimmarrjes lokale dhe në ngritjen e partneriteteve lokale që përfshijnë sektorin publik dhe të biznesit. Brenda këtij proçesi, i cili gjithashtu ishte i mbështetur nga organizatat e donatorëve, ka pasur një bashkëpunim të dukshëm aktiv ndërmjet OSHC-ve dhe MAEP. Në krahinën e Vojvodinës ka një ndihmë më të vazhdueshme dhe të fokusuar në zbatimin e LEADER në nivelin e komunave, veçanërisht nëpërmjet mbështetjes nga qeveria e krahinave. Kjo rezultoi me kapacitete të përmirësuara të partneriteteve ekzistuese të ngjashme me GLV-të për zhvillimin e strategjive të tyre të zhvillimit lokal dhe për t'u bërë më aktiv në zbatimin e një game të gjerë veprimesh. Për shkak të ndërprerjes së mbështetjes financiare, partneritetet e ngjashme me GLV-të në të gjithë territorin e Serbisë, ndjeshëm kanë humbur interesimin dhe kanë zvogëluar aktivitetet e tyre. Në Vojvodinë ekzistojnë subvencione për aktivitetet e llojit LEADER dhe interesimi i aktorëve lokalë për qasjen LEADER mbetet i lartë; megjithatë, koncepti i qasjes shumë-sektoriale në nivel të komunitetit ende nuk është kuptuar plotësisht nga vetëqeverisjet lokale dhe strukturat politike.

16 *"Prezantimi i masave të reja IPARD (LEADER dhe Shërbimet këshillimore)"*

Tabela A. IV. 1 Rekomandimet për institucionet kombëtare lidhur me veprimet strategjike, ligjore, institucionale dhe financiare për t'u përgatitur për LEADER

Shteti/ territori	Korniza strategjike dhe e programimit	Kuadri rregullator		Mbështetje financiare qeveritare	Zhvillimi i kapaciteteve		
		Rregulloret për përzgjedhjen e GLV-ve	Rregulloret për Strategjitë lokale		MB	Rrjetet e themeluara të OSHC për zhvillim rural	Partneritete të ngjashme me GLV
Shqipëria	Po	Jo	Jo	Jo	Jo	Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural	4 partneritete të ngjashme me GLV, veprojnë si OSHC
Federata e Bosnjë dhe Hercegovinës	Në nivel kombëtar, por jo në nivel të entiteteve; përparim i ulët vogël në nivel kantonesh	Jo	Jo	Jo	Jo	"Rrjeti për zhvillimin rural në BH"	3 partneritete të ngjashme me GLV, veprojnë si OSHC
Republika Serbe e Bosnjes	Po	Jo	Jo	Jo	Jo	"Rrjeti për zhvillimin rural i Bosnjë dhe Hercegovinës"	3 partneritete të ngjashme me GLV, veprojnë si OSHC
Kosova*	Po	Po	Po	Po	Po	Rrjeti i organizatave për zhvillimin rural i Kosovës*	30 partneritete të ngjashme me GLV janë themeluar formalisht
Maqedonia	Po	Po	Po	Jo	Jo	Rrjeti për zhvillimn rural i Republikës së Maqedonisë	16 partneritete të ngjashme me GLV, veprojnë si OSHC
Mali i Zi	Në progres	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo	Akoma nuk ka partneritete në formë të GLV
Serbia	Po	Në progres	Në progres	Deri më 2013; Aktualisht në territorin e KA të Vojvodinës	Është emëruar një person të merret me LEADER	Veprojnë dy rrjete: Rrjeti për zhvillimin rural i Serbisë dhe Rrjeti kombëtar LEADER (NLN).	Nuk ka të dhëna të besueshme kombëtare për numrin e GLV-ve aktive ose Partneriteteve të ngjashme me GLV-të

KAPITULLI A. V

5. KONKLUZIONET DHE REKOMANDIMET

5.1 Konkluzionet

- Në tërë shtetet/territoret e BP, LEADER është pjesë e dokumenteve kombëtare strategjike dhe dokumenteve të programeve dhe i parashikuar në IPARD. Me përjashtim të FBH, ku entitetet janë përgjegjëse për zbatimin e programit LEADER në territoret e tyre, të gjithë shtetet/territoret tjera kanë miratuar programe përmes të cilëve do të zbatohet kjo mbështetje.
- Dokumentet strategjike dhe të programeve për zhvillim rural të shteteve/territoreve të Ballkanit Perëndimor janë zhvilluar plotësisht.
- Partneritetet ekzistuese të ngjashme me GLV-të në të gjithë shtetet/territoret janë të regjistruara si OSHC.
- Rregulloret për strategjitë të zhvillimit lokal janë miratuar vetëm në Kosovë* dhe Maqedoni, ndërsa ato në Serbi janë në proçes të përgatitjes.
- Ministritë e linjës janë të përfshira në proçesin e zhvillimit të mjedisit të nevojshëm ligjor për ngritjen e strukturave administrative dhe financiare, por kapacitetet e tyre janë të ulëta, si në aspektin e numrit të stafit po ashtu dhe të aftësive për t'u marrë me këtë çështje. Ka mungesë të njohurive, përvojës dhe kuptimit të qasjes LEADER brenda institucioneve qeveritare në të gjitha nivelet (nga Ministria deri te autoritetet vendore). Përkundër kësaj, është arritur një progres i caktuar, por ritmi i këtij proçesi është shumë i ngadalshëm dhe kërcënon të rrezikojë të gjithë punën e bërë deri më tani.
- Shumica e aktiviteteve të ngjashme me LEADER në të gjithë shtetet/territoret, deri më tani janë mbështetur nga organizata të ndryshme donatorësh, përfshi edhe organizatat e burimeve lokale, qeveritë dhe rjetet lokale. Mbështetja zakonisht është e kufizuar në aspektin e burimeve të financimit dhe afatit të kufizuar, duke shkaktuar pavazhdimësi në proçesin e zbatimit të një metode LEADER plotësisht të zhvilluar. Për më tepër, hendeku i mbështetjes financiare dhe teknike i dekurajon palët e interesuara që të mbeten të përfshira në LEADER, duke e bërë shumë të vështirë mobilizimin e pjesëmarrjes dhe mbështetjes së mjaftueshme lokale. Kjo sidomos mund të ndikojë partneritetet engjashme me GLV-të të krijuara rishtazi, të cilat janë ende shumë të reja dhe të brishta.
- Partneritetet e ngjashme me GLV-të të formuara, janë me shkallë të ndryshme të pjekurisë. Deri më tani nuk ka pasur vlerësim të kapaciteteve të tyre, kështu që nuk ka informacion të mjaftueshëm në lidhje me kapacitetet dhe projektet e tyre.
- Partneritetet e ngjashme me GLV-të të formuara së fundmi janë vetëm në fazën e fillestare të një proçesi të dedikuar për t'iu përgjigjur tërësisht nevojave dhe interesave të palëve të ndryshme të interesit.
- Ministritë kombëtare në Serbi dhe në Republikën Serbe të Bosnjës patën filluar të financojnë LEADER dhe partneritetet e ngjashme me GLV-të dhe përfundimisht ndaluan financimin; vetëm Ministria përgjegjëse në Kosovë* aktualisht ofron mbështetje.

5.2 Rekomandimet e përgjithshme

Ekzistojnë rekomandime të shumta përkatëse që duhet të merren parasysh gjatë analizimit të situatës aktuale dhe përvojës së përfituar nga iniciativat e mëparshme në shtetet/territoret e BP.

Rekomandime për përmirësimin institucional

- Institucionet përgjegjëse qeveritare në të gjitha nivelet duhet të vazhdojnë të punojnë në zhvillimin e kuadrit institucional, strategjik dhe rregullator për prezantimin e LEADER si kusht paraprak për arritjen e akreditimit të masës LEADER.
- Ekziston nevoja për zhvillimin e kornizës LEADER në FBH ku entitetet duhet të përgatisin strategjitë e tyre duke përfshirë dispozitat për qasjen LEADER.
- Të gjitha shtetet duhet të angazhojnë një numër më të madh të stafit nga ministritë përkatëse dhe agjencitë e pagesave në proçesin e vazhdueshëm të organizimit të sistemit administrativ dhe organizativ të qasjes LEADER; për më tepër, ato duhet të përmirësojnë bashkëpunimin ndër-institucional për të forcuar kapacitetet e tyre për programimin strategjik të masës LEADER.
- Aktorët kryesor institucional kanë nevojë për trajnime dhe kapacitete organizative më adekuate për të qenë më të përfshirë dhe më të angazhuar ndaj proçeseve për zhvillimin rural.
- Ekziston një nevojë urgjente për rritjen e kapaciteteve dhe kordinimin e personelit përgjegjës për zbatimin e LEADER (Ministritë, Agjencitë e pagesave), si dhe për ndërveprim më të madh nga ana e këtyre institucioneve për ta bërë masën LEADER të disponueshme për partneritetet ekzistuese dhe potenciale të ngjashme me GLV-të.

Rekomandime për përmirësim të politikave

- Duhet të krijohen, miratohen dhe zbatohen politika kombëtare për zhvillim rural dhe masa shoqëruese. Një skemë kombëtare e mbështetjes për zhvillimin rural e cila parashikon role të qarta për partneritetet publiko-private është jetësore për nxitjen e pjesëmarrjes së popullsisë rurale lokale dhe do të siguronte vazhdimësinë e aktiviteteve të GLV.
- Politikat e zhvillimit lokal duhet të zbatohen me një proçes të vendimmarrjes nga poshtë-lartë, duke lejuar kështu lidhje dhe kordinim më të mirë të aktorëve të ndryshëm rural, si në aspektin vertikal (organet qeveritare në nivele të ndryshme - kombëtare, rajonale dhe lokale) dhe në atë horizontal (sipërmarrësit, shoqatat profesionale, fermerët, etj.).
- Nevojitet zhvillimi i legjislacionit dytësor, p.sh. rregulloret (rulebooks) dhe rregullat për Grupet lokale të veprimit të cilët përfshijnë udhëzime për përbërësit e mundshëm të GLV-së, për ngritjen, rolin, funksionimin dhe akreditimin e tyre, duke përfshirë mjetet e nisjes për hartimin e Strategjive të zhvillimit lokal (SZHL).
- Sinkronizimi dhe komplementariteti/plotësimi i financimit të zhvillimit rural kombëtar me fondet e IPARD të BE.
- Qeveritë kombëtare duhet të bëjnë shumë më tepër përpjekje në krijimin e proçedurave të nevojshme legjislative dhe administrative për të bërë qasjen LEADER operative si pjesë e programeve kombëtare rurale dhe IPARD të BE për të fuqizuar dhe vazhduar punën e bërë deri më tani, për të siguruar mbështetjen nga palët e interesuara në zonat rurale dhe qëndrueshmërinë e programit në tërësi.

Rekomandime për fuqizimin e aktorëve lokal

- Duhen praktikuar modele të ndryshme të rrjetëzimit të aktorëve të ndryshëm lokal (publik, shoqëria civile dhe biznesi) dhe pjesëmarrja në aktivitete të përbashkëta; këto sinergji do të promovojnë iniciativat lokale dhe do të kontribuojnë në ngritjen e ndërgjegjësimit për rolin e aktorëve lokal në proçeset vendimmarrëse në nivel lokal, duke motivuar kështu aktorët nga të tre sektorët për pjesëmarrje më aktive në zonat e tyre lokale.
- Shkëmbim i informacionit dhe transferim i praktikave më të mira ndërkombëtare nga GLV-të e BE-së. Përveç kësaj, iniciativat pilot të ngjashme me LEADER duhet të testohen me modele të suksesshme të partneriteteve trepalëshe në mënyrë që të rritet kuptimi i grupeve lokale të interesit për veprimet nga poshtë-lart, me bazë komunitetet.
- Në shtetet/territoret e BP ekziston një nevojë e përhershme për forcimin e kapitalit njerëzor vendor, të aftë për menaxhimin e GLV-ve, zbatimin e Strategjive të zhvillimit lokal, thithjen e fondeve të dedikuara për masat LEADER.

Rekomandimet mbi përgatitjen e institucioneve kombëtare në lidhje me veprimet strategjike, ligjore dhe financiare për qasjen LEADER

Hapat logjike për veprim:

- Qasja LEADER është pjesë e dokumenteve kombëtare strategjike dhe të programeve dhe IPARD në të gjithë shtetet, me përjashtim të FBH. Entitetet në FBH duhet të përgatisin strategjitë e tyre të cilët do të përfshijnë Qasjen LEADER.
- Ngritja e kuadrit rregullator në përputhje me rregulloret e Komisionit Evropian, përkatëse për CLLD/LEADER. Hartimi i rregulloreve për krijimin e GLV-ve dhe përpunimi i SZHL-ve sipas rregullores (BE) 1305/2013 dhe (BE) 1303/2013.
- Caktimi/rritja e stafit përgjegjës në departamentet përkatëse të ministrive përgjegjëse për zbatimin e Qasjes LEADER.
- Zhvillimi i kapaciteteve të Ministrisë dhe stafit të Agjencisë së pagesave për administrimin e proçedurave për masën LEADER sipas kuadrit rregullator.
- Shfrytëzimi i financimit kombëtar ose masave të asistencës teknike IPARD për mbështetjen e partneriteteve të ngjashme me LEADER/GLV.

Tabela A. V.1 Rekomandimet për forcimin e kapaciteteve të palëve të interesuara lokale nga sektori publik, shoqëria civile dhe sektori i biznesit për zbatimin e qasjes LEADER në shtetet/territoret e BP

Rekomandimet thelbësore për zbatimin e Qasjes LEADER	Të forcohet vetëdija dhe të rriten kapacitetet e popullsisë rurale për zbatimin e qasjes LEADER	Të krijohet një sistem që ofron mbështetje këshillimore për partneritetet ekzistuese dhe të ngjashme me GLV	Të mbështetet krijimi i GLV-ve dhe përgatitja e strategjive të GLV-ve	Të mbështetet zbatimi i SZHL nëpërmjet partneriteteve të themeluara të ngjashme me GLV	Të mbështetet bashkëpunimi dhe rrjetëzimi midis partneriteteve të ngjashme me GLV në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar
Aktivitetet specifike LEADER në shtetet/ territoret e BP	- Përgatitja dhe shpërndarja e materialeve promovuese - Realizimi i eventeve promovuese dhe informative në nivel kombëtar/ rajonal - Zhvillimi i vlerësimit të përgjithshëm dhe hartës së territoreve të mundshme për krijimin e GLV-ve në nivel kombëtar duke marrë parasysh parimin LEADER të qasjes me bazë territorin	- Forcimi i kapaciteteve të rrjeteve të ZHR dhe entiteteve të tjera për gjallërimin dhe mobilizimin e palëve të interesuara rurale në lidhje me qasjen LEADER - Ofrimi i mbështetjes së vazhdueshme për partneritetet e ngjashme me GLV përmes këshillimit dhe trajnimit.	- Forcimi i kapaciteteve të partneriteteve potenciale dhe ekzistuese të ngjashme me GLV-të për zhvillimin e procedurave transparente midis aktorëve kryesorë (komunikim dhe vendimmarrje) - Trajnim për ngritjen e partneriteteve lokale - Trajnim për përvetësimin e shkathtësive/ aftësive për planifikim strategjik - Trajnim për menaxhimin e ciklit të projektit	- Asistencë për realizimin e projekteve që burojnë nga SZHL - Trajnim për menaxhimin e GLV-ve për procedurat e prokurimit publik në lidhje me zbatimin e projektit - Trajnim për GLV-të për çështjet e menaxhimit financiar dhe administrativ	- Zhvillimi i projekteve të përbashkëta ndërmjet partneriteteve të ngjashme me GLV-të në nivel kombëtar - Sigurimi i mundësive për partneritetet e ngjashme me GLV-të për pjesëmarrje në projektet ndërkombëtare për bashkëpunim me partnerë evropian

PJESA B:
PIKËPAMJET E SHTETIT/TERRITORIT

KAPITULLI B.I

Vlerësimi i zbatimit të qasjes LEADER në vendet e Ballkanit Perëndimor - “nga një iniciativë lokale në një koncept qendror në zonat rurale”

Raporti i vendit: Shqipëri
Autor: Z. Edvin Zhllima

1. HYRJE

Në vitin 2014, pasi iu caktua statusi kandidat, Qeveria e Shqipërisë (QSH) bëri hapa pozitive drejt hartimit të politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural, si dhe përditësimin e bazës juridike dhe institucionale në përputhje me Politikën e Përbashkët Bujqësore (CAP). Zhvillimi rural shikohet si shtytësi kryesor për realizimin e një rritjeje të balancuar ekonomike, duke konsideruar faktin që në Shqipëri pothuajse gjysma e popullsisë jeton në zona rurale, dhe veprimtaria kryesore ekonomike që mbështet jetesën rurale, përkatësisht sektori i bujqësisë, kontribuon me 1/5 e Vlerës së Shtuar Bruto të vendit (GVA). Përkrahja buxhetore për bujqësinë dhe zhvillimin rural arriti 14.7 milion në vitin 2016. Kjo vlerë e cila u alokua për masat strukturore dhe të zhvillimit rural (Shtylla e dytë), duke marrë kështu 60% të fondit total për mbështetje. Mirëpo, fondet për përmirësimin e jetesës rurale dhe mirëmbajtjen e burimeve natyrore janë modeste. Deri më tani, pjesa dërrmuese e mbështetjes i është alokuar prodhuesve të drejtpërdrejtë, me shumë pak ndikim në zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit lokal. Kështu, sfida kryesore lidhur me zhvillimin rural është të arrihet zhvillimi i barabartë territorial, veçanërisht kur bëhet fjalë për masat e mbështetjes dedikuar zonave më pak të favorizuara (LFA). Përqendrimi në zhvillimin territorial rural është shumë i rëndësishëm tani pasi që shteti me shpejtësi të madhe është duke zbatuar reformën për zhvillimin rajonal dhe po kalon ndryshime drastike në jetesën rurale. Së fundi, dallimet qytet-fshat po thellohen, dhe po vërehet një tendencë e zhvendosjes së popullsisë rurale në dekadën e fundit[17].

Përparimi drejt integrimit në BE po hap vend për mbështetje shtesë dhe më të përshtatur për komunitetet lokale, për shembull përmes iniciativave LEADER. Kushtet për hartimin e masave dhe avancimin e iniciativave LEADER me sa duket janë të arritshme me hartimin e Programit IPARD II. Mirëpo, pikat e dobëta më të mëdha qëndrojnë në hartimin e Kuadrit rregullator për ngritjen e GLV-ve, rritjen e ndërgjegjësimit të palëve të interesuara dhe njoftimin mbi rëndësinë e iniciativave të ngjashme me LEADER, si dhe zhvillimin e mekanizmave të qëndrueshme për zhvillim lokal duke e forcuar rolin e pushtetit lokal dhe qendror me qëllim avancimin dhe përmirësimin e bashkërendimit me donatorët.

2. MJEDISI LEADER NË SHQIPËRI

2.1 LEADER në dokumentet kombëtare strategjike dhe të programeve

Zhvillimi territorial rural për herë të parë u fut si prioritet politikash me Strategjinë ndër-sektoriale për zhvillim rural 2007-2013, megjithëse nuk u pasua me aktivitete të përkushtuara. Aktualisht, në Shqipëri, janë hartuar disa dokumente strategjike në të cilat qasja LEADER zë një vend të rëndësishëm. Strategjia ndërsektoriale për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural (ISARD), miratuar nga VKM. 709, më datë 29.10.2014 është një ndër dokumentet kryesore të politikave strategjike. Masa numër 8 e këtij dokumenti thotë: Hartimi dhe zbatimi i strategjive të zhvillimit rural lokal - qasja "Leader" - e planifikuar në këtë Kapitull - ofron objektivat e zbatimit të qasjes "Leader"; qëllimin e masave; mënyrën dhe proçesin e mobilizimit të burimeve lokale dhe komponentin kryesor të qasjes "Leader".

Ratifikimi i Marrëveshjes Kuadër (FA)[18] dhe Instrumenti për Asistencë Para-anëtarësimi për zhvillimin rural (IPARD)[19] e ka hapur rrugën për programimin dhe zbatimin e strategjive të zhvillimit

[17] *Censusi i popullsisë dhe banesave së vitit 2012 identifikoi një popullsi urbane më të madhe se sa ajo rurale për herë të parë në Shqipëri. Varfëria rurale, në vitin 2012, u ndjek me një tendencë rritjeje krahasuar me vitin 2008, shumë më ndryshe nga tendenca në rënie që ishte vështruar që në vitin 2002..*

[18] *Marrëveshja Kuadër, e ratifikuar me Ligjin 37/2015, datë 04.09.2015*

[19] *Marrëveshja sektoriale (IPARD) ratifikuar me Ligjin nr. 30/2016 datë 03.17.2016*

lokal përmes qasjes së ngjashme me LEADER[20]. Sipas kësaj përpjekjeje, është realizuar një studim për diagnostikimin e gjendjes së GLV-ve dhe zbatimit të masave LEADER në Shqipëri. Në këtë drejtim, u hartua një masë për asistencë teknike e cila më pas pritet që të përfshihet në Detyrën e besuar të zbatimit të buxhetit. Kjo projekt-masë i përmban elementet përbërëse të qasjes LEADER në nivel programor, siç është kriteri që duhet të përmbushet nga përfituesi i mundshëm, zona e përfshirë nga strategjia[21], si dhe masat mbështetëse të qasjes LEADER. Në të ardhmen e afërt, aktivitetet e Autoritetit Menaxhues (MA) varen nga miratimi i bazës ligjore kombëtare për zbatimin, rekrutimin dhe aftësimin e personelit në bashkëpunim me Agjencinë e IPARD mbi ngritjen e GLV-ve dhe avancimin e strategjive lokale. Komisioni Evropian (KE) pritet që të hap vend për një masë të tillë pas vitit 2018.

Programi për zhvillim rural 2014-2020 është një dokument tjetër i rëndësishëm, i cili paraqet një përshkrim të gjendjes aktuale, analizën SWOT dhe identifikimin e nevojave për "Hartimin dhe zbatimin e strategjive LEADER për zhvillim lokal". Ky program përmban dy elemente: (i) zbatimi i strategjive do të kufizohet brenda territoreve të zonave rurale dhe (ii) përcaktimi i zonave rurale.

Një tjetër dokument strategjik kyç me fokus në qasjen LEADER është Strategjia për Decentralizimin. Në Strategjinë për Decentralizim është shënuar që *"Pushteti lokal do të ketë kompetencat lidhur me ngritjen/zhvillimin e partneriteteve publike private. Politikat rajonale po ashtu përballen me sfida të reja. Shqipëria ka kaluar një reformë të rëndësishme për zhvillimin rajonal, duke e transformuar vendin nga një strukturë tejet të fragmentuar prej 374 Njësive të qeverisjes lokale në rreth 61 Njësi të qeverisjes lokale. Ky riorganizim territorial kërkon reforma urgjente fiskale dhe financiare, të cilat do ta çojnë përpara proçesin e decentralizimit dhe transferimin e disa funksioneve dhe shpërqendrimin e funksioneve të tjera. Si rrjedhojë, skemat e mbështetjes për zhvillimin rural po ashtu do të duhet të kalonin njëfarë lloj rishikimi. Zbatimi i modelit Partneritetit Publik Privat (PPP) në nivel lokal do të lehtësohet përmes ndryshimeve të legjislacionit"*.

2.2 Rregullimet institucionale dhe ligjore

Kuadri ligjor që e rregullon zbatimin e qasjes LEADER është i ndarë në tri grupe (i) legjislacioni kombëtar që përfshin akte dhe ligje normative (ii) Akte dhe marrëveshje të përbashkëta ligjore ndërmjet BE-së dhe Shqipërisë, përfshi FA dhe IPARD dhe (iii) Dokumentet ligjore të BE-së përfshi rregullimet lidhur me Instrumentin për Asistencë Para-anëtarësimit[22] dhe rregullimet tjera lidhur me qasjen LEADER. Një listë më të plotë të ligjeve dhe dispozitave të tjera ligjore mund t'i gjeni në Shtojcën 5.2.

Siç u theksua më lart, ligjet kryesore që e rregullojnë kuadrin ligjor për zbatimin e iniciativave LEADER janë Ligji nr. 9817, i datës 22.10.2007 "Për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural" dhe Ligji nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen vendore". Ligji nr. 9817 përcakton objektivat, mjetet dhe programimin e politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural. Ligji nuk ka një dispozitë konkrete për hartimin dhe zbatimin e strategjive LEADER për zhvillim lokal. Neni 15, pika (d) e këtij ligji thekson se qëllimi i masave për politikat e zhvillimit rural është të përkrahë "përmirësimin e qeverisjes dhe mobilizimin e potencialeve të zhvillimit lokal në zonat rurale, si dhe ndërmarrjen e nismave lokale". Një nen i veçantë (neni 19) siguron veprime të hollësishme për nismat lokale pa specifikuar qasjen LEADER.

[20] *Germa "j", "k" dhe "l" e Shtojcës I, të Marrëveshjes Kuadër*

[21] *Zonat rurale në Shqipëri janë përcaktuar si "territori i të gjitha bashkive me popullsinë, siç është përcaktuar nga Censusi i vitit 2011, nën 50,000 banorë" MARDWA, 2015, Programi IPARD II 2014-2020*

[22] *Rregullorja IPA II, rregullorja e zbatimit reciprok, IPA II*

Ligji nr. 139/2015 për Vetë-qeverisjen vendore iu jep përgjegjësi bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve, kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit. Ligji ua siguron njësive të vetëqeverisjes vendore të drejtën dhe përgjegjësitë për të përcaktuar masat që ata mendojnë se janë të nevojshme për të kryer funksionet, përfshi dhe masat lidhur me qasjen LEADER. Gjithashtu, ligji mundëson shfrytëzimin e mjeteve të përshtatshme për ngritjen e partneriteteve publike private ose i miraton nenet mbi shoqatat e sipërmarrjeve, shoqërive dhe personave ose subjekteve të tjerë juridike që bashkëpunojnë ose bashkë-themelojnë subjekte të këtilla, siç kërkohet me iniciativën e llojit të GLV-së. Në këtë drejtim, bashkia mund të jetë një aktor dhe themelues i një GLV-je, dhe (v) këshilli bashkiak mund të përcaktojë rregullat e përgjithshme mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave në komunitet (Nenet 68-71) të cilat janë aktorë potencialë të rëndësishëm për zhvillimin lokal.

Aktualisht, nuk ekzistojnë kushte dhe proçedura të përcaktuara me ligj për GLV-të. Deri më tani, format e zakonshme ligjore për GLV-të ishin organizatat jo-fitimprurëse[23] të themeluara me vullnetin e lirë të individëve dhe subjekteve. Ligji përcakton që subjektet e regjistruara si organizata jo fitimprurëse (OJF) e marrin statusin e tyre ligjor pasi që të jenë themeluar dhe regjistruar në Gjykatë, në pajtueshmëri me kushtet dhe procedurat e përcaktuara me ligj. Anëtarët themelues takohen dhe e miratojnë aktin themelues dhe statutin, ndërsa mund të autorizojnë një ose më tepër persona për të kryer aktet e regjistrimit[24]. Shqetësimi kryesor qëndron në trajtimin fiskal të këtyre njësive. Aktorët e intervistuar e identifikuan barrën fiskale si një kufizim madhor që imponohet me detyrimin e OJF-ve për të paguar taksën e vlerës së shtuar (TVSH) për shërbimet që i realizojnë për komunitetin.

Qeveria para vitit 2014 ngriti bazën ligjore për përfshirjen e aktorëve privat dhe nxitjen e mjedisit të përshtatshëm për dialogun publik-privat. Plani Kombëtar i Veprimit të Partneritetit Për Qeverisje të Hapur 2012-2013 rregulloi dialogun ndërmjet aktorëve. Në lidhje me themelimin e Partneriteteve Publik-Privat, është identifikuar një akt i përgjithshëm që përfshin kuadrin ligjor. Që nga maji 2013, ekziston një Ligj i ri për Koncesione dhe Partneritete Publike Private, i cili është në pajtueshmëri me direktivën 2004/18/EC të Bashkimit Evropian. Qëllimi i këtij ligji është të krijohet kuadri i nevojshëm për nxitjen dhe lehtësimin e zbatimit të projekteve koncesionare dhe partneriteteve publike private (PPP), të financuara nga sektori privat, duke u bazuar në parimin e mos-diskriminimit dhe barazisë së trajtimit të ofertuesve aktualë dhe potencialë, në parimin e transparencës së procedurave të prokurimit dhe reciprocitetit, si dhe në parimet e proporcionalitetit të kërkesave dhe detyrimeve të imponuara mbi ofertuesit potencialë dhe sigurisë juridike. Ligji përcakton procedura të posaçme për akordimin e projekteve koncesionare dhe projekteve PPP[25].

Duke pasur parasysh gjendjen aktuale, në 5 vitet e ardhshme, do të vazhdojë përgatitja e zbatimit të qasjes LEADER nga organizatat përkatëse joqeveritare që ofrojnë shërbime dhe aktivitete sipas qasjes LEADER. Gjatë kësaj periudhe në këtë sferë pritet të jetë e disponueshme përkrahja dypalëshe dhe shumëpalëshe e donatorëve .

Autoriteti kryesor në Shqipëri për qasjen LEADER dhe politikat dhe strategjitë tjera për zhvillim

[23] *Neni 10 i Ligjit nr. 8788, datë 07.05.2001 "Për organizatat jo-fitimprurëse", i ndryshuar*

[24] *Shoqatat jo-fitimprurëse duhet të përmbushin një numër të caktuar të kritereve për anëtarët themelues që duhet të jenë pesë persona fizik ose së paku dy persona juridik. Trupi më i lartë qeverisës i një organizate jo për fitim me anëtarësi është Kuvendi ose Asambleja e të gjithë anëtarëve. Zgjidhen dhe trupa të tjerë qeverisës dhe janë përgjegjës para këtij trupi më të lartë.*

[25] *Ligji i ri e përcakton dhe fut konceptin e partneriteteve publike-private si një formë e bashkëpunimit afatgjatë ndërmjet sektorit publik dhe partneriteteve private ku të dyja palët i ndajnë rreziqet dhe financimin e projekteve publike në bazë të marrëveshjeve të arritura dhe në pajtim me ligjin në fuqi. Nga ana tjetër, koncesioni dallon nga partneritetet publike private, kryesisht për shkak të faktit që koncesioneri që e ka kontratën me sektorin publik për sigurimin e punëve dhe shërbimeve publike*

rural, është Ministria e Bujqësisë dhe zhvillimit rural (ang. **MARD**). Në nivel rajonal, MARD ushtron autoritetin e saj nëpërmjet Drejtorive Rajonale të Bujqësisë të cilat janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e veprimtarive bujqësore, ofrimin e shërbimeve këshillimore dhe mbajtjen e statistikave në nivel lokal.

Për më tepër, subjektet e rëndësishme rajonale që kanë të bëjnë me mbështetjen e nismave lokale janë Agjencitë për zhvillim rajonal, të cilat janë të themeluara si një strukturë e qeverisjes vendore për të siguruar qasjen e duhur në bashkëpunimin ndërmjet bashkive dhe pushtetit qendror. Agjencitë përbëhen nga një zyrë qendrore dhe katër zyra vendore në Tiranë, Shkodër, Vlorë dhe Korçë. Agjencitë përqëndrohen në gjetjen e fushave të përbashkëta të interesit në mesin e bashkive me qëllim shfrytëzimin e tyre në aplikimet për projekte për fondet e BE-së ose mundësi të tjera. Një partner i rëndësishëm për ngritjen e GLV-ve dhe mbështetjen e nismave të ngjashme me qasjen LEADER janë 61 bashkitë, të cilat luajnë rol të rëndësishëm në mbështetjen e zhvillimit vendor, sigurimin e shërbimeve themelore publike dhe përmirësimin e kushteve të jetës së banorëve të tyre. Politikat dhe strategjitë me fokus bujqësinë dhe zhvillimin rural, kohët e fundit kanë kaluar nën kompetencat e pushtetit vendor, gjë që ka ndodhur dy vite më parë me miratimin dhe zbatimin e Ligjit të ri për Vetëqeverisjen Vendore të vitit 2015.

2.3 Financimi

Në Shqipëri nuk ekzistojnë masa politikash aktuale për mbështetjen e aktiviteteve lidhur me masat e ngjashme me qasjen LEADER as nga Qeveria e Shqipërisë as nga organet e pushtetit vendor. Qasja LEADER, si një qasje novatore e politikë-bërjes për zhvillimin rural dhe ngritjen e Grupeve Lokale të Veprimit në pajtueshmëri me standardet e BE-së, duhet të sigurohet me programin IPARD II. Vëllimi i ndihmës nën këtë masë nuk është ende në dispozicion. Mirëpo, disa donatorë kanë ofruar mbështetjen e tyre për ngritjen e Grupeve Lokale të Veprimit (GLV) në disa rajone të vendit në bashkëpunim me organizatat për mbështetje të komuniteteve.

Duke u bazuar në partneritetin me sektorin privat dhe autoritetet vendore/rajonale, donatorët kanë hartuar strategji dhe kanë zbatuar nisma të vogla për zhvillimin e komuniteteve lokale, bazuar në objektivat e përbashkëta prioritare. Donatorët më aktiv në këtë fushë janë: IFAD (nëpërmjet Forumeve malore të themeluara nga MADA), DFID (nëpërmjet Oxfam, i cili formoi 3 GLV), SNV, UNDP, Qeveria gjermane (nëpërmjet GIZ), Banka Botërore, etj. Një numër i caktuar i grupeve lokale të veprimit (GLV) dhe/ose organizatave me bazë komunitetin nuk janë më në funksion, ndërsa disa të tjera akoma funksionojnë. Asnjë program i ngjashëm me GLV nuk është parë të funksionojë me efikasitet dhe të prodhojë rezultate të suksesshme sepse jetëgjatësia e tyre varet shumë nga financimi. Organizatat e tipit GLV kanë dëshmuar të jenë financiarisht të paqëndrueshme pas përfundimit të financimit nga donatori. Nuk ka vlerësime për sasinë e financave të nevojshme për formimin e një organizate të tipit GLV. Megjithatë, një vlerë e përafërt nuk do të tejkalonte shumën prej 10 milionë EUR. Një pjesë e madhe e këtyre fondeve bazohet në grante të huaja.

3. INICIATIVAT E MËPARSHME DHE MËSIMET E NXJERRA

Ekzistojnë disa iniciativa të zhvillimit me bazë territorin që përqëndrohen në zhvillimin rural, të cilat janë zbatuar ose janë duke u zbatuar nga organizata të ndryshme që veprojnë në zona të ndryshme të vendit. Përveç të tjerave, nisma të tilla promovojnë dialogun dhe partneritetin ndërmjet administratës publike, sektorit privat dhe shoqërisë qytetare.

Një rishikim i projekteve të mëparshme dhe projekteve aktuale, të realizuara nga organizatat e ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare që përqendrohen në përmirësimin e kushteve të jetesës në zonat rurale në rajone të ndryshme të Shqipërisë, është realizuar nga Rrjeti Shqiptar për zhvillim rural (ANRD, 2016 (c)). Për shembull, sipas studimit të realizuar nga Rrjeti Shqiptar për Zhvillim Rural (ibid), nga gjithsej 23 organizata të intervistuara, 11 prej tyre (48%) kanë raportuar se kanë zbatuar projekte për ngritjen e GLV-ve të tipit LEADER ose nismave të tjera për zhvillim lokal të udhëhequr nga komuniteti në pesë vitet e fundit.

Si rrjedhojë e nismave të shumëllojshme të zhvillimit, anembanë vendit, ekziston një numër i konsiderueshëm i burimeve njerëzore që janë trajnuar dhe aftësuar për zhvillimin me bazë territorin, zhvillimin e integruar dhe me pjesëmarrje, partneritetet vendore, promovim të territorit. Janë hartuar dhe janë në dispozicion strategji të zhvillimit dhe plane veprimi në nivele të ndryshme, siç janë në nivel vendor, nën-rajonal dhe rajonal, përfshi dhe zonat ndërkufitare, si dhe dokumente tjera strategjike për zhvillimin e territoreve. Përveç kësaj, janë hartuar dhe janë në përdorim nga aktorë të ndryshëm të zhvillimit edhe metodologji të ndryshme gjithëpërfshirëse për planifikimin e zhvillimit lokal dhe rajonal, të cilat sigurojnë proçese mjaft pjesëmarrëse në planifikimin lokal. Janë hartuar marrëveshje për Partneritete Publike Private dhe këto marrëveshje janë aktive në mesin e aktorëve të zhvillimit në nivel lokal, rajonal dhe ndër-bashkiak. Janë realizuar studime pilot me qëllim identifikimin e territoreve me kohezion që kanë potenciale të ngjashme zhvillimi, me qëllim lehtësimin e veprimtarive konkrete në nivel nën-rajonal për krijimin e GLV-ve dhe zbatimin e qasjes LEADER.

Programet që janë parë si efektive dhe që prodhojnë rezultate të suksesshme janë ato që mbështesin skema grantesh siç janë MADA, UNDP[26] dhe ALCDF[27]. Të dyja programet janë përpjekur të realizojnë investime në nivel lokal duke u bazuar në procesin me pjesëmarrje dhe në vendimmarrjen lokale. Qëllimi i programeve nuk përqendrohej vetëm në mbështetjen e investimeve në këto zona, por po ashtu përqendrohej në forcimin e veprimtarisë kolektive dhe partneritetit në mesin e aktorëve të ndryhsëm. Mirëpo, qëllimi i dytë filloi të dështojë menjëherë sapo financimi u ndërpre. Të dyja programet tashmë janë të mbyllura, ndërsa ajo çfarë ka mbetur nga këto forume ose grupe janë burimet njerëzore që kanë mbetur në rajon, por nuk ka gjurmë për rigrupim, takime aktive dhe sistematike ose mbledhjeve për qëllime të ngjashme. Organizatat/subjektet e tipit LEADER, në nivel lokal, nën-rajonal/rajonal, siç janë konsorciumet, klasterët, shoqatat, etj., të ngjashme me këta forume, duhet të marrin rolin drejtues në ngritjen e partneriteteve lokale për GLV-të e ardhshme në territoret lokale në të cilat veprojnë. Prandaj, donatorët dhe pushteti lokal duhet të gjurmojnë eksperiencën e krijuar deri më tani dhe të bëjnë përpjekje për të përditësuar rrjetet e tilla bazuar në burimet e mbetura njerëzore dhe kujtesës institucionale të këtyre grupeve.

[26] *Një skemë e përshtatshme për përmirësimin e dialogut është eksperienca e Organizatave të Zhvillimit të Komunitetit të UNDP. Në këtë qasje, grupet bazohen në nivel fshatrash. Niveli i formal është më i ulët sesa në rastin e GLV-ve, por lehtësia e arritjes së besimit dhe rritjes së përgjegjshmërisë është më e lartë. Në grupe të tilla të vogla, është shumë më lehtë të bëhet prioritizimi i ndërhyrjeve, identifikimi i interesave, ekuilibri i pushtetit, si dhe krijimi i besimit.*

[27] *ALCDF ka zbatuar dhe përkrahur 141 iniciativa lokale dhe synon përhapjen e zgjidhjeve lokale edhe në sektorët e qeverisjes vendore, pyjeve, bujqësisë dhe turizmit. Në kuadër të "Shfrytëzimit të Kapaciteteve të OSHC-ve në Veri të Shqipërisë për përmirësimin e biodiversitetit dhe mbrojtjes së mjedisit" është krijuar një projekt me Fondin për Iniciativa Lokale për financimin e projekteve të vogla në zonën e synuar, duke adresuar ruajtjen dhe rritjen e biodiversitetit, menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe luftën kundër ndryshimeve klimatike. Janë zbatuar edhe lehtësira për ngritjen e kapaciteteve (platforma për njohuri, udhëzimi dhe rrjetëzimi për OSHC-të ekologjike në veri të Shqipërisë)*

Tabela B. I. 1: Rasti studimor 1

1. Titulli dhe autori	**"Programi për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Zonave Malore Rurale (SDRMA)"** zbatuar nga Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore (MADA) dhe përkrahur nga IFAD
2. Përmbledhje ekzekutive	MADA ka formuar 21 Forume për zona malore - si strukturë zbatuese e iniciativave LEADER. Objektivat kryesore të këtyre Forumeve ishin të fuqizojnë partneritetet publike private në zonat malore rurale, përfshirjen e partnerëve lokal në procesin e vendimmarrjes në nivel lokal dhe ngritjen e kapaciteteve të aktorëve të ndryshëm lokal për t'u mundësuar atyre të bëhen partnerë potencial për zhvillim lokal, me qëllim shfrytëzimin e burimeve lokale për zhvillimin ekonomik dhe social të territorit.
3. Të dhënat për komunitetin	Bazuar në kriteret e ndërhyrjes së MADA (zonat në lartësi mbi 600 m) u formuan Forume në pjesën dërmuese të rretheve që i mbulon MADA.
4. Sfida	Forumet u shfrytëzuan për zbatimin e Planit/Programit të Investimeve Strategjike të Ndërmarrjeve (SEIP). Objektivi i SEIP ishte të sigurojë një vlerësim më të thellë të prodhimtarisë, përpunimit dhe potencialeve të marketingut të zonave specifike, duke identifikuar problemet kryesore, nevojat dhe fushat e ndërhyrjes për të siguruar mbështetje institucionale dhe financiare për përmirësimin e efikasitetit të aktorëve aktual në zinxhirin e vlerave. Me qëllim rritjen e efikasitetit dhe të pasurit një fokus të qartë, investimet duhet të synojnë dhe të analizohen në nivel të ndërmarrjeve, pavarësisht nga qëllimi për të përmirësuar mirëqenien e komunitetit në zonat e përzgjedhura. Kjo qasje mundëson një analizë më të shëndetshme dhe më të sigurt të kostos dhe përfitimit të investimeve të propozuara, si dhe ndikimit të pritur në rajon.
5. Aktivitetet	U zhvillua një përkufizim i Zonave më pak të favorizuara. U formuan forume; u mbështeten dhe pajisën me logjistikë për përzgjedhjen e projekteve të investimit. U ofruan instrumente për përzgjedhje dhe analizë.
6. Rezultatet	Investimet u bashkë-financuan nga MADA dhe përfituesit, si dhe u miratuan nga forumet. Një qasje e ngjashme u zbatua nga Fondacioni Shqiptar i Zhvillimit të Kapaciteteve Lokale (ALCDF) vitet e fundit. Mirëpo, të dyja programet tashmë janë mbyllur. Për momentin, forumet e themeluara nga MADA nuk janë më aktive. Pritet që Agjencia ta mbaroj misionin e saj në vitin 2017.
7. Mësimet e nxjerra dhe Konkluzionet	Qëndrueshmëria është një kusht themelor për funksionimin e suksesshëm të nismave të tipit LEADER. Prandaj, duhet të identifikohen mekanizma të mbështetjes për të mirëmbajtur rrjetin dhe përditësuar grupet me informacione dhe anëtarë të rinj, si dhe vazhdimisht të sigurohen ngritje kapacitetesh dhe aktivitete për grumbullim të fondeve.
8. Kontaktet	Roland Bardhi Cel: +355 68 20 35 639 e-mail: lbardhi@redeval.org

Oxfam ka punuar me partnerët e shoqërisë civile dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore me qëllim sigurimin e lidhjeve ndërmjet pushtetit vendor dhe komuniteteve rurale, veçanërisht me fuqizimin e zërit të gruas. Në këtë drejtim, ky financim ndihmoi të formohen tre GLV: GLV Adrijon-Vlorë, GLV Maranaj-Shkodër, dhe GLV Drini–Dibër. Çdo GLV ka zhvilluar identitetin e tij vizual; si dhe një sërë broshurash, fletëpalosjesh, si dhe janë përpiluar informacione të tjera për ndërgjegjësimin e komunitetit dhe rritjen e pjesëmarrjes. Shih profilin vijues. Gjithashtu, në vitin 2014, pas vizionit për një turizëm të zhvilluar, vlera të përbashkëta dhe jetë më të mirë në qarkun e Dibrës, ANTARC &

ALCDF formuan edhe një GLV me emrin GLV Deshati. Doli se të dy GLV-ve iu mungojnë financa të sigurta dhe mbivendosja gjeografike me njëra tjetrën (shih Rastin studimor 2).

Table B. I. 2: Case study 2

1. Titulli dhe autori	GLV Drini – Dibër është formuar në kuadër të projektit **"Duke ngritur zërin e saj: Promovimi i Pjesëmarrjes së Grave të varfra në Qeverisje"**, financuar nga DFID, nëpërmjet ndihmës së Oxfam GB Shqipëri. GLV DESHATI - Dibër u formua nga ANTARC & ALCDF në vitin 2014.
2. Përmbledhje ekzekutive	Qëllimi i përgjithshëm i GLV Drini është të promovojë zhvillimin e qëndrueshëm rural duke i shfrytëzuar burimet natyrore dhe njerëzore të zonës; promovimin e përfshirjes së gruas në procesin e vendimmarrjes për zhvillimin rural, si dhe rrjetëzimi me GLV-të tjera. Objektivi kryesor i GLV Deshati është të përmirësojë gjendjen ekonomike të zonës nëpërmjet promovimit dhe mbështetjes së zhvillimit të qëndrueshëm rural me theks të veçantë në mbështetjen e turizmit, mbrojtjen dhe përmirësimin e burimeve siç janë vlerat natyrore dhe trashëgimia kulturore bazuar në nismat publike dhe private.
3. Të dhënat për komunitetin	GLV Drini mbulon Bashkinë e Peshkopisë - njësitë administrative të Tomin, Kastriot dhe Fushë Çidhë. Sipërfaqja e zonës së përfshirë është 6,147 ha dhe me një popullsi prej 20.842 banorë. GLV Deshati mbulon komunitetet e vargmalit Deshat-Korab dhe komunitetet tjera të qarkut të Dibrës. Zona e përfshirë është 1,088 km² me 75,000 banorë.
4. Sfida	Territori i të dy GLV-ve ekzistuese (GLV Drini-Dibër dhe GLV Deshati) mbivendoset me njëri tjetrin. Të dy GLV-të duhet ta rishikojnë territorin që e mbulojnë që të shmanget dukuria që një territor të jetë pjesë e dy GLV-ve të ndryshme. Për më tepër, GLV Drini dhe GLV Deshati janë përballur me vështirësi për sigurimin e financave.
5. Aktivitetet	Të dy GLV-të janë duke luftuar për grumbullimin e fondeve dhe rrjetëzimin me iniciativat e tjera të tipit GLV. Asnjë masë nuk është ndërmarrë për të shmangur mbivendosjen, megjithëse kjo mund të pengojë zhvillimin e mëtejshëm të GLV-ve.
6. Rezultatet	Nismat për formimin e GLV-ve të reja (Deshati GLV) janë duke u zgjuar për shkak të mbështetjes së ardhshme financiare nga IPARD. Mungesa e planifikimit paraprak do të pengonte të dy GLV-të të përfitojnë nga Masa e financimit të IPARD LEADER.
7. Mësimet e nxjerra dhe Konkluzionet	Kordinimi me donatorët është thelbësor për të mundësuar formimin e duhur dhe financimin e qëndrueshëm të këtyre iniciativave. Pritet që Qeveria e Shqipërisë dhe MARDWA si institucione udhëheqëse ta drejtojnë procesin dhe nxitin financimin duke i përshpejtuar hapat për hartimin dhe zbatimin e Masave për promovimin e LEADER në fazën e dytë të zbatimit të IPARD II. Formimi i GLV-ve duhet të konsolidohet gjeografikisht aty ku është e mundur. Çdo përpjekje e mëvonshme për të formuar një GLV duhet të sigurojë informacione nga institucionet vendore dhe qendrore për sipërfaqen që mbulojnë GLV-të tjera tashmë të formuara në të njëjtën zonë interesi.
8. Kontaktet	GLV Drini: ueb adresa: www.LAG-al.net; Tel. +355 021822796 Celulari: +355 (0) 692796311; e-mail: LAGdrini@gmail.com GLV Deshati: adresa e ueb faqes: www.natyradiber.al Tel. 0673840009: e-mail. mehmeti68@yahoo.com ;

4. KONKLUZIONET DHE REKOMANDIMET

4.1 Konkluzionet

Pas dhënies së statusit të vendit kandidat, Shqipëria po përpiqet të nisë një proces të shpejtë të reformës së politikës së saj bujqësore në përputhje me kërkesat e integrimit në BE. Nismat lokale janë pjesë përbërëse e bujqësisë dhe zhvillimit rural dhe kërkojnë një proces vizionar në mënyrë që të menaxhojë mjedisin e ndërlikuar politik dhe ligjor i cili do të promovonte zbatimin e iniciativave të ngjashme me LEADER. Me qëllim vendosjen e një platforme për zhvillimin e këtyre iniciativave, MARDWA po miraton masat që i përshkruajnë prioritetet e politikave në përputhje me Strategjinë ndërsektoriale për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural (ISARD 2014-2020) të ndërlidhura me strategjinë e integrimit në BE për vitet 2014-2020. Mirëpo, përkundër kësaj, ekzistojnë hendeqe të vazhdueshme ndaj kuadrit ligjor që duhet të themelohet, si dhe instrumenteve financiare që duhen zbatuar. Pasi që harta e përcaktuar parashikon masat për mbështetjen e qasjes LEADER pas vitit 2018, ekziston nevoja për përgatitjen e terrenit institucional për absorbimin e mëtejshëm të financave dhe nismave për ngritjen e kapaciteteve.

Kontributi i donatorëve është përpjekur të zbatojë parimet e LEADER dhe formimin e strukturave të tipit GLV për më tepër se një dekadë. Janë zhvilluar nisma për përputhjen e interesave publike, private dhe të sektorit qytetar për promovimin e qasjes LEADER dhe gjallërimin e funksionimit të GLV-ve. Si rezultat, burime të konsiderueshme njerëzore janë përgatitur dhe janë bërë funksionale në nisma të ndryshme si partneritetet lokale, planifikimi territorial, qeverisja me pjesëmarrje dhe vendimmarrja e përgjegjshme për investimet. Janë hartuar dhe janë në dispozicion strategjitë e zhvillimit dhe planet e veprimit në nivele të ndryshme siç janë niveli vendor, nën-rajonal dhe rajonal, si dhe dokumente të tjera strategjike për zhvillimin e territoreve. Janë hartuar strategji lokale, planifikim me pjesëmarrje dhe plane veprimi. Grupe të komuniteteve dhe partneritete të zgjeruara janë fuqizuar në nivel vendor, rajonal dhe ndër-bashkiak. Mirëpo, tërë procesi i ngritjes së kapaciteteve dhe kujtesës institucionale nuk ka qenë i qëndrueshëm dhe kjo e ka sfiduar funksionimin e tyre për shkak të financimit të paqëndrueshëm.

Ekziston sfida për MARDWA dhe aktorët tjerë në fushën e zhvillimit rural për të mbajtur këto iniciativa të gjalla, të strukturuara siç duhet, dhe të nxitura për pranimin e asistencës së para-anëtarësimit dedikuar sektorit të bujqësisë në kuadër të programit IPARD. Skemat aktuale të financimit që i jep MARDWA ose transfertat e pakushtëzuara që u jepen Njësive të Vetëqeverisjes Vendore nuk sigurojnë ndonjë financim për nismat lokale. Hapi i parë do të jetë hartimi i sfondit ligjor dhe kuadrit të strukturuar ndër-institucional për funksionimin e GLV-ve në pajtueshmëri me qasjen LEADER.

4.2 Rekomandimet

Ekzistojnë rekomandime të ndryshme që duhen konsideruar gjatë analizimit të përvojës që buron nga gjendja aktuale dhe nismave të mëparshme.

Rekomandime për përmirësimin e strukturës institucionale

- Agjencitë për zhvillim rajonal duhet të vazhdojnë me zgjerimin e rolit të tyre drejt promovimit të GLV-ve. Qeveritë vendore dhe agjencitë për zhvillim rajonal duhet ta përgatisin terrenin për krijimin/ngritjen e GLV-ve duke e rritur informimin rreth dokumentacionit ekzistues dhe kapaciteteve të krijuara. Nismat pilot duhen testuar, ndërsa modelet e përpjekjeve të suksesshme trepalëshe duhen përsëritur. Qëndrueshmëria e projekteve duhet siguruar nëpërmjet formimit të forumeve/grupeve lokale të bazuara në partneritete prej aktorëve

zhvillimorë, të cilat dallojnë nga krijimi dhe promovimi i grupimeve ekonomike; formimi i forumeve tematike për fuqizimin e GLV-ve ekzistuese ose formimi i GLV-ve të reja, madje dhe formimi i shoqatave të profileve të ndryshme (pyjet, prodhues të vegjël, etj.); Në disa zona të vendit, siç janë zoant malore, krijimi i GLV-ve mund të nisë duke u mbështetur dhe duke mundësuar sinergji me iniciativat e mëparshme të zhvillimit të zonës (për shembull, shfrytëzimin ose rifreskimin e 21 forumeve të formuara nga MADA). Ato mund të shërbejnë si pikënisje për formimin e GLV-ve, mirëpo procesi duhet të jetë i hapur për të përfshirë njerëz të përkushtuar për çështjet e komunitetit vendor dhe të zhvillimit.

- Nuk ekzistojnë rrjete kombëtare ose njësi të zhvillimit rural të formuara nga ministritë ose të financuara me burime publike. MARD, RDA dhe Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore duhet tju referohen GLV-ve ekzistuese në procesin e formimit të kuadrit institucional në lidhje me qasjen LEADER. Duhet përqendruar në përpjekjet e bëra në kuadër të ANRD për krijimin e zhvillimit rural. Rrjeti është i gjerë, por me përfshirjen e akademisë (Universiteti Bujqësor i Tiranës) do të krijoheshin nisma të realizueshme.

Rekomandime për përmirësimin e politikave

- Ligji për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural ka përcaktuar masën "mbështetje për zhvillimin e nismave lokale/vendore". Zbatimi i qasjes LEADER nuk është zyrtarisht i rregulluar me një ligj konkret - nevojiten specifikime plotësuese për statusin ligjor të GLV-ve dhe trajtimin e tyre fiskal, veçanërisht regjimi TVSH që mbulon shërbimet e siguruara nga OJF-të. Si zëvendësues i Ligjit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural i ndryshuar që mund të ndodhë ngadalë, një vendim i Ministrit ose rregulloret vjetore mund ta përshpejtojnë Kuadrin ligjor dhe të sigurojnë një bazë të përshtatshme ligjore për formimin e kapaciteteve lokale për partneritete, përfshirje dhe avancim të kapaciteteve të absorbimit, gjë e cila mund të ndihmojë në mobilizimin e potencialeve vendore, promovimin e partneriteteve publik-private dhe bashkëpunimin. Specifikat ligjore duhet të jenë në pajtueshmëri me dispozitat e BE-së 1305/2013 dhe BE 1303/2013.
- Qeveria e Shqipërisë (QSH) dhe Ministria e Bujqësisë (MARD) pritet të udhëheqin këtë proces dhe të nxisin financimin duke i përshpejtuar hapat për hartimin dhe zbatimin e masave për promovimin e qasjes LEADER në fazën e dytë të zbatimit të programit IPARD II. Marrëveshja IPARD ka përcaktuar intensitetin e ndihmës, normën e kontributit për BE-në, pranueshmërinë, si dhe ka përcaktuar propozim/draft masën dhe aktivitetet shoqëruese. Të dy marrëveshjet (FA dhe IPARD) të cilët i identifikojnë kriteret kryesore ligjore dhe institucionale për formimin dhe operimin e GLV-ve akoma nuk janë përcaktuar. Gjithashtu, detyrat dhe funksionet e GLV-ve, procedurat dhe vendimmarrja brenda GLV-ve akoma nuk janë përcaktuar. Ministria e bujqësisë (MARDWA) duhet të formojë një grup pune ndër-institucional që do të jetë në krye të procesit të programimit, realizimit të një trajnimi prezantues për grupin dhe të zhvillojë një program për ngritjen e kapaciteteve që duhet të zbatohet sipas masës së IPARD TA për GLV-të potenciale. Gjithashtu MARDWA duhet të përgatitë draft-propozimet e Termave te Referencës për përzgjedhjen e konsulentëve që do të angazhohen për ngritjen e kapaciteteve të GLV-ve dhe hartimin e strategjive përkatëse të zhvillimit, si dhe të sigurojë trajnime në punë në të gjitha temat e sipërpërmendura për sektorin e programimit pranë Ministrisë së bujqësisë me qëllim konsolidimin e kapaciteteve të tyre për programimin strategjik të kësaj mase.
- GLV-të e krijuara tashmë kanë dëshmuar të jenë financiarisht të paqëndrueshme pas përfundimit të financimit nga donatorët. Po rigjallërohet një iniciativë për formimin e GLV-ve të reja për shkak të mbështetjes së ardhshme financiare sipas komponentit IPARD. Kordinimi me donatorët është thelbësor për të mundësuar formimin e duhur dhe financimin e qëndrueshëm të këtyre iniciativave. Ministria e Bujqësisë (MARDWA) duhet të marrë përsipër njoftimin dhe kordinimin e donatorëve. Promovimi i GLV-ve përmes organizimit të tryezave të rrumbullakëta dhe vazhdimit të komunikimit me donatorët do t'i lehtësonte përpjekjet e donatorëve në këtë fushë.

Rekomandime për fuqizimin e aktorëve lokal

- Subjektet/organizatat e tipit LEADER në nivel lokal, nën-rajonal/rajonal siç janë konsorciumet/ partneritetet, klasterët/grupimet, shoqatat, etj., duhet të kenë rol udhëheqës në formimin e partneriteteve lokale për GLV-të e ardhshme në territoret lokale në të cilat operojnë. Edhe njësitë e vetëqeverisjes vendore edhe komuniteti i biznesit janë të papërgatitur dhe të painformuar rreth instrumenteve LEADER. Agjencitë për zhvillim rajonal duhet të krijojnë sinergji me aktorët e tjerë lokal për të rritur ndërgjegjësimin dhe promovuar nismat lokale. Ekziston nevoja e transferimit të praktikave të mira të LEADER të BE nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve për të krijuar aktivitete kolektive, subjekte të përgjegjshme, pjesëmarrje më të madhe dhe shkathtësi për menaxhimin e ciklit të projekteve.
- Formimi i GLV-ve duhet të konsolidohet gjeografikisht kurdo që është e mundur. Metodologjitë e planifikimit lokal duhet të grumbullohen, studiohen dhe shfrytëzohen për krijimin e një metodologjie lehtësisht të qasshme dhe gjithëpërfshirëse me qëllim hartimin e strategjive lokale për GLV-të. Strategjitë e planifikimit lokal për GLV-të duhet të rishikohen që të jenë në pajtueshmëri me përmbajtjet e strategjive të tilla të rekomanduara nga BE.

5 SHTOJCAT

5.1 Shtojca 1: Referencat

FAO, 2014, Politika e Bujqësisë dhe Integrimi Evropian në Evropën Juglindore, gjendet në: http://www.fao.org/3/a-i4166e.pdf

QSH 2013, Strategjia kombëtare për zhvillim dhe integrim (NSDI) 2014-2020

Komisioni Evropian (2014). Raporti i Progresit për Shqipërinë 2014. Strategjia e zgjerimit dhe sfidat kryesore 2014-2015. Dokumentet e stafit të punës së Komisionit. Bruksel, Belgjikë.

Komisioni Evropian (2016). Dokumenti i stafit të punës së Komisionit në Shqipëri – raporti 2015 që shoqëron dokument-komunikimin nga Komisioni në Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetin e Rajoneve

MARDWA (2014). Strategjia ndër-sektoriale për bujqësinë dhe zhvillimin rural në Shqipëri (ISARD), versioni draft, Tiranë, Shqipëri, Miratuar nga VKM. 709, datë 29.10.2014.

MARDWA (2013). Drafti i Programit për zhvillimin rural 2014 - 2020 sipas Instrumentit për asistencë para-anëtarësimi (IPA), Versioni 19/12/2013, Tiranë, Shqipëri.

MARDWA, (2014(a), Master-Plani i Veprimit për zbatimin e ISARD 2014-2020, dokumentet e stafit të punës.

MARDWA, (2014) (b), Shënim shpjegues për Master-Planin e Veprimit për zbatimin e ISARD, dokumentet e stafit të punës.

MARDWA, (2014) (c), Raport për Bashkimin Evropian: Takimi i nën-komitetit për bujqësinë dhe peshkimin për vitin 2013– Shqipëri

MARDWA. (2014) (d). Strategjia ndër-sektoriale për bujqësinë dhe zhvillimin rural (ISARD 2014-2020)

MARDWA. (2014) (f). Procedurat dhe mënyra e administrimit të fondit për programin e bujqësisë dhe zhvillimit rural. Udhëzimi Nr.4, datë 4.11.2014. Tiranë, Shqipëri.

MARDWA, (2016) (a), Plani i veprimit për zbatimin e ISARD 2016-2018, dokumentet e stafit të punës.

MARDWA (2016) (b), Raportet vjetore për Këshillin e Ministrave, dokumentet e stafit të punës.

MARDWA, (2016) (c), Raport i Shqipërisë për Bashkimin Evropian- Takimi i nën-komitetit për bujqësinë dhe peshkimin për vitin 2015.

MARDWA, (2016), Raport i Shqipërisë për Bashkimin Evropian- Takimi i nën-komitetit për bujqësinë dhe peshkimin për vitin 2014.

Dokumentet e autorizuara / Raportet

Raportet në vijim janë pjesë e projektit të njëjtë: Projekti EU IPA 2011 "Mbështetje për bujqësinë dhe zhvillimin rural" (SARD – IPARD), (Rrjeti shqiptar për zhvillim rural, 2016):

1. (ANRD, 2016 (a)) Analiza e kornizës ligjore dhe rregulloreve normative për Grupet lokale të veprimit.
2. (ANRD, 2016 (b)), Sondazhi i përvojës në Qasjen LEADER në Shqipëri
3. (ANRD, 2016 (c). Sondazh për gjendjen aktuale dhe përvojën e fituar me qasjen LEADER
4. (ANRD, 2016 (d)), Profilet e organizatave mbështetëse aktive në zhvillimin rural dhe programet e donatorëve.

5.2 Shtojca 2: Ligjet dhe rregullat

Ligjet dhe rregullat

1. Ligji nr. 9817, datë 22.10.2007 Për Bujqësinë dhe zhvillimin rural (Gazeta zyrtare Nr. 148, 6 tetor, 2007)
2. Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (Gazeta zyrtare Nr. 249, e enjte, 14 janar, 2016)
3. Ligji nr. 37/2015 datë 09.04.2015, ratifikimi i Marrëveshjes kornizë midis Republikës së Shqipërisë, e përfaqësuar nga Këshilli i ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian mbi rregullat e zbatimit të mbështetjes financiare të BE për Shqipërinë në kuadrin e Instrumentit për Asistencë Para-anëtarësimi (IPA II) (Gazeta zyrtare Nr. 66, E enjte, 30 prill, 2015) (referuar si "FA").
4. Ligji nr. 30/2016 datë 17.03.2016 "Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet sektorit të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Komisioni Evropian, i cili përcakton dispozitat e menaxhimit dhe zbatimit të ndihmës financiare të BE për Republikën e Shqipërisë, në kuadrin e Instrumentit përasistencë para-anëtarësimi, në fushën e "Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural" (IPARD) (Gazeta zyrtare Nr. 51, E hënë, 4 prill, 2016) (referuar si "IPARD")
5. Ligji "Për vetëqeverisjen vendore". Gjendet në: https://www.imolin.org/doc/amlid/Albania_Law%20No.%208788%20On%20Non-Profit%20Organizations.pdf .
6. Ligji nr.8789, "Mbi regjistrimin e organizatave jofitimprurëse". Gjendet në http://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2016/02/NGO-Registration.8789.pdf.
7. Ligji nr. 37/2015 datë 09.04.2015, ratifikimi i Marrëveshjes kornizë midis Republikës së Shqipërisë, e përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian për zbatimin e rregullave të mbështetjes financiare të BE për Shqipërinë në kuadrin e Instrumentit për Asistencë Para-anëtarësimi (IPA II) (Gazeta zyrtare Nr. 66, E enjte, 30 prill, 2015) (referuar si "FA").
8. Ligji nr. 30/2016 datë 17.03.2016 "Mbi ratifikimin e Marrëveshjes midis Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian, i cili rregullon dispozitat e menaxhimit dhe zbatimit të mbështetjes financiare të BE për Republikën e Shqipërisë, në kuadrin e Instrumentit për Asistencë Para-anëtarësimi, në fushën e "Bujqësisë dhe zhvillimit rural" (IPARD) (Gazeta zyrtare Nr. 51, E hënë, 4 prill, 2016) (referuar si "IPARD")
9. Ligji nr.7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil", i ndryshuar (Nenet 39 - 53/1)

10. Ligji nr.8788, datë 07.05.2001 "Mbi organizatat jofitimprurëse", i ndryshuar. Ligji përcakton rregullat për krijimin, organizimin dhe funksionimin e organizatave jofitimprurëse që punojnë për interesin publik. Neni 3 thotë "Organizatat jofitimprurëse" do të thotë shoqata, fondacione dhe qendra, aktivitetet e të cilave zhvillohen në mënyrë të pavarur dhe pa u ndikuar nga shteti.
11. Ligji nr.8789, datë 07.05.2001 "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse"
12. Ligji nr. 9817, datë 22.10.2007, Për bujqësinë dhe zhvillimin rural (Gazeta zyrtare Nr. 148, 6 nëntor, 2007)

Vendimi i Këshillit të Ministrave

1. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 966, datë 12.02.2015 "Për përcaktimin e funksioneve, të përgjegjësive dhe të marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve dhe strukturave të menaxhimit indirekt të asistencës së Bashkimit Evropian, në kuadër të Instrumentit për Asistencë Para-anëtarësimi, IPARD II (2014-2020), sektori i bujqësisë dhe zhvillimit rural" (Gazeta zyrtare Nr. 210, E mërkurë, 9 dhjetor, 2015
2. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 709, datë 29.10.2014 Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për bujqësinë dhe zhvillim rural 2014-2020 (Gazeta zyrtare Nr. 169, E mërkurë, 5 nëntor, 2014) (referuar si "SNBZHR")
3. Dokumenti Strategjik Indikativ për Shqipërinë (2014-2020), miratuar më 18.08.2014 (referuar si "Dokument Strategjik")
4. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 74, datë 27.01.2016 Për miratimin e Planit kombëtar për integrimin Evropian 2016-2020 (Gazeta zyrtare Nr. 17, E martë, 9 shkurt, 2016 (referuar si "PKIE")
5. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 348, datë 11.05.2016 Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 (Gazeta zyrtare Nr. 86, E mërkurë, 25 Maj, 2016) (referuar si "NSDI")
6. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 691, datë 07.29.2015 Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore nga 2015 deri 2020 (Gazeta zyrtare Nr. 147, E enjte, 13 gusht, 2015) (referuar si "Strategjia për Decentralizim")
7. Programi i zhvillimit rural 2014-2020 në kuadër të Instrumentit për Asistencë Para-anëtarësimi.

Normat e BE

1. Rregullorja nr. 231/2014 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian (BE) datë 11 mars 2014, mbi krijimin e Instrumentit për Asistencë Para-anëtarësimi (IPA II) (GZ L 77, 15 mars 2014)
2. Rregullorja nr. 236/2014 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian (BE) datë 11 mars, 2014, i cili përcakton rregullat dhe procedurat e përbashkëta për zbatimin e instrumenteve të BE-së për financimin e veprimtarisë të jashtëme (GZ L 77, 15 mars, 2014)
3. Rregullorja nr. 1305/2013 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian (BE) datë 17 dhjetor 2013 mbi mbështetjen e zhvillimit rural nga Fondi Evropian për bujqësinë dhe zhvillimin rural (EAFRD) dhe shfuqizimin e Rregullores së Këshillit (KE) nr. 1698/2005
4. Rregullorja e Komisionit mbi zbatimin nr. 447/2014 (BE), mbi rregullat specifike për zbatimin e Rregullores (BE) 231/2014, Parlamenti dhe Këshilli Evropian, për krijimin e Instrumentit për Asistencë Para-anëtarësimit (IPA II) (GZ L 132, 3 maj, 2014).

5.3 Shtojca 3: Lista e kontakteve

Grigor Gjeci, grigor.gjeci@bujqesia.gov.al, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave

Sotiraq Hroni, shroni@idmalbania.org, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Evelina Azizaj, eazizaj@idmalbania.org, Rrjeti Shqiptar për Zhvillim Rural

Roland Bardhi, lbardhi@redeval.org, Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore

KAPITULLI B.II

Vlerësimi i zbatimit të qasjes LEADER në vendet e Ballkanit Perëndimor - “nga një iniciativë lokale në një koncept qendror në zonat rurale

Raporti për vendin: Bosnjë dhe Hercegovinë,
Entiteti: Federata e Bosnjë dhe Hercegovinës

Autor: Z. Sabahudin Bajramovic

1. HYRJE

Qasja LEADER, si një koncept i BE për mobilizimin dhe arritjen e zhvillimit rural në komunitetet rurale lokale në Federatën e BH, akoma nuk është e njohur si e tillë dhe në praktikë është në fazën e saj fillestare në këtë pjesë të BH. Përvojat pozitive të BE në zbatimin e programit LEADER dhe përfshirjen e partnerëve lokal në menaxhimin e zhvillimit të ardhshëm të zonave të tyre, janë arsyet për pranimin e këtij koncepti dhe për orvatjen për ta zhvilluar sa më parë të jetë e mundur. Për më shumë, sepse Federata është kryesisht (86.7%) një zonë rurale me më shumë se gjysmën (53.3%) e popullsisë[28] së Federatës që jeton atje. Për fat të keq, politika për zhvillimin rural në Federatë akoma nuk është pjesë e rëndësishme e politikës së saj të përgjithshme bujqësore, e cila pasqyrohet në mospërputhshmërinë e saj, në mbështetjen e pamjaftueshme financiare dhe në shpërfilljen e komponentit të saj të zhvillimit. Në këtë entitet të BH, me një status të ngjashëm dhe madje edhe më të keq është iniciativa LEADER, sepse ajo akoma nuk është pjesë përbërëse e politikës rurale.

Në veçanti, Federata ende nuk ka një dokument strategjik që ka të bëjë me politikën e zhvillimit rural dhe qasjen LEADER. Megjithëse "Programi për zhvillimin rural për Federatën e BH 2015-2020" është krijuar në vitin 2014, ende nuk është miratuar dhe së këndejmi nuk ka dimension ligjor të pranueshmërisë. Ky program i dha një vend të rëndësishëm iniciativës LEADER dhe krijimit të grupeve lokale të veprimit (GLV) përmes tre masave të përcaktuara: (1) krijimi dhe zhvillimi i partneriteteve GLV, (2) përfitimi i aftësive, mobilizimi i popullsisë në zonat që mbulohen nga GLV-të për të forcuar kapacitetet dhe për të mobilizuar GLV-të e përzgjedhura, dhe (3) zbatimi i strategjive të zhvillimit lokal për punën e GLV-ve të përzgjedhura. Mbështetja buxhetore nuk mund të shpërfillet; ajo lëviz midis 75,000 dhe 250,000 euro në vit.

Përgjegjësia për programimin, zbatimin dhe financimin e politikave për zhvillimin rural në Federatë i takon Ministrisë së Bujqësisë, Administrimit të Ujërave dhe Pyjeve të Federatës. Përveç këtij niveli, organet E tjera kompetente për politikat e bujqësisë dhe të zhvillimit rural janë ministritë përkatëse të kantoneve (divizioneve). Fatkeqësisht, këto nivele të qeverisjes nuk kanë ofruar ndonjë mbështetje të konsiderueshme financiare as për iniciativën LEADER, as për krijimin e GLV-ve.

GLV-të ekzistuese që veprojnë në Federatë regjistrohen sipas Ligjit për Shoqatat dhe Fondacionet të Federatës së BH[29]. Ky ligj i ka njohur GLV-të si një lloj i veçantë organizatash, themeluesit e të cilëve janë persona juridik dhe fizik të regjistruar në regjistra në vend të përfaqësuesve të personave juridik, gjë që ndodh më shpesh në rastin e regjistrimit të shoqatave civile. Sa i përket kuadrit rregullator, duhet të theksohet se akreditimi i GLV-ve aktualisht nuk është i mundur në BH/FBH, pra nuk ka asnjë organ përkatës në asnjë nivel qeverisjeje që do të mundësonte regjistrimin e GLV-ve në regjistra të veçantë si bazë për GLV-të për të ushtruar të drejta të veçanta.

Financimi i GLV-ve është një nga problemet kryesore me të cilin ballafaqohen tre GLV-të e regjistruara në Federatë (GLV Una-Sana, GLV Rajoni Doboj, dhe GLV Drina). Pjesa më e madhe e fondeve vijnë nga donatorët (projekte ndërkombëtare), ndërsa pjesa tjetër përbëhet prej fondeve publike nga komunat partnere dhe tarifave për anëtarësi. Të ardhurat vjetore ndryshojnë nga viti në vit, dhe një problem i veçantë është mbështetja e paqëndrueshme nga buxhetet e komunave që kryesisht siguron funksionim të rregullt të GLV-ve.

[28] *Bazuar në të dhënat e Censusit të popullsisë së vitit 2013 dhe kriterin e OECD-së që përcakton zonat rurale (dendësia e popullsisë nën 150 banorë për km2 në nivel lokal), 86.37% (22.550 km2) të territorit të Federatës së Bosnjë dhe Hercegovinës (FBH) me 53.31 % (1,183,101) e popullsisë së përgjithshme të kësaj njësie të BH konsiderohet një zonë rurale.*

[29] *Gazeta Zyrtare e FBH 45/02*

UNDP dhe projekti i tij " Partneriteti për projekte të zhvillimit lokal - SUTRA" meritojnë besimin për krijimin e iniciativës LEADER dhe prezantimin e GLV-ve në BH/FBH. Ky projekt rezultoi në krijimin e GLV-së më aktive dhe më të zhvilluar - GLV Una-Sana. Përveç kësaj, në Federatë veprojnë edhe dy GLV tjera - GLV Rajoni Doboj (që mbulon një pjesë të Republikës Serbe të Bosnjës) dhe GLV Drina. Të tre GLV-të mbulojnë 9.36% të territorit të Federatës me 8.1% të popullsisë së saj totale. Ky është një tregues tjetër i nënvlerësimit të iniciativës LEADER në këtë pjesë të BH.

2. MJEDISI LEADER NË FEDERATËN E BOSNJË DHE HERCEGOVINËS

2.1 LEADER në dokumentet kombëtare strategjike dhe hartuese të programeve

BH akoma nuk ka një dokument strategjik që ka të bëjë me politikat për zhvillim rural dhe Qasjen LEADER në nivel shtetëror. Një dokument i tillë është duke u zhvilluar (Plani strategjik për zhvillim rural të BH për periudhën 2018-2021), dhe nëse BH dëshiron të aplikojë për fondet e programit IPA II, ky dokument duhet të miratohet në të gjitha nivelet e saj të qeverisjes deri në nëntor të vitit 2017. Në mënyrë të veçantë, BH ende nuk ka qasje në fondet IPARD sepse duhet të plotësojë kërkesat e përmendura më parë, përveç mekanizmit të kordinimit tashmë të krijuar.

As FBH nuk ka një dokument strategjik të bazuar në ligj (të miratuar nga Parlamenti i Federatës), për politikën e zhvillimit rural dhe qasjen LEADER. Një Program për zhvillim rural të FBH 2015-2020 është zhvilluar që në vitin 2014, por akoma nuk është miratuar. Ky program i dha një vend të rëndësishëm iniciativës LEADER dhe krijimit të GLV-ve. FMA WMF është i përkushtuar për zhvillimin e metodologjisë LEADER në të gjithë territorin e Federatës, krijimin e GLV-ve dhe krijimin e strategjive të fuqishme të zhvillimit lokal. Ky program ka përcaktuar tri masa: (1) themelimi dhe zhvillimi i partneritetit GLV, (2) përfitimi i aftësive, angazhimi i popullsisë së zonave të GLV-ve në fuqizimin e kapaciteteve dhe angazhimin e GLV-ve të përzgjedhura, dhe (3) zbatimi i strategjive për zhvillim lokal për punën e GLV-ve të përzgjedhura. Buxheti për zbatimin e masave të përcaktuara varion midis 75,000 dhe 250,000 euro në vit. Mbetet një shpresë që ky program të miratohet sa më shpejt që të jetë e mundur, si një kornizë ligjore për zbatimin e masave të mirë-përcaktuara të iniciativës LEADER në këtë entitet të BH.

Kompleksiteti i shtetit të BH është pasqyruar edhe në kompetencat e konsiderueshme të kantoneve në FBH. Sa i përket politikës për zhvillim rural dhe iniciativës LEADER në nivel të kantoneve, akoma asnjë kanton nuk e ka trajtuar në mënyrë strategjike këtë fushë problemore.

Dokumentet strategjike për zhvillim lokal janë të rëndësishme për iniciativën LEADER dhe për përfshirjen e komunave në partneritete publiko-private. Fatkeqësisht, nuk ka dokumente strategjike në nivel federal. "Plani strategjik për vetëqeverisjen lokale në BH," bazuar në parimet e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore, i vlefshëm për periudhën 2006–2012 ishte baza për veprim në Federatë.

2.2 Rregullimet institucionale dhe ligjore

Entitetet dhe Distrikti Bërçko, respektivisht ministritë e tyre kompetente (kantonet) për bujqësinë, administrimin e ujërave dhe pyjeve janë përgjegjëse për zhvillimin, financimin dhe zbatimin e

politikave bujqësore dhe politikën për zhvillim rural në BH. Ministria kompetente për sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural është Ministria e Tregtisë së Jashtme dhe Marrëdhënieve Ekonomike (MOFTER), përkatësisht Divizioni i saj për Sektorin e bujqësisë, ushqimit dhe zhvillimit rural, me detyrë kryesore kordinimin e politikave të mësipërme. Iniciativa LEADER dhe qasja LEADER si pjesë e politikës për zhvillimin rural në BH, përkatësisht FBH, akoma nuk kanë një kornizë ligjore e cila i definon qartë ato për specifikat e shumta të tyre siç janë rregulluar në shtetet e BE.

Përgjegjësia për programim, zbatim dhe financim të politikave për zhvillimin rural në FBH bie mbi Ministrinë kompetente për bujqësinë, administrimin e ujërave dhe pyjet të Federatës. Përveç këtij niveli, organet tjera kompetente për politikat e bujqësisë dhe zhvillimit rural janë ministritë përkatëse të kantoneve (divizionet). Fatkeqësisht, këto nivele të qeverisjes nuk kanë ofruar ndonjë mbështetje të konsiderueshme financiare as për iniciativën LEADER, e as për krijimin e GLV-ve. Tre GLV-të ekzistuese janë vetëm rezultat i iniciativave lokale dhe mbështetjes së institucioneve donatore ndërkombëtare.

Në BH nuk ka rrjet zyrtar formal të financuar me fonde publike në nivel shteti dhe/ose entiteti, por ekziston një organizatë e shoqërisë civile "Rrjeti për zhvillim rural në BH", në të cilin në mes tjerash, një kontribut i konsiderueshëm themelues u sigurua nga GLV Una-Sana dhe Shoqata Evropiane LEADER për zhvillimin rural (ELARD). Me aktivitetet e tyre në lidhje me FBH, GLV Una-Sana dhe GLV Rajoni Doboj janë anëtarë të një rrjeti i cili është nga na tjetër anëtar i Rrjetit Ballkanik për zhvillim rural (BNRDN), Partneritetit për Evropë rurale (PREPARE), dhe rrjetet e Shoqatës Evropiane LEADER për zhvillimin rural (ELARD).

GLV-të ekzistuese që veprojnë në FBH janë të regjistruara sipas Ligjit mbi shoqatat dhe fondacionet të Federatës së BH (Gazeta Zyrtare e FBH 45/02)[30]. Ndryshe nga ligji i nivelit shtetëror[31], ky ligj parashikon regjistrimin e shoqatave nga themeluesit e identifikuar si komuna, qytete dhe institucione tjera shtetërore. Pas regjistrimit si shoqatë në nivelin e Federatës, GLV-të duhet të njihen si një lloj i veçantë i organizatave, themeluesit e të cilëve janë persona fizik dhe juridik të regjistruar në regjistra dhe jo përfaqësues të personave juridik, gjë që kryesisht ndodh në rastin e regjistrimit të shoqatave civile. Ky problem mund të zgjidhet vetëm përmes akreditimit të GLV-ve nga një institucion kompetent. Tani për tani, kjo nuk është e mundur në BH/FBH, përkatësisht akoma nuk ka një organ në asnjë nivel të qeverisjes në BH i cili mund të sigurojë akreditim të lehtë të GLV-ve dhe regjistrimin e tyre në regjistra të veçantë të GLV-ve si një bazë për GLV-të që të ushtrojnë të drejta të veçanta të rezervuara vetëm për GLV-të e akredituara.

Ligji aktual mbi parimet e vetëqeverisjes vendore në Federatën e BH (Gazeta Zyrtare e FBH 49/06 dhe 81/09) parashikon, ndër të tjera, format e bashkëpunimit midis njësive të vetëqeverisjes dhe një mundësi për krijimin e bashkëpunimit me njësi tjera në kryerjen e veprimtarive me interes të përbashkët.

Aktualisht ka tre GLV në FBH: GLV Una Sana, GLV Drina, dhe GLV Rajoni Doboj, pjesë e të cilit është në RS. Për momentin e dhënë, ka vetëm një iniciativë për GLV Blidinje (territoret e komunës Tomislavgrad dhe Posusje). GLV Una-Sana është Grupi lokal i veprimit më i vjetër (i themeluar në vitin 2008) në FBH dhe mbulon tre komuna: Sanski Most, Bosanska Krupa, dhe Buzim. GLV Drina është një Grup lokal i veprimit i cili mbulon territorin e Kantonit boshnjak Podrinje, respektivisht tre komuna në këtë kanton: Gorazhde, Pale-Praça, dhe Foça-Ustikolina. GLV e tretë në Rajonin e

[30] *Burimi: Zhvillimi lokal dhe LEADER nën udhëheqjen e komunitetit të Bosnjës dhe Hercegovinës (2015)*

[31] *Legjislacioni ekzistues shtetëror nuk është në favor të GLV-ve sepse Ligji për shoqatat dhe fondacionet i BH ndalon shtetin, entitetin, kantonin, qytetin, komunën, seksionet e qytetit ose autoritetet e tjera qeveritare që të krijojnë një GLV.*

Doboj është një GLV e përzier ndërmjet entiteteve i cili mbulon territorin e komunave Maglaj dhe Graçanica nga FBH dhe Doboj nga RS.

GLV Una-Sana dhe GLV Rajoni Doboj janë regjistruar sipas Ligjit shtetëror për shoqatat dhe fondacionet, ndërsa GLV Drina është themeluar sipas ligjit përkatës të kantonit.

Tabela B. II.1: Sipërfaqja dhe numri i popullsisë së GLV-ve sipas Censusit të vitit 2013

Emri i GLV	Sipërfaqja e GLV (km2)	Popullsia në zonën e GLV	Komunat që mbulohen nga
Una-Sana	1.471	86,360	Sanski Most, Bosanska Krupa, Buzim
Drina	504,6	23,734	Gorazhde, Pale-Praca, Foca-Ustikolina
Rajoni Doboj (Pjesa në FBH)	1,116 (468 në FBH)	136.880 (68,366 në FBH)	Doboj (RS) Maglaj (FBH) Gracanica (FBH)

Shënim: Numri i popullsisë sipas Censusit të vitit 2013

GLV-të mbulojnë 2,443.6 km2, d.m.th 9.36% të territorit të Federatës me një popullsi prej 178,460, d.m.th 8.04% nga popullsia e përgjithshme në këtë entitet të BH. Nga gjithsej 79 komuna (qytete) në FBH, vetëm 8 komunitete lokale kanë një iniciativë aktuale GLV.

2.3 Financimi

Sipas bazës së të dhënave të APM për BH (FBH) të projektit SWG JRC (2016)[32], nuk ka pasur mbështetje për iniciativën LEADER dhe për punën e GLV-ve në FBH në nivel të kantoneve dhe të entiteteve në periudhën 2006–2015.

Siç u përmend dhe më herët, akoma nuk ka plan zyrtar strategjik në FBH për zbatimin e politikave për zhvillim rural. Plani aktual për zhvillim rural i FBH (akoma i pa miratuar) parashikon një buxhet zbatimi për masat e përcaktuara të iniciativës LEADER midis 75,000 dhe 250,000 euro në vit, 25-33% e të cilëve llogariten për zbatimin e nën-masës "Përfitimi i aftësive, aktivizimi i popullsisë së zonave rurale dhe themelimi i GLV-ve" dhe 67-75% për nën-masën "Mbulimi i kostove rrjedhëse lokale për drejtimin e GLV-ve të përzgjedhura dhe zbatimin e SZHL (strategjive e zhvillimit lokal)", që nga viti 2017.

Sipas raporteve të MOFTER mbi punën e GLV-ve në FBH, burimet më të rëndësishme të financimit në këtë entitet të BH janë fondet e donatorëve, fondet publike dhe tarifat për anëtarësim. Të gjithë këto ndryshojnë nga viti në vit dhe nga një GLV në një tjetër. Në vitin 2015, GLV Una-Sana kishte të ardhura totale prej 122,000 euro, 15% e të cilave ishin fonde publike dhe 85% tjera ishin fonde donatorësh. GLV Rajoni Doboj nuk kishte fonde nga donatorët në vitin 2015 dhe ishte financuar vetëm nga tarifat për anëtarësim të personave juridik (15,000 euro).

Një nga problemet kryesore me të cilin ballafaqohen GLV-të ekzistuese në FBH është pamundësia për të mbledhur fonde për projektet e zhvillimit nga donatorët e huaj, sepse nuk mund të ofrojnë bashkëfinancim. Ndonjëherë, për shkak të burimeve modeste në dispozicion, komunitetet lokale nuk janë në gjendje të bashkë-financojnë projekte të mëdha infrastrukturore, kështu që ndihma të

[32] *Burimi: Projekti JRC SWG (2016) - Instrumentet e politikave kombëtare dhe procesi i përafrimit në BE: Efektet në njësitë ekonomike bujqësore në vendet e Ballkanit Perëndimor - Pjesa: Bosnja dhe Hercegovina: Vlerësimi dhe Zhvillimi i politikave bujqësore*

tilla duhet të kërkohen përmes përfshirjes së aktorëve të tjerë, siç janë ministritë kompetente të entitetit/kantoneve.

Në FBH (BH), edhe pse shumë më pak se më parë, ende ka shumë organizata ndërkombëtare (USDA, SIDA, CARITAS, GIZ) të cilët financojnë projekte për zhvillim dhe projekte për zhvillim rural. GLV-të ekzistuese mund ta gjejnë vendin e tyre atje.

3. NISMAT E MËPARSHME DHE MËSIMET E NXJERRA

Falë UNDP dhe projektit të tij "Partneritet për projekte të zhvillimit lokal - SUTRA" u arritën zhvillimet fillestare dhe themelimi i grupeve të para lokale për veprim (GLV) në BH. Domethënë, UNDP mbështeti "të kthyerit" përmes GLV-ve duke përfshirë komunat, OJF-të dhe sektorin e biznesit në bashkëpunim bazuar në partneritet dhe përgjegjësi të qarta midis pjesëtarëve. Për krijimin e GLV-ve të tilla nuk janë përdorur parime të përcaktuara qartë LEADER, por për herë të parë u zbatua një partneritet mes sektorit publik, privat dhe civil, prandaj besohet që projekti ka realizuar hapat e parë drejt krijimit të GLV-ve në BH. Megjithëse projekti ka paraparë krijimin e një numri më të madh të GLV-ve, pas zbatimit të tij në FBH janë krijuar vetëm dy prej tyre: GLV Una-Sana dhe GLV Doboj (pjesa e cila gjendet në RSB).

Asistenca për institucionet e BH lidhur me prezantimin e LEADER si një qasje novatore në krijimin e politikës për zhvillim rural, d.m.th. në zhvillimin e GLV-ve dhe sipas standardeve të BE, erdhi përmes projektit IPA "Ndërtimi i kapaciteteve për programin e zhvillimit rural në BH (3F-BHRD)". Aktivitetet e lidhura me projektin, të dedikuara për forcimin e kapaciteteve të përfituesve të projektit. Një veçanti e projektit u reflektua, ndër të tjera, në stërvitjen e trajnuesve të LEADER/GLV. Trajnuesit morën pjesë në ligjërata/leksione mbi metodologjinë LEADER, parimet e GLV në shtetet e BE, menaxhimin e ciklit të projektit, shembujt e praktikave më të mira, dhe ushtrime praktike.

Projekti 3P-BHRD dhe hartimi i dokumentit "Udhëzimet për prezantimin e programit LEADER në Bosnjë dhe Hercegovinë" duhet të kenë pasur një rol të rëndësishëm në prezantimin e qasjes LEADER në politikën e zhvillimit rural në BH dhe në FBH, d.m.th duke i dhënë rëndësi ekzistencës së GLV-ve. Udhëzimet duhej të jepnin një bazë për zhvillimin, punën dhe njohjen e GLV-ve në BH sipas standardeve të BE-së. Qëllimi i tyre ishte të inkurajojnë themelimin e partneriteteve lokale, respektivisht GLV-ve, në zonat rurale nën parimin e bashkëpunimit midis individëve dhe sektorit publik, privat dhe OJF-ve. Udhëzimet bënë të mundur vendosjen e një kornizë për themelimin dhe punën e GLV-ve dhe parimeve kryesore të iniciativës LEADER, rregullat dhe rekomandimet për krijimin e GLV-ve dhe veprimtaritë e tyre. Për fat të keq, për shkak të mungesës së vullnetit politik, udhëzimet kurrë nuk u bënë aktuale.

Në FBH veprojnë tre GLV: GLV Una-Sana, GLV Rajoni Doboj, dhe GLV Drina. GLV Una-Sana është më i vjetri në FBH dhe njëkohësisht GLV më aktiv i cili ka zbatuar një numër të madh projektesh deri më tani. Për shkak të këtyre veçorive, më poshtë tregohet më tepër rreth veçorive të statusit të GLV-ve, strukturës administrative, aspekteve financiare dhe projekteve të zbatuara si shembuj të praktikave më të mira.

GLV Una-Sana është themeluar si rezultat i projektit të UNDP "Partneritet për projekte të zhvillimit lokal - SUTRA". Si një organizatë jo-partiake dhe jofitimprurëse me qëllim forcimin e partneritetit në zhvillimin rural, GLV Una-Sana u regjistrua si shoqatë me seli në Sanski Most, në Ministrinë e Drejtësisë së BH në vitin 2008. Ai u themelua nën parimet e iniciativës LEADER dhe përmes përfshirjes së sektorit publik dhe privat, dhe shoqërisë civile. Themelues janë tre komuna (Sanski Most, Bosanska Krupa, dhe Buzim) në sajë të përfaqësuesve të sektorit publik, tre shoqata si përfaqësues të shoqërisë civile (Shoqata "Qendra për zhvillim lokal" Sanski Most; Shoqata për

ngritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve lokale - BK 2001, Bosanska Krupa, dhe Shoqata rinore Buzim), tre subjekte biznesi dhe dy persona fizik. Personat përgjegjës për punën e këtij GLV janë kryetari i Kuvendit, kryetari i Bordit drejtues dhe Drejtori ekzekutiv/Menaxheri.

Sipas të dhënave të MOFTER[33], numri total i anëtarëve të asamblesë së këtij GLV është 13, 10 nga të cilët janë burra, 1 grua dhe 2 të rinj; asnjë person me aftësi të kufizuara.

Edhe pse i bazuar në parimet LEADER, GLV Una-Sana, ashtu si GLV-të e tjera në FBH/BH, nuk kanë mundësi të shfrytëzojnë fondet LEADER për shkak se opsione të tilla akoma nuk janë në dispozicion. Në mënyrë të veçantë, për shkak të dështimit për të përmbushur kërkesat, BH akoma nuk është në gjendje të aksesojë fondet nga IPARD, dhe rrjedhimisht as fondet për iniciativën LEADER.

Puna e GLV Una-Sana është bërë e mundur falë fondeve publike nga tre bashkitë themeluese - Sanski Most, Bosanska Krupa dhe Buzim, dhe mbi të gjitha fondeve të donatorëve. Mungojnë fondet nga tarifat e anëtarësimit dhe subjektet e biznesit. Sipas raporteve të MOFTER mbi punën e GLV-ve në BH, GLV Una-Sana realizoi 122,300 euro të ardhura totale në vitin 2015, 15% (18,500 EUR) e të cilave vijnë nga komunat themeluese dhe 85% (103,800 EUR) janë fonde donatorësh. Shuma dhe proporcione të ngjashme janë paraqitur edhe në vitin 2012 dhe 2013. Shpenzimet vjetore të këtij GLV për kostot e shërbimeve, kostot administrative, kostot e udhëtimit dhe kostot e pagave mesatarisht janë 20-25,000 euro.

Zyra e këtij GLV ndodhet në Sanski Most dhe është e pajisur me një qendër burimesh/resursesh. Ai gjithashtu përdor ambientet e Qendrës për zhvillimin rural, e cila ka një dhomë funksionale për trajnim dhe dy ambiente të Qendrave informative turistike në Sanski Most dhe Bosanska Krupa.

GLV Una-Sana është i njohur për aktivitetet e tij edukative. Janë organizuar shumë seminare në sfera të ndryshme, në mesin e të cilëve dallohen sektori i turizmit dhe bujqësisë. Po ashtu, ky GLV ka krijuar shumë materiale promovuese, të gjithë në kontekstin e zhvillimit të komuniteteve lokale dhe zonës që ai përfaqëson.

Që nga themelimi i tij, GLV Una-Sana ka zbatuar një numër të madh të projekteve. Sa u përket dokumenteve strategjike, kjo GLV ka krijuar "Strategjinë e zhvillimit rural për rajonin Una-Sana për periudhën 2011-2016", e cila mbulon territoret e tre komunave - Sanski Most, Bosanska Krupa, dhe Buzim – dhe ka marrë pjesë në krijimin e një strategjie zhvillimi për turizmin rural "Rajoni pa kufij". Kjo ishte në kuadër të projektit IPA për bashkëpunim ndërkufitar (2013 -2015) për tre komuna në BH (Sanski Most, Bosanska Krupa, dhe Buzim) dhe katër në Kroaci (Topusko, Vojnic, Gvozd, dhe Barlovic).

Disa nga projekt-aktivitetet e tjera të realizuara nga GLV Una-Sana janë:

- *"Efikasiteti energjetik – Klinika ambulatore 'Bosanska Krupa'"*, qëllimi i projektit: Ndërtimi i fasadës termike në ndërtesën e klinikës, viti i zbatimit: 2012, vlera e projektit: 43,000 euro, Investitorë: MDG-F, Ministria e Shëndetësisë në Kantonin Una-Sana, Komuna e Bosanska Krupa.
- *"Efikasiteti energjetik – ndërtesa e ish Institutit për shëndet publik në BHaç",* qëllimi i projektit: Ndërtimi i një sistemi ngrohës qendror pelet, viti i zbatimit: 2012, vlera e projektit: 45,000 euro, Investitorë: MDG-F, komuna BHaç.
- *"Rigjallërimi i partneriteteve ndërkufitare përmes zhvillimit rural"*, qëllimi i projektit: Zhvillimi i shërbimeve turistike në rajonin ndërkufitar të Kroacisë dhe BH, vitet e zbatimit: 2011 dhe 2012, vlera e projektit: 85,000 euro, Investitor: Bashkëpunimi ndërkufitar EC IPA.

[33] *Kjo ministri përgatit raporte vjetore për punën e Grupeve lokale të veprimit.*

- *"Popullarizimi i fshatit boshnjak si destinacion turistik"*, qëllimi i projektit: Zhvillimi i shërbimeve turistike përmes popullarizimit të mjedisit tipik të fshatit, viti i zbatimit: 2014, vlera e projektit: 18,000 euro, Investitorë: Ministria Federale e mbrojtjes së mjedisit dhe turizmit, komunat Sanski Most, Bosanska Krupa dhe Buzim.
- *"ACORD"*, qëllimi i projektit: Krijimi i një rrjeti për zhvillim rural të BH, vitet e zbatimit; 2013 dhe 2014, vlera e projektit: 249,400 euro, Investitor: Programi i KE – Aftësimi i shoqërisë civile.
- *"Rehabilitimi i fortesës Stari grad Bosanska Krupa"*, qëllimi i projektit: Rehabilitimi i fortesës dhe ndërtimi i objekteve të nevojshme me qëllim të forcimit të shërbimeve turistike, viti i zbatimit: 2013, vlera e projektit: 30,000 euro, Investitorë: ICEI Itali, Komuna Bosanska Krupa.
- *"Themelimi i një qendre për qëndrim ditor të fëmijëve me aftësi të kufizuara"*, qëllimi i projektit: Përforcimi i kapaciteteve të Shoqatës për fëmijë me aftësi të kufizuara. Punë kreative. Periudha e zbatimit 2013–2014. Vlera e projektit: 25,000 euro. Investitor: KE.
- *"Sipërmarrja e grave në turizmin rural"*, qëllimi i projektit: Inkurajimi i sipërmarrjes së grave në krijimin e suvenireve në artizanatin tradicional. Viti i zbatimit: 2013. Vlera e projektit: 32,000 euro. Investues: LG FBH.
- *"Gratë në zhvillimin rural"*, qëllimi i projektit: Inkurajimi i sipërmarrjes së grave përmes nxitjes së kultivimit të perimeve të serrave. Periudha e zbatimit 2013–2014. Vlera e projektit: 25,000 USD. Investitor: Ambasada Amerikane.

Tabela B. II. 2: Rasti studimor 1

1. Titulli dhe autori	**Financimi dhe operimi i GLV-ve si një faktor i lëvizshmërisë së kapitalit njerëzor – Rasti studimor GLV Una-Sana**
2. Përmbledhje ekzekutive	Komuna Bosanska Krupa, Sanski Most, dhe Buzim - disa nga themeluesit e GLV Una-Sana nuk i paguajnë fondet në përputhje me planin e pajtuar dhe në shumën e rënë dakord, që vë në pyetje funksionimin e GLV-së dhe e vendos atë në një pozitë mjaft të pafavorshme. "Plani i zhvillimit rural për Federatën e BH" i cili parashikon fonde për bashkëfinancimin e operimit të GLV në Federatë akoma nuk është miratuar nga Kuvendi i Federatës, dhe ende nuk është i zbatueshëm. Mungesa e fondeve të nevojshme, për arsyet e mësipërme, ka çuar në ngrirjen e llogarisë bankare të GLV-së, i cili ka ndërprerë punën e tij të mëtejshme e cila deri atëherë kishte qenë e suksesshme. Shqetësimi i vazhdueshëm dhe nevoja për një "presion" të vazhdueshëm ndaj autoriteteve të komunave në lidhje me financimin - që është pjesa më e rëndësishme nga perspektiva e qëndrueshmërisë së GLV-ve (për kostot e shërbimeve dhe të personelit dhe bashkëfinancimin e disa projekteve) - shpie në një humbje graduale të entuziazmit të nevojshëm në mesin e drejtuesve të GLV-ve. Kjo arriti kulmin me dorëheqjen e Drejtorit të GLV-së në prill të vitit 2017. Meqenëse ky GLV ishte i dallueshëm nga të tjerët për nga kapitali njerëzor (drejtori), vazhdimi i operimit është i diskutueshëm.
3. Të dhënat për komunitetin	Komunat Bosanska Krupa, Sanski Most dhe Buzim janë pjesë e Kantonit Una-Sana dhe janë të vendosura në pjesën rurale të Federatës së BH. Veçoritë e tyre kryesore janë shkalla e lartë e papunësisë dhe një pjesë e konsiderueshme e popullsisë së varfër.
4. Sfida	GLV Una-Sana është rezultat i shoqërimit/partneritetit të përfaqësuesve të sektorit publik (komunave Bosanska Krupa, Sanski Most dhe Buzim), sektorit privat dhe OJF, dhe bazohet në besimin dhe mirëkuptimin reciprok. Një partneritet i tillë duhet të mbështetet në njohuritë, shkathtësitë dhe burimet e tyre dhe lobimin e përbashkët midis niveleve më të larta të qeverisë dhe fondeve ndërkombëtare lokale me qëllim zhvillimin e zonave rurale të kantoneve. GLV Una-Sana ballafaqohet me detyra/sfida të shumta: krijimi i strategjive lokale/mes-komunave për zhvillim rural; zhvillimi dhe zbatimi i projekteve specifike në këtë fushë; promovimi i një koncepti "të ri" për zhvillim rural dhe të parimeve të kompanive publiko-private; gjetjen e fondeve plotësuese për bashkëfinancimin e aktiviteteve të lartpërmendura dhe aktiviteteve të ngjashme; organizimin e ngjarjeve edukative, seminareve dhe punës profesionale; dhe zgjerimin e rrjetit dhe bashkëpunimit me organizatat e ngjashme brenda dhe jashtë BH. Një nga sfidat madhore me të cilën ballafaqohet GLV-ja është financimi i aktiviteteve të lartpërmendura. Kjo duhet të sigurohet përmes fondeve publike të komunave themeluese, tarifave për anëtarësim, fondeve nga subjektet e biznesit, dhe përmes projekteve lokale dhe ndërkombëtare (fondet e donatorëve).

5. Aktivitetet	Zbatimi i projekteve të shumta, ku ato që dallohen ishin në fushat e zhvillimit të programeve strategjike, trajnimit dhe edukimit, mbrojtjes së mjedisit, mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, zhvillimit, promovimit të ndjeshmërisë gjinore. Shumica e aktiviteteve të projekteve erdhën si rezultat i fondeve donatore, ndërsa fondet publike nga komunat themeluese kryesisht janë shfrytëzuar për funksionimin e rregullt të GLV. Për fat të keq, si rezultat i krizës së përgjithshme ekonomike në shtet (si rrjedhojë po ashtu edhe në komunat), kjo formë e financimit ka qenë në rënie gjatë viteve të fundit pasi që disa nga komunat nuk i kanë përmbushur obligimet e tyre (Buzim aspak, Sanski Most, pjesërisht), që i ka sjellë aktivitetet e GLV-së në pikëpyetje. Si një pasojë e drejtpërdrejtë e situatës së këtillë, disa nga personat kyç dhe të dallueshëm janë larguar (drejtori i GLV Una - Sana).
6. Rezultatet	GLV Una - Sana ka zbatuar projekte të shumta dhe është bërë një GLV i dallueshëm në Federatë dhe anembanë BH. Ky imazh i dallueshëm është në masë të madhe rezultat i punës së anëtarëve të GLV-së, veçanërisht të ish drejtorit i cili në një farë mënyre e krijoi imazhin e GLV-së. Operacionet e mëtejshme të GLV-së janë ndërprerë për shkak të ngrirjes së llogarisë për arsye të problemeve financiare që u diskutuan më lartë. Për më tepër, kjo ka penguar organizatën që të nënshkruajë një projekt paraprakisht të miratuar nga qeveria zvicerane sepse GLV-së do t'i duhej të shpenzonte një pjesë të porcionit të parë të depozituar të fondeve të projektit për taksat dhe kontributet e mëparshme të papaguara, të cilat me siguri nuk kualifikoheshin si kosto të pranueshme të projektit. Mungesa e vazhdueshme e fondeve publike nga ana e komunave themeluese për funksionimin e pandërprerë të GLV-së dhe nevoja për lobim të vazhdueshëm dhe presion ndaj qeverisë për sigurimin e fondeve (buxhetore) të parashikuara ka çuar në një pozicion të pasigurt të njerëzve të përfshirë në punën e GLV-së. Kulmi i këtyre ngjarjeve ishte dorëheqja e drejtorit të GLV, që rezultoi në humbjen e tërë përvojës, njohurive dhe aftësive që drejtori i kishte fituar gjatë punës së tij në GLV, dhe humbjen e imazhit organizativ që kjo GLV me siguri e kishte me drejtorin. Kjo është veçanërisht me rëndësi për konkurrencën e mëtejshme të tregut në fushën e projekteve vendore dhe ndërkombëtare.
7. Mësimet e nxjerra dhe Konkluzionet	Financimi i parregullt i GLV Una-Sana dhe mungesa e kornizës financiare për funksionimin e tij të rregullt (kostot e personelit dhe shërbimeve) kryesisht të siguruara nga buxhetet e komunave, respektivisht sektori publik, mund ta rrezikojë punën e GLV-ve dhe ekzistimin e tyre në përgjithësi. Pavarësisht nga aktivitetet e projektit dhe fondet e donatorëve që janë rezultat i kushteve të tregut, funksionimi i ngadaltë i GLV-ve ka nevojë për fonde të paracaktuara buxhetore. Pavarësisht nga suksesi i punës së GLV-së, krijimi dhe njohja e tij, mungesa e një kuadri të qartë financiar mund të jetë një arsye për largimin e personave kyç (lëvizshmëria e kapitalit njerëzor), gjë që e bën punën e mëtejshme të GLV-së të diskutueshme.
8. Kontaktet	GLV Una-Sana, Trg oslobodilaca p.n., 79260 Sanski Most, Bosnjë dhe Hercegovinë, tel. + 387 61 815 293, www.LAG.ba

4. KONKLUZIONET DHE REKOMANDIMET

4.1 Konkluzionet

Në vijim jepen konkluzionet duke u bazuar te ajo çka u paraqit në këtë raport:

- Programi LEADER akoma nuk është zbatuar në FBH. Politika aktuale e zhvillimit rural në FBH nuk e mbështet financiarisht këtë iniciativë dhe krijimin e GLV-ve të reja dhe forcimin e atyre që ekzistojnë tashmë brenda saj.
- "Plani i zhvillimit rural për FBH 2015-2020" parashikonte iniciativën LEADER dhe mbështetjen për GLV-të. Për fat të keq, plani akoma nuk është ligjërisht i vlefshëm sepse nuk është miratuar nga Kuvendi dhe së këndejmi nuk shërben për planifikimin e masave për zhvillimin rural, përfshi dhe masat mbështetëse për programin LEADER.
- Federatës së BH i mungon një dokument strategjik që merret me zhvillimin e vetëqeverisjes vendore si një dokument shumë i rëndësishëm për zhvillimin e iniciativës LEADER në këtë entitet të BH.
- Aktualisht në FBH veprojnë tre GLV: GLV Una-Sana, GLV Drina, dhe GLV Rajoni Doboj (me komunat e Federatës Maglaj dhe Gracanica). Funksionimi i tyre është individual dhe me nivele të ndryshme të suksesit të matur nga aktivitetet e projektit. GLV më aktiv është GLV Una-Sana, ndërsa GLV Drina është praktikisht në prag të kolapsit/falimentimit.
- Legjislacioni në FBH ka siguruar regjistrimin e GLV-ve përmes Ligjit për shoqatat dhe fondacionet, prandaj GLV-të në FBH janë regjistruar si shoqata civile.
- Në asnjë nivel të qeverisë në BH nuk ndodhet askush që do të bënte të mundur akreditimin e GLV-ve dhe regjistrimin e tyre në regjistrat e veçantë të GLV-ve si bazë për GLV-të që të ushtrojnë të drejta të veçanta të rezervuara vetëm për GLV-të e akredituara.
- GLV-të në FBH vazhdimisht ballafaqohen me problemin e financimit për shkak të mbështetjes së paqëndrueshme nga sektori publik, me një varësi të konsiderueshme nga fondet e donatorëve që kanë të bëjnë me zbatimin e projekteve ndërkombëtare. Shembulli i GLV Una-Sana tregon se financimi i GLV-ve në FBH varet kryesisht nga fondet e donatorëve. Pjesa më e vogël e të ardhurave totale të GLV-ve vjen nga sektori publik (komunat), ndërsa financimi nga sektori i biznesit pothuajse nuk ekziston.
- Rrjetëzimi dhe ndërlidhja si një nga parimet e LEADER është në një nivel shumë të ulët në GLV-të ekzistuese në FBH. Është e domosdoshme të forcohet bashkëpunimi ndërmjet GLV-ve brenda BH dhe po ashtu me GLV-të nga rajoni (Ballkani Perëndimor) e më gjerë, me GLV-të në shtetet e BE.
- Mungesa e vullnetit politik është arsyeja kryesore për të cilën BH akoma nuk ka qasje në fondet IPARD dhe brenda tyre në fondet për përmirësimin e iniciativës LEADER. Progresi i arritur në themelimin e mekanizmit kordinues dhe planit të zhvillimit rural në nivel shtetëror, që është në zhvillim e sipër, duket premtuese që BH të bëhet përfitues i këtyre burimeve të rëndësishme për financim të zhvillimit rural që nga viti i ardhshëm.

4.2 Rekomandimet

Rekomandimet më të rëndësishme për përmirësimin e iniciativës LEADER dhe pozitës së GLV në FBH janë:

Rekomandime për përmirësimin e rregullimit institucional

- Zhvillimi rural dhe rajonal duhet të intensifikohen përmes rrjetëzimit të të gjithë aktorëve në një territor më të gjerë të FBH/BH së bashku me forcimin e GLV-ve si një lidhje e rëndësishme në këtë proces.
- Duhet të rritet interesi dhe rëndësia e rolit të niveleve më të larta të qeverisë (FMAWMF, ministritë e kantoneve kompetente për zhvillimin rural) gjithashtu dhe prezenca aktive e tyre në përhapjen e iniciativës LEADER.
- Duhet sa më shpejt që të jetë e mundur të nisin aktivitetet për finalizimin e zhvillimit të dokumentit tashmë të filluar "Udhëzimet për futjen e iniciativës LEADER në BH", pasi që ky është një dokument i rëndësishëm i cili do të ndihmojë në promovimin e iniciativës LEADER dhe përshpejtimin e themelimit të GLV-ve të reja në FBH/BH.

Rekomandime për përmirësim të politikave

- "Plani i zhvillimit rural për FBH (2015-2020)" në të cilin iniciativa LEADER dhe roli i GLV-ve janë të përcaktuar qartë dhe pranojnë mbështetje të konsiderueshme buxhetore, duhet të miratohet sa më parë.
- Duhet sa më parë të krijohet një strategji për zhvillimin e vetëqeverisjes vendore për Federatën e BH, bazuar në parimet e Kartës Evropiane të vetëqeverisjes vendore, duke parashikuar pozita të qarta për partneritetet publiko-private dhe në përgjithësi, për iniciativën LEADER.
- Derisa zhvillohet buxheti për zhvillimin rural në nivel të entiteteve dhe të kantoneve, duhet të parashikohen fonde për të ndihmuar krijimin e GLV-ve të reja dhe për të mbështetur GLV-të ekzistuese. Ky nivel i qeverisë duhet të sigurojë financim të vazhdueshëm për funksionimin e përhershëm të GLV-ve, të paktën në një nivel themelor/të qëndrueshëm.

Rekomandime për fuqizimin e palëve të interesuara lokale

- Meqenëse baza për ekzistencën dhe funksionimin e GLV-ve është një partneritet trepalësh mes sektorit publik, atij të biznesit dhe joqeveritar, GLV-të e tanishme në FBH duhet të angazhohen më shumë në motivimin e aktorëve nga të tre sektorët në nivelin lokal.
- Është e nevojshme të vazhdohet puna për ngritjen e kapaciteteve në FBH në kontekstin e iniciativës LEADER dhe shkëmbimin e informacionit me vendet e BE-së sa më shumë që të jetë e mundur.
- Rrjeti për zhvillimin rural në BH është themeluar pa ndonjë formulim të qartë të rolit të subjekteve për zhvillimin rural dhe pa dukshmëri/shikueshmëri, prandaj është e nevojshme që sa më shpejt të përmirësohen veprimet për rrjetëzim. Përvojat e shumta, duke përfshirë ato nga iniciativa LEADER dhe puna e GLV-ve në BH, duhet të jenë të dukshme dhe transparente.

5. SHTOJCAT

5.1 Shtojca 1: Referencat

- ACED (2015): LEADER dhe CLLD në Bosnjë dhe Hercegovina, Banja Luka.
- Ašonja, Slavica (2016): Studim mbi kornizën kombëtare për zhvillimin e qëndrueshëm rural, Rrjeti i zhvillimit rural në Bosnjë dhe Hercegovinë Projekti ALTER.
- Helić, Benida. (2015): Roli dhe rëndësia e Grupeve lokale për veprim në zhvillimin rural të Bosnjë dhe Hercegovinës, Diplomë Master, Fakulteti i bujqësisë dhe ushqimit i Universitetit të Sarajevës.
- Ministria federale e bujqësisë, administrimit të ujërave dhe pylltarisë (2014): Plani i zhvillimir rural i Federatës së Bosnjë dhe Hercegovinës për periudhën 2015-2020, Sarajevë.
- Ministria federale e bujqësisë, administrimit të ujërave dhe pylltarisë (2014): Strategjia afatmesme për zhvillimin e sektorit të bujqësisë të Federatës së Bosnjë dhe Hercegovinës për periudhën 2015-2019, Sarajevë.
- Projekti SWG JRC (2016) - Instrumentet e politikave kombëtare dhe procesi i përafrimit në BE: Efektet në njësitë ekonomike bujqësore në vendet e Ballkanit Perëndimor - Pjesa: Bosnja dhe Hercegovina: Vlerësimi dhe Zhvillimi i politikave bujqësore
- Ministria Për Tregti Të Jashtme Dhe Marrëdhënie Ekonomike e BH: Raportet për punën e Grupeve lokale për veprim (GLV-ve) për 2012, 2013 dhe 2015
- Projekti ACoRD – Aleanca për zhvillim të përbashkët rural (2015): LEADER dhe zhvillimi lokal i drejtuar nga komuniteti në Bosnjë dhe Hercegovinë, ACED, Agjencia për bashkëpunim, arsim dhe zhvillim, Banja Luka.
- VESTA (2012): Qasja LEADER – Përfitimi për komunitetet rurale në Bosnjë dhe Hercegovinë, Tuzla.
- Gazeta zyrtare FBH. Nr. 45/02.
- Gazeta zyrtare FBH, Nr. 49/06
- Gazeta zyrtare FBH, Nr. 81/09

5.2 Shtojca 2: Lista e Kontakteve

1. Jakub Butkovic, Zyra për harmonizimin dhe koordinimin e pagesave në bujqësi, ushqim dhe zhvillim rural, MOFTER BH, e-mail: jakub.butkovic@hops.gov.ba
2. Sedina Kahriman – Zyra për harmonizimin dhe koordinimin e pagesave në bujqësi, ushqim dhe zhvillim rural, MOFTER BH, e-mail: sedina.kahriman@hops.gov.ba
3. Elda Hodžić Isović, MOFTER BH, e-mail: Elda.Hodzic-Isovic@mvteo.gov.ba
4. Pejo Janjić, FMAWMF, e-mail: pejo.janic@fmpvs.gov-ba
5. Elva Omerović, FMAWMF, e-mail: elvaomerovic@hotmail.com
6. Šefik Veladžić, LAG Una-Sana, telefoni celular + 387 61 815 293
7. Asima Džambegović, LAG Drina (Zyra në Gorazhde)

KAPITULLI B.III

Vlerësimi i zbatimit të qasjes LEADER në vendet e Ballkanit Perëndimor - “nga një iniciativë lokale në një koncept qendror në zonat rurale”

Raport i territorit: Republika Serbe, Bosnjë dhe Hercegovinë

Autor: Z. Dragan Brkoviç

1. HYRJE

Zbatimi i politikave të bujqësisë dhe zhvillimit rural në Bosnjë dhe Hercegovinë bëhet në nivel të entiteteve (Republika Serbe e Bosnjës dhe Federata e Bosnjë dhe Hercegovinës), si dhe Distrikti i Bërçkos. Në bazë të kësaj, Ministria e bujqësisë, pyjeve dhe administrimit të ujërave e Republikës Serbe të Bosnjës (MAFWM RSB) është përgjegjëse për zbatimin e qasjes LEADER në territorin e Republikës Serbe të Bosnjës. Ky raport paraqet gjendjen aktuale lidhur me zbatimin e qasjes LEADER në territorin e Republikës Serbe të Bosnjës. Në veçanti, paraqitet prania e qasjes LEADER në dokumentet strategjike dhe e hartimmit të programeve, si dhe masat e nevojshme për Grupet lokale të veprimit (GLV) që do të funksionojnë në pajtueshmëri me parimet e LEADER. Do të përmenden edhe dokumente tjera strategjike që janë të rëndësishme për territoret rurale, por rrallëherë përdoren nga GLV-të dhe në strategjitë e tyre për zhvillim lokal.

Përveç MAFWM RSB, ekzistojnë dhe institucione të tjera përgjegjëse për mbështetjen e zhvillimit rural dhe krijimin e kuadrit ligjor. Këto institucione, rolet dhe përgjegjësitë e tyre do të paraqiten në pjesën institucionale dhe ligjore të këtij raporti. Është analizuar dhe theksuar se financimi i qëndrueshëm është problemi më i madh për funksionimin e GLV-ve në bazë të parimeve LEADER.

Që të japim një pasqyrë të gjendjes, konkluzioneve dhe rekomandimeve për zbatimin e qasjes LEADER në territorin e Republikës Serbe të Bosnjës, ishte e nevojshme të paraqiten iniciativat e mëparshme dhe ato aktuale. Një nga nismat është paraqitur nëpërmjet një rasti studimor. Këto nisma ofrojnë përvojë të vlefshme për nismat e tjera LEADER në BH dhe vendet tjera të Ballkanit Perëndimor me qëllim shmangien e gabimeve të njëjta, si dhe të shfrytëzimit të praktikave të mira për të arritur funksionim të qëndrueshëm.

2. MJEDISI LEADER NË REPUBLIKËN SERBE TË BOSNJËS

2.1 Leader në dokumentet kombëtare strategjike dhe të programeve

Për momentin, qasja strategjike për bujqësinë dhe zhvillimin rural është përcaktuar në nivel entitetesh (Republika Serbe e Bosnjës - RSB dhe Federata e Bosnjë dhe Hercegovinës - FBH) dhe Distrikti Bërçko (DB)). Në mbarë vendin në Bosnjë dhe Hercegovinë, plani strategjik për zhvillimin rural është në proces e sipër. Neni 68 i Kushtetutës së Republikës Serbe të Bosnjës përcakton dhe garanton objektivat themelore dhe drejtimet e zhvillimit ekonomik, shkencor, teknologjik, demografik dhe social, zhvillimit të bujqësisë dhe zonave rurale, përdorimit të hapësirave, politikat dhe masat që çojnë drejt zhvillimit. Në përputhje me Kushtetutën e RSB për territorin e Republikës Serbe të Bosnjës në periudhën e viteve 2009-2015, qasja strategjike ishte përcaktuar në Planin strategjik për zhvillim rural[34]. Pastaj pasoi Plani strategjik për zhvillimin e bujqësisë dhe zonave rurale të Republikës Serbe të Bosnjës për vitet 2016- 2020[35]. Bosnja dhe Hercegovina, si dhe entitetet e saj nuk kanë dispozita ligjore as ligje kombëtare që i përcaktojnë zonat rurale, qytezat dhe fshatrat, as në pikëpamjen administrative as në lidhje me zbatimin e politikave të zhvillimit rurale dhe qasjen LEADER si pjesë përbërëse.

[34] *Qeveria e RSB (2009)*
[35] *Qeveria e RSB (2015)*

Mbështetja strategjike për zhvillimin rural është e organizuar në nivel entitetesh (RSB dhe FBH) dhe DB. Plani strategjik për zhvillimin e bujqësisë dhe zonave rurale i Republikës Serbe të Bosnjës ka gjashtë (6) objektiva strategjikë: 1. Rritja e vëllimit/sasisë dhe produktivitetit të prodhimit bujqësor dhe sigurimi i qëndrueshmërisë së të ardhurave të fermerëve; 2. Rritja e aftësisë konkurruese të sektorit bujqësor përmes rritjes së investimeve; 3. Rritja e tregtisë dhe finalizimit të prodhimit bujqësor; 4. Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore dhe zbutja e ndryshimeve klimatike; 5. Zhvillimi i balancuar i integruar rural; 6. Sistemi për mbështetjen e sektorit të bujqësisë dhe zonave rurale. Mbështetja në Republikën Serbe të Bosnjës sigurohet duke u bazuar në rregulloren vjetore për mbështetjen e bujqësisë dhe zhvillimit rural, e cila është hartuar në pajtueshmëri me masat e përcaktuara në Planin strategjik për zhvillimin e bujqësisë dhe zonave rurale të Republikës Serbe të Bosnjës për vitet 2016-2020.

Plani strategjik për zhvillimin e bujqësisë dhe zonave rurale të Republikës Serbe të Bosnjës për vitet 2016-2020 krijon mundësi për mbështetjen e qasjes LEADER me masat për mbështetjen e zbatimit të LEADER nëpërmjet GLV-ve në zonat rurale dhe masat për nxitjen e krijimit të strategjive të zhvillimit lokal.

Dokumente të tjera strategjike nuk e prekin drejtpërdrejtë qasjen LEADER dhe GLV-të, mirëpo ato ofrojnë udhëzime për zhvillim të balancuar të rajoneve dhe sektorëve të ndryshëm brenda ekonomisë së Republikës Serbe të Bosnjës. Dokumentet aktive strategjike dhe të programeve që janë të rëndësishme për zhvillimin rural përfshijnë: Strategjinë për zhvillim të sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme të RSB në periudhën kohore 2016 - 2020[36], Strategjinë për mbrojtjen e mjedisit të RSB[37], Strategjinë për zhvillimin e industrisë së RSB në periudhën kohore 2016 - 2020[38], Planin hapësinor të RSB deri në vitin 2025[39], Studimin mbi ruajtjen e artizanatit në RSB[40]. Fatkeqësisht, GLV-të nuk janë pjesë përbërëse e këtyre dokumenteve strategjike në strategjitë e tyre të zhvillimit lokale dhe rrallëherë i përdorin ato dokumente për planifikimin e programeve dhe të projekteve.

2.2 Rregullimet institucionale dhe ligjore

Në nivel kombëtar, Bosnja dhe Hercegovina ka Ministrinë e tregtisë së jashtme dhe marrëdhënieve ekonomike (MOFTER), si dhe sektorin e saj për Bujqësinë, Ushqimin dhe Zhvillimin Rural, të cilat kanë përgjegjësi për të kordinuar politikat mbi bujqësinë dhe zhvillimin rural. MAFWMRSB ka përgjegjësinë për të hartuar, financuar dhe zbatuar politikat mbi bujqësinë dhe zhvillimin rural në territorin e Republikës Serbe të Bosnjës. Zbatimi i qasjes LEADER nuk është trajtuar zyrtarisht në asnjë ligj ose legjislacion, në asnjë nivel qeverisës të Bosnjë dhe Hercegovinës.

MAFWMRSB është institucion përgjegjës për programim, zbatim dhe financim të politikave të zhvillimit rurale në territorin e RSB. Agjencia e pagesave është agjenci ekzekutive e MAFWMRS B përgjegjëse për menaxhimin financiar të fondeve publike për zhvillimin rural. Agjencinë e pagesave e mbikëqyr MAFWMRSB në mënyrë të njëjtë siç duhet bërë me IPARD nga Autoriteti Menaxhues. Mbikëqyrja e aktiviteteve të financuara nëpërmjet fondeve për bujqësinë dhe zhvillimin rural kryhet nga Agjencia e pagesave dhe MAFWMRSB, por duke konsideruar se që nga viti 2013 e këtej nuk ka pasur financime për masat që synojnë zbatimin e qasjes LEADER, pra nuk ka pasur mbikëqyrje të

[36] *Qeveria e RSB (2016a)*
[37] *Qeveria e RSB (2011)*
[38] *Qeveria e RSB (2016b)*
[39] *Ministria e planifikimit hapësinor, inxhinierisë civile dhe ekologjisë (2013)*
[40] *Ministria e industrisë, energjisë dhe minierave (2011)*

GLV-ve dhe aktiviteteve të tyre që në vitin 2013.

Nuk ekzistojnë dokumente ligjore që i përcaktojnë procedurat e regjistrimit të GLV-ve ose që i dallojnë GLV-të nga shoqatat e tjera, prandaj GLV-të kanë emër të vetëshpallur si "Grupe lokale të veprimit" si pjesë përbërëse e emrit të tyre zyrtar. GLV-të aktuale janë të regjistruara si shoqata, në pajtueshmëri me Ligjin për shoqata dhe fondacione të Republikës Serbe të Bosnjës[41] të miratuar nga Kuvendi i Republikës Serbe të Bosnjës ose Ligjin për shoqata dhe fondacione të Bosnjë dhe Hercegovinës[42] po ashtu të miratuar në vitin 2001 nga Kuvendi i Bosnjë dhe Hercegovinës. Ky lloj i shoqatave me emrin Grupe lokale të veprimit mbulojnë 7.706 km2 ose 27.61% të territorit të Republikës Serbe të Bosnjës me një popullsi prej 435.660 banorë ose 37.23 % të popullsisë totale. Gjithsej 16 nga 62 komunat e Republikës Serbe mbulohen me nismat GLV[43]. Nuk ekziston legjislacion që përcakton se puna e këtyre GLV-ve duhet të jetë në pajtueshmëri me parimet LEADER, prandaj mund të themi se funksionojnë si organizata zhvillimi që mbulojnë një territor të caktuar.

Nuk ekzistojnë rrjete formale për zhvillimin rural në nivel kombëtar ose entitetesh të formuara nga Ministritë ose të financuara me burime publike, mirëpo ekziston Rrjeti rural i shoqërisë civile në Bosnjë dhe Hercegovinë. GLV Devetak, GLV Savus dhe GLV Rajoni Doboj, të cilët janë aktiv në territorin e Republikës Serbe, janë anëtarë të Rrjetit për zhvillim rural të Bosnjë dhe Hercegovinës, i cili është anëtar i Rrjetit të Zhvillimit rural të Ballkanit (BRDN), Rrjetit të Partneritetit për Evropë Rurale (PREPARE) dhe Rrjetit të Shoqatave Evropiane LEADER për Zhvillimin Rural (ELARD). Ekzistojnë shumë shoqata dhe kooperativa të regjistruara në territorin e Republikës Serbe të Bosnjës, të cilat janë aktive në fushën e zhvillimit rural me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetesës në zonat rurale të RSB. Për shkak të mungesës së financimit dhe burimeve njerëzore, këta shoqata dhe kooperativa kanë kapacitete të kufizuara të veprimit.

Pas shqyrtimit të institucioneve të rëndësishme për zbatimin e qasjes LEADER, është e rëndësishme të bëhet një shqyrtim i shkurtër i kuadrit ligjor në lidhje me politikat e zhvillimit rural në territorin e Republikës Serbe të Bosnjës. Në nivel kombëtar, Bosnja dhe Hercegovina zbaton Ligjin për Bujqësinë, Ushqimin dhe Zhvillimin Rural të Bosnjë dhe Hercegovinës[44] të miratuar në Kuvendin Kombëtar në vitin 2008. Ky ligj përcakton përgjegjësitë institucionale lidhur me politikat e bujqësisë dhe zhvillimit rural, por nuk e trajton çështjen lidhur me zbatimin e qasjes LEADER. Ligji për Bujqësinë i Republikës Serbe të Bosnjës, i miratuar në vitin 2006, po ashtu vlen për territorin e Republikës Serbe të Bonjës[45]. Ligji për Bujqësinë i RSB e përcakton kuadrin e politikave bujqësore dhe zhvillimit rural në nivel entitetesh, por nuk përmend asgjë rreth zbatimit të qasjes LEADER. Për momentin, MAFWMRSB po përgatit një Ligj të ri për Bujqësinë në Republikën Serbe të Bosnjës. Një pjesë e këtij ligji duhet të jetë për shoqatat dhe ekziston mundësia për të shqyrtuar kushtet e themelimit dhe akreditimit të GLV-ve.

2.3 Financimi

MAFWMRSB futi qasjen LEADER në Planin strategjik për zhvillim rural të Republikës Serbe për vitet 2009 - 2015[46] dhe propozoi masa për zbatimin e LEADER. Kjo masë kontribuoi në Objektivin strategjik nr.3: Përmirësimi i cilësisë së jetës dhe diversifikimi i të ardhurave në ekonominë rurale;

41 *Gazeta zyrtare e RSB Nr. 52 (2001)*
42 *Gazeta zyrtare e BH Nr. 32 (2001)*
43 *Më shumë hollësi për sipërfaqen e GLV, popullsinë dhe komunat në Shtojcën 3: Sipërfaqja dhe popullsia e GLV*
44 *Gazeta zyrtare e BH Nr. 50 (2008)*
45 *Gazeta zyrtare e RSB Nr. 70 (2006) Ligji për bujqësi i Republikës Serbe të Bosnjës*
46 *Qeveria e RSB (2009) Plani strategjik për zhvillim rural për vitet 2009 - 2015*

dhe Objektivin specifik nr.3.7: Përkrahja e nismave lokale për zhvillim rural. Masa e propozuar për financimin e GLV-ve është masa 3.7.1: Mbështetje për zhvillimin dhe zbatimin e strategjive të zhvillimit lokal.

Në bazë të kësaj mase, gjatë dy viteve (2011-2012), MAFWMRSB i jepte mbështetje GLV-ve nëpërmjet Rregullores vjetore për mbështetjen e zhvillimit të bujqësisë dhe zonave rurale[47]. Aksesi në këtë mbështetje ishte ekskluzive për GLV-të dhe nismat GLV, të cilat zbatonin projekte për zhvillimin e zonave rurale. GLV-të duhej t'i dorëzonin një kërkesë Agjencisë së pagesave së bashku me fletë-regjistrimin dhe programin e tyre të zhvillimit të bujqësisë dhe zonave rurale, si dhe kontratën për zbatimin e projektit ose faturën e furnizimit me materiale dhe pajisje. Në këtë fazë u bë e mundur që mbështetja për një program ose projekt arrinte deri në vlerën prej 20.000 BAM. Me këtë masë u financuan gjithsej 5 projekte, në vlerë totale prej 40,426 BAM (të dhëna të siguruara gjatë intervistës me përfaqësues të MAFWMRSB). Për shkak të mungesës së fondeve publike, përkrahja e GLV-ve u ndërpre nga Rregulloret vjetore që në vitin 2013 e deri më sot. Mund të themi që kjo ishte një mbështetje publike nëpërmjet masave të qasjes LEADER që në vitin 2010 në Republikën Serbe të Bosnjës.

Një financim tjetër për qasjen LEADER ishte pjesë e projektit "Fuqizimi i kapaciteteve për programim të zhvillimit rural të BH - 3P-BHRD", i cili u financua nga Bashkimi Evropian në vlerë prej 1 milion euro, nëpërmjet programit IPA 2007. Ky projekt i ngriti kapacitetet programuese për bujqësinë dhe zhvillimin rural, si dhe kapacitetet për pagesat që përfshinin skema-pilot për zhvillimin e partneriteteve lokale. Personeli i projektit i ndihmonte njerëzit për të zhvilluar, regjistruar dhe planifikuar aktivitete me qëllim formimin e së paku 3 GLV-ve deri në fund të vitit 2010.

MAFWMRSB ka përfshirë masa për mbështetjen e qasjes LEADER në Planin strategjik për zhvillimin e bujqësisë dhe zonave rurale për vitet 2016 - 2020. Ekzistojnë masa që kontribuojnë për Objektivin strategjik nr. 5: Zhvillimi i integruar rural që kontribuon për zhvillim të balancuar; dhe Objektivin specifik nr. 5.5. Mbështetje e nismave lokale për zhvillim rural; si dhe masën nr. 5.5.2: Mbështetje e Grupeve lokale të veprimit në zonat rurale, dhe masa nr. 5.5.3: Mbështetje për formimin e strategjive të zhvillimit lokal. Megjithëse këto masa - 552 dhe 553 - ekzistojnë në Planin strategjik, nuk janë shfrytëzuar në Rregulloret vjetore për mbështetje të zhvillimit të bujqësisë dhe zonave rurale në vitin 2016 dhe 2017. Ministritë tjera në kuadër të Qeverisë së Republikës Serbe të Bosnjës nuk ofrojnë mbështetje për zbatimin e qasjes LEADER.

Qasja në fondet e IPARD është ende i pasigurt për Bosnjë dhe Hercegovinën dhe nuk mund të parashikohet se kur dhe në çfarë vlere këto fonde do të jenë të aksesueshme për GLV-të e BH.

Në territorin e Bosnjë dhe Hercegovinës veprojnë një numër i madh i organizatave donatore të cilat i mbështesin projektet për zhvillim rural. Ekzistojnë disa fondacione dhe kompani private në nivel lokal dhe kombëtar që përkrahin projekte të zhvillimit. Pjesa dërmuese e ambasadave publikojnë thirrje publike në pajtueshmëri me programet e asistencës për zhvillim të vendeve të tyre përkatëse. Për më tepër, ekziston një numër agjencish ndërkombëtare për zhvillim që u ofrojnë ndihmë organizatave të shoqërisë civile në BH. Këto fonde nuk synojnë enkas GLV-të ose zbatimin sipas qasjes LEADER, prandaj nuk mund të supozojmë se këto fonde do të shfrytëzohen për zbatimin e qasjes LEADER.

[47] *Gazeta zyrtare e RSB Nr. 25 (2011) dhe Gazeta zyrtare e RSB Nr. 18 (2012)*

3. NISMAT E MËPARSHME DHE MËSIMET E NXJERRA

Në periudhën ndërmjet prillit 2003 dhe dhjetorit 2007, UNDP zbatoi projektin "Partneriteti për projekte të zhvillimit lokal (SUTRA)". Projekti synonte që komunitetet lokale të zhvillojnë menyrat nëpërmjet të cilave do të qartësonin mbështetjen për kthimin dhe ri-integrimin e refugjatëve, duke rindërtuar shtëpi me përpjekje të përbashkëta nga qeveria, sektori publik dhe ai i biznesit. Qëllimi kryesor i UNDP, nëpërmjet projektit SUTRA, ishte të sigurojë ndihmë për personat e kthyer nga emigracioni, si përfitues të drejtpërdrejtë, në mënyrë që të forcohen kapacitetet e kthimit të tyre, e cila gjë po ashtu do ishte në favor të nevojave afatgjata për zhvillim. Komunat, OJF-të dhe sektori i biznesit ishin të përfshirë në grupet e mbështetjes për personat e kthyer nga emigracioni, të quajtur GLV nga UNDP-ja, ndërsa bashkëpunimi i tyre bazohej në deklaratën e Partneritetit që siguroi një ndarje të qartë të përgjegjësive ndërmjet partnerëve. GLV-të e formuara nëpërmjet SUTRA vepronin si organe për zbatimin e projekteve të UNDP-së në nivel komunal. GLV-të kanë përgatitur projekt-ide për komunitetin e tyre, ndërsa ato përfshinin rindërtimin e shtëpive, infrastrukturën dhe grupin për ngritje e kapaciteteve. Gjithashtu, grupet GLV të UNDP-së i kordinonin aktivitetet për zbatimin e projektit. UNDP i përkrahu GLV-të me ofrimin e shërbimeve këshillimore, hartimin e planeve lokale të veprimit dhe shërbimeve lidhur me ngritjen e kapaciteteve. Megjithëse GLV-të e formuara në kuadër të projektit SUTRA nuk kanë qenë në përputhje me parimet e LEADER, ky projekt mund të konsiderohet si pionier në kuptimin e zhvillimit të partneriteteve publike - private - civile dhe futjen e nocionit të GLV-ve. Projekti i UNDP SUTRA e filloi formimin e 22 GLV-ve, mirëpo vetëm 3 prej tyre u regjistruan zyrtarisht pas mbarimit të projektit (GLV Una-Sana, GLV Rajoni Doboj, GLV G.O.Z.B.). GLV G.O.Z.B. ndërpreu funksionimin në vitet pasuese për shkak të mospasjes së financimit.

Mbështetje për institucionet e BH lidhur me futjen e qasjes LEADER dhe zhvillimin e GLV-ve në përputhje me standardet e BE-së është siguruar edhe me projektin e IPA "Ngritja e kapaciteteve për programet e zhvillimit rural në BH ((3P-BHRD)". Aktivitetet e projektit "3P BHRD" u përqendruan në ngritjen e kapaciteteve të përfituesve të projektit. Projekti mbështeti trajnime për trajnues të qasjes LEADER/GLV nëpërmjet pesë seminareve dy ditore. Pjesëmarrësit e trajnimeve vijuan me leksionet mbi metodologjinë e LEADER, parimet e GLV-ve në vendet anëtare të BE-së, mjetet për menaxhimin e ciklit të projekteve, praktikat e mira dhe po ashtu u përfshinë në ushtrime praktike. Përkrahja institucionale për zhvillimin e GLV-ve në BH u sigurua nga MOFTER, MAFWMRSB, Ministria Federale e Bujqësisë, Drejtoria e Menaxhimit të Ujërave dhe Pyjeve dhe Departamenti i bujqësisë i Distriktit Bërçko (DABD). Këto ministri identifikuan katër pilot-zona për formimin e GLV-ve në bazë të parimeve të LEADER. Dy prej këtyre GLV-ve janë regjistruar në territorin e Republikës Serbe të Bosnjës (GLV Devetak – Sokolac, Han Pijesak dhe Rogatica, GLV SAVUS - Laktashi, Gradishka, Srbac dhe Kozarska Dubica).

Pavarësisht këtyre aktiviteteve të projekteve, në vitin 2011, u formua edhe një GLV - Vrbanja-Ukrina, që mbulon komunat Përnjavor, Çelinac dhe Kotor Varosh në Republikën Serbe të Bosnjës. Për më tepër, në vitin 2016, GLV Biraç u regjistrua zyrtarisht në territorin e komunave Miliçi, Vlasenica, Srebrenica, Bratunac, Zvornik and Shekoviçi.

GLV Devetak është GLV më i vjetër i formuar në bazë të parimeve LEADER në territorin e Republikës Serbe të Bosnjës. Nisma për formimin e GLV Devetak filloi nga MAFWMRS dhe MOFTER me qëllim futjen e qasjes LEADER në programet e zhvillimit rural në RSB dhe BH nëpërmjet projektit 3P-BHRD. Ky GLV u formua në Rogaticë, ndërsa gjatë këtij procesi, GLV Devetak ndoqi udhëzimet për futjen e qasjes LEADER. Ky ishte udhëzimi i vetëm për formimin e strukturës GLV që është në pajtueshmëri me parimet e nismave LEADER. Ky GLV përbëhet prej partneritetit publik-privat-civil të formuar në territorin e tre komunave: Han Pijesak, Sokolac dhe Rogatica, të cilat janë homogjene në pikëpamje hapësinore dhe konsiderohen të jenë zona rurale sipas kritereve dhe dendësisë së popullsisë.

Organet menaxhuese të GLV Devetak janë: Asambleja, Bordi drejtues dhe Presidenti i shoqatës. Organet menaxhuese janë në përputhje me parimin e përfaqësimit të barabartë të tre komunave dhe përfaqësimit të tre sektorëve sipas përqindjeve të vlerësuara (sektori publik përfaqësohet me rreth 40%, ai civil me 45% dhe ai privat me 15%).

GLV Devetak kishte strategji të zhvillimit lokal për zonën e GLV Rogatica, Han Pijesak dhe Sokolac për vitet 2012 - 2015, ndërsa në fund të kësaj periudhe u hartua një strategji e re për GLV Devetak për vitet 2016 - 2020. Objektivi themelor i hartimit të këtyre strategjive ishte avancimi i zhvillimit rural dhe zbutja e varfërisë në pjesën lindore të Bosnjë dhe Hercegovinës, në territorin që e mbulon GLV Devetak, përmes zbatimit të plotë të qasjes strategjike për aktivitetin planifikues për zhvillimin rural. Që nga periudha e themelimit të tij në vitin 2011 e deri në fund të viti 2015, GLV Devetak zbatoi projekte në vlerë prej 203.892,58 BAM, nga të cilat 9.426,00 BAM (<5%) buruan nga masat LEADER prej MAFWMRSB. Përveç zbatimit të projekteve të financuara nga donatorë, anëtarët e tyre morën pjesë në më shumë se 25 lloje të ndryshme të kurseve edukative (seminare, trajnime, konferenca, workshope), të cilat i ngritën kapacitetet e tyre. Në raste të shumta, GLV Devetak ishte përfitues i projekteve që u zbatuan nga organizata të tjera, ndërsa ata aplikonin në thirrje publike për alokimin e projekteve të financuar nga donatorë sikurse çdo organizatë tjetër e shoqërisë civile.

Në Bosnjë dhe Hercegovinë akoma nuk ka një fond në dispozicion për qasjen LEADER, nga i cili GLV-të do të mund të thithnin fonde të veçanta të dedikuara për mbështetjen e projekteve për zhvillimin rural lokal, ndërsa GLV Devetak funksionon sipas parimit të njëjtë sikur edhe çdo shoqatë tjetër. Ato aplikojnë në projekte të financuara nga donatorë vendas apo të huaj dhe i zbatojnë ato në territorin e GLV-së. GLV-ja nuk ka personel të përhershëm, por tre kordinatorë komunal (nga një për çdo komunë), të cilët shpenzojnë një të tretën e orarit të tyre të punës në aktivitetet e GLV-së bazuar në vendimin e Kryetarëve të Komunave. Nëpërmjet rezultateve të arritura nga puna e GLV Devetak, mund të themi që modeli me kordinatorët komunal (nga një për çdo komunë) ishte shembull i mirë për zhvillimin e GLV-së si një organizatë e përbashkët para se të ekzistonte ndonjë fondi i veçantë për LEADER.

Strategjia e GLV Devetak për periudhën 2016-2020 bazohet në respektimin e plotë të parimit "nga poshtë-lart", duke përfshirë kështu publikun dhe krijimin e politikave të zhvillimit në përputhje me nevojat e zonës. Për shkak të të gjithë kufizimeve që u vërejtën gjatë zbatimit të strategjisë së mëparshme për periudhën 2012-2015, e cila lidhej me përkufizimin e gjerë të strategjisë si "strategji e zhvillimit rural", nuk pati një bazë reale kur bëhej fjalë për buxhetet në dispozicion sa i përket mundësisë së zbatimit. GLV-të mund të ndikojnë në këta objektiva të zhvillimit, në projekte dhe burime që janë potencialisht në dispozicion bashkë me aktivitetet e saj.

Tabela B. III. 1: Rasti studimor 1

1. Titulli dhe autori	**Hartimi i strategjisë për zhvillimin lokal dedikuar GLV Devetak për periudhën 2016-2020.; GLV Devetak.**
2. Përmbledhje ekzekutive	Territori që GLV Devetak mbulon është jashtëzakonisht rural me popullsi prej 16,7 banorë për km2 dhe me varfëri ekstreme në kuptimin e gjendjes sociale, demografike dhe ekonomike. Arsyet për këtë janë të shumta, mirëpo karakteristikë e këtij territori është "paradoksi i varfërisë" - banorët janë të varfër dhe të pasur njëkohësisht. Nga njëra anë, pasuria e popullsisë lokale reflektohet në pasurinë e vërtetë në burime dhe potenciale për zhvillim rural (pasuri natyrore, trashëgimi kulturore dhe historike, potenciale turistike) që nuk janë shfrytëzuar dhe nuk janë vënë në funksion siç duhet, ndërsa nga ana tjetër, ekzistojnë tregues katastrofik socio-ekonomik (papunësia është mbi 50%, shpopullim dhe strukturë të dobët të moshës, margjinalizim të kategorive të cenueshme sociale, nivel i ulët i veprimtarisë ekonomike, prodhim bujqësor në nivel tepër të ulët, etj.). Strategjia e parë e zonës GLV u hartua për periudhën 2012-15 si pjesë përbërëse e projektit. Gjatë punës së saj të mëparshme, GLV po përpiqej të inkorporojë të gjitha parimet e qasjes LEADER sa më shumë që mundej. Mirëpo, zhvillimi i sistemit dhe zbatimi i strategjisë për territorin e GLV-së nënkupton aksesin e një fondi të veçantë LEADER për të financuar projektet e përcaktuara në strategji. Ky fond i veçantë LEADER nuk ekziston në RSB. Bazuar në strategjinë e mëparshme, GLV zbatoi projekte, por të gjitha ishin aty për aty sipas kushteve të donatorëve dhe rezultuan në zbatimin e qasjes oportune për të tërhequr fonde donatorësh. Në periudhën vijuese, kjo GLV do të shfrytëzojë të gjitha mundësitë dhe burimet e fondeve të donatorëve me qëllim që GLV-ja të njihet si një organizatë që merret me zhvillimin rural bazuar në qasjen LEADER. Ata kanë zgjedhur një qasje strategjike ndaj donatorëve në kuptimin e asaj që ata ofrojnë konceptin e tyre të zhvillimit.
3. Të dhënat për komunitetin	Zona administrative mbulon komunat Han Pijesak, Sokolac dhe Rogatica; vendndodhja gjeografike: Rajoni i Drinit të Epërm dhe rrafshnalta Romania; Sipërfaqja totale: 1,677 km2 . Popullsia: 28,054 banorë (2013); Dendësia e popullsisë: 16.7 banorë/km2; Niveli i zhvillimit: I takon zonave të pazhvilluara të RSB/BH.
4. Sfida	Sfida është të përmirësohet zhvillimi rural dhe zbutet varfëria në pjesën lindore të Bosnjë dhe Hercegovinës, në territorin që e mbulon GLV Devetak, nëpërmjet zbatimit të plotë të qasjes strategjike për planifikimin e aktiviteteve për zhvillimin rural.
5. Aktivitetet	Aktivitetet janë të bashkërenditura me procesin klasik të hartimit të strategjive (5 hapa - analiza, kursi i drejtimit, zbatimi, kontrolli), e cila është e përshtatur me koncept-modelin LEADER që shfrytëzohet për hartimin e strategjive të GLV-ve evropiane. Paralelisht me hartimin e strategjive të zhvillimit lokal, zbatohen dhe aktivitetet e ngritjes së kapaciteteve në kuptimin e zhvillimit organizativ dhe ndërgjegjësimin dhe edukimin e të gjithë përfituesve.

6. Rezultatet	1) Aktorët lokal të zhvillimit rural, përfshi dhe fëmijët dhe të rinjtë, u njoftuan me parimet e LEADER dhe rëndësinë e qasjes strategjike për zhvillimin rural nëpërmjet prezantimeve gjatë ditëve informuese; 2) Aktorët lokal të zhvillimit rural janë të vetëdijshëm për aktivitetet e GLV Devetak; për rezultatet e arritura deri më tani dhe mundësitë që i ofrojnë metodat me pjesëmarrje, si dhe përfshirjen e tyre në aktivitetet e ardhshme; 3) Rritja e numrit të anëtarëve të GLV-së prej 17 në 27 organizata; 4) Bazuar në informacionet dhe analiza e pyetësorëve nga dita informative, u përgatit një metodologji e veçantë e strategjive sipas nevojave dhe kapaciteteve të GLV Devetak, si dhe për mundësitë e zbatimit të tij real; 5) Pjesëmarrje dhe përfshirje aktive e përfaqësuesve të të gjithë sektorëve, përfshi fëmijët dhe të rinjtë në hartimin e strategjisë së GLV Devetak.
7. Mësimet e nxjerra dhe Konkluzionet	Strategjia është rezultat i punës së GLV-së dhe rezultat i mësimeve të nxjerra në periudhën prej formimit e deri më sot. Në periudhën e kaluar, GLV zbatoi projekte, por ato ishin të gjitha aty për aty dhe sipas kushteve të donatorëve, si dhe u zbatua një qasje oportune me qëllim tërheqjen e fondeve të donatorëve, ndërsa strategjia e zhvillimit lokal e GLV mbeti vetëm si një dëshirë për shkak të mungesës së fondeve LEADER. Për këtë arsye GLV hartoi një strategji për GLV Devetak që të mund të jenë të aftë të realizojnë nëpërmjet rritjes së kapaciteteve të tyre. Që të funksionojnë GLV-të, veçanërisht në kushtet socio-politike dhe ekonomike të Republikës Serbe dhe të Bosnjë e Hercegovinës, është e domosdoshme t'u qasemi aktorëve në terren (aktorëve lokal) dhe t'i angazhojmë ata me koncepte novatore, siç është LEADER dhe vazhdimisht të punojmë për të ngritur kapacitetet dhe njohuritë lidhur me mundësitë që ofrohen me përfshirjen personale të individëve, nëpërmjet një organizate siç është GLV-ja. Porosia e GLV DEVETAK për GLV-të tjera në Ballkanin Perëndimor është të përqendrohen në ngritjen e kapaciteteve të tyre dhe përmirësimin e organizatave të tyre që të jenë në gjendje t'i përmbushin nevojat e territorit në të cilin veprojnë.
8. Kontaktet	www.lag-devetak.org, info@lag-devetak.org, Slavica Ašonja, kryetar, +38765982746 Snezhana Kanostrevac Cvijetiç, nënkryetar, +38765665819.

4. KONKLUZIONET DHE REKOMANDIMET

4.1 Konkluzionet

GLV-të e regjistruara në Republikën Serbe të Bosnjës e të themeluara në bazë të parimeve LEADER duhet të kenë akses në fonde që do t'u mundësonin të zbatojnë strategjitë e zhvillimit lokal.

Ekziston nevoja që sektori publik, privat dhe civil të promovojë qasjen LEADER, si dhe të angazhojnë donatorët për të dhënë mbështetje GVL-ve funksionale dhe për të promovuar përhapjen e mëtejme të informacioneve rreth qasjes LEADER.

Është e nevojshme të krijohet kuadri ligjor për qasjen LEADER në territorin e Republikës Serbe të Bosnjës. Dokumentet strategjike e njohin qasjen LEADER, por nuk ekzistojnë rregulla të qarta për atë sesi GLV-të duhet të regjistrohen, akreditohen, përkrahen, madje dhe çfarë procedurash duhet të ndjekin për t'u regjistruar.

Ekziston nevoja për forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar ndërmjet GLV-ve të Bosnjë dhe Hercegovinës dhe GLV-ve të vendeve tjera të Ballkanit Perëndimor dhe BE-së.

GLV-të ballafaqohen me sfida kur bëhet fjalë për vazhdimësinë e funksionimit të tyre, konsideruar faktin që ata nuk kanë financim të qëndrueshëm, përkatësisht funksionimi i tyre varet nga financat/ fondet në dispozicion të projekteve.

Ekziston sfida për institucionet qeveritare të Bosnjë dhe Hercegovinës për miratimin e planit mbarëkombëtar strategjik për zhvillim rural, si dhe themelimin e strukturave për absorbimin e asistencës për para-anëtarësim në sektorin e bujqësisë nëpërmjet programit IPARD. Kjo i bllokon fondet në dispozicion për qasjen LEADER në periudhën e pranimit.

Qeveritë e BH sfidohen me mungesën e fondeve për mbështetje të bujqësisë dhe zhvillimit rural, gjë e cila i bën ata të jenë të përjashtuar nga mbështetja për zbatimin e qasjes LEADER.

Duke pasur parasysh financimin e kufizuar publik, gjetja e burimeve plotësuese financiare ose rialokimi i buxheteve aktuale për bujqësinë dhe zhvillimin rural për të financuar qasjen LEADER paraqet një sfidë të madhe.

Nuk ekziston sfond ligjor ose mbështetje e vërtetë institucionale për funksionimin e GLV-ve në përputhje me qasjen LEADER në Bosnjë e Hercegovinë.

Pjesa dërmuese e GLV-ve zotërojnë kapacitete të kufizuara për gjallërimin e aktorëve rural dhe ata duhet të vazhdojnë të punojnë për njohjen e tyre në kontekstin lokal.

4.2 Rekomandimet

Rekomandime për përmirësimin e strukturës institucionale

- Institucionet përgjegjëse qeveritare të të gjitha niveleve duhet të vazhdojnë punën për krijimin e kuadrit institucional për ngritjen, akreditimin dhe funksionimin e GLV-ve.
- Institucionet përgjegjëse qeveritare të të gjitha niveleve duhet të këshillohen me GLV-të ekzistuese në procesin e krijimit të kuadrit institucional lidhur me qasjen LEADER.
- Institucionet publike duhet të sigurojnë mbështetje dhe shërbime këshillimore për

funksionimin e GLV-ve në përputhje me qasjen LEADER në Republikën Serbe të Bosnjës, Bosnjë e Hercegovinë.

Rekomandime për përmirësimin e politikave

- Ministria e Bujqësisë, pyjeve dhe administrimit të ujërave e Republikës Serbe të Bosnjës (MAFWMRSB) duhet të zbatojë masa për mbështetjen e GLV-ve në kuadër të rregulloreve të tyre vjetore në pajtueshmëri me Planin strategjik për zhvillimin e bujqësisë dhe zonave rurale për periudhën e viteve 2016-2020.
- Ministria e Bujqësisë, pyjeve dhe administrimit të ujërave e Republikës Serbe të Bosnjës duhet të parashikojë që edhe ministritë tjera, donatorët dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore të përkrahin zbatimin e strategjive të zhvillimit lokal në pajtueshmëri me kapacitetet e tyre.
- MAFWMRSB duhet të punojnë në krijimin e kuadrit ligjor për qasjen LEADER në bashkëpunim të ngushtë me GLV-të ekzistuese.

Rekomandime për fuqizimin e aktorëve lokal

- Institucionet përgjegjëse qeveritare dhe joqeveritare të të gjitha niveleve duhet të promovojnë dhe mbështesin zbatimin e qasjes LEADER në mesin e komuniteteve rurale.
- Të gjithë aktorët e zonave GLV duhet të përkrahin funksionimin e GLV-ve dhe të bashkëpunojnë në realizimin e strategjive për zhvillim lokal.
- Ekziston nevoja për transferimin e praktikave të mira nga LEADER të BE në nismat LEADER të BH.
- GLV-të duhet të punojnë për ngritjen e kapaciteteve të organizatave të tyre, veçanërisht në lidhje me menaxhimin e programeve dhe projekteve me qëllim shfrytëzimin e fondeve të LEADER kur ata të bëhen të disponueshme.

5. SHTOJCAT

5.1 Shtojca 1: Referencat

ACED (2015) LEADER dhe CLLD në Bosnjë dhe Hercegovinë; Aleanca për zhvillim të përbashkët rural; Banja Luka, 2015;

Komisioni Evropian (2016) Raporti i vitit 2016 për Bosnjë dhe Hercegovinën; SWD (2016) 365 finale; Bruksel, 9.11.2016;

Qeveria e RSB (2009) Plani strategjik për zhvillim rural të Republikës Serbe të Bosnjës për periudhën 2009-2015.; Banja Luka, Prill 2009;

Qeveria e RSB (2011) Strategjia për mbrojtje të mjedisit jetësor të Republikës Serbe të Bosnjës; Banja Luka, Prill 2011;

Qeveria e RSB (2015) Plani strategjik për zhvillim të Bujqësisë dhe zonave rurale të Republikës Serbe të Bosnjës në periudhën prej vitit 2016 deri në vitin 2020; Banja Luka, Maj 2015;

Qeveria e RSB (2016a) Strategjia për zhvillim të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme të RSB në periudhën prej vitit 2016 deri në vitin 2020; Banja Luka, Shtator 2016;

Qeveria e RSB (2016b) Strategjia për zhvillim të industrisë së RSB në periudhën prej vitit 2016 deri në vitin 2020; Banja Luka, Tetor 2016;

GLV Devetak (2016) Strategjia për GLV Devetak; Rogaticë, 2016;

GLV Devetak dhe GLV Drina (2015) Raport mbi konferencën: Pozita e BH në procesin e krijimit të GLV - roli dhe rëndësia e GLV-ve në procesin e përafrimit të BH me standardet e BE-së për zhvillimin rural; Rogaticë, maj 2015;

MAFWMRS (2010, 2011, 2012, 2013, 2014, 2015, 2016, 2017), Rregulloret për mbështetjen e zhvillimit të bujqësisë dhe zonave rurale; Ministria e Bujqësisë, pylltarisë dhe administrimit të ujërave e Republikës Serbe të Bosnjës, Banja Luka;

Ministria e industrisë, energjisë dhe minierave (2011) Studim mbi ruajtjen e zejeve të vjetra në RSB; Banja Luka, Dhjetor 2011;

Ministria e planifikimit hapësinor, inxhinieri civile dhe ekologjisë (2013) Plani hapësinor i Republikës Serbe të Bosnjës deri më 2025; Banja Luka, Nëntor 2013;

MOFTER (2011, 2012, 2013, 2014, 2015) Raportet mbi aktivitetet e Grupeve Lokale të Veprimit; Sarajevë, 2012, 2013, 2014, 2015, 2016;

Gazeta Zyrtare e BH Nr. 32 (2001) Ligji për shoqata dhe fondacione e Bosnjës dhe Hercegovinës i miratuar nga Kuvendi i BH në vitin 2001; botuar në Gazetën Zyrtare të BH nr. 32, e datës 28 dhjetor 2001;

Gazeta Zyrtare e BH Nr. 50 (2008) Ligji për Bujqësi, Ushqim dhe Zhvillim Rural i Bosnjë dhe Hercegovinës miratuar nga Kuvendi i BH në vitin 2008; botuar në Gazetën Zyrtare të BH, nr. 50, e datës 23 qershor 2008;

Gazeta Zyrtare e RS Nr. 18 (2012) Rregullorja Vjetore mbi kushtet për arritjen e stimujve financiarë

për zhvillimin e bujqësisë dhe fshatrave;

Gazeta Zyrtare e RSB Nr. 25 (2011) Rregullorja Vjetore mbi kushtet për arritjen e stimujve financiarë për zhvillimin e bujqësisë dhe fshatrave;

Gazeta Zyrtare e RSB Nr. 52 (2001) Ligji për shoqata dhe fondacione e Republikës Serbe të Bosnjës, miratuar nga Kuvendi i RS në vitin 2001; botuar në Gazetën Zyrtare të RSB Nr. 52 nga 17 tetor 2001;

Gazeta Zyrtare e RSB Nr. 70 (2006) Ligji për Bujqësi i Republikës Serbe të Bosnjës, miratuar nga Kuvendi i RSB në vitin 2006; botuar në Gazetën Zyrtare të RSB nr. 70 nga 4 korriku 2006;

Gazeta Zyrtare e RSB Nr. 97 (2016) Ligji për Vetëqeverisjen lokale në Republikën Serbe të Bosnjës, miratuar nga Kuvendi i RSB në vitin 2016; publikuar në Gazetën Zyrtare të RSB Nr. 97 nga 18 nëntori 2016;

UNDP (2013) Zhvillimi rural në Bosnjë dhe Hercegovinë: Miti dhe RealitetI; Sarajevë, 2013;

VESTA (2012) Qasja LEADER – përdorimi për komunitetet rurale në BH; Tuzla, 2012;

5.2 Shtojca 2: Lista e kontakteve

Aleksandra Gavrić-Rožić, Bashkëpunëtor i lartë për zhvillim rural në Ministrinë e Bujqësisë, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave të Republikës Serbe të Bosnjës,
e-mail: A.Gavric.Rozic@mps.vladars.net;

Slavica Ašonja, kryetar i GLV Devetak,
e-mail: info@GLV-devetak.org or slavicaasonja@yahoo.com;

Snežana Kanostrevac Cvijetić, nënkryetare e GLV Devetak,
e-mail: info@GLV-devetak.org or snezakc@yahoo.com.

5.3 Shtojca 3: Sipërfaqja dhe popullsia e GLV në Republikën Serbe të Bosnjës

Emri i GLV	Sipërfaqja e GLV (km²)	Popullsia në zonën e GLV	Komunat që mbulohen nga GLV
Devetak	1.677	28.054	Sokolac, Han Pijesak, Rogatica
Savus	2.102	136.650	Laktashi, Gradishka, Srbac, Kozarska Dubica
Vrbanja – Ukrina	1.553	77.274	Prnjavor, Çelinac, Kotor Varosh
Biraç	1.726	125.168	Srebrenica, Miliçi, Zvornik, Bratunac dhe Vlasenica
Rajoni Doboj (Pjesa në RSB)	1.197 (648 në RS)	150.598 (68.514 në RS)	Doboj (RS) Maglaj (FBH) Graçanicë (FBH)
Gjithsej në Republikën Serbe të Bosnjës	7.706 km²	435.660 ban.	16 nga 62 komuna

KAPITULLI B.IV

Vlerësimi i zbatimit të qasjes LEADER në vendet e Ballkanit Perëndimor - “nga një iniciativë lokale në një koncept qendror në zonat rurale

Raporti i shtetit: Kosovë*

Autor: Prof. Dr. Mihone Kerolli-Mustafa

1. HYRJE

Qëllimi i këtij punimi është që të kontribuojë në kuptimin se si funksionon "Qasja LEADER" - Iniciativat e reja për zhvillim rural, në Kosovë*. Qasja LEADER përqendrohet në integrimin e mundësive për zhvillim rural ku energjia njerëzore, burimet njerëzore dhe të organeve si aktorë të zhvillimit janë thelbësor. Kjo qasje kontribuon në formimin e partneriteteve dhe zhvillimin e rajonit përmes përfshirjes së të gjithë palëve të interesuara dhe formimin e Grupit lokal të veprimit (GLV) të bazuar në territor. GLV-të janë partneritete territoriale ndërmjet sektorit publik, civil dhe privat, manifestimi më i dukshëm i LEADER[48].

Nga 2007-2013, periudha e programimit të zhvillimit rural, Qasja LEADER në Kosovë* është zhvendosur nga politika e përgjithshme e zhvillimit rural të BE. Kjo do të thotë se LEADER është përfshirë në programet kombëtare dhe rajonale për zhvillim rural të mbështetura nga BE. Objektivat kryesore të qasjes LEADER adresojnë ndërtimin e kapaciteteve lokale, mundësitë e reja për punësim, diversifikimin e aktiviteteve në zonat rurale, stimulimin e zhvillimit endogjen, përmirësimin e menaxhimit në zonat rurale dhe zgjerimin e inovacionit[49]. Qasja LEADER në Kosovë* është ndërtuar mbi bazën e Programit për bujqësi dhe zhvillim rural (ARDP) 2007-2013[50] pasuar nga ARDP 2014-2020[51]. Duke marrë parasysh këtë kontekst, Kosova* ka bërë përparim në procesin e zhvillimit të strategjive kombëtare bujqësore dhe mekanizmave të kontrollit. Mbështetja e BE-së përmes Instrumentit për Asistencë Para-anëtarësimi (IPA) 2014-2020 dhe ndihmës së TAIEX, inkurajon zhvillimin e mëtejshëm të sektorit bujqësor dhe harmonizimin e politikave kombëtare. Megjithatë, Raport Progresi i KE[52] për Kosovën* i referohet një niveli të përgatitjes/fillestar në bujqësi dhe zhvillim rural. Rritja e alokimeve buxhetore për sektorin e bujqësisë ka kontribuar në njëfarë progresi. Në vitin 2016, buxheti i alokuar për grante investuese bujqësore dhe rurale u rrit nga 20 milionë në 23 milionë euro. Prandaj, mungesa e stafit vazhdon ta dëmtojë/ gërryejë përparimin e duhur të shumë aktiviteteve në sektorin e bujqësisë. Në përgjithësi, zonat rurale të Kosovës* karakterizohen nga burime natyrore shumë të pasura (toka, cilësia e ajrit, shumëllojshmëria e madhe, peizazhi i ndryshëm) dhe jetesa në zonat rurale është e favorshme në kuptimin e një mjedisi më të pastër dhe më të qetë dhe kostove më të ulëta të jetesës se sa në qytete. Kështu që, përmirësimi i qasjes LEADER dhe mbështetja e investimeve për zonat rurale do të mbetet prioritet.

Fokusi kryesor i këtij punimi i është përkushtuar zbatimit të LEADER në Kosovë*. Përveç Hyrjes dhe Konkluzioneve, ky dokument përbëhet nga dy Kapituj që analizojnë LEADER në dokumentet kombëtare strategjike dhe të programeve dhe një Kapitull që i është kushtuar sukseseve dhe dështimeve të LEADER, bazuar në iniciativat e mëparshme dhe mësimet e nxjerra. Është përdorur metoda e intervistës me postë të përfaqësuesve të grupeve dhe shoqatave të ndryshme për të grumbulluar një përqindje të mirë të përgjigjeve në lidhje me qasjen aktuale LEADER në Kosovë*. Pyetësorët iu dërguan me postë përfaqësuesve dhe u grumbulluan duke i vizituar përfaqësuesit personalisht, gje që ofroi mundësinë për kontakt të drejtpërdrejtë me të intervistuarit.

[48] *Lukic A, Obad O. Aktorët e rinj në zhvillimin rural - Qasja LEADER dhe Projektifikimi në Kroacinë rurale, Sociologjia dhe hapësira, 54 (2016) 204 (1): 71-90.*

[49] *Cunder T, Bedrac M. "QASJA LEADER" – MUNDËSI E RE ZHVILLIMI PËR ZONAT RURALE NË SLOVENI, Revista për Gjeografi, 5 (2010) 2, 55-65.*

[50] *MAFRD, (2013), Plani për bujqësi dhe zhvillim rural 2010- 2013, http://app.seerural.org/wp-content/uploads/2013/08/Kosovë*-ARDP-2010-2013-ENG.pdf*

[51] *MAFRD. 2013b. Programi për bujqësi dhe zhvillim rural 2014-2020. Prishtinë*

[52] *https://ec.europa.eu*

2. MJEDISI LEADER NË KOSOVË*

2.1 Leader në dokumentet kombëtare strategjike dhe të programeve

Duke ndjekur parimet e strategjisë së re të BE 2020 dhe CAP për periudhën 2014-2020, Ministria e Bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural (MAFRD) përgatiti Programin për bujqësi dhe zhvillim rural (ARDP) 2014 - 2020 me mbështetjen e një projekti të BE për binjakëzim dhe një projekti të financuar nga Asistenca teknike daneze. ARDP 2014-2020 ndjek prioritetet e IPA për:

1. Rritje të qëndrueshmërisë të fermës, aftësisë konkurruese;
2. Rivendosja, ruajtja dhe rritja e ekosistemeve;
3. Promovim i përfshirjes sociale, ekonomike; dhe
4. Transferim i dijes, inovacionit.

ARDP 2014-2020 dhe prioritetet e tij janë në përputhje me Strategjinë e BE 2020 për Rritje të zgjuar, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, duke qenë posaçërisht në konvergjencë/linjë me këto objektiva të strategjisë për mbështetjen e diversifikimit të aktiviteteve ekonomike dhe forcimit të Qasjes LEADER.

Sot, LEADER është pjesë e masës 303 të ARDP për 2014-2020 të Kosovës*, me një buxhet prej rreth 2.4 milionë euro. Sot në Kosovë* ka 12 GLV, që përfshijnë pothuajse 55% të territorit të Kosovës*. Më shumë se gjysma e popullsisë së Kosovës* jeton në njësi administrative lokale të përfshirë në GLV-të. Prandaj, parimet kryesore të qasjes LEADER në Kosovë* janë përqendruar në përpjekjet për zhvillimin e shoqërinë civile dhe dialogut social brenda popullsisë rurale dhe për lehtësimin e qeverisjes së mirë përmes partneriteteve lokale, nxitjen e punësimit dhe zhvillimin e kapitalit njerëzor. Objektivat specifike janë përqendruar në forcimin dhe ndërtimin e kapaciteteve të GLV-ve në mesin e banorëve të zonave rurale; rritjen e ndërgjegjësimit mbi mundësitë LEADER; promovimin e zhvillimit rural nëpërmjet iniciativave lokale dhe partneritetit; inkurajimin e popullatës rurale për pjesëmarrje aktive në aktivitetet e GLV-ve; zhvillimin, organizimin dhe drejtimin e GLV-ve; duke siguruar që GLV-të të funksionojnë në përputhje me Qasjen LEADER; dhe shkëmbimin e përvojave dhe mësimeve të nxjerra mes GLV-ve. Sipas ARDP 2007-2013, GLV-të janë të regjistruara si OJF në Ministrinë e Administratës publike dhe ata mund të aplikojnë për financim nga fonde të ndryshme (jo vetëm mbështetja LEADER). Ata veprojnë nëpërmjet strukturave të tyre drejtuese të përbërë nga një komitet drejtues me minimumi tetë anëtarë, të propozuar dhe të miratuar nga asambleja e përgjithshme.

Elementet kryesore të cilët e paraqesin qasjen ligjore sipas strategjisë kombëtare përqendrohen në strategjitë kryesore të zhvillimit lokal të bazuar në territore të dedikuara për territore ndër-rajonale rurale të mirë-identifikuara; partneritetet publike-private-lokale; qasja nga poshtë-lart me fuqi vendimmarrëse për Grupet lokale të veprimit në lidhje me shtjellimin dhe zbatimin e strategjive për zhvillim lokale (SZHL); hartimin dhe zbatimin shumë-sektorial të strategjisë së bazuar në ndërveprimin ndërmjet aktorëve dhe projekteve në sektorë të ndryshëm të ekonomisë lokale; rrjetëzimin e partneriteteve lokale dhe zbatimin e qasjeve novatore.

2.2 Rregullimet institucionale dhe ligjore

Departamenti i politikave për zhvillim rural (DPZHR), duke vepruar si Autoriteti menaxhues (AM) i ARDP është përgjegjës për koordinimin dhe funksionimin e duhur të strukturës LEADER në Kosovë*. Autoriteti menaxhues ka përgatitur planin dhe programin, ndërsa Agjencia e pagesave është përgjegjëse për ekzekutimin dhe pagesat e projekteve. Struktura organizative e AM-së dhe ndarja e funksioneve të tij janë në përputhje me kërkesat e IPARD. Kriteret për mbështetjen e qasjes

LEADER janë të rregulluara me Udhëzim Administrativ[53] sipas kriterit të MAFRD për mbështetje të strategjive për zhvillim lokal- Qasja LEADER si një ndryshim dhe plotësim i Ligjit kryesor 03/098[54] për Bujqësinë dhe zhvillimin rural. Objektivi kryesor i Udhëzimit mbështetet në ndërtimin e një kapaciteti të qëndrueshëm në nivel lokal për hartimin e politikave për zhvillimin rural dhe zbatimin e strategjive të zhvillimit lokal. Udhëzimi Administrativ mbi kriteret për mbështetjen e strategjive të zhvillimit lokal - Qasja LEADER u ndryshua me një Udhëzim të ri Administrativ[55] duke shtuar informacion të ri në ndarjen e mjeteve financiare për GLV-të. Në përputhje me ARDP 2007-2013, në vitin 2008, GLV-të u krijuan përmes një projekti të financuar nga BE i cili mbështeti GLV-të përgjatë periudhës 15-mujore të hartimit të strategjive të zhvillimit lokal, duke përfshirë edhe draft-propozimin e projektit. Mbështetja drejt zbatimit të strategjive të zhvillimit lokal dhe zbatimit të masave 303 dhe 303.2 është ndërtuar në bazë të ligjeve të mbështetura si më poshtë: Ligji për Bujqësinë dhe zhvillimin rural[56], Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Bujqësinë dhe zhvillimin rural[57], Ligji për vetëqeverisjen vendore[58], Ligji për barazi gjinore[59], Ligji për Lirinë e asocimit në OJQ[60] dhe Ligji për shërbimet këshillimore për bujqësinë dhe zhvillimin rural[61]. Në pothuajse çdo komunë ekziston një Grup lokal i veprimit, me përjashtim të disa komunave të reja që kanë krijuar grupe pune në vend të GLV-ve, komuna të cilat nuk kanë qenë përfitues të projektit të BE-së ose komunat të cilat janë themeluar kohët e fundit. Lidhjet midis komunave dhe GLV-ve janë shumë të forta. Sipas procedurës, GLV duhet të përfaqësojnë një zonë rurale me një popullsi prej më shumë se 10,000 dhe më pak se 150,000 banorë, përfshi qytetet e vogla dhe qytetet me një popullsi më të vogël se 30,000. Në këtë drejtim, GLV-ja duhet të jetë koherente në aspektin gjeografik dhe të ofrojë masë të mjaftueshme kritike në aspektin e burimeve njerëzore, financiare dhe ekonomike për të mbështetur një strategji të qëndrueshme zhvillimi. Për më tepër, një GLV duhet të jetë një person juridik i regjistruar zyrtarisht në përputhje me aktet përkatëse ligjore në fuqi dhe duhet të tregojë aftësi për të përcaktuar dhe zbatuar një strategji të zhvillimit lokal për zonën. Për t'u bërë GLV i zgjedhur në kuadër të ARDP 2014-2020, GLV-të potenciale vlerësohen në bazë të kritereve të dhëna nga MA dhe në bazë të cilësisë së Strategjisë së zhvillimit lokal (SZHL) që ata kanë. Vlerësimi bëhet nga Komisioni për vlerësim i përbërë nga përfaqësues nga Autoriteti menaxhues dhe nga aktorët tjerë relevant rural dhe OJF-të që merren me zhvillimin rural. Anëtarët e Komisionit për vlerësim zgjidhen nga Ministri përgjegjës për ARDP 2014-2020 bazuar në propozimet e Autoritetit menaxhues. Edhe pse 30 GLV janë themeluar zyrtarisht, më pak se gjysma prej tyre promovojnë dhe zbatojnë në mënyrë aktive projekte në zonat e tyre[62], ndërsa të tjerët janë gjithnjë e më pak aktive.

GLV-të në Kosovë* përbëhen nga 25-30 anëtarë (të cilët vijnë nga sfera të ndryshme, siç janë përfaqësuesit e komunave, OJF-të lokale, fermerët, ekspertë biznesi dhe vullnetarë nga fusha të ndryshme) me një ndarje 50:50 ndërmjet organizatave apo personave publik dhe privat. Në të shumtën e rasteve kryetari i bordit është shefi i Zyrës së Komunës për bujqësinë. Tridhjetë për qind e anëtarëve të bordit duhet të jenë gra me qëllim të sigurimit të pjesëmarrjes së grave rurale në proceset e zhvillimit lokal. Komunikimi, shpërndarja, promovimi dhe informimi ndërmjet GLV-ve dhe palëve tjera të interesuara rurale, zhvillohet përmes Rrjetit për zhvillim rural (NRD). NRD është themeluar si një platformë ku mund të diskutohen idetë e projektit dhe propozime dhe përvoja tjera të ndryshme. Anëtarët e NRD janë po ashtu anëtarë të grupeve të ndryshme të punës të emëruar nga MBPZHR. Roli i Rrjetit është të bëjë lobim për GLV-të dhe t'i promovojë ato brenda dhe jashtë vendit. Tarifa e anëtarësimit është 100 euro në vit për secilin GLV që është angazhuar nën një projekt nga

53 *Udhëzimi administrativ 16/2014, http://www.mbpzhr-ks.net*
54 *Ligji 03/098, Gazeta zyrtare, http://www.gazetazyrtare.com/*
55 *Udhëzimi administrativ 19/2014, http://www.mbpzhr-ks.net*
56 *Ligji 03/L098, Gazeta zyrtare, http://www.gazetazyrtare.com/*
57 *Ligji 04/L090 (Neni 1 dhe Neni 5), Gazeta zyrtare, http://www.gazetazyrtare.com/*
58 *Ligji 03/L040 (Neni 2 dhe Neni 3), Gazeta zyrtare, http://www.gazetazyrtare.com/*
59 *Ligji Nr.2004/2 (Neni 4), Gazeta zyrtare, http://www.gazetazyrtare.com/*
60 *Ligji Nr. 03/L-13 (Neni 14), Gazeta zyrtare, http://www.gazetazyrtare.com/*
61 *Ligji 04/L-074 (Neni 2, Neni 3 dhe Neni 7), Gazeta zyrtare, http://www.gazetazyrtare.com/*
62 *http://www.mbpzhr-ks.net*

MBPZHR. Aktivitetet e NRD janë të kufizuara për shkak të mungesës së kuptimit të rolit dhe rëndësisë së NRD si dhe mungesës së mbështetjes financiare. Mbështetja për zhvillimin organizativ të GLV-ve të përzgjedhura në Kosovë* ofrohet përmes Rrjetit të organizatave për zhvillimin rural të Kosovës* (RROZHRK)[63]. RROZHRK është themeluar me qëllim që të përfaqësojë interesat e organizatave nga zonat rurale dhe të kontribuojë në zhvillimin socio-ekonomik të zonave rurale të Kosovës*. Rreth 55 organizata individuale rurale janë të përfaqësuara nën ombrellën e tij (kooperativat bujqësore, shoqatat e fermerëve, klubet e fermerëve të rinj, GLV-të dhe shoqatat e grave). Roli i RROZHRK drejt aktiviteteve të GLV-ve mbështetet gjerësisht në rritjen e bashkëpunimit ndërmjet anëtarëve të rrjetit brenda organizatës, duke përfshirë GLV-të, në aspektin e rritjes së nivelit të përkrahjes dhe lobimit mbi çështjet e zhvillimit rural. Shumica e GLV-ve të themeluara në Kosovë* funksionojnë në mënyrë të pamjaftueshme për të menaxhuar zbatimin e strategjive për zhvillim lokal për shkak të përfshirjes së kufizuar të aktorëve rural, për shkak të ndërgjegjësimit të ulët dhe mungesës së informacionit, si dhe mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare dhe njerëzore. Nevojitet trajnim adekuat, instrumente fillestare dhe ngritje e ndërgjegjësimit që drejtuesit e GLV-ve dhe aktorët rural të përfshihen më shumë dhe të përkushtohen në proceset e zhvillimit lokal. Masat aktuale për mbështetje nuk janë në përputhje me konceptin LEADER të BE-së dhe nuk kanë qasje nga poshtë-lart dhe fuqi vendimmarrëse për GLV-të. Për më tepër, rritja e mbështetjes financiare për punën e vazhdueshme administrative dhe organizative të GLV-ve është e rëndësishme për aktivizimin e pjesëmarrjes së vendasve dhe për të siguruar që GLV-të janë vazhdimisht aktive.

2.3 Financimi

Fondet që në mënyrë të drejtpërdrejtë mbështesin GLV-të janë fondet kombëtare të MBPZHR (boshti 4, masa 8). Në vitin 2011, MBPZHR-ja ka alokuar/ndarë 100,000 euro, në vitin 2012, 200,000 euro, ndërsa në vitin 2016, 375,375 euro për zbatimin e projekteve të vogla dhe të paracaktuara për investime. Megjithatë, nuk ka pasur financim nga BE (LEADER/MBPZHR) për GLV-të. Projektet nga fondet e MBPZHR janë kryesisht projekte të vogla dhe megjithëse nuk ofrojnë mundësi për planifikim të zhvillimit strategjik, i mbajnë GLV-të aktive. Për mbulimin e kostove të tyre operacionale GLV-të kryesisht mbështeten në angazhimin vullnetar të anëtarëve të bordit. Përveç kësaj, disa drejtues të GLV-ve, me iniciativën e tyre personale krijojnë kontakte me donatorë të ndryshëm për mbështetje. Që nga viti 2012, për projekte LEADER kanë aplikuar 21 nga Grupet lokale të veprimit dhe janë mbështetur vetëm 52 projekte me një vlerë prej 290,613 euro (MTE, 2012). Fondet e alokuara janë paguar tërësisht vetëm në vitin 2011 kur niveli i mbështetjes ka qenë 70% (Shtojca 5.1. Tabela 1).

Shpenzimet totale publike (fondet kombëtare plus fondet e BE-së) përbëjnë deri në 100% të vlerës së Masës për asistencë teknike - "Përvetësimi i aftësive dhe nxitja e banorëve të territoreve rurale për GLV-të e mundshme", nën masën 303.1 - "Përvetësimi i aftësive dhe nxitja e banorëve të territoreve të GLV-ve për GLV-të e përzgjedhura" dhe shpenzimet operative të GLV-ve të përzgjedhura (MBPZHR 2014). Nga ana tjetër, shpenzimet publike (kombëtare) për projektet në shkallë të vogël nën nën-masën 303.2 - "Zbatimi i strategjive të zhvillimit lokal për GLV-të e përzgjedhura" përbëjnë deri në 70%. Sipas procedurës, GLV-të e kontraktuara do të pranojnë një pagesë paraprake për aktivitetet fillestare nga fondi kombëtar. Por këto fonde nuk do të kalojnë 50% të alokimit vjetor të mbështetjes publike në lidhje me shpenzimet operative dhe projektet e vogla dhe të nxitjes. Treguesi i buxhetit të shpërndarë për periudhën 2014-2020 është paraqitur në Shtojcën 5.2 (Tabela 2.)

[63] *Rrjeti i Organizatave për zhvillim rural të Kosovës* është një shoqatë civile jofitimprurëse e themeluar nga 55 organizata dhe aktiviteti i tij kryesor është zhvillimi bujqësor dhe rural në rajonet më pak të zhvilluara të Kosovës*.*

3. NISMAT E MËPARSHME DHE MËSIMET E NXJERRA

Tabela B. IV. 1: Rasti studimor 1

1. Titulli dhe autori	**Iniciativa të veprimit lokal në komunën e Vitisë**
2. Përmbledhje ekzekutive	Ky rast studimor shqyrton në detaje efektivitetin e funksionimit të GLV në Viti në arritjen e qëllimeve të vendosura nga ARDP në Kosovë*. GLV e Vitisë vepron duke përdorur asistencën teknike të ofruar nga Ministria, Komuna dhe donatorë tjerë. Fokusi kryesor ishte shkëmbimi i njohurive dhe përvojës së tyre për rëndësinë e strategjisë për komunitetin lokal dhe se si u zhvillua strategjia e GLV-së për t'iu përgjigjur nevojave të komunitetit duke shfrytëzuar burimet lokale. Për të përfunduar këtë rast studimor, u përdorën prova nga dy perspektiva: • Të dhënat sasiore u përdorën për të shqyrtuar zbatimin efektiv të praktikave të mira. • Të dhënat cilësore u përdorën për të shqyrtuar suksesin e GLV në përmirësimin e cilësisë së jetesës në zonat rurale dhe inkurajimin e diversifikimit të aktivitetit ekonomik në rajonin përkatës.
3. Të dhënat për komunitetin	Komuna e Vitisë është e vendosur në jug-lindje të Kosovës*. Ajo mbulon një sipërfaqe prej përafërsisht 276 km² dhe përfshin qytetin e Vitisë dhe 38 fshatra. Popullsia totale është përafërsisht 47,000 (46,987 sipas censusit të popullsisë dhe banesave në Kosovë të vitit 2013)[64]. Ekonomia e komunës së Vitisë kryesisht është e bazuar në bujqësi dhe bizneset e vogla tregtare. Në këtë komunë operojnë rreth 1.000 biznese të regjistruara. Nuk ka të dhëna të besueshme për numrin e të punësuarve në sektorin privat në Viti[65]. Grupi lokal i veprimit "Vitia" në Viti është themeluar në vitin 2009 nën emrin "AGROVITIA". Në partneritet të plotë me të gjithë palët e interesuara, kjo GLV është themeluar për të ndihmuar në krijimin e kushteve dhe mundësive për zhvillim të qëndrueshëm rural në zonat rurale të Vitisë, me theks të veçantë mbi zhvillimin infrastrukturor, turizmin rural, bujqësinë, agrobiznesin dhe shfrytëzimit të burimeve, duke përdorur burimet natyrore dhe duke mbrojtur mjedisin dhe trashëgiminë.
4. Sfida	Që nga fillimi i saj, Qasja LEADER në Kosovë* ka synuar tu ofrojë komuniteteve rurale një mundësi për përfshirjen e partnerëve lokal në hartimin e zhvillimit të zonës së tyre. Ajo ka përfaqësuar një nga aktivitetet më sfiduese për adresimin e mundësisë së mobilizimit të zonave rurale, duke përdorur burimet e tyre natyrore, duke adresuar nevojat e tyre dhe duke promovuar mbrojtjen e mjedisit dhe trashëgimisë. Ndërgjegjësimi dhe pranimi i qasjes LEADER dalëngadalë ka fituar terren. Megjithatë, kuptimi më i thellë i LEADER mbetet si një nga mjetet më të fuqishme për nxitjen e zhvillimit rural në përgjithësi. Për këtë proces, krijimi i GLV-ve në Kosovë* u pa si një hap i rëndësishëm drejt rritjes dhe zbatimit të strategjive të zhvillimit lokal, partneriteteve publike-private lokale, veprimeve të integruara dhe shumë-sektoriale, inovacionit, bashkëpunimit dhe rrjetëzimit. Sfidat kryesore me të cilat ballafaqohet qasja LEADER në Kosovë* mbështeten

[64] *KAS, Kosovë* Censusi i popullsisë dhe banesave 2013, http://ask.rks-gov.net*
[65] *OSCE Profilet e komunave, www.osce.org/kosovo/66047*

	në bazën e LEADER për të përkrahur strategjitë lokale për zhvillim. Ky fakt lidhet me disa probleme si pasojë e mungesës së përvojës relevante në institucionet dhe agjencitë e përfshira në menaxhimin dhe zbatimin e Qasjes LEADER, si dhe shkallës së ulët të vetëdijes së komuniteteve lokale rreth potencialit të qasjes LEADER. Zbatimi i strategjive për zhvillim lokal dhe funksionimi i GLV në Viti gjatë periudhës së programimit 2009-2017 ka treguar se përfshirja e aktorëve lokal në zhvillimin e zonave në të cilët ata veprojnë do të kontribuojë në zhvillimin lokal dhe do të shpie në një zhvillim dinamik. Megjithatë, mbështetja financiare dhe kushtet siç janë decentralizimi politik-administrativ, rrjetëzimi i aktorëve dhe politikave, si dhe dinamika dhe qasja në fondet e huaja mbeten shumë sfiduese në arritjen e qëllimeve të programit.
5. Aktivitetet	Zbatimi i LEADER në komunën e Vitisë u prezantua "hap pas hapi" përgjatë disa viteve meqë hartimi i strategjive të zhvillimit lokal ishte sfiduese. Koncepti i qasjes LEADER në Komunën e Vitisë është promovuar në dokumentet të cilët miratojnë Strategjitë e zhvillimit lokal dhe Planin zhvillimor të komunave (MDP)[66] të cilët paraqesin planin strategjik dhe dokumentin e programimit financiar të zhvilluar nga një partneritet i gjerë që udhëzon dhe stimulon zhvillimin socio-ekonomik në përputhje me Strategjinë kombëtare për zhvillim 2016-2021 (NDS)[67] Vetë qasja kryesisht është përcaktuar nga prioritetet e mëposhtme: • Rritja e vetëdijes dhe promovimi i qasjes LEADER; • Përmirësimi i bashkëpunimit ndërmjet komunës dhe qytetarëve; • Hartimi, zbatimi dhe mbikëqyrja e programeve dhe politikave rurale lokale; • Shfrytëzimi koherent i burimeve lokale; • Krijimi i programeve koherente dhe shfrytëzimi i mbështetjes së jashtme/huaj; • Pjesëmarrja në seminare, workshope, takime, vizita studimore dhe ngjarje tjera të organizuara nga rrjetet kombëtare dhe evropiane për ZHR; • Zhvillimi dhe zbatimi i projekteve të vogla në përputhje me strategjinë e zhvillimit lokal me qëllim mbështetjen e zhvillimit të infrastrukturës, turizmit rural, bujqësisë, agrobiznesit dhe dhe shfrytëzimit të burimeve, përmes shfrytëzimit të burimeve natyrore dhe mbrojtjes së mjedisit dhe trashëgimisë. Broshura e projektit GLV për LEADER e hartuar në bashkëpunim me Komunën dhe Departamentin për zhvillim ekonomik në Viti ilustroi aktivitetet e GLV dhe vlerën e shtuar të LEADER. Për më tepër, shpërndarja e një sërë fletësh informative "Praktikat më të mira LEADER për Strategjinë e zhvillimit lokal në Viti" tregon shembuj relevantë praktikë të përdorur nga GLV në Viti gjatë zbatimit të Qasjes LEADER gjatë periudhës së viteve 2009 - 2017. Sidoqoftë, mungesa e fondeve të mjaftueshme dhe përvojës së drejtimit të projekteve, vazhdojnë të ndjekin funksionimin e GLV në Viti. Përveç rrjetëzimit të shkëlqyer të krijuar brenda komunës, kapaciteti drejtues i GLV në Viti duhet të forcojë bashkëpunimin me GLV-të tjera në Kosovë*, shkëmbimin e njohurive dhe të mësuarit nga njëri-tjetri për të informuar palët e interesuara dhe të stimulojnë zonat rurale për t'u përfshirë më shumë në procesin e zhvillimit rural.

[66] *MADRD, 2016 Programi PZHR i Vitisë (2010-2020).*

[67] *Qeveria e Kosovës*. 2016. Strategjia kombëtare për zhvillim 2016-2021, Prishtinë.*

6. Rezultatet	Në periudhën prej 2009 - 2017, kjo GLV ka drejtuar disa projekte. Projekti i parë "Promovimi i ushqimit tradicional" u realizua në vitin 2009 në bashkëpunim me MAFRD, departamentin e bujqësisë së komunës, rrjetin e GLV-ve dhe shoqatat tjera të fermerëve. Aktiviteti ndihmoi në rritjen e përfshirjes së palëve të ndryshme të interesuara lokale dhe forcimin e partneritetit në komunitet. Projektet të tilla si: Strategjia për zhvillim rural 2010, Oborri shkollor "Hysen Tërpeza", Riparimi i fushës së futbollit në Viti, Zhvillimi i turizmit rural në Debellde, Organizimi i panaireve, inkubatorët e biznesit, mundësive të punësimit në zonat rurale[68], etj., kontribuuan në përmirësimin e infrastrukturës rurale dhe krijuan një mjedis më të mirë për bizneset e reja fillestare ne zonat rurale. Në këtë drejtim, pas shpërndarjes së informacionit dhe njohurive të përfituara, anëtarët e GLV-së arritën të krijonin një interesim të madh brenda bashkësisë lokale, kështu që i gjithë komuniteti ishte i përfshirë dhe dëshironte të merrte pjesë në zhvillimin e këtyre projekteve. Përmes zbatimit të këtyre projekteve, GLV-ja në Viti arriti të integrojë në mënyrë të duhur sektorë të shumtë (bujqësi, turizëm, mjedis, tregti) në zhvillimin e komuniteteve lokale. Shumica e këtyre projekteve janë mbështetur nga komuna, GIZ, Helvetas dhe Banka botërore. Projekti më i madh ishte punësimi i të rinjve në zonat rurale, i cili filloi në vitin 2016. Projekti mbështeti 50 përfitues të inkubatorit (fermer pularie, i cili u shoqërua me një trajnim për përdorimin e pajisjeve të ndryshme), 50 koshere dhe tymues, krijimin e sistemit të ujitjes për dy anëtarë të shoqatave të grave - "Lubisht" me 16 përfitues dhe "Gratë e Sllatinës" me 12 përfitues. Po ashtu, nëpërmjet këtyre projekteve, fermerët dhe anëtarët e tjerë u trajnuan mbi rolin dhe rëndësinë e sistemit për ujitje me shihedhës. Kur bëhet fjalë për kostot e tyre të funksionimit, GLV-të mbështeten në angazhimin vullnetar të anëtarëve të bordit, dhe projektet e vogla të komunës (50% e stafit të komunës). Si një OJF, GLV në Viti vepron si marrës i fondeve nga komuna. Një dobësim i financimit zbuloi se projektet nga fondet e MBPZHR kryesisht zbatohen në shkolla, oborre, ekspozita. Në këtë drejtim, mbështetja për GLV-të në nivelin qendror dhe lokal nuk është në nivel të kënaqshëm. Sipas rezultateve të intervistës, Rrjeti për zhvillim rural është krijuar dhe është aktiv në Viti, por megjithatë ka mungesë të stafit dhe ka një kapacitet të dobët financiar. Prandaj, për të rritur motivimin e anëtarëve, nevojitet fleksibilitet më i madh për bashkëfinancim të projekte, duke lejuar kontribute nga pushteti lokal, sektori privat, shoqëria civile ose komuniteti lokal. Një problem që duket se shfaqet në GLV në Viti dhe pothuajse në të gjitha GLV-të që kemi kontaktuar është çështja e fitimit të besimit të komunitetit lokal dhe gjetja e mënyrave për të motivuar qytetarët të marrin pjesë në aktivitetet e GLV-së dhe të aplikojnë për projektet e tyre. Edhe pse GLV në Viti tregon sukses në zbatimin e projekteve në shkallë të vogël, si dhe në ofrimin e trajnimeve dhe organizimin e fushatave të mira informuese, rezultatet e hulumtimit tregojnë se kjo GLV është akoma në fazën fillestare të zhvillimit dhe se është shumë herët për një analizë gjithëpërfshirëse të ndikimit të programit LEADER në zhvillimin rural në rajon. Megjithatë, niveli i arsimit, aftësia e menaxhimit të projektit dhe afërsia me kornizën e politikave brenda të cilave zbatohen programet siç është LEADER, u ofrojnë atyre një pozicion të privilegjuar e të qenit ndërlidhës/ndërmjetës të

[68] *Raporti vjetor i HELVETAS Nder-kooperimi Zvicerian për vitin 2014*

	kuadrit institucional të politikave rurale dhe aktorëve lokal në komunat e tyre përkatëse. Megjithatë, bazuar në analizën në Viti, mund të arrihet në përfundim se proceset e zhvillimit rural dhe aktivitetet socio-ekonomike kanë evoluar përgjatë viteve (RDP, 2016).
7. Mësimet e nxjerra dhe Konkluzionet	Hulumtimi dëshmoi se rrjetëzimi, si një tipar i rëndësishëm i LEADER, është i zhvilluar mirë brenda GLV-së në tërë Komunën e Vitisë. Ky fakt rriti "zërin" e GLV-ve në rajon dhe ne besojmë se ky rast mund të shërbejë si një shembull i mirë për zbatimin e suksesshëm të zhvillimit lokal të udhëhequr nga komuniteti në këtë rajon. Në periudhën e ardhshme është e nevojshme të vazhdohet me promovimin e prodhimeve bujqësore lokale dhe pikave turistike, të cilat do të çojnë në zhvillimin e turizmit dhe investime më të mëdha në këtë zonë. Kjo mund të arrihet përmes krijimit të një agjencie marketingu në rajon, përmes krijimit të pakove turistike, përmes rregullimit të bazave turistike për strehim, organizimit të vizitave në vendet e trashëgimisë kulturore dhe përmes forcimit të bashkëpunimit me GLV-të e tjera që veprojnë në Kosovë*.
8. Kontaktet	https://kk.rks-gov.net/viti/

4. KONKLUZIONET DHE REKOMANDIMET

4.1 Konkluzionet

Bazuar në analizë, zhvillimi i qasjes LEADER dhe zbatimi i tij bazuar në ARDP është një hap i rëndësishëm për Kosovën* drejt harmonizimit me kontekstin e BE-së për bujqësinë dhe zhvillimin rural. Tiparet thelbësore të qasjes LEADER mund të përmblidhen në vëzhgimet kryesore mëposhtë:

- Megjithëse ekzistojnë strategji të zhvillimit lokal, perspektiva e zhvillimit të një strategjie për zhvillimin rural është ende larg për shkak të kapaciteteve të kufizuara të GLV-ve, mungesës së burimeve njerëzore, mungesës së trajnimit për aftësitë e përgatitjes/menaxhimit të projektit dhe mungesës së vetëdijes në lidhje me strategjitë lokale të zhvillimit dhe ekzistencën/rolin e GLV-ve. Një problem tjetër shfaqet për shkak të mungesës së burimeve financiare dhe mbështetjes nga MBPZHR. Analiza tregon një rënie në cilësinë e jetesës dhe mundësitë e punësimit dhe një rritje të pabarazive midis zonave urbane dhe rurale. Megjithatë, reforma të rëndësishme, si legjislative ashtu dhe institucionale, janë zbatuar në sektorin e ARD drejt qasjes LEADER. Sfida kryesore është zbatimi dhe investimi nga ana e Qeverisë për inkurajimin e zhvillimit ekonomik lokal.
- Palët kyçe të përfshira në qasjen LEADER nuk janë të përgatitura dhe të informuara mirë për rregullat dhe kërkesat e kësaj mase. Gjithashtu, informacionet e duhura në lidhje me mundësitë dhe parimet themelore të LEADER nuk janë të qarta për grupet tjera të palëve të interesuara, siç janë GLV-të, organizatat rurale, bizneset dhe komunat të cilët mund të përfshihen në ndërtimin e partneriteteve efektive. Këto grupe kanë nevojë për më shumë trajnim për aftësitë, kërkesat dhe procedurat e zbatimit të LEADER.
- Disa GLV në Kosovë* treguan mungesë të njohurive dhe shkathtësive për përgatitjen e dokumenteve të kërkuara për akreditim nga MBPZHR. Nga 30 GLV të regjistruara në fillim, vetëm 12 janë të akreditуar dhe janë aktivë. Kjo e pasqyron mungesën e stafit të aftë për të zbatuar masën LEADER dhe mungesën e njohurive mbi kërkesat dhe specifikat e LEADER.

4.2 Rekomandimet

Për të forcuar Qasjen LEADER dhe rolin e GLV-ve në Kosovë*, në të ardhmen, është e nevojshme të merren në konsideratë disa nga Rekomandimet kryesore:

Rekomandime për përmirësimin e rregullimit institucional

- Duhet të përmirësohet Kuadri strategjik dhe rregullator, si një nga iniciativat kryesore LEADER në Kosovë*. Aktorët kryesor institucional kanë nevojë për trajnime më të përshtatshme dhe instrumente fillestare, me qëllim që të jenë më të angazhuar dhe të përkushtuar ndaj proceseve të zhvillimit rural lokal. Për më tepër, rritja e mbështetjes financiare dhe rritja e numrit të personelit për punën e vazhdueshme administrative dhe organizative është e rëndësishme për zbatimin e kësaj mase.

Rekomandime për përmirësim të politikave

- Është me rëndësi të ketë më shumë mbështetje financiare për punën e vazhdueshme administrative dhe organizative, për të stimuluar pjesëmarrjen e komunitetit dhe për të siguruar që GLV-të janë vazhdimisht aktiv. Ministritë dhe organet tjera të qeverisjes lokale duhet t'i krijojnë kushtet e nevojshme në buxhetin vjetor për të mbështetur aktivitetet e GLV-ve dhe zbatimin e zhvillimit të strategjisë lokale. Përveç mbështetjes financiare në kuadër të fondeve të konsoliduara të qeverisë, gjithashtu është e nevojshme të ketë fonde të tjera plotësuese në kuadër të projekteve të donatorëve/granteve për zbatimin e aktiviteteve të financuara në partneritetet urbane-rurale, organizatat e fermerëve dhe të biznesit ose në infrastrukturë të përgjithshme zhvillimore. Pra, në përgjithësi, qasja në fonde të ndryshme jo vetëm që u lejon partneriteteve lokale të zgjerojnë fushëveprimin e tyre por gjithashtu u jep atyre më shumë mundësi për të krijuar vende pune në zonat rurale.

Rekomandime për fuqizimin e palëve të interesuara/aktorëve lokalë

- Ngritja e kapaciteteve për menaxhimin e projekteve dhe organizimi i proceseve të zhvillimit lokal është i nevojshëm për kordinatorët e GLV dhe anëtarët tjerë të stafit. Si të tillë, duhet të merren parasysh masat e mëposhtme: 1) Duhet të intensifikohet zhvillimi i stafit në GLV. 2) Duhet të forcohet trajnimi për planifikimin dhe menaxhimin e zhvillimit lokal. 3) Zbatimi i një auditimi të stafit për të përcaktuar zonat me kapacitete të dobëta. 4) Rekrutimi i personave të kualifikuar siç duhet, për përmirësimin e cilësisë së stafit të GLV. Duke marrë parasysh këto pika, ekziston edhe një qasje tjetër që duhet të merret parasysh nga MBPZHR dhe organet e tjera të qeverisjes lokale: rritja e bashkëpunimit ndërmjet aktorëve lokal dhe lehtësuesve të jashtëm dhe sjellja e praktikave më të mira ndërkombëtare të cilat janë më të përshtatshme për kontekstin e Kosovës*.
- Trajnimi duhet të plotësohet nga një fushatë e gjerë ndërgjegjësimi për komunitetin. Kur ka mundësi, duhet të angazhohen komunikues profesional për të ndihmuar në hartimin dhe realizimin e fushatave të ndërgjegjësimit dhe publicitetit. Për më tepër, vizitat personale dhe diskutimet me komunitetet fermere dhe të biznesit preferohen në mënyrë që të arrihet shpejt në një audiencë më të madhe.

5. SHTOJCAT

5.1 Shtojca 1: Mbështetja financiare për GLV-të

Tabela B. IV. 2: Mbështetja financiare për GLV-të 2009-2012

Viti	Nr. i aplikimeve	Nr. i projekteve të pranuara	% e projekteve të pranuara	Buxheti i planifikuar	Intensiteti i ndihmës në %	Fondet e shfrytëzuara në €	Buxheti i shfrytëzuar në %
2009	21	11	48%	42.300	50%	40.295	95.3%
2010	19	13	68%	100.000	50%	60.287	60.3%
2011	18	15	83%	100.000	70%	100.663	101%
2012	15	13	86%	150.000	70%	89.368	59%

Burimi: Raporti i MTE 2011; MAFRD 2012

5.2 Shtojca 2: Buxheti indikativ (dëshmues) për masën 303

Tabela B. IV. 3: Alokimi financiar i fondeve për Masën 303

Viti	Gjithsej shpenzime të pranueshme	Shpenzimet publike							
		GJITHSEJ		Kontributi BE		Kontributi kombëtar		Kontributi privat	
		EUR	%	EUR	%	EUR	%	EUR	%
1	2=3+9	3=5+7	4=3/2	5	6=5/3	7	8=7/3	9	10=9/2
2014	€ -	€ -		€ -	0%	€ -		€ -	
2015	€ 357,500	€ 357,500	100%	€ -	0%	€ 357,500	100%	€ -	0%
2016	€ 375,375	€ 375,375	100%	€ -	0%	€ 375,375	100%	€ -	0%
2017	€ 394,144	€ 394,144	100%	€ -	0%	€ 394,144	100%	€ -	0%
2018	€ 413,851	€ 413,851	100%	€ -	0%	€ 413,851	100%	€ -	0%
2019	€ 434,543	€ 434,543	100%	€ -	0%	€ 434,543	100%	€ -	0%
2020	€ 456,271	€ 456,271	100%	€ -	0%	€ 456,271	100%	€ -	0%
TOTAL	**€ 2,431,684**	**€ 2,431,684**	**100%**	**€ -**	**0%**	**€ 2,431,684**	**100%**	**€ -**	**0%**

Burimi: MAFRD, 2014.

KAPITULLI B.V

Vlerësimi i zbatimit të qasjes LEADER në vendet e Ballkanit Perëndimor - “nga një iniciativë lokale në një koncept qendror në zonat rurale

Raporti i shtetit: Republika e Maqedonisë

Author: Mr. Petar Gjorgievski

1. HYRJE

Republika e Maqedonisë u bë një vend kandidat i BE në vitin 2005 dhe ka mbetur në këtë fazë që nga ajo kohë. Sa i përket aftësisë për të marrë detyrimet e anëtarësimit, vendi ka një nivel relativisht të mirë të harmonizimit me acquis. Ndërsa Maqedonia po lëviz drejt anëtarësimit në BE, politika e zhvillimit rural në vend ruan vazhdimësinë e përshtatjes graduale ndaj drejtimeve strategjike për zhvillimin rural në objektivat e CAP të BE-së. Qeveria e Maqedonisë është e angazhuar në një punë intensive dhe kërkuese në përgatitjen për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Programet mbështetëse të para-anëtarësimit janë duke u zbatuar dhe kanë pasur një ndikim të madh në ekonomitë dhe shoqëritë rurale. Vendi është mesatarisht i përgatitur në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural, ndonëse është bërë përparim në zbatimin e Instrumentit për Asistencë Para-anëtarësimi për Zhvillimin Rural (IPARD). Përkundër përpjekjeve për përmirësimin e zbatimit të Programit IPARD dhe rritjes së numrit të aplikimeve, rreth 16.2 milionë euro në fondet e BE-së mbetën të papërdorura në vitin 2015. Megjithatë, përveç mbështetjes specifike për fermerët, zhvillimi i ekonomive më të gjera rurale luan një rol të rëndësishëm në përgatitjen e popullsisë rurale për mundësitë e formimit të së ardhmes së tyre. CAP i BE, përfshi zhvillimin rural dhe Qasjen LEADER luajnë një rol të rëndësishëm në këtë proces. Rëndësia ekonomike, sociale dhe demografike e zonave rurale në Maqedoni mbetet shumë e lartë për tërë procesin e zhvillimit. Zonat rurale përcaktohen në kuadër të Ligjit për Bujqësinë dhe zhvillimin rural sipas të cilit totali i zonës rurale mbulon pothuajse 88,7% të të gjithë territorit të Republikës së Maqedonisë (RM) duke përfshirë 62 komuna me 985,000 banorë ose 47,3% të popullsisë totale.[69] Sistemi administrativ i shtetit është i organizuar në nivel shtetëror dhe lokal. Qeverisja lokale është organizuar nga njësitë e vetëqeverisjes vendore në nivel komunash në bazë të Ligjit mbi organizimin territorial të vetëqeverisjeve vendore. Qasja strategjike e politikës për zhvillim rural të RM kryesisht buron nga Strategjia Kombëtare për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural (NARDS)[70] dhe është përqendruar në modernizimin e këtij sektorit dhe përmirësimin e kushteve të jetesës dhe punës në zonat rurale.

Qëllimi kryesor është që të rriten ndjeshëm fondet për bashkëfinancimin e investimeve të sektorit privat në bujqësi dhe të sektorit të përpunimit, veçanërisht të atyre që janë duke investuar në infrastrukturë rurale dhe ujitje. Zhvillimi i ndërmarrjeve në zonat rurale ka potencial të madh në produkte të shumta dhe shërbime e si rrjedhojë mund të jenë konkurruese. Krijimi i një mjedisi politik që u mundëson prodhuesve dhe përpunuesve të zgjerohen, pavarësisht konkurrencës në rritje dhe mbështetjes publike të kufizuar, është një nga sfidat kryesore për zhvillimin e biznesit në zonat rurale. Skemat e mbështetjes kombëtare për pagesat direkte ishin 55.121.951 euro në 2016, ndërsa programi kombëtar për zhvillimin rural ishte 29.356.016 euro. Përfituesit kryesorë të PZHR-së kombëtare janë: fermerët, përpunuesit, komunat dhe bizneset e ndryshme në zonat rurale. Siç u përmend më lart, Maqedonia ballafaqohet me vështirësi në miratimin e modelit aktual të zhvillimit rural të BE, për shkak të procedurave të ndërlikuara për zbatim. Problemi më i madh për qasjen në instrumentet IPARD janë kapacitetet joadekuate administrative dhe institucionale në nivel kombëtar dhe lokal dhe kapaciteti i dobët i përfituesve potencial. Që nga viti 2014, programi i ri IPARD 2014-2020[71] vazhdon të ruajë lidhje të ngushta me politikën e zhvillimit rural të BE-së duke financuar lloje të përzgjedhura veprimesh që kryesisht përputhen me objektivat kryesore strategjike sipas NARDS 2014 -2020, respektivisht për rritjen e qëndrueshmërisë së fermave dhe konkurrencën e të gjitha llojeve të bujqësisë dhe të përpunimit të ushqimit, objektivat agro-mjedisore për restaurimin, ruajtjen dhe përmirësimin e ekosistemeve të varura nga bujqësia dhe pylltaria, përmirësimin e zhvillimit socio-ekonomik në zonat rurale dhe potencialit njerëzor. Kontributi maksimal i BE i programuar për periudhën 2014-2020[72] është 60,000,000 euro.

[69] *TImpakti i strukturës socio-ekonomike të popullsisë rurale në suksesin e politikës për zhvillimin rural*
[70] *www.mzsv.gov.mk*
[71] *Gazeta zyrtare e RM nr. 177, 22.09.2016*
[72] *Programi IPARD 2014-2020*

2. MJEDISI LEADER NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

2.1 Leader në dokumentet kombëtare strategjike dhe të programeve

Korniza strategjike e politikave për zbatimin e Qasjes LEADER është paraqitur nën NARDS, me një theks në përmirësimin e kushteve të jetesës dhe të biznesit në zonat rurale. Me qëllim të rifillimit të aktiviteteve ekonomike, një fokus i veçantë i kushtohet zhvillimit të politikave për zonat malore rurale dhe zonat me kushte të pafavorshme për prodhim, si dhe për zonat plotësisht të shpopulluara. Ky objektiv strategjik është planifikuar të arrihet përmes rritjes së qasjes pjesëmarrëse për identifikimin e nevojave të komuniteteve lokale. Kjo do të kontribuonte në hartimin e masave të përshtatshme si pjesë e strategjive të zhvillimit lokal që do të zbatohen përmes themelimit të Grupeve lokale të veprimit (GLV) të përbërë nga anëtarë prej vetëqeverisjes vendore, bizneseve dhe OJF-ve. Një nga çështjet më të rëndësishme për sigurimin e qëndrueshmërisë së aktiviteteve ekonomike në zonat rurale, përveç aktiviteteve bujqësore, janë aktivitetet jo-bujqësore. Në këtë drejtim, do të mbështeten aktivitetet e popullsisë rurale që kanë për qëllim diversifikimin e aktiviteteve të tyre ekonomike.

Programi kombëtar për zhvillim rural NRDP[73] është një dokument tjetër i cili i përshkruan masat mbështetëse për zbatimin e Qasjes LEADER. Ai u referohet Neneve 87, 88 dhe 89 të Ligjit për bujqësinë dhe zhvillimin rural[74]. Këto masa synojnë të mbështesin realizimin e Strategjive për zhvillim lokal (SZHL) të cilat duhet të plotësojnë kriteret e neneve të lartpërmendura. Grupet lokale të veprimit janë përfituesit kryesorë të këtyre masave. Megjithatë, deri më tani për këto masa nuk është publikuar asnjë thirrje publike nga ana e MAFWE.

Objektivat e IPARD II në pjesën më të madhe përputhen me objektivat kryesore strategjike dhe objektivat specifike sipas NARDS 2014-2020. Programi IPARD II parashikon prezantimin e qasjes LEADER si një masë e re brenda periudhës së programit 2014-2020. Masa e re LEADER në kuadër të IPARD bazohet në nevojën për mobilizimin e aktorëve lokal të cilët përfaqësojnë nevojat dhe interesat e banorëve të zonave rurale dhe të bizneseve në zonat rurale për pjesëmarrje aktive në planifikimin e zhvillimit lokal.

Si pjesë e IPARD II, masa "fiche" e LEADER është një nga dokumentet kryesore që mund të japë informacione dhe të drejtojë procesin e konsultimeve për zhvillimin e masës LEADER. Masa "Fiche" përshkruan arsyetimin, objektivat dhe kërkesat e LEADER në kuadrin e IPARD, përzgjedhjen e grupeve lokale të veprimit, kriteret e përzgjedhjes dhe pranimit, si dhe masat që do të jenë në dispozicion për mbështetjen e LEADER.

2.2 Rregullimet institucionale dhe ligjore

Ministria e Bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave (MAFWE) është institucioni kryesor përgjegjës për zhvillimin dhe zbatimin e Qasjes LEADER. Masa LEADER u përfshi në skemat e financimit NRPD dhe IPARD të Maqedonisë për periudhat 2014-2020. Sipas programit IPARD II, prezantimi i masës "Zbatimi i strategjive të zhvillimit lokal - Qasja LEADER" ishte planifikuar për vitin 2016, por në të vërtetë zbatimi pritet të fillojë në vitin 2019. Pavarësisht progresit të dukshëm në zhvillimin e nevojshëm të kuadrit rregullator, MAFWE duhet të finalizojë procesin e akreditimit të BE në mënyrë që ta bëjë masën LEADER vepruese ose në funksionim.

[73] *Gazeta zyrtare e RM nr.7.20.01.2017*
[74] *Gazeta zyrtare e RM nr.49 12.04.2010*

Iniciativat për zhvillim lokal me bazë qasjen nga poshtë-lart të LEADER, të cilat u përqendruan në mobilizimin e komuniteteve rurale, kryesisht u zbatuan përmes Rrjetit për zhvillim rural të Republikës së Maqedonisë (NRD të RM) dhe përmes projektit të USAID për zgjerimin e bizneseve të Vogla (SBEP). Këto iniciativa synonin ndërtimin dhe forcimin e kapitalit social dhe njerëzor në zonat rurale nëpërmjet konsultimeve, arsimimit, trajnimit dhe pilotimit të projekteve për zhvillim ekonomik rural lokal.

Midis viteve 2014 dhe 2015, pjesa më e madhe e këtyre grupeve u formalizuan në 16 Grupe lokale të veprimit. Këto GLV nuk janë pjesë e programit LEADER të MAFWE pasi programi nuk ka filluar akoma, por janë të regjistruara si organizata të shoqërisë civile sipas Ligjit për shoqatat dhe fondacionet. GLV-të së bashku mbulojnë 73% të të gjithë territorit rural të Maqedonisë në 61 komuna[75]. Gjatë gjashtë viteve të fundit është siguruar një sasi e madhe e mbështetjes për zhvillimin e kapaciteteve të GLV-ve, por secila është në një fazë të ndryshme të "pjekurisë" për shkak të dallimeve në kapacitetin bazë të anëtarëve të GLV-ve në secilin rajon. Sidoqoftë, kapaciteti mesatar organizativ dhe i menaxhimit të ciklit të projektit i GLV-ve mbetet i ulët. Asnjë nga 16 GLV-të aktualisht nuk është në gjendje që në mënyrë të pavarur të zbatojë Strategjitë e zhvillimit lokal dhe të zhvillojë procedura për administrimin e zbatimit të projekteve të zhvillimit rural në nivel lokal pa trajnime dhe financime nga burimet e jashtme.

Korniza fillestare e politikave për zbatimin e programit LEADER në Maqedoni është themeluar në kuadër të Ligjit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, (nenet 87, 88 dhe 89). Ky Ligj përcakton format themelore ligjore për themelimin e grupeve lokale për veprim dhe u referohet karakteristikave kryesore kyçe të LEADER të BE-së (p.sh. qasja me bazë territorin, partneriteti publik-privat). Ligji përcakton formimin e GLV përmes: bashkëpunimit dhe asocimit të një ose më shumë komuniteteve rurale që janë fqinjë sipas kufijve kadastral.

Në vitin 2012, nga ana e MAFWE është themeluar një grup pune përgjegjës për hartimin e versionit draft të rregullores për: kushtet e detajuara për regjistrimin e grupit lokal të veprimit në regjistra, procedurën e regjistrimit, dokumentacionin e duhur dhe mënyrën e mbajtjes së shënimeve. Rregullorja e dytë ishte e ndërlidhur me përmbajtjen dhe metodologjinë për përgatitjen e strategjive për zhvillimin lokal të zonave rurale[76] dhe mënyrën e miratimit të tyre. Për më tepër, përmbajtja e rregulloreve është analizuar dhe përshtatur me rregulloret e BE-së - (BE) 1305/2013, (BE) 1303/2013, i përshtatshëm për LEADER (dhe CLLD). Rregullorja paraqet një mbulim gjithëpërfshirës të shumicës së aspekteve të strategjisë të zhvillimit lokal siç janë të radhitura në rregulloret përkatëse të BE-së. Kriteret e vlerësimit përfshijnë shumicën e aspekteve të vlerësimit të SZHL. Në përgjithësi, kjo bazë ligjore ofron një themel të mirë për zhvillimin e LEADER në Maqedoni. Në vitin 2015 u përgatitën udhëzime të reja për formimin e GLV, përgatitjen dhe zbatimin e SZHL me qëllim të mbështetjes së GLV-ve potenciale si pjesë e projektit të BE-së Prezantimi i masave të reja IPARD (LEADER dhe Shërbimet këshillimore). Veprimet e mëtejshme institucionale përfshinin futjen e masës LEADER në Programin kombëtar për zhvillim rural (PZHBN). Megjithatë, kjo si masë nuk është aktivizuar asnjëherë.

Sa i përket ndarjes së përgjegjësive dhe marrëdhënieve midis ministrive të ndryshme, Ligji për Bujqësinë dhe zhvillimin rural përcakton njësitë e vetëqeverisjes vendore (komunat) si institucione që luajnë një rol të rëndësishëm në zbatimin e politikës për zhvillim rural. Prandaj, krijimi i sinergjisë përmes themelimit të një bashkëpunimi të mirë mes tyre dhe aktorëve tjerë nga shoqëria civile dhe sektori i biznesit do të ishte një nga mekanizmat më të rëndësishëm për zbatimin e suksesshëm të programit LEADER. Baza ligjore për bashkëpunim ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë dhe komunave

[75] *AShtojca 2 Harta e GLV-ve*

[76] *Gazeta zyrtare e RM nr.40/13 14.03.2013*

përfshihet në ligjet që rregullojnë funksionet dhe autoritetet e këtyre institucioneve, kryesisht Ligji për bujqësinë dhe zhvillimin rural, Ligji për vetëqeverisjen vendore[77] dhe Ligji për zhvillim të barabartë rajonal[78]. Për më tepër, në sistemin legjislativ të Maqedonisë ka një përshtatje të plotë të objektivave të Politikës së bujqësisë dhe zhvillimit rural të MAFWE me objektivat dhe politikën për zhvillim lokal të komunave nga njëra anë dhe Strategjisë së BE-së për zhvillim rural, nga ana tjetër. Ligji për Vetëqeverisjen vendore rregullon bashkëpunimin mes komunave dhe Qeverisë dhe gjithashtu bashkëpunimin mes komunave. Ligji i mësipërm thotë se në bazë kompetencave të tyre, komunat mund të formojnë organe të përbashkëta administrative. Për realizimin e interesave të përbashkëta dhe kryerjen e detyrave të përbashkëta ata mund të bashkojnë fondet dhe të krijojnë agjenci të përbashkëta publike.

2.3 Financimi

Deri më sot, Grupet lokale të veprimit dhe strategjitë e zhvillimit lokal janë financuar në mënyrë simbolike nga ana e NRD të RM dhe USAID SBEP në Maqedoni. Në disa raste, kjo është plotësuar nga fondet prej komunave të synuara, të cilat kanë siguruar zyra dhe lehtësira mbështetëse për GLV-të. Financat janë përdorur kryesisht për të mbuluar kostot për trajnim dhe lehtësira të grupeve lokale dhe kostot që lidhen me analizën e nevojave të zonës lokale dhe hartimin e strategjive për zhvillim lokal. Përveç kësaj, në disa zona janë financuar shembuj të projekteve të vogla pilot (rreth 3,000-5,000 euro) për të demonstruar efektivitetin e iniciativave me bazë komunitetin. Edhe pse duhet bërë ende punë për forcimin e qëndrueshmërisë së GLV-ve, projektet në shkallë të vogël të mbështetura nga NRD e RM dhe SBEP e USAID të cilët u zbatuan përmes GLV-ve, demonstrojnë në mënyrë të suksesshme efektivitetin e iniciativave të tilla nga poshtë-lart me bazë komunitetin. Në disa raste, kjo është plotësuar përmes sigurimit të mbështetjes në mjete nga komunat përfshirëse të GLV-ve, të cilët kanë siguruar zyra dhe lehtësira mbështetëse për GLV-të. Financimi i total i siguruar përmes SBEP të USAID dhe NRD të RM që nga viti 2012 vlerësohet në 500,000 USD.

Kjo mbështetje ka nxitur përfshirje më të madhe të palëve të interesuara në këto rajone dhe ka rritur pritshmëritë për mundësitë e financimit në të ardhmen për projekte me prioritete më të mëdha që do të financohen përmes masave kombëtare LEADER.

Masat e politikave për aktivitetet mbështetëse në lidhje me LEADER përgatiten nga MBPZHR. Megjithatë, akoma nuk është vënë në dispozicion asnjë financim përmes MAFWE për të mbështetur LEADER për shkak të vonesës së procesit të akreditimit të BE.

3. NISMAT E MËPARSHME DHE MËSIMET E NXJERRA

Aktivitetet e ngjashme me LEADER në nivel lokal janë zbatuar nga MAASP në vitin 2009. Projekti ka përkrahur formimin e grupeve me shumë aktorë me bazë komune për zhvillim rural, të cilët inkurajuan qeveritë lokale të marrin në konsideratë zhvillimin rural në fushëveprimin e aktiviteteve të tyre në nivel komune. Në këtë proces janë përfshirë komunat në vijim: Manastiri, Resnja, Mogilla, Novaci, Gjevgjelia, Valandova, Bogdanci, Berova, Pehçeva, Dellçeva, Kumanova, Staro-Nagoriçani, Likova, Gostivari, Mavrovë - Rostusha, Vrapçishti.

[77] *Gazeta zyrtare e RM nr.5 24.01.2002*
[78] *Gazeta zyrtare e RM nr.63 15.05.2007*
[79] *Gazeta zyrtare e RM no.63 15.05.2007*

Gjatë këtij procesi, Qasja LEADER u shfrytëzua për sigurimin e shembujve lidhur me atë se çfarë mund të arrihet përmes mobilizimit të palëve të ndryshme të interesuara. Në veçanti, u angazhuan banorë të rinj, relativisht të mirë-arsimuar të komunave në zonat rurale, të cilët tashmë kishin qenë aktivë në sektorin e OJF-ve. Sinergjitë lindën përmes një kombinimi të rritjes së ndërgjegjësimit në të gjitha nivelet, transferimit të njohurive dhe aftësive, iniciativave të vogla "pilot" në nivel lokal dhe përgatitjes së nën-strategjive për zhvillim rural të miratuara nga 16 këshillat e komunave. Me këtë proces, pronësia lokale e zhvillimit rural është rritur në mënyrë indikative/eksponenciale dhe komunat kanë filluar të ndajnë fonde nga buxhetet e tyre për zbatimin e aktiviteteve në kuadër të nën-strategjive të tyre për zhvillim rural.

Më poshtë janë dhënë shembuj të projekteve të realizuara që burojnë nga strategjitë e komunave për zhvillimin rural përmes përdorimit të Qasjes LEADER.

Tabela B. V. 1: Rasti studimor 1

1. Titulli dhe autori	**"DITËT E PRODUKTEVE TË PELISTERIT"** Koncepti i projektit nga: Grupi lokal për zhvillimin rural të komunës së Manastirit
2. Përmbledhje ekzekutive	Qëllimi i përgjithshëm i projektit ishte përmirësimi i jetesës së popullsisë rurale në këtë rajon nën-malor përmes identifikimit, promovimit dhe shitjes së produkteve bujqësore dhe produkteve të punuara me dorë të zonës, zhvillimit të turizmit alternativ dhe përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe nëpërmjet hapjes së një Panairi të prodhimeve lokale dhe shërbimeve rurale. Grupi i synuar i projektit ishin fermerët, artizanët dhe prodhuesit lokal nga katër fshatrat malor: Dihovë, Nizhe pole, Trnovo dhe Magarevo. Aktiviteti kryesor i projektit ishte organizimi i një Panairi për prodhimet dhe shërbimet lokale nga 4 fshatrat nën-malore në Rajonin e Pelisterit. Panairi kishte më shumë se 30 pjesëmarrës të cilët ua prezantuan vizitorëve prodhimet dhe shërbimet e tyre dhe krijuan marrëdhënie të mira biznesi mes palëve të ndryshme të interesuara në rajon.
3. Të dhënat për komunitetin	Pelisteri është një PARK KOMBËTAR në komunën e Manastirit. Është i vendosur në pjesën jug-perëndimore të Republikës së Maqedonisë dhe përfshin një sipërfaqe prej 17,150 ha në pjesën veriore të masivit malor Baba në lartësi midis 900 dhe 2,601 m. Në mesin e shumë bimëve, rreth 90 janë "bimë të ngjashme si pemë" të ndara në 23 familje/klasa. Një nga bimët më të famshme është pisha e njohur si 'Molika' Pinus peuce Grisebach. Pelisteri ka një rrjet hidrografik të zhvilluar, kështu që kjo zonë ka me bollëk burime, përrenj dhe lumenj malorë dhe ka dy liqene akullnajore. Fshatrat në këtë zonë ofrojnë mundësi për zhvillimin e disa llojeve të turizmit tradicional dhe alternativ.
4. Sfida	Potencialet natyrore në këtë zonë nuk janë të shfrytëzuara për shkak të mungesës së kapaciteteve dhe vetëdijes për shfrytëzimin dhe integrimin e të gjithë mundësive dhe përparësive që i ofron ky rajon. Rajoni përballet me një gamë të gjerë problemesh si niveli i ulët i aktiviteteve ekonomike, plakja e popullsisë, shpopullimi dhe migrimi. Të rinjtë nuk inkurajohen të qëndrojnë në fshatra si pasojë e mungesës së mundësive për punë dhe burimeve të kufizuara të të ardhurave. Ekziston një nevojë urgjente për përmirësimin e jetesës së popullsisë rurale që këto fshatra të mbahen gjallë dhe që të ndalet migrimi. Zona e Pelisterit ofron eko-turizëm me peizazhe mbresëlënëse, ajër të pa ndotur, ku turistët mund të shijojnë ushqimet dhe prodhimet tradicionale; Këto fshatra janë të njohura për prodhimet e tyre lokale tradicionale të fermave dhe për mjedisin e pastër.

5. Aktivitetet	Panairi u organizua në fshatin malor Trnovo në 28 gusht. 30 stenda u instaluan në oborrin e kishës së fshatit. 28 pjesëmarrës ua ekspozuan vizitorëve prodhimet dhe shërbimet e tyre. Panairi pati shumë vizitorë (700-800 vizitorë) të cilët treguan interes të madh për prodhimet dhe shërbimet e ekspozuara. Në panair ishin prezente dhe mediat e gjithashtu u mbështet shumë nga zyrtarët e komunës. Ekipet nga 5 stacione televizive e xhiruan ngjarjen dhe intervistuan vizitorët dhe ekspozuesit; Kryetari i komunës së Manastirit bëri hapjen zyrtare të panairit në prani të 7 anëtarëve të Këshillit të komunës dhe 2 deputetëve të Kuvendit.
6. Rezultatet	Gjatë Panairit u shitën prodhime lokale, u krijua një komunikim i mirë midis aktorëve të ndryshëm dhe u zhvilluan diskutime paraprake për bashkëpunimin e ardhshëm. Pronarët e 3 restoranteve në rajonin nën-malor vendosën bashkëpunim me 7 fermerë vendas për ofrimin e prodhimeve të tyre lokale për vizitorët e restoranteve. Përfaqësuesit e 2 agjencive të udhëtimit ishin shumë të interesuar për mundësitë për turizëm rural dhe u pajtuan për një bashkëpunimin të ardhshëm me 2 fermerë të cilët i ofrojnë shtëpitë e tyre të fshatit për akomodimin e turistëve.
7. Mësimet e nxjerra dhe Konkluzionet	Harta e mirë e të gjitha burimeve potenciale (njerëzore, financiare dhe materiale) është thelbësore. Të gjithë anëtarët e LGRD duhet të jenë kompetentë në aftësitë komunikuese dhe prezantuese dhe duhet të punojnë si një ekip transparent. Planifikimi dhe kordinimi i projektit është bazë për zbatimin të suksesshëm; sistemi i mbikëqyrjes dhe vlerësimit duhet të ekzistojë para fillimit të zbatimit të projektit.
8. Kontaktet	Sasho Angelovski sasho.angelovski@weeffect.org

Siç u tha më lart, shtytja fillestare për LEADER në Maqedoni filloi në vitin 2009 si pjesë e MAASP. Procesi vazhdoi me aktivitetet e zbatuara nga NRD dhe u mbështet në mënyrë plotësuese në vitin 2012 përmes punës së SBEP të USAID. Proçesi vazhdoi me zbatimin e workshopeve informuese dhe edukative me popullsinë rurale në më shumë se gjysmën e të gjithë territorit rural të Maqedonisë në lidhje me qasjen LEADER, që u realizua gjatë vitit 2012 dhe 2013. Pasi u krijua një interesim i mjaftueshëm për LEADER, në çdo rajon u identifikuan aktorët kryesor nga sektori publik, privat dhe civil dhe u trajnuan mbi parimet dhe mekanizmat e qasjes LEADER, në përgatitje për formimin e GLV-ve. Këto grupe aktorësh të rëndësishëm lokal, të cilët më vonë do të formalizoheshin në GLV, po ashtu u udhëzuan në procesin e hartimit të SZHL.

Përmes një sërë trajnimesh, udhëzimesh dhe metodash trajnuese, aktorët lokal u përfshinë në krijimin e një GLV si mekanizëm dhe strukturë qendrore për qeverisjen e zhvillimit rural në zonat e synuara dhe në krijimin e SZHL si një dokument qendror i cili përcakton grupin e prioriteteve dhe masave për zhvillimin rural. NRD ka punuar me pjesëtarët e GLV (komunitetet rurale, sektorin e biznesit dhe OJF-të) në simulimin e metodologjisë së qasjes LEADER dhe zbatimin e projekteve të zhvillimit rural në shkallë të vogël. Përveç kësaj, USAID ka plotësuar përpjekjet e NRD në drejtimin e metodologjisë LEADER përmes zbatimit të projekteve të vogla për zhvillim rural të cilat treguan se ishin një mjet shumë efikas në nxitjen e përgjegjshmërisë së aktorëve të zonave rurale për çështjet e lidhura me zhvillimin e rritur/të përmirësuar të komunitetit lokal. Më poshtë është dhënë shembulli i një rasti studimor të mbështetur nga USAID/SBEP.

Table B. V. 2: Case study 2

1. Titulli dhe autori	**ZHVILLIMI TURISTIK I PIKËS ARKEOLOGJIK-ASTRONOMIKE TË KOKINOS** Koncepti i projektit nga: Grupi i veprimit lokal Aber 2015
2. Përmbledhje ekzekutive	Qëllimi i përgjithshëm i projektit ishte përmirësimi i infrastrukturës turistike të Kokinos dhe rritja e dukshmërisë së kësaj pike si destinacion turistik kryesor në Maqedoni. Qëllimi i tij përfundimtar ishte rritja e numrit të turistëve që vizitojnë rajonin verilindor të Maqedonisë, duke rritur kështu fluksin e të ardhurave nga turizmi në ekonominë e rajonit. Grupi i synuar i projektit ishin turistët nga Maqedonia dhe nga jashtë, dhe guidat turistike që do të trajnohen për ofrimin e vizitave me udhëzim profesional të kësaj pike. Projekti udhëhiqej nga ideja për zhvillimin e kushteve për zhvillim të avancuar të turizmit rural dhe arkeologjik në komunën e Staro Nagoriçane, me prezantimin e qasjes miqësore për turistët/vizitorët në pikën Kokinos dhe ofrimin të turneve profesionale me udhëzues të certifikuar turistik. Projekti përfshiu rregullimet infrastrukturore në pikën arkeologjike-astronomike Kokino, prezantimin e mjeteve të avancuara promovuese dhe të një modeli të ardhurash, për të arritur një progres të qëndrueshëm dhe një ofertë të përmirësuar turistike.
3. Të dhënat për komunitetin	Në vitin 2001, në Republikën e Maqedonisë, pikërisht nën majën malore të Tatikjev Kamenit - në komunën Staro Nagoriçane, u zbulua një vend arkeologjik i Epokës së Bronzit, që nxori në shesh disa fakte për zhvillimin e civilizimit njerëzor. Produktet e ekspeditës arkeologjike, si dhe analizat arkeologjike-astronomike në vitet në vijim, në të njëjtën kohë zbuluan një vend në këtë mal i cili i kishte të gjitha veçoritë e një observatori të lashtë. Sot, ky vend njihet si Observatori i lashtë i Kokinos ose thjesht si Kokino. Observatori i lashtë i Kokinos gjendet në pjesën verilindore të Maqedonisë, në afërsi të kufirit me Serbinë dhe në afërsi të fshatit Kokino. Sot, rajoni ka dendësi të ulët popullsie pasi që ka më pak se 1000 banorë në zonën e dhjetë fshatrave në afërsi. Kjo pikë ka mundësi të mëdha për një ofertë të përmirësuar për turizëm arkeologjik-astronomik që mund të jetë forcë shtytëse për zhvillimin e ekonomisë rurale lokale.
4. Sfida	I vendosur në komunën Staro Nagoricane në Maqedoninë verilindore, Kokino është në mesin e observatorëve të lashtë më të vjetër dhe më të rëndësishëm në botë. Që nga zbulimi i tij në vitin 2001, Kokino është menaxhuar si një vend arkeologjik, si dhe si një destinacion turistik nga ana e Institucionit kombëtar - Muzeu i Kumanovës. Vlerësohet që këtë vend çdo vit e vizitojnë rreth 10.000 deri 30.000 turistë nga Maqedonia dhe jashtë vendit, gjë që flet për potencialin e Kokinos për t'u rritur në atraksion/tërheqje të madhe turistike, nëse menaxhohet siç duhet. Sidoqoftë, mundësitë e mëdha të kësaj pike nuk janë shfrytëzuar mjaftueshëm për qëllime të zhvillimit rural. Vendi nuk disponon infrastrukturën e nevojshme për të siguruar akses të lehtë për turistët dhe vizitorët dhe nuk është promovuar mjaftueshëm. Me zbatimin e këtij projekti u krijuan kushte më të mira për zhvillim të qëndrueshëm të pikës arkeologjike-astronomike. Projekti ka rritur sigurinë e vizitorëve në këtë vend dhe ka përmirësuar mundësitë e hyrjes në rrugë përmes vendosjes së shenjave drejtuese, si dhe përmes përmirësimit dhe pasurimit të përmbajtjes së tabelave informative.

	Projekti gjithashtu rriti dukshmërinë dhe promovimin e pikës Kokino përmes krijimit të një ueb faqeje, aplikacionit audio-udhëzues Kokino për pajisjet mobile dhe ofroi trajnim për guidat turistike. Më në fund, u zhvillua një model të ardhurash që do të kontribuonte në zgjerimin e qëndrueshëm dhe në shfrytëzimin e plotë të potencialeve të pikës Kokino.
5. Aktivitetet	U realizuan aktivitetet në vijim: Instalimi i një gardhi rreth gurëve të thyeshëm në Kokino, me qëllim kufizimin e aksesit në këtë veçori të rëndësishme, por të brishtë të pikës; Instalimi i shenjave drejtuese/tabelave për lehtësimin dhe kontrollin e lëvizjes së vizitorëve përreth Kokinos; Riparimi i tabelave informative për Kokinon (përmirësimi i përmbajtjes dhe dizajnit të tyre, dhe zëvendësimi i tabelave të dëmtuara); Krijimi dhe vendosja në përdorim i faqes web së parë zyrtare të Kokinos – www.kokino.mk; Krijimi dhe vendosja në përdorim i aplikacionit të parë të Kokinos për udhëzim-audio, për pajisjet mobile që funksionojnë me sistemin operativ Android; Trajnimi dhe certifikimi i guidave turistike për turne udhëzuese në Kokino; Krijimi i një modeli të ardhurash për Kokinon, bazuar në prezantimin e tarifave të hyrje/biletave (hyrja në këtë pikë ishte falas para projektit pilot).
6. Rezultatet	Guidave turistike iu dhanë mjetet e nevojshme për të krijuar turne më të sakta/kujdesshme dhe më joshëse/përfshirëse të Kokinos në mënyrë që të ofrojnë një përvojë më të mirë për vizitorët që preferojnë udhëtime me guida. Reagimet fillestare nga guidat, gazetarët dhe arkeologët kanë qenë pozitive, duke deklaruar se vendi tani menaxhohet dhe kuptohet më lehtë për shkak të infrastrukturës së përmirësuar, duke mbrojtur gjatë gjithë kohës pjesët më të rrezikuara të Kokinos nga konsumimi i shkaktuar nga numri në rritje i vizitorëve. Ueb faqja gjithëpërfshirëse, audio udhëzuesi dhe tabelat informative e kanë bërë Kokinon më lehtë të arritshme për udhëtarët e pavarur, gjë që është veçanërisht e rëndësishme për shkak të rritjes së qëndrueshme globale të turistëve nga kjo kategori.
7. Mësimet e nxjerra dhe Konkluzionet	Ndikimi i plotë i këtij projekti pilot do të bëhet i qartë 2-3 vjet pas përfundimit të tij, por një pjesë e ndikimit të tij tashmë është i dukshëm. Më i rëndësishmi i të gjitha ndërhyrjeve është modeli i ri i të ardhurave që do t'i mundësojë Muzeut të Kumanovës të krijojë të paktën 20,000 dollarë në vit për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e vazhdueshëm të Kokinos (ky vlerësim është konservator dhe i bazuar në të dhëna anekdotike (jo domosdoshmërisht të vërteta apo të besueshme) për numrin e vizitorëve vjetor). Të ardhurat aq shumë të nevojshme do t'i mundësojnë Muzeut që në mënyrë të pavarur të financojë projektet e infrastrukturës turistike në këtë pikë, e cila ka qenë në harresë për vite të tëra për shkak të mungesës së financimit; (psh. siç është një gardh mbrojtës rreth vendit, një dyqan dhuratash dhe një galeri e vogël e artikujve/produkteve arkeologjike). Ai po ashtu do t'i mundësojë Muzeut të përcjellë saktësisht numrin e vizitorëve që vijnë në Kokino, diçka që aktualisht nuk është e mundur.
8. Kontaktet	Elizabeta Cvetkovska elizabeta3@yahoo.com

4. KONKLUZIONET DHE REKOMANDIMET

4.1 Konkluzionet

- MBPZHR duhet të marrë parasysh dhe të njohë natyrën e aktiviteteve të zbatuara nga donatorët dhe NRD të RM deri më tani si një e mirë publike, dhe duhet të mbështetet në veprimet aktuale dhe të ardhshme për zbatimin e plotë të qasjes LEADER, duke siguruar vazhdimësi efikase të mbështetjes për zbatimin e suksesshëm të SZHL.
- Ka nevojë për forcimin e kapaciteteve të të gjithë Grupeve ekzistuese Lokale të Veprimit dhe atyre potenciale përmes një procesi të këshillimit, trajnimit, udhëzimit dhe zbatimit të projekteve të vogla që burojnë nga Strategjia për Zhvillim Lokal.
- Ekziston një domosdoshmëri e vërtetë për krijimin e një mase kritike të kapitalit njerëzor lokal, të aftë për zbatimin e një programi të suksesshëm LEADER në Maqedoni. Kjo është vendimtare me qëllim që t'u mundësohet Partneriteteve të GLV dhe strategjive për zhvillim lokal të dalin në pah dhe të zhvillohen nga poshtë-lart, me barazi të vërtetë në mes të sektorit publik, privat dhe civil. Kjo do të avancojë përfshirjen e GLV dhe përfshirjen e qytetarëve në të gjitha aspektet e qeverisjes lokale, si dhe do të promovojë bashkëpunimin dhe partneritetet ndërmjet sektorëve të ndryshëm dhe palëve të interesuara në zonat rurale, bazuar në parimet LEADER.
- Për shkak të kapacitetit bazë mesatar të ulët të GLV-ve, nevojiten të paktën dy vite të tjera të stërvitjes dhe financimit të projekteve të vogla para se ata të mund të zhvillojnë kapacitetet e nevojshme organizative dhe për menaxhim të ciklit të projektit të nevojshëm për operacione plotësisht të pavarura.
- Pritet që financimi kombëtar dhe ai i BE-së për LEADER të mos vihet në dispozicion para fundit të vitit 2018 ose fillimit të vitit 2019, duke krijuar një boshllëk dyvjeçar financiar të cilin GLV-të nuk mund ta kapërcejnë në mënyrë të pavarur me kapacitetin e tyre aktual;
- Ngadalësimi ose ndërprerja e aktiviteteve të filluara që nga viti 2007 do t'i jepte fund vrullit të tanishëm dhe do t'i dekurajonte të gjithë aktorët që të përfshihen përsëri në LEADER, duke e bërë shumë të vështirë mobilizimin e një mbështetjeje të mjaftueshme lokale për rigjallërimin e procesit të miratimit të LEADER;
- Nëse GLV-të lihen ta tejkalojnë më vete dhe me financim të pamjaftueshëm zbrazëtirën financiare dy apo më tepër vjeçare, ata me gjasë do të shpërbëhen. Kjo do të përbënte një humbje të konsiderueshme të burimeve të investuara në procesin e miratimit të LEADER deri në këtë pikë.
- Partneritetet e sapoformuara të GLV-ve janë vetëm në fazën fillestare të një procesi të dedikuar për t'iu përgjigjur tërësisht nevojave dhe interesave të aktorëve të ndryshëm rural të bazuar në zbatimin e Strategjive për zhvillim lokal. Ritmi i ngadalshëm i këtij procesi dhe shtyrja e përsëritur e fillimit të masës LEADER si pjesë e politikës qeveritare për zhvillim rural, kërcënojnë të rrezikojnë të gjithë punën e bërë deri më tani për grumbullimin e mbështetjes së palëve të interesuara në zonat rurale. Kjo mund të dëmtojë GLV-të tashmë të krijuara, të cilat akoma janë partneritete publik-private (të formalizuara si OJF) shumë të reja dhe të ndjeshme.
- GLV-të akoma janë organizata në zanafillë me kapacitete të pazhvilluara organizative dhe kapacitete të pazhvilluara për menaxhimin e ciklit të projektit dhe si të tilla kanë vështirësi të funksionojnë të pavarura nga financimi dhe mbështetja e donatorëve.

4.2 Rekomandimet

Rekomandime për përmirësimin e rregullimit institucional

- Miratimi formal i masës LEADER nga MBPZHR duhet të përshpejtohet dhe të lejojë veprime të mëtejshme në procesin e finalizimit të paketës së akreditimit. Sapo të finalizohet ky proces, masa do të ndahet me DG AGRI për fillimin e procesit dhe dorëzimin për miratim formal. Koha e parashikuar për përfundimin e këtij procesi është 2 vjet. Kjo është kohë tepër e gjatë për të ruajtur interesimin dhe entuziazmin e aktorëve lokalë të përfshirë në përgatitjen e LEADER dhe simulimin e aktiviteteve të kryera deri më tani.
- Ekziston një zhvillim i dukshëm i Strategjive për Zhvillim Lokal në nivel rajonal në 16 para-GLV-të e mbështetura nga projektet donatore të SBEP të USAID dhe NRD të RM. Ky proces duhet të vazhdojë në bazë të rezultateve shumë inkurajuese duke krijuar një masë kritike të kapaciteteve njerëzore lokale si një bazë e mirë për zbatimin e një programi cilësor LEADER në Maqedoni.

Rekomandime për përmirësim të politikave

- Politikat për zhvillim lokal duhet të zbatohen me më shumë koordinim ndërmjet institucioneve përkatëse dhe me një proces vendimmarrës nga poshtë-lart. Përveç kësaj, nevojitet lidhje dhe kordinim më i mirë i aktorëve të ndryshëm rural, si në aspektin vertikal (organet qeveritare në nivele të ndryshme - kombëtare, rajonale dhe lokale) dhe në aspektin horizontal (sipërmarrësit, shoqatat profesionale, fermerët etj.).

Rekomandime për fuqizimin e palëve të interesuara lokale

- Para procesit të fillimit të LEADER të BE si një masë e ardhshme IPARD në Maqedoni, nevojitet forcimi i kapaciteteve organizative të aktorëve lokal nga sektori publik, civil dhe privat në mënyrë që të sigurohen mjete efektive të përfshirjes sociale lokale brenda Grupeve lokale të veprimit, dhe të jenë të përgatitur mirë për zbatimin e Qasjes LEADER brenda periudhës së Programit IPARD 2014-2020.
- Procesi i ndërtimit/ngritjes të kapaciteteve duhet të përfshijë hartimin dhe ofrimin e trajnimit për aktorët lokal në:
  1. Kuptimin e hapave kryesore dhe procedurave teknike për zbatimin e qasjes LEADER në nivel lokal;
  2. Forcimin e kapaciteteve të drejtueseve të GLV-ve për të kordinuar zbatimin e Strategjive për zhvillim lokal;
  3. Zhvillimin e procedurave transparente ndërmjet aktorëve kryesor (krijimi i sinergjisë, sistemeve për komunikim dhe vendimmarrje)
  4. Hartimin dhe zbatimin e fushatave të informimit në terren të cilat do të rrisin vetëdijen në nivel lokal dhe do të grumbullojnë mbështetje për Qasjen LEADER, duke joshur në këtë mënyrë anëtarë të rinj për GLV-të;
  5. Përgatitjen e materialeve teknike këshillimore (udhëzues dhe broshura) për GLV-të. Sigurimin e mbështetjes së vazhdueshme stërvitore për menaxhimin e GLV-së për operacionet administrative dhe programuese, si dhe mbështetjes për krijimin e mekanizmave financiare dhe administrative për veprimtarinë e GLV. Një element tjetër kyç në procesin e ndërtimit të kapaciteteve është mbështetja e palëve të interesuara në menaxhimin e ciklit të projektit përmes zbatimit të projekteve të vogla që burojnë nga SZHL. Objektivi do të ishte që GLV-ve ekzistuese t'u ofrohet ndihmë teknike për realizimin e projekteve që burojnë nga SZHL për të ndërtuar kapacitetin e tyre të menaxhimit të ciklit të

projektit dhe për të demonstruar efektivitetin e iniciativave të bazuara në komunitet, duke ndihmuar në këtë mënyrë GLV-të për të tërhequr financim dhe anëtarë të rinj. Mbështetja mund të përbëhet nga trajnimi i GLV-ve lidhur me atë se si t'i zbatojnë SZHL-të dhe si t'i administrojnë projektet për zhvillim rural në nivel lokal dhe se si të punojnë me përfituesit lokal dhe komunitetin në një mënyrë të hapur, gjithëpërfshirëse dhe transparente. Kjo mund të arrihet duke bashkuar aktorët lokal për të ndihmuar në zhvillimin e ideve të projektit në bazë të prioriteteve të tyre të SZHL-së dhe duke e lehtësuar komunikimin i cili do t'u mundësojë aktorëve në nivel lokal të diskutojnë për nevojat e komunitetit të tyre mbi një bazë strategjike të shëndoshë. Është e rëndësishme që të diskutohen publikisht "vizionet" e ndryshme për zhvillimin e ardhshëm dhe të strategjisë për zhvillim ekonomik për secilin mikro-rajon të mbuluar nga GLV-të në mënyrë që të arrihet një shkallë e lartë përfshirjeje dhe konsensusi.

5. SHTOJCAT

5.1 Shtojca 1: Literatura e përdorur, referencat dhe kontaktet

- MAFWE www.mzsv.gov.mk Biljana Kostovska, Udhëheqësi i Autoritetit Menaxhues biljana.kostovska@ipard.gov.mk
- USAID www.usaid.gov Tanja Markovska, Zyra e Rritjes Ekonomike tmarkovska@usaid.gov
- NRD e RM www.ruralnet.mk Vesela Lambevska Domazetova, vesela.ld@ruralnet.mk; Ana Damovska, ana.d@ruralnet.mk
- GLV "Bojmija" www.bojmija.lag.mk , Risto Atanasovski, risto.atanasovski@gmail.com
- GLV "Malesh Pijanec" www.malesh-pijanec.lag.mk, Jasminka Pasaliska Andonovska jasminka72@yahoo.com
- GLV "Belasica Ograzden" www.lag-belasicaograzden.mk, contact@lag.belasicaograzden.mk
- GLV "Plackovica" www.plachkovica.lag.mk, Stole Georgiev stole.georgiev@gmail.com
- GLV"Bregalnica" www.bregalnica.lag.mk , Zaklina Golceva zgolceva@yahoo.com
- GLV "Skardus" Angelina Voskoska 070/248560; Besim Imeri 075/209163 lagskardusjt@gmail.com

Bibliografia

- Strategjia Kombëtare e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural 2014 – 2020; Shkup, Nëntor 2014
- Njoftimi i masave të reja IPARD (LEADER dhe Shërbime këshillimore) që do të zbatohen në kuadër të IPARD II – Raporti fillestar, shkurt - mars 2015
- Njoftimi i masave të reja IPARD (LEADER dhe Shërbime këshillimore) që do të zbatohen në kuadër të IPARD II –Raporti përfundimtar Gusht 2016
- Krijimi i sinergjive për inicimin e aktiviteteve të BE në zhvillimin rural dhe zbatimin e Metodologjisë LEADER - MAASP Qershor 2009

Ligjet

- Ligji për vetëqeverisjen vendore, gjendet në http://mls.gov.mk/images/laws/EN/Law_LSG.pdf
- Ligji për zhvillimin e barabartë rajonal, gjendet në http://www.rdc.mk/southeastregion/files/law/Final%20version%20of%20the%20Law%20on%20BRD_adopted_eng%5B1%5D.pdf
- Ligji për shoqatat dhe fondacionet, gjendet në http://www.icnl.org/research/library/files/Macedonia/maclaw.pdf

5.2 Shtojca 2: Harta e GLV-ve

KAPITULLI B.VI

Vlerësimi i zbatimit të Qasjes LEADER në vendet e Ballkanit Perëndimor - “nga një iniciativë lokale në një koncept qendror në zonat rurale”

Raporti i shtetit: Mali i Zi

Autor: Ratko Batakovic

1. HYRJE

Mali i Zi ka qenë kandidat për anëtarësim në BE që nga 17 dhjetori i vitit 2010. Deri më sot janë hapur 26 nga 35 kapituj. Në mesin e atyre të fundit, më 13 dhjetor 2016, u hap Kapitulli 11 për Bujqësinë dhe zhvillimin rural. Raporti i Komisionit Evropian për vitin 2016 thotë: "Mali i Zi është mesatarisht i gatshëm në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural". Është arritur përparim i mirë në këtë fushë, përfshi miratimin e rregulloreve dhe përparimin drejt delegimit të zbatimit të buxhetit për IPARD II. Në vitin 2014, qeveria malazeze e miratoi Strategjinë për zhvillimin rajonal të Malit të Zi për periudhën 2014-2020, në të cilën thuhet se qëllimi kryesor për arritjen e një zhvillimi më të balancuar socio-ekonomik të të gjitha njësive të qeverisjes lokale dhe të rajonit bazohet në aftësinë konkurruese, inovacionin dhe punësimin. Në këtë strategji, përparësi i është dhënë zhvillimit të bujqësisë dhe zonave rurale, meqë bazuar në metodologjinë e OECD, i gjithë territori i Malit të Zi mund të konsiderohet si rural, duke pasur parasysh se dendësia mesatare e popullsisë në Mal të Zi është dukshëm më e ulët se 150 banorë për km². Sipas regjistrimit të vitit 2011, 228.009 banorë ose 36,8 % e popullsisë së Malit të Zi jeton në zona rurale. Sipas analizës statistikore të problemeve strukturore, prioriteteve të zhvillimit ekonomik kombëtar dhe rajonal, MARD ka krijuar një Strategji për zhvillim të bujqësisë dhe zonave rurale 2015-2020. Duke pasur parasysh se të gjitha objektivat janë në përputhje me politikat dhe kuadrin ligjor të BE-së në këtë fushë, drejtimet prioritare për aktivitet janë: Nxitja e transferimit të njohurive dhe inovacioneve në bujqësi, pylltari dhe zona rurale; Forcimi i aftësisë konkurruese të menaxhimit të qëndrueshëm; Promovimi i organizimit të zinxhirit furnizues të ushqimit dhe menaxhimit të rrezikut në bujqësi; restaurimi, ruajtja dhe forcimi i ekosistemeve të varura nga bujqësia dhe pylltaria; Promovimi i përdorimit efikas të burimeve dhe inkurajimi i tranzicionit në ekonomi me nivele të ulëta të emetimit të karbonit, rezistuese ndaj ndryshimeve klimatike në sektorët e bujqësisë, ushqimit dhe pylltarisë; Promovimi i përfshirjes sociale, ulja e varfërisë dhe zhvillimi ekonomik i zonave rurale. Skemat e mbështetjes kombëtare në Mal të Zi realizohen përmes zbatimit të Buxhetit për bujqësinë, i cili arrin në 31,54 milionë euro për vitin 2017 dhe është gati 40 për qind më i lartë se një vit më parë. Shuma totale e buxhetit për masat që mbështesin zhvillimin rural në buxhetin për bujqësinë është 18,667,000.00 euro. Përfituesit kryesor të buxhetit kombëtar janë: fermerët, komunitetet e fermerëve, përpunuesit, komunat dhe kompanitë e ndryshme në zonat rurale. Programi IPARD II përshkruan gjendjen aktuale të sektorit dhe i përcakton masat mbështetëse në fushën e zhvillimit rural. Masat e zgjedhura të cilat janë të përcaktuara në programin IPARD II u përzgjodhën në bazë të rezultateve të analizave sektoriale që janë realizuar dhe përditësuar gjatë vitit 2014. Një nga masat është zbatimi i qasjes LEADER përmes zbatimit të IPARD II nga viti 2018. Qëllimi i masave të përzgjedhura është përmirësimi i aftësisë konkurruese, rritja e vlerës së shtuar të prodhimeve, krijimi i vendeve të reja të punës, përmirësimi i kushteve të jetesës në zonat rurale dhe lidhja e bujqësisë me turizmin. Një arsye tjetër për zgjedhjen e këtyre masave është zbatimi i tyre përmes mbështetjes kombëtare, granteve siç janë projektet MIDAS dhe IPARD për periudhën e kaluar. Në këtë mënyrë fermerët mund t'i përgatisin fermat e tyre për shfrytëzim të fondeve të BE për periudhën e programit 2014-2020. Alokimi financiar u bë në bazë të përvojës së përfituar nga projekti për Zhvillimin Institucional dhe Fuqizimit Bujqësor i Malit të Zi (MIDAS) dhe projektet e ngjashme me IPARD; në veçanti në lidhje me kapacitetin absorbues, kapacitetin administrativ, si dhe planet për përafrimin me Acquis të BE-së. Nga IPARD dhe buxheti kombëtar do të sigurohen gjithsej 51 milionë euro për mbështetje publike, respektivisht 39 milionë euro nga fondet e BE-së dhe përafërsisht 12 milion euro nga buxheti kombëtar. Duke marrë parasysh pjesëmarrjen publike prej rreth 35 milionë euro, arrijmë në shumën prej 86 milionë euro investime në këtë sektor për periudhën e programit 2014-2020.

2. MJEDISI LEADER NË MALIN E ZI

2.1 Leader në strategjitë dhe programet kombëtare

Me Strategjinë për prodhimin e ushqimit dhe zhvillimin e zonave rurale, u vendosën drejtime afatgjata për zhvillimin e bujqësisë dhe zonave rurale, respektivisht u vendos politika bujqësore e Malit të Zi. Politika bujqësore zbatohet në bazë të Programit Kombëtar për prodhimin e ushqimit dhe zhvillimin e zonave rurale, miratuar nga Qeveria për një periudhë prej 5 vitesh. Kushtet, metoda dhe dinamika e zbatimit të masave të politikës bujqësore të përcaktuara nga Strategjia dhe Programi Kombëtar, do të rregullohen nga buxheti për bujqësinë deri në fillim të vitit fiskal. Kështu, skica e kornizës strategjike të politikës për zbatimin e masës LEADER është përcaktuar në Strategjinë për zhvillimin e bujqësisë dhe zonave rurale 2015-2020. Këtu gjejmë një përkufizim të saktë të LEADER përmes masës 5 në programin IPARD II. Programi për zhvillimin e bujqësisë dhe zonave rurale të Malit të Zi përmes IPARD II 2014-2020, është një dokument i cili në detaje përshkruan masat e mbështetjes për zbatimin e qasjes LEADER. Qasja LEADER kontribuon në angazhimin në nivel lokal për zhvillimin e resurseve dhe në bazë të kësaj, siguron vlerë shtesë për ekonominë rurale, cilësinë e jetës, mjedisin dhe trashëgiminë kulturore. Përveç këtyre ndikimeve në zhvillim, qasja LEADER kontribuon në përmirësimin e qeverisjes lokale dhe ka një potencial të rëndësishëm për ndërtimin e mirëbesimit dhe kapitalit social. Efikasiteti i Qasjes LEADER qëndron në përshtatjen më të mirë të projekteve me nevojat e përfituesve të tyre, gjë që sjell efekte pozitive në punësim. Si një burim i integruar i zhvillimit territorial në nivel "lokal", LEADER do të kontribuojë drejtpërdrejt në zhvillimin e baraspeshuar territorial të zonave rurale në Mal të Zi, që është një nga qëllimet e përgjithshme të politikës për zhvillim rural. Zonat rurale inkurajohen të hulumtojnë mënyra të reja për t'u bërë konkurrues ose të qëndrojnë të tillë, t'i përdorin burimet e tyre ekzistuese në mënyrën më të mirë dhe t'i tejkalojnë sfidat përkatëse. Prandaj, kjo qasje ka një rol shumë të rëndësishëm në gjetjen e përgjigjeve novatore ndaj problemeve të reja dhe të vjetra në zonat rurale. Qëllimi i kësaj mase është përdorimi i potencialeve për zhvillimin e komuniteteve lokale, krijimi i partneriteteve lokale të sektorit publik, privat dhe OJF, të cilat do të kenë kapacitetin për të vepruar si Grupe lokale të veprimit (GLV) në përgatitjen dhe zbatimin e strategjive për zhvillimin lokal dhe në këtë mënyrë të sigurojë menaxhim të mirë përmes partneriteteve lokale dhe të stimulojë rritjen e punësimit dhe zhvillimin e kapitalit social. Përparësia kryesore e Qasjes LEADER është se ajo është në gjendje të merret me probleme specifike në nivel lokal, duke u mundësuar pjesëmarrësve në nivel lokal të zhvillojnë dhe zbatojnë projekte të përshtatura për nevojat lokale. Përdoruesit e kësaj mase do të jenë GLV-të e zgjedhura ndërsa zbatimi planifikohet të fillojë në vitin 2018 dhe financimi duhet të rrjedhë sipas dinamikës së paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Tabela B. VI. 1: Alokimi financiar i fondeve për masën LEADER

Viti	Kostot e pranueshme në total	Pjesëmarrja e BE - Euro	Pjesëmarrja e BE %	Pjesëmarrja kombëtare - Euro	Pjesëmarrja kombëtare %
2018	233.333	210.000	90%	23.333	10%
2019	266.667	240.000	90%	26.667	10%
2020	266.667	240.000	90%	26.667	10%
Total	**766.667**	**690.000**	**90%**	**76.667**	**10%**

2.2 Rregullimet institucionale dhe ligjore

Brenda Ministrisë së bujqësisë dhe zhvillimit rural ekziston një Drejtori aktive për zhvillimin rural. Drejtoria i përgatit strategjitë dhe programet në fushën e zhvillimit rural, me qëllim të përmirësimit të aftësisë konkurruese dhe standardit të jetesës në zonat rurale dhe të mbrojtjes së mjedisit. Gjithashtu, zhvillon programe dhe projekte për zhvillimin rural nga fondet kombëtare

dhe ndërkombëtare në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare dhe donatorët. Qendra për arsim profesional, Agjencia për punësim e Malit të Zi, Drejtoria për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, Fondi për investim dhe zhvillim, etj., po ashtu punojnë në përmirësimin e bujqësisë dhe zhvillimit rural, por në një masë shumë më të vogël. Sipas përgjegjësive të tyre, ata kryejnë aktivitete përmes të cilave mbështesin zhvillimin rural duke miratuar mbështetje kreditore për fermerët, të papunësuarit dhe/ose ndërmarrjet e vogla dhe të mesme nga fusha e bujqësisë dhe agro-industrisë, si dhe duke organizuar trajnime të ndryshme. Shërbimet këshillimore dhe degët e komuniteteve, si Dhoma e tregtisë, Aleanca e punëdhënësve, Aleanca e biznesit e Malit të Zi dhe Rrjeti për zhvillim rural, gjithashtu sigurojnë një mbështetje të rëndësishme për zhvillimin përmes aktiviteteve të cilat ato ndërmarrin.

Ministria për bujqësi dhe zhvillim rural është institucioni kryesor përgjegjës për zhvillimin dhe zbatimin e Qasjes LEADER. Masa LEADER është përfshirë në Programin për zhvillim të bujqësisë dhe zonave rurale të Malit të Zi si pjesë e skemës së financimit IPARD për periudhën 2014-2020. Sipas programit IPARD II, prezantimi i kësaj mase, zbatimi i Strategjisë për zhvillim lokal - Qasja LEADER është planifikuar për vitin 2018 dhe ka shumë të ngjarë që ajo të realizohet në periudhën e planifikuar. Siç është theksuar në një raport të kohëve të fundit nga Komisioni Evropian, është bërë përparim i dukshëm në zhvillimin e rregullave të nevojshme, gjë që inkurajon dhe bën reale faktin që masa LEADER të bëhet funksionale. Iniciativat për zhvillim lokal në Mal të Zi, të bazuara në qasjen nga poshtë-lart, dhe të përqendruara në mobilizimin e popullsisë rurale, kryesisht u zhvilluan nga Rrjeti për zhvillim rural të Malit të Zi, përgjithësisht në veri, me disa përjashtime individuale në komunat jugore bregdetare. Është interesante të theksohet se të ashtuquajturat "fondet e krizës" ose donatorë që do të mbështetnin zhvillimin rural kanë munguar në Malin e Zi për vite me radhë. Këto lloje të mbështetjes janë orientuar kryesisht në zgjidhjen e problemeve të tjera sociale, dhe rrjedhimisht përqendrimi nuk ishte mbi zhvillimin rural, por në fushat e tjera. Gjatë dy viteve të fundit, këto iniciativa u drejtuan kah ndërtimit dhe forcimit të kapitalit social dhe njerëzor në zonat rurale nëpërmjet pjesëmarrjes në seminare, trajnime dhe projekte-pilot në nivel lokal për zhvillimin ekonomik rural. Pasojë e këtij procesi është ndoshta fakti që në Mal të Zi akoma nuk ka ndonjë Grup lokal të veprimit të themeluar. Rrjeti për zhvillim rural aktualisht po zbaton aktivitetet nga projekti rajonal ALTER, në lidhje me promovimin e LEADER dhe themelimin e GLV-ve, kështu që pritet që me fillimin e zbatimit të masës LEADER, të themelohen disa GLV në Mal të Zi. E vetmja formë e mundshme ligjore për organizimin e tyre është që të regjistrohen si organizata të shoqërisë civile në pajtim me Ligjin për organizatat dhe fondacionet joqeveritare. Po ashtu, bërthama për një GLV është duke u formësuar si një sekuencë logjike e projektit të realizuar nga SWG përmes programit të zhvillimit me bazë territorin ABD në formimin e rajonit të KRSH (Kroaci, Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Mal i Zi), ku është krijuar një grup i palëve të interesuara nga të tre sektorët e shoqërisë nga disa komuna.

Korniza kryesore e politikave për realizimin e programit LEADER në Mal të Zi është krijuar sipas Ligjit për bujqësinë dhe zhvillimin rural (nenet 12, 19 dhe 20). Ky ligj përcakton format ligjore bazë për përcaktimin e kushteve për zbatimin e programit LEADER dhe u referohet tipareve kryesore të BE-LEADER (p.sh. qasja me bazë territorin, partneriteti publik-privat).

Baza ligjore për zbatimin e programit IPARD II 2014-2020, si dhe të masës së tij LEADER është vendosur, respektivisht, është nënshkruar Marrëveshja Kuadër dhe është miratuar Ligji për ratifikimin e Marrëveshjes kuadër ndërmjet Qeverisë së Malit të Zi dhe Komisionit Evropian duke konfirmuar rregullat për administrimin e mbështetjes financiare të BE ndaj Malit të Zi nëpërmjet Instrumentit për Asistencë Para-anëtarësimi (IPA II); U nënshkrua Marrëveshja Sektoriale dhe u miratua Ligji për ratifikimin e Marrëveshjes Sektoriale midis Qeverisë së Malit të Zi dhe Komisionit Evropian, duke konfirmuar rregullat për menaxhimin dhe administrimin e mbështetjes financiare të BE për Malin e Zi, në kuadrin e instrumentit për Asistencë Para-anëtarësimi në fushën e politikave të bujqësisë dhe zhvillimit rural (IPARD). Po ashtu, Qeveria miratoi Rregulloren për zbatimin e masave 1 dhe 3. Ajo që mbetet është nënshkrimi i Marrëveshjes Financiare, me qëllim të plotësimit të detyrimit ligjor formal për shfrytëzimin e fondeve IPARD. Përveç akteve të lartpërmendura ligjore, një sërë ligjesh

që rregullojnë fushat e turizmit, ekonomisë, OJF-ve, kompanive, janë të rëndësishme për zbatimin e LEADER, sepse zbatimi i LEADER është i pamundur pa pajtim të sinkronizuar me pothuajse të gjitha rregulloret në Malin e Zi.

Formimi i GLV-ve siç është rasti në BE ose në rajon, nëpërmjet: bashkëpunimit dhe asocimit të një ose më shumë komuniteteve rurale që janë pranë njësive të tyre kadastrale akoma nuk është adresuar apo përcaktuar në legjislacionin malazez. Sipërfaqja dhe popullsia që do të ishin mbuluar nga GLV-të, po ashtu nuk janë përcaktuar. Ministria e bujqësisë dhe zhvillimit rural ende nuk ka formuar një grup pune që do të ishte përgjegjës për hartimin e rregulloreve (versioni draft) për: kushtet e detajuara për regjistrimin e grupeve lokale të veprimit, dokumentacionin e nevojshëm dhe metodën për mbajtjen e shënimeve. Po ashtu, nuk ekzistojnë rregullore të cilët do të përcaktonin metodologjinë e krijimit të një strategjie për zhvillim lokal të zonave rurale dhe mënyrat për miratimin e tyre, të cilat do të përputheshin me rregulloret e BE-së lidhur me LEADER (dhe CLLD). Rregulloret duhet të mbulojnë shumicën e aspekteve të strategjisë të zhvillimit lokal, siç thuhet në rregulloret përkatëse të BE. Kriteret e vlerësimit i mbulojnë të gjitha aspektet e vlerësimit të strategjisë të zhvillimit lokal. Në përgjithësi, masa LEADER është planifikuar në Mal të Zi, por nuk ekzistojnë akte nënligjore të mjaftueshme për krijimin e GLV-ve, dhe rjedhimisht nuk ka bazë të mirë për zhvillimin e LEADER në Malin e Zi. Prandaj, kjo ndoshta do të ishte detyrë për veprim të ri institucional përpara aktivizimit të masës LEADER. Dokumentet strategjike lokale ende nuk janë miratuar në asnjë nga komunat lokale. Përjashtim ishte komuna e Pljevljës, e cila miratoi Strategjinë e saj për zhvillim rural në vitin 2010, si rezultat i projektit të realizuar nga FAO e OKB në Mal të Zi. Kjo strategji ka skaduar në vitin 2015. Pas kësaj, ka pasur disa përpjekje në dy komuna në bregdetin e Malit të Zi, por këto procese asnjëherë nuk u përfunduan. Mungesa e strategjive ngadalësoi procesin e krijimit të GLV-ve. Baza ligjore për bashkëpunimin ndërmjet Ministrisë së bujqësisë dhe komunave bazohet në ligjet që rregullojnë funksionet dhe fuqinë e këtyre institucioneve, mbi të gjitha në Ligjin për bujqësinë dhe zhvillimin rural, Ligjin për qeverisjen vendore dhe Ligjin për zhvillimin rajonal. Përveç kësaj, sistemi legjislativ i Malit të Zi ka një harmonizim të plotë të objektivave për bujqësinë dhe politikën e zhvillimit rural të Ministrisë së bujqësisë dhe zhvillimit rural, me synimet dhe politikat e zhvillimit lokal të komunave në njërën anë dhe strategjitë e BE-së për zhvillimin rural nga ana tjetër. Ligji për qeverisjen vendore rregullon bashkëpunimin ndërmjet komunave dhe qeverisë dhe bashkëpunimin mes vetë komunave. Ky ligj konstaton që, në krijimin e strategjive në nivel lokal, komunat duhet të konsultohen me ministritë dhe t'i përafrojnë ato me strategjitë në nivel kombëtar.

2.3 Financimi

Duke pasur parasysh se deri më tani, në Mal të Zi nuk ka GLV të themeluara dhe asnjë dokument strategjik lokal për zhvillimin rural, burimet për promovimin e qasjes LEADER dhe aktivitetet në pajtim me të janë organizuar nga Rrjeti për zhvillim rural i Malit të Zi, me mbështetjen e Ministrisë për bujqësi dhe zhvillim rural, Ministrisë për zhvillim të qëndrueshëm dhe turizëm, qeveritë vendore dhe disa kompani të vogla nga zonat rurale. Fondet e përgjithshme që Rrjeti për zhvillim rural i Malit të Zi i siguroi nga partnerët, donatorët dhe projektet e ndryshme lokale, kombëtare dhe rajonale deri më tani arrijnë në rreth 250.000 euro dhe një numër i konsiderueshëm të orëve të punës vullnetare. Vetëm tani disa nga qeveritë vendore kanë caktuar mbështetjen për zhvillimin rural si një prioritet, përmes alokimit konkurrues të fondeve për OJF-të. Projekti rrjedhës rajonal ALTER, do të ofrojë promovimin e qasjes LEADER përmes aktiviteteve të ndryshme, duke përfshirë krijimin e GLV-ve dhe forcimin e qëndrueshmërisë së tyre. Projektet e vogla që u realizuan në të kaluarën kryesisht u mbështetën nga Rrjeti për zhvillim rural të Malit të Zi, dhe siç u përmend më parë, ato u mbështetën nga organizatat që janë pjesë e Rrjetit. Ata tregojnë me sukses efikasitetin e këtyre iniciativave nga poshtë-lart në komunitet.

Masat mbështetëse për aktivitetet që lidhen me LEADER u projektuan përmes IPARD II dhe aktivizimi i tyre është planifikuar për 2018.

Tabela B. VI. 2: Kontributi i BE në fondet IPARD II me masat 2014-2020, në euro

Masa	Mbështetja totale publike %	Mbështetja totale publike	Kontributi i BE	Kontributi i BE	Kontributi kombëtar	Kontributi komb ëtar %
Investimet në kapitalin fizik të njësive ekonomike bujqësore	60%	15.840.000	11.880.000	75%	3.960.000	25%
Investimet në kapitalin fizik në lidhje me përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore dhe të peshkimit	50%	23.693.334	17.770.000	75%	5.923.334	25%
Masat agro-mjedisore	100%	4.117.647	3.500.000	85%	617.647	15%
Zbatimi i strategjive të zhvillimit lokal - LEADER	100%	766.667	690.000	90%	76.667	10%
Investimet në infrastrukturën rurale	100%	2.133.333	1.600.000	75%	533.333	25%
Diversifikimi në ferma dhe në zhvillimin e biznesit	65%	2.933.333	2.200.000	75%	733.333	25%
Mbështetja teknike	100%	1.600.000	1.360.000	85%	240.000	15%
GJITHSEJ		**51.084.314**	**39.000.000**		**12.084.314**	

3. NISMAT E MËPARSHME DHE MËSIMET E NXJERRA

Kohët e fundit në Mal të Zi ka pasur nisma dhe projekte të ndryshme që mund të konsiderohen si një "simulim" i qasjes LEADER, ku rezultati kryesor ishte përdorimi i burimeve lokale me pjesëmarrjen e të tre sektorëve të shoqërisë. Sidoqoftë, ato aktivitete nuk janë rregulli, por një përjashtim dhe realizimi i tyre kërkon punësimin e njerëzve që do të fillojnë procesin dhe do ta udhëheqin deri në fund, dhe më vonë do ta menaxhojnë atë. Që në të vërtetë, është mënyra e funksionimit të GLV-së, me strukturën e saj të krijuar dhe një person që e menaxhon atë.

Aktivitetet aktuale janë reduktuar kryesisht në organizimin e një shumëllojshmërie të ngjarjeve njëditore ose shumëditore të krijuara për të promovuar produktet lokale, zakonet dhe traditat, në aspektin e mbështetjes së turizmit.

Deri më tani, ndoshta iniciativat më serioze me potencial të rritjes në GLV janë krijuar nga SWG e cila e zbaton programin e zhvillimit me bazë territorin (ABD), i cili përfshin një rajon të Serbisë, Bosnjë dhe Hercegovinës dhe Malit të Zi, respektivisht rajonin Drina-Tara dhe rajonin KRSH, midis Kroacisë, Bosnjë dhe Hercegovinës dhe Malit të Zi. Përmes aktiviteteve në këto zona, janë formuar grupet e

palëve të interesuara të cilët shumë lehtë mund të rriten në themelues të GLV-ve të ardhshme ose të jenë vetëm një shembull i mirë se si duhet vepruar.

Aktualisht në vazhdim e sipër është projekti i lartpërmendur - ALTER, i cili realizohet nga Rrjetet për zhvillimin rural të vendeve të Ballkanit Perëndimor, me aktivitete të planifikuara për promovimin e qasjes LEADER dhe mbështetjen e formimit të GLV-ve.

Një shembull i projektit të realizuar në pajtim me planin strategjik të komunës së Nikshiqit, me karakteristikat e Qasjes LEADER, është prezantuar në rastin studimor të mëposhtëm.

Tabela B. VI. 3: Rasti studimor 1

1. Titulli dhe autori	**„Panairi i fundvitit i produkteve lokale në Nikshiq"** Projekt i zbatuar nga Rrjeti për zhvillimin rural të Malit të Zi.
2. Përmbledhje ekzekutive	Objektivi i përgjithshëm i projektit ishte përmirësimi i jetesës së popullsisë rurale në rajonin e Nikshiçit përmes hartimit, promovimit dhe shitjes së produkteve bujqësore lokale dhe dhuratave/suvenireve (punimet me dorë) si dhe zhvillimi i turizmit alternativ dhe shfrytëzimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe mirëmbajtjes së Panairit të produkteve lokale dhe traditës. Grupi i synuar i projektit ishin fermerët, artizanët dhe prodhuesit lokal. Aktiviteti kryesor i projektit ishte organizimi i një panairi të produkteve lokale dhe traditave të zonës për njerëzit e më shumë se 30 fshatrave të Nikshiqit: Piva, Zhupa, Banjani, Gornje Polje, Pjesivci, Golija, Katunska nahija dhe Lukovo. Panairi u vizitua nga mbi 120 ekspozues vendas dhe 20 nga rajoni, të cilët ua prezantuan prodhimet dhe shërbimet e tyre vizitorëve dhe krijuan marrëdhënie të mira personale dhe biznesi ndërmjet aktorëve të ndryshëm. Ata po ashtu krijuan kontakte personale me zyrtarë dhe vendimmarrës në nivel lokal dhe kombëtar.
3. Të dhënat për komunitetin	Sipas territorit, Nikshiqi është komuna më e madhe në Mal të Zi dhe ka qenë komuna më e madhe në ish-Jugosllavi me rreth 2000 km2. Sipas regjistrimit të vitit 2011, ai ka 76,000 banorë. Ka një potencial jashtëzakonisht të lartë kur është fjala për bujqësinë dhe produktet ushqimore. Ka një markë dalluese të birrës lokale dhe pemë të cilësisë së lartë. Gjithashtu ka një potencial shumë të madh në aspektin e turizmit. Pozita gjeografike e vendos atë në një pozicion shumë të favorshëm për pasurinë turistike, sepse ndodhet në udhëkryqin midis detit dhe maleve afër kishës më të madhe ortodokse në këtë pjesë të Evropës, Ostrog, me një numër vizitorësh në vit prej rreth 1 milion (pelegrinë). Një burim i madh ujor i pa valorizuar që përbëhet nga dy lumenj dhe katër liqene është po ashtu shumë i rëndësishëm. Natyra e ruajtur dhe fshatrat piktoreske krijojnë një ofertë shumë të larmishme me mundësi të mëdha për zhvillimin e turizmit rural.
4. Sfida	Në dy dekadat e fundit, me një industri shumë të zhvilluar Nikshiqi bënte pjesë në qendrat industriale rajonale. Në atë kohë, Nikshiqi kishte një infrastrukturë të madhe dhe plane zhvillimi. Megjithatë, lufta e viteve 90-të i mbylli lidhjet e krijuara të tregtisë dhe komunikimit, dhe solli një rishpërndarje të stafit e shkaktuar kjo nga largimi i njerëzve nga Nikshiqi dhe ardhja e një numri të madh të personave të zhvendosur nga Bosnja dhe Kroacia dhe më vonë nga Kosova*. Ndërkohë, Bashkimi i Malit të Zi me Serbinë vuajti pasojat e sanksioneve nga bashkësia ndërkombëtare. Të gjithë këto ngjarje ecën paralelisht me tranzicionin dhe privatizimin e kompanive, që ishte pika kur një numër i madh njerëzish nga Nikshiqi filluan të humbnin vendet e tyre të punës. Kompanitë e madha siç janë „Zeljezara" dhe „Boksiti" të cilët punësonin rreth 10.000 njerëz, tani kanë më

	pak se 1000 punëtorë. Me kalimin e kohës shumë kompani për prodhime dhe shërbime vazhduan të humbnin konkurrencën dhe u larguan nga tregu. Qeveria lokale u bë e paqëndrueshme dhe tani po përpiqet të krijojë një baraspeshë sociale. Rezultati i të gjithë këtyre ngjarjeve është një numër i madh i personave të papunë me një tendencë për një normë edhe më të lartë të papunësisë.
5. Aktivitetet	Panairi u organizua në Qendrën sportive të Nikshiqit. Kohëzgjatja e panairit ishte 3 ditë me 140 stenda ekspozuese, të cilat u grumbulluan nga dy shkolla të zonës rurale dhe shoqatat lokale të bletë-rritësve. E gjithë zona ishte përshtatur për këtë ngjarje. 140 pjesëmarrës i ekspozuan produktet dhe shërbimet e tyre para vizitorëve. Panairi ishte shumë i vizituar (10-12.000 vizitorë), ndërsa vizitorët treguan interesim të madh për produktet dhe shërbimet e ekspozuara. Panairi u promovua shumë mirë dhe u mbështet nga të gjithë mediat e shkruara dhe elektronike dhe u mbështet fuqishëm nga zyrtarët e komunës së Nikshiqit dhe Ministrisë së bujqësisë dhe zhvillimit rural. Kryetari i Nikshiqit i përshëndeti ekspozuesit dhe mysafirët, ndërsa Ministri i bujqësisë dhe zhvillimit rural bëri hapjen zyrtare të Panairit në prani të një numri të madh të përfaqësuesve të sektorit të biznesit dhe qytetarëve. Pesë shoqëri kulturo-artistike nga Nikshiqi dhe rajoni morën pjesë në pjesën argëtuese të Panairit.
6. Rezultatet	Të gjithë prodhimet e ekspozuara u shitën gjatë panairit, u krijua një komunikim i mirë ndërmjet aktorëve të ndryshëm dhe u zhvilluan bisedime fillestare për bashkëpunimin e ardhshëm. U mblodhën dyzet pako ushqimore në ndihmë të familjeve në nevojë. Gjatë Panairit u mbushën kapacitetet e 3 nga 5 hotelet lokale. Pronarët e dy restoranteve kombëtare krijuan bashkëpunim me disa fermerë vendas për furnizimin e tyre me produktet lokale për vizitorët e restoranteve. Kompanitë e taksive kishin një numër rekord të lëvizjeve. Një numër i madh i shkrimeve në rrjetet sociale kishin mesazhe shumë pozitive për komunitetin lokal.
7. Mësimet e nxjerra dhe Konkluzionet	Planifikimi dhe organizimi shumë i mirë i të gjitha llojeve të burimeve (njerëzore, fizike, financiare dhe materiale) është thelbësor; të gjithë anëtarët e ekipit të organizatës duhet të jenë kompetentë dhe të kenë besueshmërinë e komunitetit lokal, të jenë shumë të shkathtë në aftësitë e tyre për komunikim dhe prezantim dhe të jenë të stërvitur të punojnë si ekip. Planifikimi i projekteve, zgjedhja dhe kordinimi i palëve të interesuara është bazë për zbatimin e suksesshëm të projektit; duhet të krijohet një sistem për mbikëqyrje dhe vlerësim para fillimit të zbatimit të projektit për mbikëqyrje të vazhdueshme të personave përgjegjës.
8. Kontaktet	Milica Radojicic dhe Aleksa Mijuskovic

4. KONKLUZIONET DHE REKOMANDIMET

4.1 Konkluzionet

Si rezultat i hulumtimeve dhe analizave të bëra të gjendjes aktuale të gatishmërisë për zbatimin e programit LEADER në Mal të Zi, u përcaktuan qartë konkluzionet e mëposhtme:

- Nivel i ulët i promovimit të Qasjes LEADER në të tre sektorët e shoqërisë.
- Masa të papërcaktuara të mbështetjes për financimin e GLV-ve në nivel lokal dhe kombëtar.

- Rregulla të papërcaktuara të metodës juridike/ligjore për formimin e GLV-ve dhe akreditimin e tyre. Aktualisht, forma e vetme juridike për regjistrimin e GLV-ve është si një OJF.
- Nevoja e panjohur për krijimin e strategjive lokale për zhvillimin rural.
- Nevoja e panjohur për krijimin e GLV-ve dhe mbështetjes LEADER nga ana e vendimmarrësve, veçanërisht në nivel lokal.
- Numri papranueshëm i ulët i njerëzve në ministritë dhe qeveritë lokale që merren me GLV-të dhe çështjet LEADER.
- Media e paarsimuar rreth proceseve të zhvillimit rural dhe programeve LEADER.
- Nivel i ulët i përfaqësimit të zhvillimit rural si një temë në garat për financimin e projekteve nga fondet publike.
- Mungesë e masave të hartuara për të mbështetur buxhetet e qeverive lokale për zbatimin e modelit LEADER në bashkëpunim me Ministrinë e bujqësisë dhe zhvillimit rural.
- Mungesë e mbështetjes së qeverive lokale në sigurimin e infrastrukturës së nevojshme dhe kushteve teknike për punën e GLV-ve.

Studimi tregon qartë se pjesa e punës për të cilën është përgjegjëse Ministria e bujqësisë, është e vendosur shumë mirë në përputhje me nevojat e komuniteteve lokale dhe në lidhje me dokumentet strategjike dhe rregulloret ligjore. Gjithashtu, është treguar qartë se nuk ka përpjekje apo nisma drejt zhvillimit të këtij procesi në nivel lokal. Në këtë drejtim, paraqiten rekomandimet në vijim.

4.2 Rekomandimet

Rekomandime për përmirësimin institucional:

- Personat përgjegjës në të gjitha nivelet e vendimmarrjes duhet të vazhdojnë të zhvillojnë dhe përmirësojnë të gjithë kuadrin për zhvillimin e ngadaltë të GLV-ve.
- Të përcaktohen masat e mbështetjes për financimin e GLV-ve në nivel lokal dhe kombëtar.
- Të përcaktohen rregullat e metodës juridike/ligjore për themelimin e GLV-ve dhe akreditimin e tyre.
- Të njihet nevoja për krijimin e strategjive për zhvillim rural në nivel lokal.
- Të njihet nevoja për krijimin e GLV-ve dhe mbështetjes LEADER nga ana e vendimmarrësve, veçanërisht në nivel lokal.
- Të rritet numri i njerëzve në ministritë dhe qeveritë lokale që merren me çështjet që kanë të bëjnë me GLV dhe LEADER.
- Personat përgjegjës në të gjitha nivelet e vendimmarrjes duhet po ashtu të forcojnë komunikimin me sektorin civil dhe atë të biznesit, me qëllim të përmirësimit të vazhdueshëm të kornizës për zbatimin e LEADER.
- Të promovohen modelet e rrjetëzimit dhe një bashkëpunim më i fuqishëm i të gjithë sektorëve përmes pjesëmarrjes në aktivitete të përbashkëta, veçanërisht në nivel lokal.
- Të mbështeten qeveritë lokale në krijimin e dokumenteve të strategjive.
- Të mbështeten të gjitha iniciativat lokale dhe të promovohen shembujt e praktikave të mira.
- Aktivitet më intensiv diplomatik në shprehjen e nevojës për mbështetje të donatorëve të huaj për projekte në fushën e zhvillimit rural.

Rekomandime për përmirësimin e politikave:

- Zbatimi i politikave për zhvillimin rural dhe rajonal duhet të organizohet përmes komunikimit më të mirë të mundshëm mes të gjithë palëve të interesuara nga të tre sektorët shoqëror.
- Forcimi i komunikimit horizontal dhe vertikal, përmes pjesëmarrjes transparente të përfaqësuesve të të gjithë sektorëve.
- Krijimi i rregulloreve në përputhje me të gjithë dokumentet e strategjive.

Rekomandime për fuqizimin e palëve të interesuara lokale:

- Që nga shpallja e fillimit të LEADER si një nga masat IPARD në Mal të Zi, është e nevojshme që të mbështeten fuqimisht të gjitha iniciativat serioze lokale dhe të fuqizohen kapacitetet tashmë të dobëta të aktorëve lokalë, në mënyrë që ndihma për zbatimin e Qasjes LEADER në kontekstin e periudhës së programit IPARD 2014 – 2020 të administrohet mirë.
- Të sigurohet akses në informacion për të gjithë palët e interesuara.
- Të nxiten aktorët/palët e interesuara e ardhshëm, lidhur me këtë proces në komunitetet në të cilat ende nuk ka promovim të organizuar të kësaj qasjeje.
- Të sigurohet transferimi i njohurive dhe të organizohen vizita studimore tek praktikat e mira të projekteve të realizuara në bazë të parimit LEADER.
- Të promovohen financat në dispozicion dhe të mbështeten proceset e aplikimit.

5. SHTOJCAT

5.1 Shtojca 1 Literatura e përdorur, referencat dhe kontaktet

1. Politika e përbashkët bujqësore e Bashkimit Evropian 2014-2020, http://www.emim.org/images/publikacije/Zajednicka_poljoprivredna_politika_Evropske_unije.pdf;
2. Strategjia për zhvillimin e bujqësisë dhe zonave rurale 2015-2020, http://www.mpr.gov.me/biblioteka/strategije;
3. Plani i veprimit për ndjekjen e Strategjisë për bujqësinë dhe zonat rurale në Malit të Zi, http://www.mpr.gov.me/biblioteka/strategije;
4. Programi për zhvillim të bujqësisë dhe zonave rurale në Mal të Zi (Programi IPARD II 2014-2020), http://www.minpolj.gov.me//rubrike/IPARD_program/;
5. Strategjia kombëtare për zhvillim rural deri në 2030, www.mrt.gov.me/odrzivi/odrzivi-nacionalna-strategija;
6. Rregullorja mbi kushtet, metodën dhe dinamikën e zbatimit të masave të politikës bujqësore, www.mpr.gov.me/ministarstvo;
7. ALTER, Studim mbi kornizën kombëtare për zhvillim të qëndrueshëm rural në Mal të Zi
8. www.mek.gov.me
9. http://www.minpolj.gov.me/rubrike/IPARD_program/
10. https://www.eu.me/mn/
11. http://www.privrednakomora.me/
12. http://www.monstat.org/cg/
13. http://www.ruralportal.me/
14. Le ta takojmë Evropën (Let's meet Europe), Savo Cavor, Ratko Batakovic, Veselin Gardasevic, Agrogrupa, Podgoricë, 2007.

KAPITULLI B.VII

Vlerësimi i zbatimit të qasjes LEADER në vendet e Ballkanit Perëndimor - “nga një iniciativë lokale në një koncept qendror në zonat rurale”

Raporti i shtetit: Republika e Serbisë

Autor: Prof. Natalija Bogdanov

1. HYRJE

Ky raport synon ofrimin e një pasqyre informuese dhe përshkruese të kuadrit institucional, strategjik dhe politikave për zbatimin e qasjes LEADER në Serbi. Për më tepër, raporti merret me aktivitetet e ndërmarra deri më tani nga aktorë të ndryshëm (Ministria e bujqësisë dhe mbrojtjes së mjedisit, Sekretariati krahinor i bujqësisë i Vojvodinës dhe donatorët) rreth mbështetjes së nismave LEADER në Serbi. Raporti përfundon me konkluzione dhe rekomandime konkrete dhe të përgjithshme që burojnë nga vlerësimi i informacioneve në këtë raport.

Më datë 1 mars 2012, Këshilli Evropian i akordoi Serbisë statusin shtet-kandidat, gjë e cila ishte një shtysë që i rriti aktivitetet për harmonizimin e politikave dhe kuadrit ligjor me CAP. Duke i ndjekur parimet e Strategjisë së BE 2020 dhe CAP për periudhën e viteve 2014-2020, Ministria e bujqësisë dhe mbrojtjes së mjedisit e Serbisë (MAEP) hartoi dhe miratoi Strategjinë për bujqësi dhe zhvillim rural për vitet 2014 - 2024[80] (SARD). Përveç kësaj, Programi IPARD II për Serbinë u miratua nga KE, u përgatitën dokumentet kombëtare të programit (në proces të miratimit), si dhe u intensifikua puna legjislative në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural. Megjithëse objektivat e politikave mbi bujqësinë janë të harmonizuara me prioritetet kryesore të sektorit të bujqësisë dhe zonave rurale, realizimi i tyre mbetet problematik, veçanërisht në fushën e mbështetjes së qasjes LEADER.

Nisma e parë që kishte për qëllim ndërgjegjësimin e komuniteteve vendore mbi çështjet lidhur me LEADER u zbatua nga MAEP në vitin 2005. Në vitet më pas, donatorët e përkrahën ngritjen e kapaciteteve për zhvillimin, zbatimin dhe administrimin e qasjes LEADER, dedikuar edhe MAEP-së edhe aktorëve vendor. Që në vitin 2010, MAEP e ndërpreu financimin e aktiviteteve të ngjashme me qasjen LEADER, ndërsa vitet e fundit, përkrahja donatore për bujqësinë u zvogëlua. Ndërkohë, shumica e partneriteteve lokale të themeluara më herët pushuan së ekzistuari, ndërsa disa kapacitete (kryesisht njerëzore) janë humbur në mënyrë të pakthyeshme. GLV-të potenciale, të cilat u identifikuan gjatë zbatimit të projektit LIS, mbetën funksionale kryesisht në Krahinën Autonome të Vojvodinës, falë mbështetjes së Qeverisë së Sekretariatit Krahinor për Bujqësi. Megjithatë, shumë pak mund të thuhet për veprimtarinë e tyre. Ekzistojnë shumë pak informacione të aksesueshme për GLV-të potenciale dhe rrjetet e tyre, përvojat e tyre, aktivitetet dhe kapacitetet për të krijuar dhe zbatuar strategji në përputhje me parimet LEADER.

Institucioneve dhe aktorëve kryesor iu mungojnë njohuri dhe përvojë për të mundësuar funksionimin e qasjes LEADER në Serbi, ndërsa financimi i kufizuar e bën të vështirë punësimin dhe ruajtjen e personelit, për të mobilizuar aktorët dhe për të zgjeruar aktivitetet në nivel lokal. Skema kombëtare për mbështetje do të mund ta ndihmonte këtë proces, ndërsa përkrahja e donatorëve mund të përdoret për trajnimin e personelit të MAEP dhe për të demonstruar zbatimin e strategjive nga GLV-të potenciale duke iu dhënë mundësi për të përgatitur, përzgjedhur, zbatuar dhe raportuar për projektet e vogla të zbatuara.

[80] *Gazeta Zyrtare e RS nr. 84/14*

2. MJEDISI LEADER NË REPUBLIKËN E SERBISË

2.1 Leader në dokumentet kombëtare strategjike dhe të programeve

Kuadri për hartimin dhe zbatimin e politikave mbi zhvillimin rural, si dhe të qasjes LEADER në Serbi, përcaktohet nga disa dokumente të ndërthurura strategjike dhe të programeve.

Dokumenti kryesor që i artikulon objektivat dhe prioritetet e zhvillimit të sektorit të bujqësisë është Strategjia e bujqësisë dhe zhvillimit rural e RS për periudhën e viteve 2014-2020 (SARD)[81]. Në këtë dokument, koncepti LEADER është i njohur si i tillë në 14 fusha prioritare të ndërhyrjes, në të cilin Fusha prioritare 12 i referohet *"Përmirësimit të strukturës sociale dhe fuqizimit të kapitalit social në zonat rurale"*. Objektivat e këtij prioriteti strategjik janë për të përmirësuar strukturat rurale dhe për të fuqizuar potencialin e brendshëm të komuniteteve rurale për aktivitete të përbashkëta. Objektivat operacionale për të arritur këto qëllime përcaktohen si: a) mobilizimi i potencialit njerëzor dhe social në nivel lokal përmes organizimit të grupeve lokale të veprimit dhe qasjes LEADER; dhe b) promovimi i organizimit bashkëpunues dhe përfshirjes bashkëpunuese në grupet lokale të veprimit. Strategjia SARD theksoi se vëmendje e posaçme do t'i kushtohet fuqizimit të grupeve lokale të veprimit, në kuptimin e përmirësimit të burimeve dhe ekspertizës së tyre për zbatimin e qasjes nga poshtë-lart sipas aksit/boshtit LEADER.

Programi Kombëtar për zhvillim rural (NRDP) dhe Programi Kombëtar i Bujqësisë (NPA), të dyja për periudhën deri në vitin 2020, janë hartuar dhe presin miratim (pritet të ndodhë në gjysmën e dytë të vitit 2017). Këta programe janë në përputhje me strategjinë SARD dhe janë të strukturuara në përputhje me programin IPARD me qëllim arritjen e komplementaritetit të masave të mbështetjes, si dhe shmangien e mbivendosjes së prioriteteve dhe financimit. Për sa i përket llojit të mbështetjes, masat janë të ngjashme, ndërsa është bërë një dallim në kriteret e kualifikimit dhe përfituesve të mundshëm. Në grupin e masave të NRDP, është parashikuar mbështetje për hartimin dhe zbatimin e strategjive lokale për zhvillimin rural (LSRD).

Programi i ri IPARD për Serbinë për periudhën 2014-2020 u miratua zyrtarisht nga Komisioni Evropian (KE) në janar të viti 2015[82]. Masa LEADER është parashikuar në Programin IPARD II dhe planifikohet të dorëzohet për akreditim në paketën e dytë të masave (së bashku me masat e agro-mjedisit)[83]. Masa nuk është përpunuar plotësisht (masa Fiche ende nuk është përgatitur), mirëpo planifikohet që dokumentacioni që ka mbetur, si dhe trajnimet të realizohen me projektin vijues të BE-së (gjysmën e dytë të vitit 2017).

Përveç nivelit kombëtar, Krahina Autonome (AP) dhe vetëqeverisjet vendore kanë të drejtë që financiarisht ta përkrahin zbatimin e politikave bujqësore në territoret e tyre, duke pritur pagesa të drejtpërdrejta. Në pajtim me Ligjin për Stimujt në Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural (LLBZHR)[84], Qeveria e Krahinës Autonome të Vojvodinës, Sekretariati i Bujqësisë, e ka mbështetur zhvillimin e GLV-ve dhe përgatitjen e SZHRL që në vitin 2013, duke u bazuar në legjislacionin vjetor që i përcakton

[81] *Gazeta Zyrtare e RS, Nr. 84/14*

[82] *Në vitin 2008, Serbia nisi përgatitjen e Programit IPARD I. Megjithëse Programi u përgatit dhe u dërgua për vlerësim ex-ante, ai kurrë nuk iu dërgua zyrtarisht Komisionit për miratim, sepse Serbia nuk e kishte statusin e shtetit-kandidat, prandaj nuk kishte të drejtë të fillonte procedurën e akreditimit.*

[83] *Paketa e parë e masave për akreditim përfshiu: Masa 1 – Investime në pasuri bujqësore për ristrukturimin dhe avancimin e tyre sipas standardeve të BE-së; Masa 3 – Investime në përpunimin dhe marketingun e bujqësisë dhe prodhimeve të peshkimit; Masa 7 – Zhvillimi dhe diversifikimi I aktiviteteve ekonomike rurale; Masa 9 – Asistenca teknike..*

[84] *Gazeta Zyrtare e RS, Nr. 10/13, 142/2014, 103/2015 dhe 101/2016*

aktivitetet kualifikuese, kushtet dhe kriteret për shfrytëzimin e lehtësimeve, si dhe kriteret për miratimin e SZHRL. Programet e tyre për mbështetje janë komplementare me politikat që zbatohen në nivel kombëtar dhe miratohen nga MAEP.

Një dokument tjetër strategjik që merret me çështjet lidhur me qasjen LEADER është Strategjia Kombëtare për krijimin e mjedisit të favorshëm për shoqërinë qytetare në Republikën e Serbisë për periudhën 2015-2019. Qëllimi i përgjithshëm i Strategjisë është të përmirësojë kuadrin ligjor dhe institucional për zhvillimin e shoqërisë qytetare dhe fuqizimin e partneritetit ndërmjet administratës publike dhe shoqërisë qytetare me qëllim hartimin dhe zbatimin e politikave publike. Dokumenti ende nuk është miratuar.

2.2 Rregullimet institucionale dhe ligjore

Mjedisi institucional dhe aktorët përkatës

Programi për zhvillim rural, përkatësisht qasja LEADER në Serbi, administrohet nga njësitë organizative të MAEP:

- Departamenti për zhvillim rural i MAEP, i cili është përgjegjës për programimin, mbikëqyrjen, komunikimin, promovimin dhe vlerësimin e zbatimit të politikave të zhvillimit rural, po ashtu funksionon edhe si autoritet administrues; dhe
- Drejtoria e Pagesave Bujqësore (DAP), e cila do të bëhet agjencia e pagesave për IPARD, përkatësisht një agjenci e vetme pagesash për të gjitha skemat financiare të bujqësisë.

Zbatimi i programeve për zhvillimin rural po ashtu përkrahet nga Këshilli Kombëtar për zhvillim rural (që funksionon si komision mbikëqyrës), Rrjeti Kombëtar për zhvillim rural (që përqendrohet në mbështetjen e aktiviteteve lokale - LEADER), si dhe Shërbimi këshillimor (që promovon skemat e zhvillimit rural dhe këshillon përfituesit).

Në territorin e Krahinës Autonome të Vojvodinës, Departamenti për zbatimin e politikave bujqësore, që e mbikëqyr integrimin evropian në fushën e zhvillimit rural dhe shërbimeve këshillimore të Sekretariatit të bujqësisë, administrimit të ujërave dhe pyjeve, është përgjegjës për planifikimin e masave mbështetëse, si dhe për bashkërendimin e punës së GLV-ve (në Vojvodinë). Për më tepër, aktorët e rëndësishëm publik në nivel rajonal janë Agjencitë e akredituara për zhvillim rajonal (RDA), (gjithsej janë 15 që i mbulojnë të gjitha rajonet) sepse ato kanë mandat për të zhvilluar bashkëpunimin ndërmjet aktorëve lokal. Këto agjenci kanë të drejtë të hartojnë dokumente strategjike për zhvillim lokal dhe të zbatojnë strategji në rajonet përkatëse.

Aktivitetet që synojnë ndërgjegjësimin e komuniteteve vendore për çështjet lidhur me qasjen LEADER filluan në vitin 2005, kur MAEP shpalli thirrjen e parë për të identifikuar OJF-të që kanë interesim dhe potenciale për të adresuar zhvillimin rural në nivel lokal. Për të forcuar pjesëmarrjen e komunitetit në procesin e hartimit dhe zbatimit të politikave të zhvillimit rural, MAEP-ja i inkurajoi aktorët e nivelit lokal që të krijojnë partneritete të ngjashme me qasjen LEADER. Si rrjedhojë e këtyre përpjekjeve, në vitin 2010, u themelua Rrjeti për zhvillim rural i Serbisë si organizatë ombrellë e 16 zyrave rajonale aktive në fushën e zhvillimit rural në atë kohë[85]. Më tutje, në kuadër të projektit të BE-së "Ngritja e kapaciteteve për themelimin dhe zbatimin e nismave LEADER në Republikën e Serbisë" (2011-

[85] *http://eukonvent.org/eng/project/256/*

2013), më tepër se 20 partneritete lokale të sapo formuara i përmbushën kushtet e përcaktuara nga projekti dhe u identifikuan si GLV të mundshme. Një grup i këtyre partneriteteve e themeluan Rrjetin Kombëtar LEADER (RRKL) si organizatë ombrellë e këtyre GLV-ve. RRKL bashkëpunon me më tepër se 20 GLV duke përfshirë aktorë nga më shumë se 60 komuna të zonave rurale që mbulojnë 15% të territorit të Republikës së Serbisë[86].

Megjithëse u bënë disa përpjekje nga MAEP dhe komuniteti i donatorëve për themelimin e partneriteteve lokale dhe fuqizimin e kapaciteteve të tyre, mungesa e kuadrit të nevojshëm ligjor çoi në vështirësi të konsiderueshme për funksionimin e tyre. GLV-të ekzistuese nuk janë zyrtarisht të njohura nga MAEP dhe ende aplikojnë në projekte të ndryshme në mënyrë të pavarur ose si pjesë e rrjeteve të cilat veprojnë në cilësinë e rrjeteve të shoqërisë qytetare. Nuk ka të dhëna kombëtare të sigurta për numrin e GLV-ve aktive (disa faqe interneti nuk përditësohen rregullisht ose e-mail adresat nuk janë aktive). Baza e të dhënave për subjektet afariste (Agjencia e Serbisë për regjistrimin e bizneseve) nuk është e sigurt. Megjithëse ky regjistër mundëson kërkimin e emrit, veprimtarisë, profilit dhe lokacionit të subjektit, është e pamundur të përcaktohet nëse një organizatë e regjistruar është partneritet lokal në kuptimin e qasjes LEADER.

Analiza e kuadrit ligjor për zbatimin e qasjes LEADER në Serbi përfshin: a) bazën juridike për masat mbështetëse, b) legjislacionin relevant lidhur me ngritjen e partneriteteve lokale, dhe c) kuadrin rregullator për formulimin e dokumenteve strategjike dhe planifikuese;

Funksionimi i politikave bujqësore të Serbisë bazohet në Ligjin për stimujt në bujqësinë dhe zhvillimin rural (LLBZHR), i cili siguron kuadrin e përgjithshëm për zbatimin e politikave. Neni 34 i LSBZHR parashikon subvencione për përgatitjen dhe zbatimin e strategjive të zhvillimit rural. Kjo pikë do të shfrytëzohet për zbatimin e masave mbështetëse të NRDP dhe IPARD lidhur me nismat e tipit LEADER. Neni 40 i përshkruan për së afërmi stimujt për programet e mbështetjes lidhur me përgatitjen dhe zbatimin e strategjive për zhvillimin rural në nivel lokal. Ai përfshin mbështetje për përgatitjen dhe për zbatimin e SZHRL. Është parashikuar që personat juridik të regjistruar në Regjistër të kenë të drejtë të shfrytëzojnë stimujt, përfshi dhe vetëqeverisjet vendore dhe shoqatat.

Pjesa dërmuese e partneriteteve lokale në Serbi janë të regjistruara në pajtueshmëri me *Ligjin për shoqatat*[87]. Ky ligj përcakton se një shoqatë mund të themelohet nga së paku tre themelues - persona fizik ose juridik, për qëllime humanitare, sociale, mbrojtje të mjedisit, por gjithashtu edhe për interesa dhe qëllime tjera të përgjithshme. Kuadri ligjor për veprimtarinë e rrjeteve të tyre përcaktohet me të njëjtin ligj, i cili përcakton se shoqata "mund të bashkohet me aleanca dhe shoqata tjera" (jo rrjete).

Ligji për vetëqeverisjen vendore[88] - rregullon kriteret për themelimin e njësive të vetëqeverisjes vendore dhe çështje tjera të rëndësishme për të drejtat dhe detyrimet e tyre. Ligji përcakton se njësitë e vetëqeverisjeve vendore mund të bashkëpunojnë dhe bashkojnë përpjekjet për të arritur qëllime të përbashkëta, programe dhe plane zhvillimi, si dhe nevoja të tjera të interesit të përbashkët. Mirëpo, Ligji nuk e specifikon mënyrën, kushtet dhe procedurat e vendosjes së bashkëpunimit mes komunave, si dhe format e bashkëpunimit mes komunave. Në pajtueshmëri me Nenin 88 dhe 89, Vetëqeverisjet vendore mund të themelojnë bashkëpunim në fushat me interes të përbashkët me komunitetet territoriale korresponduese dhe vetëqeverisjet lokale në shtete të tjera. Me qëllim të përmirësimit të zhvillimit të vetëqeverisjes vendore, mbrojtjen e saj dhe realizimin e interesave të përbashkëta, njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të themelojnë shoqatën e tyre.

[86] *http://www.nln.rs/en/)*
[87] *Gazeta Zyrtare e RS, Nr. 51/2009 dhe 99/2011*
[88] *Gazeta Zyrtare e RS, Nr. 129/2007 dhe 83/2014*

Ligji për zhvillimin rajonal[89] - përcakton metodën për caktimin e zonave që e përbëjnë një rajon, masat, lehtësimet dhe burimet e financimit për zbatimin e mbështetjes për zhvillim rajonal; po ashtu Ligji përcakton kuadrin juridik dhe institucional për planifikimin, bashkërendimin dhe realizimin e aktiviteteve të zhvillimit dhe mbështetjen e bashkëpunimit mes komunave, ndër-rajonal, ndërkufitar dhe ndërkombëtar. Mirëpo, ky dokument nuk i njeh shoqatat si bartës "zyrtar" të zhvillimit rajonal.

Gjatë vitit 2016, Qeveria përgatiti Ligjin për sistemin e planifikimit të Republikës së Serbisë, i cili e rregullon menaxhimin e sistemit të politikave publike dhe planifikimin afatmesëm, llojin dhe përmbajtjen e dokumenteve të planifikimit. Neni 10 i këtij Ligji siguron mundësi për miratimin e strategjisë nën-kombëtare, përderisa ka të bëjë me pjesën e territorit të Republikës së Serbisë dhe njësitë administrative përkatëse, të cilat nuk janë të lidhura gjeografikisht apo administrativisht. Ky ligj ende nuk është miratuar.

2.3 Financimi

Financimi i masave mbështetëse për nismat e ngjashme me LEADER nga buxheti i Serbisë filloi në vitin 2005, kur MAEP nisi një skemë subvencionesh për ngritje të kapaciteteve dedikuar shoqatave rurale dhe partneriteteve të tyre. Që në vitin 2010 kjo mbështetje është anulluar edhe për shkak të ndryshimit të politikave prioritare dhe mungesës së fondeve. Në vitin 2013 MAEP përfshiu masat LEADER në Rregullimin vjetor të stimujve për bujqësinë dhe zhvillimin rural për vitin 2014, mirëpo thirrja për propozime nuk u realizua.

Në Krahinën Autonome (KA) të Vojvodinës, procesi i ngritjes së grupeve të ngjashme me GLV-të filloi në vitin 2007, me pesë GLV të mundshme, të cilat u zgjeruan në 10 përfitues në vitet pasuese (që në vitin 2015). Objekti i mbështetjes ishte dhënie e një granti për përgatitjen e strategjive të zhvillimit rural në nivel lokale. Përfituesit e granteve ishin të ashtuquajturat Partneritete për zhvillim territorial rural - Grupe të mundshme të veprimit lokal, nga territori i KA të Vojvodinës. Këto fonde ishin për GLV-të e territorit të KA të Vojvodinës për të përkrahur hartimin e strategjive të zhvillimit rural në nivel lokal. Vlera e përgjithshme e fondeve të alokuara për një vit ishte 10.000.000,00 RSD (dinarë), duke përfshirë vlerën maksimale për një përfitues prej rreth 8.000 euro. Shoqatat e regjistruara të qytetarëve, si dhe format e tjera të organizatave jo fitimprurëse, të cilat kanë status ligjor, kishin të drejtë të shfrytëzojnë këto stimuj. Procesi i aplikimit dhe çështjet tjera të rëndësishme lidhur me konkursin janë të rregulluara me *Urdhëresën për kushtet dhe mënyrën e shfrytëzimit të stimujve për hartimin e strategjive të zhvillimit rurale në nivel lokal dedikuar Partneriteteve për zhvillim territorial rural në territorin e KA të Vojvodinës*.

Përveç buxhetit të KA të Vojvodinës, aktivitete të ngjashme me qasjen LEADER u mbështetën edhe nga disa projekte donatore:

- Projekti për Fuqizimin e kapitalit social rural dhe rrjeteve 2008-2009 (UNDP Serbia) ishte një iniciativë e re për themelimin e GLV-ve në Serbi. Projekti u zbatua në partneritet me Sekretariatin Krahinor të bujqësisë, ekonomisë së ujërave dhe pyjeve të KA të Vojvodinës, si dhe vetëqeverisjet lokale të pesë komunave të synuara. Aktivitetet e projektit përfshinë: trajnime rreth qasjes LEADER, menaxhim të ciklit të projekteve, zhvillim të projekteve, planifikim të financave, përfshi mbështetje të trajnuesve. Projekt-propozimet më të mira fituan financime fillestare (5.000 deri 12.000 euro për projekt).

[89] *Gazeta Zyrtare e RS, Nr. 51/2009, 30/2010 dhe 89/2015*

- Projekti Turizmi i qëndrueshëm për zhvillimin rural 2009-2012 u zbatua në kuadër të programit të përbashkët të Kombeve të Bashkuara, i financuar nga Mbretëria e Spanjës nëpërmjet Fondit për Arritjen e objektivave të zhvillimit të Mijëvjeçarit (MDG). Ky aktivitet u realizua në të gjitha 19 vetëqeverisjet lokale. Për të nxitur më tutje pjesëmarrësit që të zbatojnë njohuritë e tyre në mënyrë praktike, të cilat i fituan gjatë programit të trajnimit, projekti mbështeti komunitetet lokale për të hartuar dhe zbatuar projekte për zhvillimin e turizmit rural. Gjashtë projektet lokale të realizuara në territorin e 15 komunave fituan grant prej 180.000 USD.
- Iniciativa e projektit LEADER në Serbi 2011-2013 (LIS) - projekt i financuar nga BE-ja zyrtarisht i njohur me emrin Ngritje kapacitetesh për themelimin dhe zbatimin e nismave LEADER në Republikën e Serbisë, kontribuoi në forcimin e kapaciteteve njerëzore, teknike, organizative dhe financiare për mbështetjen e përgjithshme të zbatimit të qasjes LEADER në kuadër të MAFWM, mirëpo po ashtu edhe për zhvillimin e 21 GLV-ve të mundshme që u identifikuan.
- Në vitin 2009, me mbështetje të SWG dhe KE, filloi një projekt i financuar nga BE për mbështetje të zbatimit të Qasjes së zhvillimit me bazë territorin. Kjo qasje i testoi nismat e ngjashme me qasjen LEADER në zonat ndërkufitare të disa territoreve (Drina - Tara, Drina- Sava dhe Rajoni Pcinja). Rezultatet e projektit kanë dëshmuar se ekziston një interesim i madh dhe mundësi të mëdha për nisma të drejtuara nga komuniteti, veçanërisht kur shoqërohen me financa për projekte konkrete lidhur me strategjitë e hartuara për territoret e përcaktuara.

3. NISMAT E MËPARSHME DHE MËSIMET E NXJERRA

Përvoja e mëparshme me mbështetjen lidhur me qasjen LEADER sugjeron se aktivizimi dhe mobilizimi i aktorëve lokal dhe ngritja e partneriteteve duhet të fillojë pasi të jetë përgatitur i tërë sistemi për të përballur këtë masë në mënyrë të rregullt. Ndryshe, ekziston rreziku që mungesa e vazhdimësisë, konsistencës, transparencës dhe qëndrueshmërisë të zbatimit të politikave të mund të shkaktojë humbje të interesimit ose besimit të aktorëve. Probleme të tilla u vërejtën veçanërisht në vendet në tranzicion të Evropës Lindore. Përvoja hungareze Fekete (2014) tregon se përveç faktorëve të tjerë, mungesa e fondeve për të financuar aktivitetet, si dhe kapitali i paktë social lokal mund ta pengojnë veprimtarinë e parashikuar sipas parimeve LEADER.

Megjithëse këta mësime që u nxorën iu përcjellën politikë-bërësve në Serbi, disa gabime të caktuara nuk u shmangën.

Tabela B. VII. 1: Rasti studimor 1

1. Titulli dhe autori	*Mospasja e mbështetjes për politikat e parandalon vazhdimësinë dhe qëndrueshmërinë e partneriteteve lokale*
2. Përmbledhje ekzekutive	Megjithëse aktivitetet e para të MAEP rreth promovimit dhe ngritjes së partneriteteve lokale dhe rrjeteve të tyre në Serbi filluan më tepër se 10 vjet më parë, aktualisht ende nuk ekziston një skemë financimi për masat e ngjashme me qasjen LEADER në buxhetin kombëtar të bujqësisë. Mirëpo, mjedisi në të cilin veprojnë sot GLV-të nuk është i barabartë në të gjithë territorin e Serbisë - GLV-të e territorit të Krahinës Autonome të Vojvodinës e gëzojnë mbështetjen e buxhetit të Sekretariatit të Bujqësisë, ndërsa ata në Serbinë Qendrore janë të detyruar të mbështeten vetëm në aftësitë e tyre për të garuar për grante.
3. Të dhënat për komunitetin	Organizatat e shoqërisë civile (OSHC) në zonat rurale (kooperativat, shoqatat e prodhuesve, shoqatat e grave rurale, shoqatat e grupeve etnike, etj.) kanë një traditë të gjatë në Serbi. Për më tepër, bashkëpunimi ndërmjet shtetit dhe OSHC-ve, në veçanti OJF-ve, është intensifikuar që në periudhën e hershme të vitit 2000, kur për herë të parë u ftuan të marrin pjesë në hartimin e disa strategjive kombëtare. Pjesëmarrja e OSHC-ve nga zonat rurale në procesin e vendimmarrjes lokale dhe ngritjen e partneriteteve lokale me publikun dhe sektorin e biznesit u ndikua nga aktivitetet e donatorëve për mbështetjen e strategjive të zhvillimit lokal (kryesisht të strategjive për zhvillim të qëndrueshëm lokal, ndërsa më vonë ata u përqendruan në çështje sociale dhe mjedisore). Megjithatë, në këto procese, OSHC-të ishin aktive vetëm në një shtrirje të ngushtë të punës, shpeshherë vetëm duke i ndjekur udhëzimet dhe kufizimet e përcaktuara nga donatorët ose vetëqeverisjet lokale .
4. Sfida	Në Serbi, procesi i vendimmarrjes me pjesëmarrje në nivel lokal filloi në mesin e viteve 2000, kur përgjegjësitë dhe detyrimet e planifikimit të politikave u zgjeruan në mënyrë të konsiderueshme. Duke pasur parasysh rëndësinë e madhe të bujqësisë në ekonominë në nivel lokal, por po ashtu edhe problemet e ndërlikuara të zonave rurale, ekzistonte nevoja e përfshirjes së fermerëve, shoqatave të tyre dhe përfaqësuesve tjerë të grupeve të ndryshme shoqërore të zonave rurale në këto procese. Kapacitetet e pamjaftueshme të shoqërisë qytetare për të pranuar një rol në këto procese, si dhe ndërgjegjësimi i pamjaftueshëm i komunitetit të fermerëve dhe sektorit të biznesit rreth përparësive të të qenit të angazhuar në vendimmarrje ishin pengesat kryesore për zbatimin efektiv të qasjes nga poshtë-lartë. Ndërgjegjësimi në rritje që konceptet moderne të zhvillimit lokal dhe rural kërkojnë transformimin e strukturave të vjetra drejtuese dhe organizative rezultuan në faktin që MAEP filloi me masat mbështetëse për forcimin e rrjeteve sociale rurale.
5. Aktivitetet	Aktivitetet dhe detyrat fillestare u ndërlidhën me trajnimin e OSHC-ve për të përdorur zhvillimin e komunitetit me pjesëmarrje dhe teknikat PLA/PRA. Në vitet vijuese, deri në vitin 2010, MAEP mbështeti aktivitete të partneriteteve lokale në lidhje me fushatat informuese, trajnimet, promovimin e praktikave të mira dhe bashkëpunimin me partnerët në nivel lokal. Falë mbështetjes aktive dhe bashkëpunimit ndërmjet OSHC-ve dhe MAEP-së, gjatë kësaj periudhe, u formuan 16 qendra rurale rajonale me gjithsej 149 zyra rajonale që e mbulonin të gjithë territorin e Serbisë. Ndryshimet e shpeshta të strukturave të menaxhimit dhe ndryshimet radikale të sistemit të mbështetjes së bujqësisë dhe zonave rurale rezultuan në anullimin e kësaj mbështetje në vitin 2010.

	Në KA të Vojvodinës, ekziston mbështetje e vazhdueshme e OSHC-ve e cila sigurohet nga buxheti kombëtar, si dhe synon nxitjen e bashkëpunimit të tyre me autoritetet lokale dhe organizatat tjera (pothuajse çdo sekretariat i KA-së mbulon bashkëpunimin me OSHC-të). Mbështetja e parë për zbatimin e qasjes LEADER u sigurua nga projekti Forcimi i kapitalit social rural dhe rrjeteve (2008-2009) që u zbatua në pesë pilot-komuna në territorin e Vojvodinës - Zitiste, Coka, Mali Idjos, Alibunar dhe Irig. Pasi mbështetja për nismat LEADER u ndërpre së financuari nga buxheti kombëtar, Qeveria Krahinore vazhdoi me financimin e këtyre aktiviteteve me burimet e veta. Prandaj, partneritetet në Vojvodinë të cilat i përmbushën kriteret e vlerësimit të propozuara nga projekti ILS dhe u vlerësuan se posedojnë kapacitete të shndërrohen në GLV, patën mundësi të mbështeten financiarisht me qëllim përballimin e hendekut financiar. Sekretariati Krahinor për bujqësinë, administrimin e ujërave dhe pyjeve mbështet zhvillimin e GLV-ve dhe përgatitjen e strategjive për zhvillim rural në nivel lokal (SZHRL), bazuar në dispozitat vjetore të cilat i përcaktojnë aktivitetet, kushtet dhe kriteret e pranueshme për shfrytëzimin e stimujve, si dhe kriteret për miratimin e SZHRL.
6. Rezultatet	Gjatë viteve të fundit, donatorët ndërkombëtarë i zvogëluan aktivitetet e tyre në sektorin e bujqësisë, si dhe ato në lidhje me çështjet rurale, duke e lënë kështu pjesën dërmuese të OSHC-ve rurale të luftojnë për mbijetesë. Ekziston një diversifikim i dobët e burimeve financiare, ndërsa skemat financiare për qasjen LEADER nga buxheti kombëtar për bujqësinë ende nuk janë përcaktuar. Pjesa dërmuese e partneriteteve dhe rrjeteve lokale të formuara nëpërmjet projekteve të donatorëve në Serbinë Qendrore bëjnë përpjekje për mirëmbajtjen e aktiviteteve të tyre. Veprimtaria dhe angazhimi i tyre në zhvillimin rural dhe mbikëqyrjen e performancës së njësive të vetëqeverisjeve lokale është pak e dukshme, ndërsa disa burime janë humbur në mënyrë të pakthyeshme. Partneritetet lokale në KA të Vojvodinës janë më aktive dhe realizojnë një sërë aktivitetesh, por po ashtu shpeshherë e ndërrojnë fokusin varësisht nga tendencat aktuale dhe opsionet e mundshme të financimit.
7. Mësimet e nxjerra dhe Konkluzionet	Progresi fillestar i bërë për forcimin e bashkëpunimit me aktorët dhe themelimi i partneriteteve, ndërgjegjësimi për dobitë e qasjes LEADER, mobilizimi dhe rritja e kapitalit njerëzor ka ngecur në Serbi. Hendeku që u shfaq për shkak të mungesës së financimit shkaktoi që shumica e GLV-ve të reduktojnë aktivitetet e tyre. Disa prej tyre as që ekzistojnë më. Kthimi i tyre në qasjen LEADER do të jetë një proces i vështirë. Disa prej tyre ishin të mbështetur në mënyrë të konsiderueshme nga vetëqeverisjet lokale dhe patën mbështetje politike, e cila tashmë nuk ekziston më. Disa prej tyre e humbën interesimin pasi asnjë efekt i dobishëm ose praktik nuk u pa nga kjo qasje. Në disa komuna, kryesisht në KA të Vojvodinës ku u planifikuan subvencione në nivel lokal për aktivitetet e tipit LEADER, ekziston një interesim relativisht i lartë për këtë lloj qasjeje. Fatkeqësisht, vetëqeverisjet lokale dhe strukturat politike nuk e kuptojnë konceptin dhe rolin e këtij lloji të organizimit të grupeve të komunitetit. Vendosja e rregullave themelore për procesin LEADER do të duhet të drejtohet me aktivitete të planifikuara dhe me mesazhe të transmetuara me kujdes.

4. KONKLUZIONET DHE REKOMANDIMET

4.1 Konkluzionet

Kuadri strategjik dhe rregullator për zbatimin e qasjes LEADER në Serbi nuk është përfunduar, gjë që ka krijuar një vakum institucional për zbatimin e politikave.

- Qasja LEADER njihet në dokumentet e strategjive kombëtare (SARD dhe programi IPARD II) dhe ligjet relevante (Ligji për bujqësinë dhe zhvillimin rural dhe Ligji për stimujt në bujqësi dhe zhvillim rural). Megjithatë puna e legjislacionit dytësor që e drejton zbatimin e mbështetjes për masat LEADER është ende në proces e sipër dhe pritet të përfundojë deri në fund të viti 2017.
- Masat fiche, dokumentet dhe të gjitha modelet e nevojshme për akreditimin e masës LEADER në Programin IPARD II ende nuk janë përgatitur. Këta dokumente dhe modele do të duhet të përgatiten para se të dërgohet kërkesa për akreditim, përfshi dhe Rregulloren për zbatimin e masës LEADER.

Institucionet dhe aktorët kryesorë nuk i posedojnë njohuritë, përvojën dhe të kuptuarit për të bërë që qasja LEADER të jetë funksionale në Serbi.

- Ekziston mungesë personeli për zbatimin e masës LEADER, si dhe mungesë njohurish rreth kërkesave dhe specifikave të qasjes LEADER. Në strukturat operacionale të MAEP nuk ekziston një masë e konsiderueshme e kapitalit njerëzor të trajnuar me kompetenca themelore për zbatimin e nismave të tipit LEADER. Numri aktual i personelit të punësuar në MA dhe PA nuk i përmbushin kërkesat e nevojshme për të kaluar akreditimin e Programit IPARD II.
- Për shkak të mungesës së përvojës, ekziston potencial i kufizuar në mesin e PGLV-ve (Vojvodinë) dhe partneriteteve të tyre për të gjeneruar dhe programuar projekt-ide të përshtatshme. Kjo mund të ndodhë vetëm gjatë periudhës së ardhshme në qoftë se ekziston financim fillestar nga buxheti kombëtar për t'u mundësuar këtyre grupeve vënien në praktikë të asaj që kanë mësuar në trajnime.
- Aktorët nuk janë të përgatitur dhe të informuar mirë rreth rregullave dhe kërkesave të kësaj mase. Për më tepër, informacionet për mundësitë dhe parimet thelbësore të filozofisë LEADER nuk janë të qarta për grupet e mundshme të aktorëve që do të mund të përfshiheshin në krijimin e partneriteteve. Ata kanë nevojë për më tepër trajnime rreth shkathtësive/aftësive dhe rregullave lidhur me procedurat dhe kërkesat e LEADER.
- Aktorëve u mungojnë shkathtësi/aftësi dhe njohuri për të gjallëruar/nxitur dhe përgatitur të gjitha dokumentet e nevojshme për njohjen e GLV-ve nga MAEP-ja. Ekziston keqkuptim në njësive të vetëqeverisjet lokale për rolin e tyre në procesin LEADER dhe llojin e partneriteteve, si dhe logjikën e ndërhyrjeve.

Financimi i kufizuar e bën të vështirë punësimin dhe ruajtjen e personelit për të mobilizuar aktorët dhe zgjeruar aktivitetet në nivel lokal.

- Zhvillimi i ngritjes së partneriteteve lokale dhe përgatitja e partneriteteve/grupeve të mundshme për procesin e përzgjedhjes si GLV të mundshme u krye në kuadër të projektit ILS pesë vite më parë. Hendeku i madh kohor që u krijua ndërmjet projektit ILS e deri më sot ka shkaktuar që GLV-të e formuara me këtë projekt të përballen me humbje të kapaciteteve, kryesisht për shkak të mungesës së financimit dhe pasigurisë së mbështetjes qeveritare në të ardhmen.
- Nuk është miratuar skema kombëtare e mbështetjes, ndërsa zbatimi i saj pritet të ndodh këtë

vit. MAEP-ja duhet të kërkojë mekanizma të mbështetjes për të rritur dhe përkrahur fushatën promotive dhe sqaruese. Ky proces mund të bëhet me mbështetjen e numrit të vogël të ekspertëve kombëtar të trajnuar, aktorëve nga procesi i mëparshëm dhe GLV-ve të ngritura nga projekti ILS, me materiale të dizajnuara mirë dhe mesazhe që duhet t'u transmetohen aktorëve.

- Masa për asistencë teknike e Programit IPARD II parashikon mbështetje për aktorët dhe GLV-të e mundshme në përgatitjen e partneriteteve, së bashku me strategjitë për dorëzim të thirrjeve sipas Programit. Megjithatë, gjendja aktuale nuk ofron një pasqyrë të qartë se kur mund të ndodhë kjo. Gjithashtu, aktualisht nuk ekzistojnë projekte dypalëshe ose të financuara nga BE, të cilat do të ishin të formuluara për të ofruar këtë lloj të trajnimit të kordinuar, si dhe ngritjen e kapaciteteve për të gjithë pjesëmarrësit gjatë zbatimit të masës LEADER.

4.2 Rekomandimet

Rekomandime për përmirësimin e rregullimit institucional

Kuadri rregullator dhe strategjik i pa kompletuar, si një ndër pengesat kryesore për nisjen e mbështetjes së tipit LEADER në Serbi duhet të përmirësohet. Kjo do të bëhej nëpërmjet:

- miratimit të NRDP, i cili do të nis ngritjen e partneriteteve dhe hartimin e dokumenteve strategjike në bazë të parimeve, me kërkesa më të lehta, por të ngjashme me ato të programit IPARD II;
- rritjes së numrit të personelit të Agjencisë së Pagesave në pajtueshmëri me analizën e ngarkesës së punës. (Akreditimi i masës LEADER pranë programit IPARD II kërkon që për çdo pozitë pune në këtë proces të ekzistojë një Manual procedurash adekuat dhe personel i trajnuar). Gjithashtu, Autoriteti menaxhues duhet të plotësojë vendet e planifikuara të punës për qasjen LEADER, si dhe të planifikojë personel i cili do të përfshihet në zbatimin e aktiviteteve promovuese dhe trajnuese për zbatimin e kësaj mase.

Rekomandime për përmirësim të politikave

Duhet të përpilohet Rregullorja individuale për zbatimin e masës LEADER

- Nevojitet Rregullore Kombëtare për zbatimin e masës. Përgatitja e masës së ngjashme me qasjen LEADER sipas skemës kombëtare të mbështetjes për zhvillimin rural do të ishte një mënyrë e mirë për të përgatitur partneritetet lokale për masën LEADER në kuadër të Programit IPARD II.
- Përkrahja kombëtare për qasjen LEADER duhet të formulohet në përputhje me kërkesat e BE-së, mirëpo duhet të merret parasysh se çfarë do të jetë përmbajtja për Thirrjen për Aplikacione që do të shpallet nga PA.
- Pasi që nuk janë hartuar të gjitha dokumentet dhe modelet e nevojshme në periudhën e kaluar, është e rëndësishme të rishikohen ato ekzistuese dhe të hartohen ato që mungojnë, siç e kërkon procesi i akreditimit.
- Personeli i Autoritetit menaxhues dhe Agjencisë së pagesave do të duhet të aftësohen për të zbatuar këtë masë. Kjo përfshin trajnime për vlerësim të strategjive të GLV-ve të mundshme, si dhe rregullave dhe parimeve të përgjithshme për zbatimin e masës LEADER.
- Duhet të përgatiten seminare dhe fushata të specializuara informuese për përfaqësuesit e vetëqeverisjeve lokale. Ata duhet të përfshijnë informacione të qarta për masën dhe pozitën e tyre, rolin dhe dobitë që mund të ofrojë zbatimi i masës LEADER për qytetarët e tyre dhe

subjektet juridike, përfshi dhe këndvështrimin në nivel më të gjerë dhe rezultatet e pritura në nivel kombëtar.

- Mbështetja e donatorëve mund të shfrytëzohet për trajnimin e personelit të MAEP-së, si dhe t'u ndihmojë atyre për të zbatuar masën në bazë të skemës kombëtare të mbështetjes, duke zbatuar metodologjinë e 'të mësuarit duke punuar'.

Rekomandime për fuqizimin e palëve të interesuara / aktorëve në nivel lokal

Aktorët do të duhet të jenë më të përgatitur dhe më të informuar rreth rregullave dhe kërkesave të mbështetjes LEADER.

- Informacionet e përshtatshme rreth mundësive dhe parimeve thelbësore të filozofisë LEADER do të duhet t'u transmetohen grupeve të mundshme të aktorëve, të cilët do të mund të përfshiheshin në ngritjen e partneriteteve. Ata duhet të aftësohen përmes trajnimeve të mirë-dizajnuara për të fituar shkathtësi/aftësi rreth procedurave dhe kërkesave të LEADER.
- Skema kombëtare e mbështetjes mund ta ndihmojë këtë proces, mirëpo do të duhet të shoqërohet nga një fushatë e fuqishme informuese për të shpjeguar rregullat dhe kushtet.
- Vetëqeverisjet lokale duhet të trajnohen dhe informohen rreth rolit të tyre në mbështetjen e zbatimit të programit LEADER.
- Mbështetja e donatorëve po ashtu mund të shfrytëzohet për zbatimin e strategjive të GLV-ve të mundshme duke iu dhënë mundësinë për të ushtruar përgatitjen, përzgjedhjen, zbatimin dhe raportimin rreth zbatimit të projekteve të vogla.

5. SHTOJCAT

5.1 Shtojca 1: Referencat

Komiteti Ekonomik dhe Social Evropian. REX / 381 2013. Roli i shoqërisë civile në marrëdhëniet BE-Serbi. Bruksel http://civilnodrustvo.gov.rs/upload/old_site/2013/07/EESC-opinion-on-The-role-of-civil-society-in-EU-Serbia-relations_July-2013_en.pdf

Suni, J. 2009. Forcimi i kapitalit dhe rrjeteve Sociale Rurale. UNDP Serbi, Grupi për zhvillim përfshirës

Volk, T., M. Rednak, E. Erjavec, E. Zhllima, G. Gjeci, S. Bajramović, Ž. Vaško, D. Ognjenović, J. Butković, M. Kerolli-Mustafa, E. Gjokaj, B. Hoxha, D. Dimitrievski, A. Kotevska, I.J. Stamenkovska, A. Martinovic, D. Konjevic, M. Spahic, N. Bogdanov, R. Papić, S. Todorović (autorë); Volk, T., E. Erjavec, P. Ciaian, S. Gomez y Paloma (ed.) 2017. Monitorimi i zhvillimeve të politikave bujqësore në vendet e Ballkanit Perëndimor, Komisioni Evropian, Qendra e Përbashkët Kërkimore

Fekete, E., 2014. Bashkëpunimi ndërmjet komuniteteve në hapësirën rurale pas-socialiste hungareze, në: Kasabov, E. (Ed.), Në kërkim të 'maredhenieve ne fshat`: Bashkëpunimi në zonat rurale, periferike të Evropës, sfidat dhe zgjidhjet e saj. Palgrave Macmillan, fq. 68-97

TACSO. 2016. Raporti i vlerësimit të nevojave - Serbi, 2016. http://tacso.org/doc/doc2016_nar_rs.pdf

Drejt zhvillimit të qëndrueshëm rural: Qasja LEADER+ në Republikën Çeke; CSD 16, 5 - 16 maj, 2008; https://sustainabledevelopment.un.org/content/documents/czech_7may_agriculture.pdf

6.2 Shtojca 2: Lista e dokumenteve politike dhe ligjore të rishikuara

Strategjia për Bujqësi dhe Zhvillim Rural për periudhën 2014 – 2024 - Gazeta zyrtare e RS, Nr. 84/14

Ligji mbi stimujt në Bujqësi dhe Zhvillim Rural (LIARD) - Gazeta zyrtare e RS, Nr. 10/2013, 142/2014, 103/2015 dhe 101/2016

Ligji për shoqatat - Gazeta zyrtare e RS, Nr. 51/2009 dhe 99/2011

Ligji për vetëqeverisje lokale - Gazeta zyrtare e RS, Nr. 129/2007 dhe 83/2014

Ligji për zhvillim rajonal - Gazeta zyrtare e RS, Nr. 51/2009, 30/2010 dhe 89/2015

PJESA C :
QASJA- ZHVILLIMI ME BAZË TERRITORIN (ABD)

KAPITULLI C.I

Zhvillimi me bazë territorin (ABD) – një qasje rajonale nga poshtë-lartë për rritje të qëndrueshme të jetesës rurale në rajonet ndërkufitare të BP

Autorë: Z. Damjan Surlevski – Menaxher projekti i SWG, Znj. Irena Djimrevska – Këshilltare e GIZ, Z. Boban Ilic – Sekretar i përgjithshëm i SWG, Znj. Katerina Spasovska – SWG Menaxhere e Lartë e Projektit

1. HYRJE

Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik i zonave rurale dhe jetesa e përmirësuar rurale janë të bazuara në zhvillimin gjithëpërfshirës socio-ekonomik në nivel lokal, pjesëmarrjen e madhe të qeverisjes lokale dhe iniciativat novatore me bazë komunitetin.

Ekonomitë lokale dhe aftësia e tyre konkurruese kërkojnë një vazhdim/rrjedhë të qëndrueshme të ndërveprimit, të përqendruar në ndërtimin e marrëdhënieve të qëndrueshme dhe afatgjata midis rrjeteve të aktorëve të autoriteteve lokale, operatorëve të biznesit të vogël, fermerëve dhe shoqërisë civile.

Zhvillimi me bazë territorin si një qasje novatore për zhvillim me bazë komunitetin, lehtëson rritjen e qëndrueshme në zonat rurale. Ai ka dëshmuar të jetë i përshtatshëm për rajonet ndërkufitare në Ballkanin Perëndimor, të cilat karakterizohen nga sfida të ndërlikuara të zhvillimit.

Ngjashëm me Qasjen "Liaison entre Actions de Developpment de l'Economie Rurale" (LEADER) dhe Zhvillimin lokal të udhëhequr nga komuniteti (CLLD), Qasja e zhvillimit me bazë territorin (ABDA) shërben si një mjet për synimin/përzgjedhjen e zonave të përcaktuara gjeografike në rajonet ndërkufitare të cilët karakterizohen nga një sërë problemesh të përbashkëta, të ndërlikuara të zhvillimit dhe që ndajnë një kulturë dhe burime natyrore të ngjashme. Është një qasje rajonale (lokale) e cila lehtëson rritjen e qëndrueshme në zonat e vogla rurale me kohezion social në rënie, shpesh të karakterizuara nga një traditë dhe identitet i përbashkët. ABDA zbatohet në bazë të strategjive për zhvillim lokal me bazë territorin, të cilët i mbështesin aktorët lokal nga shtetet, sektorët dhe entitetet e ndryshme, të marrin pjesë në proceset e vendimmarrjes dhe përzgjedhjes së prioriteteve të cilat duhet të ndiqen në komunitetet e tyre lokale përmes qasjes së integruar nga poshtë-lart. Me anë të Grupeve të palëve të interesuara (GPI), të cilët veprojnë si Grupe rajonale lokale të veprimit, ABD bazohet në themelimin e partneriteteve lokale, integrimin dhe veprimet shumë-sektoriale, nxitjen e inovacionit (futja e prodhimeve/proceseve/tregjeve të reja) dhe gjetjen e zgjidhjeve për problemet rurale të vazhdueshme. Mbi të gjitha, kjo qasje lehtëson rrjetëzimin dhe bashkëpunimin midis palëve të interesuara në zonat rurale, administratave dhe organizatave të përfshira në zhvillimin rural për shkëmbimin e arritjeve, përvojave dhe njohurive. Një bashkëpunim i tillë u ndihmon komuniteteve lokale të rrisin aktivitetet e tyre dhe u lejon atyre të zgjidhin probleme të caktuara ose t'u shtojnë vlerë resurseve, produkteve dhe shërbimeve lokale. Qasja e zhvillimit me bazë territorin, po ashtu përqendrohet në ndërtimin e kapaciteteve lokale dhe rrjetëzimin midis rajoneve kufitare rurale dhe të komuniteteve tyre lokale dhe në këtë mënyrë kontribuon në kapërcimin e pengesave kombëtare të hasura gjatë proceseve të politikave të reformës së BE.

Përgatitjet për zbatimin e Qasjes së zhvillimit me bazë territorin në Ballkanin Perëndimor filluan me themelimin e Grupit të përhershëm të punës për zhvillim rural rajonal (SWG) në vitin 2005 me identifikimin e zonave ndërkufitare, të cilat, si zona më të margjinalizuara dhe më të pazhvilluara, kanë nevojë për vëmendje të veçantë nga Qeveritë pjesëmarrëse. Duke u bazuar në rezultatet e hulumtimit të dokumentacionit , Komisioni Evropian - Drejtoria e përgjithshme për bujqësi në bashkëpunim me Qendrën e përbashkët kërkimore të KE-së ka financuar një projekt për: "Identifikimin e zonave potenciale ndërkufitare rurale të synuara për zbatimin e një qasjeje për zhvillim me bazë territorin në Ballkanin Perëndimor: metodologjia dhe vlerësimi ". JRC IPTS, në bashkëpunim me SWG, ka bërë vlerësimin krahasues të fushave të mundshme të identifikuara për sa u përket aseteve dhe të handikapëve/të metave të tyre për zbatimin e suksesshëm të qasjes për zhvillim mr bazë territorin. Përveç kësaj, u vlerësuan rregullimet për zhvillim dhe nevojat kritike të zonës së synuar potenciale të "Drina-Tara", si një pilot rajon ndërkufitar për zbatimin e qasjes ABD.

Procesi vazhdoi në 2011-2017 kur SWG u kontraktua nga ana e DG NEAR i KE (ENLARG) në kuadër të disa projekteve për të kryer analiza bazë dhe planifikim të detajuar strategjik për zhvillimin e

rajoneve ndërkufitare "Prespa", "Sharri", "Drina - Sava", "Prokletije - Bjeshkët e Nemuna", "Krsh" dhe "Pcinja - Krajishte" si dhe ngritjen e strukturave operacionale dhe menaxhuese. Në mënyrë paralele, aktivitetet po ashtu u përqendruan në ndërtimin e kapaciteteve dhe strukturave brenda SWG-së në mënyrë që ajo të jetë në gjendje të zbatojë më tej qasjen ABD.

Veprimet e ndërmarra rezultuan me krijimin e kushteve-kuadër për zbatimin e qasjes ABD, përmes forcimit të bashkëpunimit ndërmjet administratave publike dhe organeve tjera publike, sektorit privat dhe OJF-ve në lidhje me zhvillimin lokal dhe bashkëpunimin rajonal. Kjo po ashtu u mbështet nga ngritja e kapaciteteve lokale dhe rajonale ndërkufitare që kontribuojnë në rritjen e qëndrueshme të rajoneve ndërkufitare rurale.

2. ABD NË BALLKANIN PERËNDIMOR

Qëllimi i përgjithshëm i qasjes ABD në Ballkanin Perëndimor është të lehtësojë bashkëpunimin dhe pajtimin ndërkufitar dhe rajonal, përmes sigurimit të mekanizmave për proceset legjitime, transparente, pjesëmarrëse dhe të vazhdueshme të vlerësimit të nevojave, përcaktimit të prioriteteve dhe zbatimit të Programeve për zhvillimin ekonomik të rajoneve ndërkufitare të BP duke përdorur qasjen metodologjike të Zhvillimit me bazë territorin.

Që nga prezantimi i saj, qasja ABD ka dëshmuar të jetë një mekanizëm efikas për lehtësimin e qasjes nga poshtë-lart për zhvillimin rural rajonal dhe për nxitjen e rritjes së integruar ekonomike në rajonet rurale ndërkufitare të BP. Ky sukses vjen nga fakti se kjo qasje është e përqendruar tek njerëzit, bazuar në të kuptuarit e realiteteve të popullsisë rurale dhe në parimin e pjesëmarrjes së tyre në përcaktimin e prioriteteve për ndërhyrje. Është gjithashtu gjithëpërfshirëse në atë që ajo është jo-sektoriale dhe njeh aktorë të shumtë, strategji të shumta dhe rezultate të shumëfishta. Aktivitetet e saj janë të përkushtuara në disa dimensione të ndryshme të qëndrueshmërisë, siç janë ato mjedisore, ekonomike dhe shoqërore.

Në përputhje me planet dhe analizat strategjike, ABD lehtëson perspektivat e mëposhtme :

- frenimin e largimit të popullsisë dhe tërheqjen e punëtorëve të rinj të kualifikuar në zonat kufitare rurale;
- përmirësimin e përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe mbrojtjes së mjedisit;
- krijimin e rrjeteve të biznesit ndërmjet operatorëve të vegjël të biznesit, zinxhirëve të shkurt të vlerave dhe grupimin;
- promovimin, marketingun e rajoneve dhe vlerave të tyre për jetesë, punë, vizitë;
- transferimin e njohurive dhe shkëmbimin e përvojës, futjen dhe zbatimin e inovacioneve në proceset e prodhimit dhe ofrimin e shërbimeve, si dhe standardeve të cilësisë në shërbim dhe prodhim.

Në përgjithësi, qasja përqendrohet në tre procese paralele:

1. Lehtësimin e bashkëpunimit dhe pajtimit ndërkufitar dhe rajonal, duke siguruar mekanizma për procese të ligjshme, transparente, pjesëmarrëse dhe të vazhdueshme të vlerësimit të nevojave, përcaktimit të prioriteteve dhe planifikimit të veprimit në një rajon të caktuar;
2. Forcimin e bashkëpunimit të administratave publike dhe organeve tjera publike dhe OJF-ve në fushën e zhvillimit lokal dhe bashkëpunimit rajonal përmes ndërtimit të kapaciteteve ndërkufitare lokale dhe rajonale;
3. Kontributin për rritjen e qëndrueshme ekonomike të një rajoni të caktuar duke lehtësuar

zbatimin e veprimeve të identifikuara dhe në veçanti përmes ofrimit të mbështetjes në investime me vlerë të shtuar më të lartë të mundshme dhe efekte katalitike për ekonomitë rurale;

Kjo më së miri trajtohet nëpërmjet mjeteve dhe mënyrave të ndryshme të veprimit:

- Mbështetje për përgatitjen e projekt propozimeve cilësore dhe strategjive lokale/rajonale të zhvillimit për zhvillimin e integruar ekonomik;
- Aktivitete për ngritjen e kapaciteteve dhe sistemit të themeluar për transferim të njohurive;
- Komunikim, bashkëpunim dhe dialog i rregullt, ndërmjet grupeve të interesit - takime, diskutime specifike të grupeve të punës;
- Bashkëpunim, promovim dhe shkëmbim i përmirësuar i përvojave, përmes mbështetjes së organizimit të eventeve njerëzit për njerëzit (P2P) - organizimi i aktiviteteve rurale, panaireve rurale, ngjarjeve kulturore dhe tradicionale, mbështetja e krijimit të rrjeteve profesionale dhe të biznesit e partneriteteve, etj.;
- Zbatimi i skemave për mbështetje të cilat përqendrohen në krijimin e të ardhurave - përmirësimin e aftësisë konkurruese të prodhuesve dhe ofrueseve të vegjël dhe të mesëm të shërbimeve në dhe zhvillimin e zinxhirëve të vlerave të shkurtra për produktet ushqimore cilësore dhe për produktet dhe shërbimet turistike rurale.

2.1 ABD në dokumentet e strategjive dhe programeve

Analiza bazë dhe kornizat e detajuara për zhvillim strategjik janë hartuar për rajonet ndërkufitare "Prespa", "Sharri", "Drina-Sava", "Prokletije - Bjeshkët e Nemuna", "Krsh" dhe "Pcinja - Krajishte", përmes shfrytëzimit të qasjes me pjesëmarrje nga poshtë-lart. Kornizat strategjike kanë një perspektivë shumëvjeçare të planifikimit për zhvillimin ekonomik të zonave ndërkufitare të Ballkanit Perëndimor. Fushat prioritare për zhvillim paraqesin fushat kryesore në të cilat strategjia mund të kontribuojë për përmirësime (qoftë përmes trajtimit të sfidave kryesore ose përmes përqafimit të mundësive kryesore). Gjatë procesit të planifikimit pjesëmarrës janë identifikuar dhe përzgjedhur sferat prioritare. Informacionet nga faktorë të shumtë po ashtu janë përdorur në procesin e përcaktimit të prioriteteve. Fushat e identifikuara prioritare të përcaktuara për të gjitha rajonet ndërkufitare janë:

1. Mjedisi;
2. Bujqësia;
3. Rritja ekonomike dhe turizmi;
4. Kohezioni social;
5. Infrastruktura rajonale;
6. Efikasitet energjetik.

Kornizat strategjike janë krijuar përmes përdorimit të metodologjisë ABD dhe përmes pjesëmarrjes angazhuese të aktorëve rajonal gjatë takimeve të grupeve të interesit, të organizuara në bazë të tematikave në nën-grupe, me qëllim marrjen e kontributit të tyre për identifikimin e prioriteteve dhe drejtimeve për zhvillimin e zonave ndërkufitare. Përveç kësaj, mjetet e pjesëmarrjes siç janë sondazhet dhe intervistat u përdorën gjatë këtij procesi, për të analizuar situatën e përgjithshme në rajon, duke identifikuar fushat prioritare dhe duke vendosur vizionin dhe kuadrin strategjik. Kuadri strategjik ofron një deklaratë të nivelit të lartë për drejtimin e ardhshëm dhe prioritetet e rajoneve ndërkufitare dhe i udhëzon vendimet e palëve të interesuara gjatë periudhës së zbatimit.

Kornizat strategjike dhe dokumentet e programeve për çdo rajon ndërkufitar, marrin në konsideratë strategjitë lokale dhe kombëtare, si dhe pasqyrojnë angazhimin në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar për një rritje të qëndrueshme të një rajoni të caktuar.

Këto korniza strategjike dhe dokumente të programeve ndërlidhen me Dokumentin e Strategjisë Indikative të shumë-vendeve 2014-2020 (MCSP) dhe fushat me sektorët e tij kyç ku asistencat e shumë vendeve dhe ndërkufitare do të jenë më të dobishme për mbështetjen e përfituesve të IPA II që të përgatiten për përmbushjen e kritereve të pranimit. Kuadri është hartuar për të mbështetur bashkëpunimin rajonal dhe territorial, për të lehtësuar kordinimin dhe mekanizmat efektiv horizontal dhe vertikal për zbatim dhe gjithashtu ky kuadër strategjik plotëson MCSP. Kornizat strategjike dhe dokumentet përkatëse për programim për secilën prej rajoneve ndërkufitare të synuara dhe prioritetet e përzgjedhura për zhvillim, në analizën bazë nga ana e palëve të interesuara në rajonet ndërkufitare të synuara janë të lidhura ngushtë me fushat kryesore të politikave të Rregullores IPA II: (i) reformat për përgatitjen për anëtarësimin në BE dhe çështjet përkatëse institucionale dhe ngritjen e kapaciteteve, (ii) zhvillim socio-ekonomik dhe zhvillim rajonal, (iii) punësim, politikë sociale, arsim, promovim të barazisë gjinore dhe zhvillim të burimeve njerëzore, (iv) bujqësi dhe zhvillim rural, dhe (v) bashkëpunim rajonal dhe territorial. Më konkretisht, ato janë në përputhje me dy nga katër akset e MCSP: (i) strukturat rajonale dhe rrjetëzimi dhe (ii) bashkëpunimi territorial, respektivisht për të ndihmuar promovimin e projekteve ABD në një numër të kufizuar të zonave të marxhinalizuara kufitare dhe për të mbështetur projekte që ndjekin qasjen ABD për të lehtësuar rritjen e qëndrueshme në zonat gjeografike të përcaktuara në rajonet ndërkufitare në Ballkanin Perëndimor.

Në veçanti, MCSP 2014-2020 thekson se "bashkëpunimi rajonal dhe shkëmbimi i praktikave më të mira janë një mënyrë efikase për nxitjen e zhvillimit rural, veçanërisht në zonat kufitare të cilat duhet të ndërlidhen më mirë me rajonet fqinje. Këto sfida do të trajtohen më mirë përmes ndjekjes së një qasjeje gjithëpërfshirëse, të bazuar, për shembull, në konceptin për "zhvillim me bazë territorin" i cili promovohet nga SWG. Për më tepër, MCSP 2014-2020 parashikon që "projektet e përgatitura sipas qasjes ABD për lehtësimin e rritjes së qëndrueshme në zonat e caktuara gjeografike në rajonet ndërkufitare të Ballkanit Perëndimor, në zonat e veçanta rurale të karakterizuara nga probleme specifike të ndërlikuara të zhvillimit, do të merren parasysh për financim nga programet për bashkëpunim ndërkufitar".

ABD është gjithashtu në përputhje me synimin e strategjisë për Evropës Juglindore (SEE) 2020, që është të përmirësojë kushtet e jetesës në këtë rajon dhe të sjellë në qendër të vëmendjes aftësinë konkurruese dhe zhvillimin; gjithashtu është duke ndjekur nga afër vizionin e strategjisë së BE-së Evropa 2020. Në kontekst të Strategjisë EJL 2020, BE-ja synon të ndihmojë Ballkanin Perëndimor për t'iu përgjigjur më mirë sinjaleve të tregut, të integrojë bujqësinë në zgjerimin e tregjeve rajonale dhe ndërkombëtare, të përmirësojë efikasitetin dhe të ofrojë vende pune alternative jashtë bujqësisë.

Në kuadër të Programit IPARD të Republikës së Serbisë për periudhën 2014-2020, ABDA njihet si qasje gjithëpërfshirëse për zhvillimin socio-ekonomik të territoreve duke përfshirë komunitetet lokale më pak të favorizuara në zonat kufitare.

Sipas Programit IPARD, për të arritur një ndryshim domethënës në zonat ndërkufitare rurale të përzgjedhura, nevojitet përpilimi i të gjitha burimeve të financimit, në shumë raste të plotësuara me veprime rregullatorë nga shteti dhe autoritetet lokale. Në këtë drejtim, zbatimi i IPARD në ato zona ndërkufitare gjithashtu do të luajë një rol të rëndësishëm. Prandaj, duhet bërë një përpjekje për të siguruar që IPARD të kontribuojë drejt ABD dhe që ka sinergji midis instrumenteve të ndryshme që kontribuojnë drejt objektivave të ABD.

2.2 Rregullimet institucionale dhe ligjore

* *Ky përcaktim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve mbi statusin dhe është në përputhje me RKSKB 1244 dhe Mendimin e GJND mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës*

Qasja ABD është aplikuar përmes Zyrave Rajonale funksionale/Njësitë për menaxhimin e projekteve (PMU) të themeluara në katër rajonet ndërkufitare të "Drina-Tara" (Bosnjë e Hercegovinë, Mal i Zi dhe Serbi), "Drina-Sava" (Bosnjë e Hercegovinë, Kroaci dhe Serbi), "Prespa" (Shqipëri dhe Maqedoni) dhe "Sharri" (Shqipëri, Maqedoni dhe Kosovë*), si dhe Zyrës Rajonale në Beograd. Me analizën bazë të përfunduar si dhe me një kornizë të përgatitur strategjike, qasja ABD është iniciuar dhe e gatshme për institucionalizim të mëtejshëm në tre rajonet plotësuese: "Krsh" (Bosnjë e Hercegovinë, Kroaci dhe Mal i Zi), "Pcinja-Krajishte" (Serbi, Bulgari dhe Maqedoni) dhe "Prokletije-Bjeshkët e Nemuna" (Shqipëri, Kosovë*, Mal i Zi).

Njësitë për Menaxhimin e Projektit (PMU) shërbejnë si mbështetje teknike e kuadrit të ABDA për lehtësimin e kornizave strategjike rajonale dhe programimin e drejtuar kah zhvillimi ekonomik i rajoneve rurale. PMU-të veprojnë si organe kordinuese për anëtarët e grupeve të palëve të interesuara (SHG) në secilin rajon.

Në çdo rajon ndërkufitar, është themeluar SHG e cila përbëhet nga një përfaqësues i qeverisë lokale, sektorit të biznesit (aktorët privat dhe organizatat e biznesit, përfshi njësitë ekonomike bujqësore dhe/ose kooperativat) dhe organizatat e shoqërisë civile (OSHC), përveç organizatave të biznesit. Grupet e palëve të interesuara funksionojnë si Grupe lokale të veprimit (GLV) të heshtura/fshehura, me karakter rajonal në rajonet ndërkufitare.

Është hartuar Protokolli specifik i operimit/veprimit për SHG-të i cili përcakton rregullat themelore dhe procedurat për funksionim.

Që nga fillimi, qasja ABD bëri një përpjekje të veçantë për përfshirjen e të gjithë palëve të interesuara përmes një qasjeje të vërtetë nga poshtë-lart, e cila gjithashtu përfshinte edhe sektorin privat të biznesit. Kjo u arrit përmes vënies së përqendrimit mbi zhvillimin e zinxhirit të vlerave të shkurtra, integrimin e operatorëve të vegjël të biznesit në zinxhirët e shkurtër të vlerës dhe në rritjen e cilësisë së produkteve lokale, tradicionale dhe shërbimeve turistike. Roli i tyre është forcimi dhe promovimi i pronësisë lokale përmes rritjes së pjesëmarrjes brenda komuniteteve dhe nxitja e ndjenjës së përfshirjes dhe pronësisë që mund të nxisë planifikimin dhe zhvillimin lokal. Ndërhyrjet horizontale tashmë janë ndërmarrë nën qasjen ABD për të krijuar një identitet rajonal dhe markë të rajoneve ABD, duke përfshirë identifikimin dhe regjistrimin e të gjithë operatorëve relevantë të biznesit në rajonet ABD.

Njësia për zbatimin e projektit u themelua në kuadër të Zyrës kryesore të SWG/Sekretariatit në Shkup, Maqedoni, e cila është përgjegjëse për menaxhimin e përgjithshëm të qasjes ABD dhe komunikimin me donatorë të ndryshëm dhe Ministritë përkatëse.

2.3 Financimi

Që nga prezantimi i tij, ABD kryesisht u mbështet nga donatorët. Bashkimi Evropian (BE), GIZ (Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit) dhe FAO (Organizata për Ushqimin dhe Bujqësinë) kanë mbështetur qasjen ABD në formën e granteve të drejtpërdrejta në vlerë të llogaritur prej më shumë se 3.000.000 euro, ku donator kryesor është BE.

Nuk ka alokime kombëtare ose fonde specifike për mbështetjen e qasjes ABD. Shtetet/territoret anëtare të SWG dhe ministritë përkatëse të Bujqësisë dhe zhvillimit rural kanë mbështetur zbatimin në një mënyrë më teknike dhe administrative, siç është sigurimi i zyrave dhe lehtësirave tjera të vogla për funksionimin e duhur të PMU-ve dhe Zyrës rajonale në Beograd, Serbi.

Deri më tani janë zbatuar/janë duke u zbatuar dy pilot skema mbështetëse (grante), fillimisht në

"Drina-Tara" dhe "Drina-Sava" dhe më vonë edhe në zonat ndërkufitare "Prespa" dhe "Sharri". Skemat e granteve kryesisht ndjekin mënyrat specifike të masave mbështetëse të zbatuara në kuadër të Fondit Evropian për bujqësinë dhe zhvillimin rural (EAFRD) dhe komponentit të Instrumentit për Asistencë Para-anëtarësimi për zhvillimin rural (IPARD).

Skema e parë - pilot e granteve u zbatua në rajonet "Drina-Tara" dhe "Drina-Sava" ndërmjet janarit 2014 dhe prillit 2015 me fokus rritjen e aftësisë konkurruese të prodhuesve të vegjël dhe të mesëm. Skema u financua nga Bashkimi Evropian me një shumë prej rreth 145.000 euro si pjesë e zbatimit dhe konsolidimit të qasjes ABD. Investimi total arriti në rreth 260.000 euro duke treguar një interes të lartë dhe vullnet në mesin e përfituesve për të gjetur mjete për bashkëfinancim. Qëllimi i tij kryesor ishte të rriste aftësinë konkurruese të prodhuesve të vegjël dhe të mesëm duke ofruar mbështetje financiare për rinovimin e objekteve për prodhim dhe blerje të pajisjeve për krijimin e produkteve të reja novatore ose për përmirësimin e atyre ekzistuese. U zbatuan me sukses gjithsej 9 projekte me përfshirjen e 28 përfituesve.

Skema e dytë e granteve, e financuar nga GIZ me një shumë prej 400.000 euro, u zbatua në rajonet ndërkufitare "Drina-Tara", "Drina-Sava", "Prespa" dhe "Sharri". Kjo skemë bazohet në parime dhe procedura të ngjashme me ato të aplikuara në skemën e parë të granteve të financuara nga BE. Mbështet zhvillimin e zinxhirëve të shkurtër të vlerave për produkte ushqimore cilësore dhe produkte e shërbime turistike rurale përmes krijimit të partneriteteve dhe përqendrimit në inovacion dhe përmirësim të cilësisë së produkteve lokale, produkteve dhe shërbimeve turistike, me fokus të veçantë në përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe përfshirjen e të rinjve dhe grave. Për më tepër, u bë një përpjekje e veçantë për përmirësimin e kapacitetit të përfituesve potencial për të shtjelluar strategjitë dhe planet e biznesit.

Zbatimi i aktiviteteve rajonale dhe krijimi i identitetit të përbashkët si dhe përpjekjet e caktuara të caktimit të një marke po ashtu janë mbështetur përmes veprimeve Njerëzit për Njerëzit (P2P). Veprimet P2P janë parë si një mjet i shkëlqyer ushtrimi për të praktikuar partneritetet dhe bashkëpunimin midis palëve të interesuara. kontribuon shumë në forcimin, rrjetëzimin, bashkëpunimin dhe promovimin e trashëgimisë kulturore, natyrore dhe traditave, si dhe të potencialeve ekonomike të rajoneve ndërkufitare rurale. Kjo rezultoi me rritjen e një ndjenje identiteti të përbashkët dhe të rrjetëzimit në zonat ndërkufitare. Deri më tani, në kuadër të qasjes ABD, janë organizuar më shumë se 110 ngjarje P2P me karakter rajonal me një mbështetje të vlerësuar prej më shumë se 200.000 euro.

3. INICIATIVAT ABD DHE MËSIMET E NXJERRA

Qasja ABD gjithashtu bën lehtësimin e mbështetjes për fermerët dhe bizneset e vogla si një nga drejtuesit më të rëndësishëm të zhvillimit ekonomik lokal. Që kjo të ketë sukses, si brenda rajonit ashtu edhe ndërmjet rajoneve, është thelbësore që të përfshihen partneritetet dhe rrjetet e biznesit siç janë strukturat e grupeve, si dhe procesi i grupeve. Përmes këtij bashkëpunimi, "markat", e rrënjosura në rajon, të cilat nganjëherë përfshijnë më shumë se një biznes, mund të krijohen dhe të zhvillohen, veçanërisht në sektorin e turizmit dhe produkteve bujqësore/ushqimore. Markat e tilla ofrojnë mundësi që idetë dhe qëllimet e përbashkëta të rriten më fuqishëm dhe të bëhen produkte të qëndrueshme që shiten në treg (rajonal) si rezultat i veprimeve tregtare të përbashkëta. Ndërhyrja kërkon ndërtimin e kapaciteteve të grupimit të zinxhirit të vlerave dhe transferimin e njohurive për krijimin e kushteve të përshtatshme për veprime lokale efektive dhe për të përshpejtuar në masë të madhe ngritjen e praktikave më të mira në nivel lokal. Grumbullimi i resurseve lokale (produkte dhe shërbime), i thekson prioritetet socio-kulturore të rajoneve, duke i dhënë vlerë të shtuar zhvillimit dhe promovimit të tregut lokal.

Më poshtë jepen shembuj të projekteve dhe iniciativave të realizuara nën qasjen ABD:

Table C. I. 1: Case study 1

1. Titulli dhe autori	**Forumi i Biznesit i Prespës 2016** - ngjarje e mbështetur në kuadër të mjetit P2P të ABD *Koncepti i projektit nga:* Komuna e Resnjës (Maqedoni), në partneritet me komunën e Pustecit dhe komunën e Korçës (Shqipëri)
2. Përmbledhje ekzekutive	Duke pasur parasysh nevojën për të nxitur bashkëpunimin rajonal dhe respektin e ndërsjellë, si dhe nevojat e shprehura për krijimin e një prosperiteti të qëndrueshëm ekonomik në rajonin ndërkufitar të Prespës, komunat Resnjë, Pustec dhe Korçë nënshkruan një Memorandum për bashkëpunim të ndërsjellë ekonomik në nëntor të vitit 2015. Nënshkrimi i Memorandumit u mbështet nga Ambasada e Maqedonisë në Shqipëri si një arritje shumë e rëndësishme në marrëdhëniet ekonomike dypalëshe. Megjithëse faktorët politikë në nivel lokal e nënshkruan Memorandumin në mënyrë deklarative, sfida e vërtetë ishte krijimi i komunikimit dhe rrjetëzimit në sektorin e biznesit të tri komunave, veçanërisht në sektorët ekonomik të turizmit, bujqësisë dhe industrisë ushqimore, të cilat janë karakteristike për të tre komunat. Forumi i Biznesit i Prespës e trajtonte këtë sfidë si ngjarjen e parë të rëndësishme e cila rezultoi nga nënshkrimi i Memorandumit. Qëllimi kryesor i ngjarjes ishte krijimi i një mundësie për arritjen e një bashkëpunimi më të gjerë dhe më të madh në sektorët e turizmit, bujqësisë dhe industrisë ushqimore, si dhe nxitja e përfitimit ekonomik për popullsinë lokale në rajonin ndërkufitar të Prespës. Mirëkuptimi dhe bashkëpunimi i ndërsjellë midis bizneseve në rajon është i nevojshëm për rritjen e zhvillimt ekonomik dhe pritej që kjo ngjarje të ofronte zgjidhje për sfidat e biznesit në rajon.
3. Të dhënat për komunitetin	Rajoni ndërkufitar i Prespës ndodhet në pjesën jugperëndimore të Republikës së Maqedonisë dhe pjesën juglindore të Shqipërisë dhe përfshin dy komuna në Maqedoni, Resnjë dhe Ohër, dhe të gjithë rajonin e Korçës në Shqipëri. Rajoni ka burime të rëndësishme natyrore, infrastrukturë mjaft të mirë fizike dhe të komunave dhe një nivel të caktuar të homogjenitetit të performancës ekonomike, sociale etj.. Sipërfaqja e përgjithshme e tij është 3381,93 km2 me një popullsi prej 328.390. Theksi i aktiviteteve ekonomike në rajon tradicionalisht është vënë mbi bujqësinë, me fokus të veçantë në prodhimin/kultivimin e mollës, industrinë e përpunimit të ushqimit, industrinë tekstile, industrinë e ndërtimit dhe turizmit. Këto sektorë janë zhvilluar sipas karakteristikave kryesore të zonës, siç janë klima, pozita gjeografike, historia e ekonomisë dhe bashkëpunimit dhe kapacitetet e burimeve njerëzore. Rajoni promovohet si një vend unik, i përbërë nga komunitete me interes të përbashkët dhe aktivitete të ngjashme në të dyja anët. Rajoni njihet si një vend me shumë karakteristika krahasuese dhe përfitime për popullsinë lokale.
4. Sfida	Në përgjithësi, organizimi i Forumit të parë të Biznesit të Prespës ishte një sfidë në vete, pasi që ishte ngjarja e parë e këtij lloji në rajon, veçanërisht pasi që ishte e para që rezultoi si një bashkëpunim nga Memorandumi i nënshkruar për bashkëpunim ekonomik të ndërsjellë. Sfida kryesore ishte të identifikohet dhe sigurohet prania e pjesëmarrësve dhe aktorëve relevantë. Grupi kordinues i formuar në Komunën e Resnjës ka punuar në këtë çështje gjatë fazës përgatitore, në bashkëpunim me përfaqësuesit e komunave partnere.

5. Aktivitetet	Me qëllim arritjen me sukses të organizimit dhe zbatimit të eventit, u themelua një grup kordinuesish në komunën e Resnjës, si organizator udhëheqës. Obligimet kryesore të partnerëve nga Shqipëria ishin të sigurojnë pjesëmarrjen e përfaqësuesve përkatës nga sektorët që mbuloheshin nga Forumi, si dhe të përgatitin prezantimet sipas programit. Ngjarja u mbajt në Oteshevë, Maqedoni në Hotelin "Lakeview" në periudhën prej 1-2 dhjetor të vitit 2016. Dita e parë e programit të Forumit përfshinte mbledhje prezantimi dhe diskutimi. Prezantimet u dhanë nga komunat dhe përfaqësuesit nga të gjitha sektorët përkatës. Përfaqësuesit e komunave Resnjë, Korçë dhe Pustec paraqitën gjendjen e përgjithshme dhe parakushtet lidhur me komunat, ndërsa përfaqësuesit e bizneseve dhe organizatave dhanë prezantime përmbledhëse të të dhënave dhe praktikave të përgjithshme në fushën përkatëse. Prezantimi i ambasadorit të Maqedonisë në Shqipëri mbuloi bashkëpunimin ekonomik ndërmjet dy shteteve, ndjekur me të dhëna zyrtare për eksportin dhe importin e mallrave në vitet e fundit. Përfaqësuesi i SWG prezantoi një pasqyrë të projekteve aktuale dhe të zbatuara dhe aktiviteteve të ndërmarra në rajonin ndërkufitar. Dita e dytë e Forumit ishte dedikuar për një vizitë në terren të dy kompanive në komunën e Resnjës: Agroplod dhe Apple-Land.
6. Rezultatet	Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve në Forumin e Biznesit të Prespës ishte 42 persona, 20 nga të cilët ishin nga Shqipëria dhe 22 nga Maqedonia. Nga numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve, 7 ishin nga sektori i turizmit, 12 nga sektori i bujqësisë, 10 nga industria ushqimore, ndërsa të tjerët ishin përfaqësues nga komunat, SWG dhe Ambasada e Maqedonisë në Shqipëri. Të tre partnerët organizues kishin një bashkëpunim të suksesshëm gjatë realizimit të ngjarjes. Qëllimet kryesore që u arritën gjatë Forumit përfshijnë: • Shkëmbimi i informacionit rreth kushteve të përgjithshme në komunat Resnjë, Korçë dhe Pustec. • Shkëmbimi i informacionit rreth situatës aktuale në sektorët e bujqësisë, turizmit dhe prodhimit të ushqimit në Maqedoni dhe Shqipëri, brenda rajonit të Prespës. • Shkëmbimi i praktikave të mira përmes vizitës në terren të dy subjekteve kryesore ekonomike në Komunën e Resnjës - Agroplod dhe Apple Land. • Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet komunave organizuese: Resnjë, Korçë dhe Pustec. • Shkëmbimi i praktikave të mira ndërmjet përfaqësuesve dhe pjesëmarrësve në Forum, si dhe ideve për bashkëpunim në të ardhmen. Pjesëmarrësit po ashtu kishin mundësinë të realizonin takime B2B dhe të propozonin masa dhe aktivitete të cilat do të kontribuojnë për realizimin e dispozitave të Memorandumit, dhe janë të pasqyruara tek Konkluzionet e nevojshme për veprim në të ardhmen.

7. Mësimet e nxjerra dhe Konkluzionet	Forumi siguroi një prezantim dhe rrjetëzim të drejtpërdrejtë të sektorit të biznesit në komunat e përzgjedhura. Forumi me sukses arriti të përmbushë nevojën shumëvjeçare të rajonit për zhvillimin e një platforme të përbashkët në sferën e bujqësisë, turizmit dhe industrisë ushqimore, bashkëpunimit të bizneseve, veçanërisht në gjetjen e tregjeve të përbashkëta që do të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik të rajonit ndërkufitar. Përfaqësuesit e sektorëve të ndryshëm, kompani dhe komuna u njoftuan me ekonominë në rajon, kapacitetet kryesore industriale dhe mundësitë për bashkëpunim dhe qasje të përbashkët në treg. Forumi shërbeu si një platformë në të cilën bizneset shkëmbyen idetë, nevojat aktuale dhe planet për zhvillim të ardhshëm të bizneseve dhe komunave. Përfaqësuesit e bizneseve i njohën partnerët e tyre potencial nga komunat përtej kufirit, që do të shërbejë si hap fillestar për ndërmarrjen e aktiviteteve të mëtejme të përbashkëta.
8. Kontaktet	Naume Tashovski, Komuna e Resnjës, Maqedoni, sulc75@yahoo.com

Table C. I. 2: Case study 2

1. Titulli dhe autori	**"Drejt integrimit të prodhimit dhe zhvillimit të suksesshëm të produkteve bujqësore"** - Projekt i mbështetur në kuadër të Skemës së Grantit ABD Projekti nga: 1. Sirogojno Company d.o.o, Sirogojno, Serbi 2. Kooperativa "Uvac - Rudo", Rudo, B&H 3. Shoqata e prodhuesve të mjedrave "Malina", Rudo, B&H 4. Qendra për demokraci të përgjegjshme "COD Luna", Rudo, B&H
2. Përmbledhje ekzekutive	Qëllimi i këtij projekti ndërkufitar ishte të promovojë rrjetëzimin dhe ngritjen e kapaciteteve të prodhuesve bujqësor, furnizuesve, përpunuesve të ushqimit dhe konsumatorëve final, me qëllim të krijimit të një zinxhiri të gjelbër të vlerave në prodhimin e mjedrave. Investimet sollën deri në përmirësimin e proceseve të prodhimit, shfrytëzimin më të mirë të burimeve, krijimin e produkteve të reja me skica të veçanta, dhe përfundimisht në rritjen e të ardhurave. Katër partnerët e projektit nga dy shtetet e rajonit ndërkufitar "Drina-Tara" mbuluan aspekte të ndryshme të prodhimit dhe tregtisë së mjedrës.
3. Të dhënat për komunitetin	Komuna Rudo, si dhe komunat tjera në pjesën lindore të Bosnjë e Hercegovinës, ballafaqohen me procese dhe ndryshime negative demografike. 27 vendbanimet pjesë e komunës Rudo kanë më pak se 10 banorë. Për më tepër, shkalla e papunësisë është e lartë si pasojë e procesit të tranzicionit, në të cilin ish punonjësit nuk mund të gjenin punë për shkak të moshës së tyre (qytetarë mbi 50 vjet të cilët akoma nuk i përmbushin kriteret minimale për pension). Me një traditë të gjatë, bujqësia njihet si një sektor me potenciale më të mëdha zhvillimi për zonën. Prodhimi i mjedrës është sektori më fitimprurës i bujqësisë në komunën Rudo. Në një periudhë të shkurtër kohore përmes shfrytëzimit të burimeve dhe investimeve në dispozicion, prodhimi i mjedrës dha rezultate për sa i përket zhvillimit të kushteve për vetëpunësim, veçanërisht për grupet e përjashtuara sociale. Themelimi i kooperativës me investime modeste të komunës Rudo, krijoi efekte të shumëfishta pozitive, përveç rritjes së punësimit, po ashtu u rritën dhe të ardhurat nga shitja e produkteve bujqësore dhe kohezioni më i mirë social në zonat rurale.

4. Sfida	Kooperativa ballafaqohet me shumë sfida të ndryshme zhvillimi të cilat janë të zakonshme në punën e një kooperative. Por me praktika të mira, plane të qarta dhe marrëveshje ndërmjet të gjithë anëtarëve dhe investimeve të partnerëve të projektit, ajo mund të kapitalizohet ashtu siç ishte planifikuar në fillim. Për këtë shembull, plani i partnerëve të projektit ishte të punësohen 14 persona dhe të rriten të ardhurat e tyre për më shumë se 100,000 euro. Aktivitetet tashmë i kanë arritur qëllimet e synuara përmes projektit, pavarësisht vështirësive të shkaktuara nga kushtet klimatike dhe problemet në treg.
5. Aktivitetet	Shoqata e prodhuesve të mjedrave "Malina" ka investuar në një laborator të lëvizshëm për analiza kimike të tokës që i pajis ato me më tepër informacione dhe me rezultate më të mira në procesin e prodhimit. Me këtë ata mund të rrisin kapacitetin e tyre dhe të punësojnë më tepër njerëz nga komuniteti i tyre që do t'u ndihmojë atyre në prodhimin e produktit final - lëng për tregun e vendit. Kompania Sirogojno dhe Kooperativa Uvac-Rudo i investuan fondet nga granti për një kalibrues me dridhje për magazina frigoriferike dhe një peshore bashkëkohore me shumë kokë e cila do të ndihmojë në përzgjedhjen dhe paketimin e mjedrave. Qëllimi i OJF Luna, si një partner projekti, ishte të rrisë kapacitetin e tij dhe të punësojnë më tepër njerëz nga komuniteti i tyre, këta njerëz do të përfshiheshin në aktivitete e prodhimit të produktit final - lëng për tregun e vendit. Përmes grantit ata siguruan një linjë prodhimi dhe një makinë paketimi në shishe për lëngjet e frutave dhe perimeve.
6. Rezultatet	• Pajisja me Laborator për analizat kimike të tokës; • Pajisja me Kalibrues me dridhje për magazina frigoriferike; • Pajisja me peshore bashkëkohore me shumë kokë; • Pajisja me linjë prodhimi dhe makinë për paketimin në shishe për lëngjet e frutave dhe perimeve; • Riblerja e 400 ton mjedra; • Kultivimi në parcela të reja të mjedrave me sipërfaqe deri në 20ha • Nisja e prodhimit të Lëngjeve dhe marmelatës/reçelit; • Përmirësimi i cilësisë së mjedrave prej kalibrimit; • Futja e standardit HACCP; • Prodhimi i fidanëve cilësor të mjedrës; • Punësime të reja.
7. Mësimet e nxjerra dhe Konkluzionet	Themelimi i Kooperativave funksionale në Rudo dhe integrimi i prodhuesve bujqësor është thelbësor për zhvillimin rural në këtë zonë. Bashkëpunimi midis sektorit privat, publik dhe civil në këtë komunë tashmë ka rezultuar me disa projekte të miratuara dhe të zbatuara. Po ashtu, kooperativa e orientuar kah tregu dhe integrimi me organizatat e sektorit civil, me mbështetjen e blerësit kryesor dhe partnerit të projektit, kompanisë Sirogojno, ka pasur një rol të rëndësishëm në eksportimin e mjedrave nga e tërë zona. Plani është të zgjerohet prodhimi bujqësor me lloje tjera të drufrutorëve dhe perimeve dhe të arrihet punësim më i madh në këtë komunë. Bashkëpunimi dhe integrimi i sipërpërmendur i organizatave në komunën Rudo, paraqet një model zhvillimi të qëndrueshëm të zonave rurale në rajonin ndërkufitar "Drina -Tara", por po ashtu edhe në pjesët tjera të Ballkanit Perëndimor.

8. Kontaktet	Ana Ljubojevic, Sirogojno Company d.o.o, Sirogojno, Serbi ana.ljubojevic@sirogojno-company.com Nenad Ljubojevic, Kooperativa" Uvac – Rudo", Rudo, B&H pzuvacrudo@gmail.com Milos Bukva, Shoqata e prodhuesve të mjedrave "Malina", Rudo, B&H malinarirudo@gmail.com Svetlana Vukovic, Qendra për demokraci të përgjegjshme "COD Luna", Rudo, B&H, lunabih@teol.net

4. KONKLUZIONET DHE REKOMANDIMET

4.1 Konkluzionet

- ABD kontribuon në masë të madhe për ndërveprimet paqësore përmes bashkëpunimit rajonal dhe pajtimit midis kombësive dhe grupeve etnike të ndryshme që jetojnë dhe veprojnë në rajonet ndërkufitare.
- ABD arriti të promovojë pronësinë rajonale mbi procesin e zhvillimit në zonat ndërkufitare të BP-së, të lehtësojë krijimin e partneritetit dhe rrjetëzimit midis palëve të interesuara në të shtatë rajonet ndërkufitare të cilat kontribuuan në forcimin e bashkëpunimit rajonal.
- Prioritetet strategjike për zhvillimin ekonomik të rajoneve ndërkufitare të BP janë vënë në një vijë me procesin e integrimit në BE.
- Masat për ngritjen e kapaciteteve i kanë përmirësuar aftësitë dhe njohuritë e aktorëve dhe stafit që kanë të bëjnë me përgatitjen e projekt propozimeve, zhvillimin e planeve të biznesit, zhvillimin e zinxhirëve të vlerës dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore.
- Veprimet Njerëzit-për-Njerëzit në të gjitha rajonet ndërkufitare kontribuuan për promovimin e trashëgimisë kulturore, natyrore dhe traditës si dhe për bashkëpunimin dhe zhvillimin ekonomik të rajoneve ndërkufitare.
- ABDA kontribuoi për rritjen e qëndrueshme ekonomike përmes promovimit të parimeve të shfrytëzimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore, për integrimin e operatorëve të bizneseve të vogla në zinxhirin e vlerave dhe përmes investimeve për rritjen e cilësisë së prodhimeve cilësore lokale, tradicionale dhe shërbimeve turistike.
- PMU-të (Njësitë e menaxhimit te projektit) janë të mirë-vendosura dhe të njohura nga palët e interesuara si pikat qendrore për ndërmjetësi.
- SWG i bazoi aktivitetet e zbatuara me sukses, për të tërhequr interesin e donatorëve të ndryshëm për të investuar në rajonet ndërkufitare rurale dhe për të rritur rezultatet.
- Palët e interesuara kanë vullnet për të vazhduar bashkëpunimin në shkallë ndërkufitare dhe të kontribuojnë për procesin e ABD.
- Për këto rajone specifike nevojiten fonde plotësuese dhe vazhdim i procesit me qëllim vazhdimin e zhvillimit të tyre, rritjes së bashkëpunimit dhe zvogëlimit të shkallës së migrimit nga këto zona drejt BE dhe shteteve të tjera.

4.2 Rekomandimet

Përmirësimet e rregullimit institucional

- Duke marrë parasysh rolin drejtues, administrativ, organizativ të PMU-ve për lehtësimin e bashkëpunimit rajonal, rritja e numrit të stafit të kualifikuar së bashku me rritjen e mbështetjes financiare është i rëndësishëm për zbatimin e suksesshëm të qasjes ABD.
- Themelimi juridik i SWG-së në të gjitha vendet e BP do të mundësojë një komunikim më të mirë midis SWG-së dhe PMU-ve dhe do të ofrojë një ndërveprim më të mirë me autoritetet kombëtare dhe mundësi për t'u kualifikuar si aplikues dhe pjesëtar në mekanizmin IPA dhe mekanizma të tjerë mbështetës. Aktualisht, SWG është themeluar zyrtarisht vetëm në Republikën e Maqedonisë.

Përmirësimi i politikave

- Përveç dokumentit të Strategjisë indikative të shumë vendeve 2014-2020 (MCSP) dhe programeve IPA CBC për vendet e Ballkanit Perëndimor, nuk ekziston ndonjë kornizë tjetër strategjike që synon zonat ndërkufitare rurale. Qasja ABD duhet të merret në konsideratë në strategjitë e tjera të rëndësishme rajonale duke pasur parasysh qasjen e saj pjesëmarrëse, nga poshtë-lart, shumë aktorësh dhe shumë-sektoriale. Në mënyrë që të arrihet një ndryshim domethënës në zonat e përzgjedhura ndërkufitare, nevojitet përpilimi i të gjitha burimeve të financimit, në shumë raste të plotësuara me veprime rregullatore nga ana e shteteve pjesëmarrëse dhe autoriteteve lokale.
- Shtetet/territoret anëtare të SWG-së dhe Ministritë përgjegjëse për bujqësinë dhe zhvillimin rural në dokumentet e tyre kombëtare strategjike dhe të programeve duhet të marrin parasysh prioritetet e identifikuara për zhvillimin e zonave ndërkufitare rurale dhe duhet të planifikojnë alokimin e fondeve specifike për bashkëpunim, ngritje të kapaciteteve dhe investim në bizneset ndërkufitare dhe iniciativat për zhvillimin rural.

Fuqizimi i palëve të interesuara lokale

- Nevojiten investime të mëtejshme në zhvillimin e ofertave të integruara të produkteve me cilësi të lartë dhe shërbimeve turistike në rajonet ndërkufitare, si dhe promovimin e bashkëpunimit ndërmjet operatorëve ekonomik përmes krijimit të klasterëve/grupimeve dhe partneriteteve.
- Në zonat ndërkufitare duhet të planifikohen dhe zbatohen edhe më tej aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve në forcimin e zinxhirëve të shkurtër të vlerës për përmirësimin e cilësisë së produktit, veçanërisht të specialiteteve lokale dhe tradicionale, nëpërmjet inovacionit dhe zhvillimit të praktikave të përbashkëta.
- Palëve të interesuara duhet t'u ofrohen edhe më tej aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve në përcaktimin e prioriteteve të zhvillimit lokal/rajonal dhe përgatitjen e projekt propozimeve kualitative.

5. SHTOJCAT

5.1 Shtojca 1: Literatura e përdorur, referencat dhe kontaktet

Djordjevic – Milosevic Suzana, Sivric Ivica, Djimrevska Irena, Përgatitja për zbatimin e Qasjes zhvillimi me bazë territorin (ABD) në Ballkanin Perëndimor, Studimi Bazë dhe Plani Strategjik për zhvillimin e rajonit ndërkufitar "Krsh", Maj 2017;

Djordjevic – Milosevic Suzana, Markovic Predrag, Djimrevska Irena, Përgatitja për zbatimin e Qasjes zhvillimi me bazë territorin (ABD) në Ballkanin Perëndimor, Studimi Bazë dhe Plani Strategjik për zhvillimin e rajonit ndërkufitar "Pçinja-Krajishte", Maj 2017;

Djordjevic – Milosevic Suzana, Krivcevic Jelena, Guri Fatmir, Djimrevska Irena, Përgatitja për zbatimin e Qasjes zhvillimi me bazë territorin (ABD) në Ballkanin Perëndimor, Studimi Bazë dhe Plani Strategjik për zhvillimin e rajonit ndërkufitar "Prokletije-Bjeshket e Namuna", Maj 2017;

Fabien Santini, Silva Saravia Matus, Geertrui Louwagie, Gert Guri, Natalija Bogdanov, Sergio Gomez y Paloma, Lehtësimi dhe qasja zhvillimi me bazë territorin në rajonet rurale të shteteve të Ballkanit Perëndimor, Komisioni Evropian, Qendra e Përbashkët Kërkimore, qershor 2012.

Ilic Boban, Dzimrevska Irena, Qasja zhvillimi me bazë territorin në shtetet e Ballkanit Perëndimor – Një mjet për zhvillimin rural me potencial të rritjes së peshës nr.34 "Agjenda globale e Pas-2015 dhe e ardhmja e Mesdheut", CIHEAM, tetor 2015;

Instrumenti për Asistencë Para-Anëtarësimi (IPA II), Dokumenti i Strategjisë Indikative e shumë vendeve (2014-2020), qershor 2014;

Natalija Bogdanov, Aleksandra Nikolic - Përgatitja për zbatimin e Qasjes zhvillimi me bazë territorin (ABD) në Ballkanin Perëndimor, Studimi Bazë dhe Plani Strategjik për zhvillimin e rajoneve ndërkufitare, qershor 2012;

Zvonko Naumoski, Përgatitja për zbatimin e Qasjes zhvillimi me bazë territorin (ABD) në shtetet e Ballkanit Perëndimor, Studimi Bazë dhe Plani Strategjik për zhvillimin e rajonit ndërkufitar "Prespa", qershor 2012;

Zvonko Naumoski, Përgatitja për zbatimin e Qasjes zhvillimi me bazë territorin (ABD) në shtetet e Ballkanit Perëndimor, Studimi Bazë dhe Plani Strategjik për zhvillimin e rajonit ndërkufitar "Sharri", qershor 2012.

Kontaktet:

Zyra Qendrore e SWG/Sekretariati (Shkup, Maqedoni) - swgsecretariat@swg-seerural.org

- Boban Ilic - Sekretari i përgjithshëm i SWG - boban.ilic@swg-seerural.org
- Katerina Spasovska - SWG Menaxher i Lartë i Projektit - katerina.spasovska@swg-seerural.org
- Damjan Surlevski - SWG Menaxher Projekti - damjan.surlevski@swg-seerural.org

Zyra rajonale e SWG (Beograd, Serbi) - aleksandar.damnjanovic@swg-seerural.org

Njësia e SWG për menaxhimin e projektit për rajonin ndërkufitar "Drina-Tara" (Uzhicë, Serbi) - drina-tara@swg-seerural.org

Njësia e SWG për menaxhimin e projektit për rajonin ndërkufitar "Drina-Sava" (Brçko, Bosnjë dhe

Hercegovinë) - drina-sava@swg-seerural.org

Njësia e SWG për menaxhimin e projektit për rajonin ndërkufitar "Prespa" (Korçë, Shqipëri) - prespa@swg-seerural.org

Njësia e SWG për menaxhimin e projektit për rajonin ndërkufitar "Sharri" (Prizren, Kosovë*) - sharra@swg-seerural.org

Lidhje

http://seerural.org/
http://sharra.seerural.org/
http://prespa.seerural.org/
http://drina-tara.seerural.org/
http://drina-sava.seerural.org/

Shtojca 2: Harta e rajoneve ndërkufitare ABD

ABDA cross-border regions

"Drina – Tara"
(Bosnia and Herzegovina, Serbia and Montenegro)

"Drina – Sava"
(Bosnia and Herzegovina, Croatia and Serbia)

"Sharra"
(Albania, Macedonia and Kosovo*)

"Prespa"
(Albania and Macedonia)

"Prokletije – Bjeshket e Nemuna"
(Albania, Kosovo* and Montenegro)

"Pcinja - Krajishte"
(Macedonia, Bulgaria and Serbia)

"Neretva - Krsh"
(Croatia, Bosnia and Herzegovina and Montenegro)

*This designation is without prejudice to positions on status, and is in line with UNSCR 1244 and the ICJ Opinion on the Kosovo declaration of independence

ISBN: 978-608-4760-25-2

Published by:
Regional Rural Development Standing Working Group in SEE (SWG)
Blvd. Goce Delcev 18,
MRTV Building, 12th Floor,
1000 Skopje
Macedonia